

OMBUDSPERSON

**Raporti i Pestë Vjetor**  
**2004 – 2005**



Institucioni i  
Ombudspersonit  
në Kosovë





INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

# RAPORTI I PESTË VJETOR

2004 – 2005

Telefoni: ++381 38 545 303

Telefaksi: ++381 38 545 302

e-mail: [ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)

web faqja: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org)

**Publikuar nga:**  
Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë

Ombudspersoni falënderon punonjësit e Institucionit dhe të gjithë personat e përfshirë për kontributin e tyre në realizimin e këtij Raporti Vjetor.

**Falënderim i posaçëm i shprehet:**

znj. Alice Thomas, Këshilltare Ndërkombëtare e Drejtorit të Hetimeve  
znj. Antonella Ingravallo, Ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv  
znj. Katalin Mester, Këshilltare Ndërkombëtare për Media dhe Marrëdhënie me Publik  
znj. Katharina Wehrstein, Praktikante  
z. Lirak Hamiti, Përkthyes i Lartë  
z. Alban Stafai, Përkthyes i Lartë  
z. Isak Skenderi, Përkthyes  
z. George Kaurin, Përkthyes  
z. Vuk Stefanović, Përkthyes

Falënderim i posaçëm gjithashtu i shprehet edhe punonjësve të administratës për mbështetjen e tyre të rëndësishme.

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë dëshiron t'i falënderohet Qeverisë së Norvegjisë për zemërgjerësinë e saj, që e mundësoi financimin e publikimit të Raportit Vjetor përmes një subvencionit special.

**Përpunimi kompjutorik:**  
XHAD studio

**Fotografitë:**  
Arkiva e Institucionit

**Shtypi:**  
Shtypshkronja "Iliri"-Prishtinë

2005, Prishtinë

## **PËRMBAJTJA:**

PARATHËNIE.....	7
HYRJE.....	10
FAKTET LIDHUR ME INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT.....	10
Prezantim i Institucionit të Ombudspersonit.....	10
Ombudspersoni.....	12
Zëvendësit e Ombudspersonit.....	12
Qasja në Institucionin e Ombudspersonit.....	13
ASPEKTE TË CAKTUARA TË SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË.....	17
Aspektet e përgjithshme.....	17
Zhvillimet në sektorin ligjor.....	18
Gjyqësori në Kosovë.....	24
Papërshtatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe roli i Ombudspersonit.....	30
Situata e komuniteteve minoritare në Kosovë.....	36
Situata e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.....	44
dhe perspektivat për kthimin e tyre.....	44
Personat e pagjetur.....	50
Kthimet me forcë.....	52
Të drejtat pronësore.....	55
Efektet negative të nivelit ende të pamjaftueshëm të bashkëpunimit mes UNMIK-ut dhe qeverisë së Serbisë.....	57
AKTIVITETET DHE VEPRIMET E INSTITUCIONIT TE OMBUDSPERSONIT.....	59
Aktivitetet kryesore.....	59
Grupi për të Drejtat e Fëmijëve.....	63
Grupi për mos-diskriminim.....	64
Njësia për barazi gjinore.....	65
Ndërmjetësimi.....	66
Bashkëpunimi me Institucionet tjera të.....	67
Ombudspersonit dhe organet e ngjashme.....	67
Përmbledhja e rasteve.....	68
Përkrahja financiare dhe në të mira.....	70
Perspektivat e ardhshme për Institucionin e Ombudspersonit.....	71
ANEKSI 1: PËRMBLEDHJE STATISTIKORE E RASTEVE.....	74
ANEKSI 2: MASAT E PËRKOHSHME DHE KËRKESA TË TJERA PËR VEPRIME URGJENTE.....	76
ANEKSI 3: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE.....	87
ANEKSI 4: PËRMBLEDHJE E LETRAVE TË PËRZGJEDHURA.....	113
ANEKSI 5. SKEMA ORGANIZATIVE E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT ...	165
ANEKSI 6: LISTA E PUNONJËSVE.....	167
ANEKSI 7: LISTA E SHKURTESAVE.....	169



Zyra Qendrore e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë

## PARATHËNIE

Ky është raporti i pestë vjetor që po ia dorëzoi Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në Kosovë.

Sipas të gjitha gjasave, ky është raporti i fundit i tillë që do ta kem kënaqësinë ta prezantoj. Edicioni i ardhshëm i tij do të jetë detyrë e rëndësishme e pasuesit tim.

Është e qartë për të gjithë në Kosovë dhe jashtë saj që periudha e mbuluar me këtë raport do të duhej të jetë dhe është me rëndësinë më të madhe për Kosovën. Përkundër zgjidhjeve të miratuara politike, e ardhmja e Kosovës do të duhej të jetë në Evropë, duke respektuar standardet evropiane për demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe, posaçërisht në kontekstin e Kosovës, të drejtat e pakicave.

Ende ka shumë punë para komuniteteve të Kosovës dhe udhëheqësve të tyre për ta bërë vendin një shtëpi për të gjithë që jetojnë këtu apo kanë ndërmend të kthehen pas shumë viteve të mërgimit.

Në këtë periudhë të vlerësimit të standardeve, disa nga standardet prioritare dhe çështjet në lidhje me to, posaçërisht nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, janë në të njëjtën kohë shumë të pranishme në agjendën e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe janë nën juridiksionin e Ombudspersonit. Në një situatë të tillë, edhe nëse Ombudspersoni nuk është i përfshirë zyrtarisht në vlerësimin e standardeve, detyra ime do të duhej të jetë që të ndaj me PSSP-në dhe publikun mendimet dhe përfundimet e mia lidhur me së paku disa aspekte të situatës dhe të arriturat e fundit apo mungesën e tyre në atë drejtim, si dhe lidhur me probleme serioze të vazhdueshme, ashtu si shihen nga perspektiva e veçantë e Ombudspersonit.

Është natyrë e punës së Ombudspersonit që secilën ditë të bëjë një vlerësim jozyrtar të standardeve të vërteta në Kosovë – jo të “Standardeve për Kosovën” që janë politike dhe të cilave bashkësia ndërkombëtare shpesh herë u referohet si “pika referente”. Këto Standarde politike janë kriteret e caktuara nga faktorët ndërkombëtarë për njerëzit dhe qeverinë e Kosovës për t’i përmbushur ose për të treguar përparim të shënuar, duke hapur rrugën përmes kësaj që të fillohen bisedat për “statusin” që kanë për qëllim vendosjen e të ardhmes së vendit.

Në vend të kësaj, standardet e Ombudspersonit janë disi të pavarura nga fushatat e promovimit të Standardeve politike. Ato janë standarde në kuptimin më themelor. Niveli i suksesit apo dështimit lidhur me to shihet në masë të madhe në përvojat e përditshme të njerëzve të rëndomtë gjatë ndërveprimeve të tyre personale me autoritetet dhe institucionet publike të vetë atyre, si dhe në fqinjësi së tyre. Me fjalë tjera, jemi duke folur për jetën e përditshme dhe si ajo duket në Kosovë.

Edhe pse në një masë më të vogël se më parë, tensionet etnike ende kontribuojnë për një situatë shumë reale të rrezikut në Kosovë, që keqësohet edhe më tej përmes mungesës së perceptuar të sigurisë në mesin e joshqiptarëve të cenueshëm. Gjatë gjashtë viteve të fun-



dit, serbët dhe joshqiptarët tjerë kosovarë janë mbështetur në masë të madhe në mbrojtjen ushtarake të KFOR-it për t'u ndier të sigurt. Të kuptohet pse dhe si ka ndodhur kjo është thelbësore. Kjo ka rëndësi të veçantë kur të kujtohet që paqeruajtësit do të jenë në Kosovë vetëm për një periudhë të kufizuar kohore. Po pas kësaj...?

Ndjenja e vazhdueshme e pasigurisë në mesin e serbëve dhe joshqiptarëve tjerë kosovarë është e bazuar në përvojat e kaluara negative të dhunës. Sa mund të pritët të ndihen njerëzit të sigurt në enklavat e tyre fshatra nëse gjatë gjashtë viteve të fundit kanë pësuar nga një seri e akteve të dhunës? Përveç vrasjeve josistematike, ka pasur sulme, vendosje eksplozivash, vjedhje dhe incidente të zjarrvënies dhe hedhjes së gurëve. Pothuajse në asnjë nga rastet nuk janë gjetur dhe sjellë para drejtësisë kryerësit e këtyre veprave, gjë që forcon bindjen që këto vepra mund të kryhen me pandëshkueshmëri.

Shumë vëmendje është përqendruar në angazhimin dhe sukseset e paraqitura të qeverisë në arritjen e përparimit të shënuar në procesin e Standardeve politike. Një shembull për të cilin është folur shumë është rindërtimi i shtëpive të shkatërruara gjatë dhunës së marsit të vitit 2004, që i detyroi përafërsisht 4000 joshqiptarë që të largohen nga shtëpitë e tyre. Më shumë se një vit pas kësaj, përafërsisht 1500 njerëz janë ende të zhvendosur. Megjithatë, një pyetje nuk mund të mos shtrohet: A do të thotë kjo që rindërtimi i këtyre shtëpive do ta garantojë edhe rindërtimin e këtyre komuniteteve?

Nëse nuk krijohen kushtet themelore për “rindërtimin e jetës”, e jo vetëm rindërtimin e shtëpive, atëherë është e qartë që angazhimet lidhur me rindërtimin nuk do t'i shërbejnë qëllimit të deklaruar, përkatësisht që të sigurohen komunitetet e prekura me dhunën e marsit që janë të mirëpritura dhe që këtu kanë vend edhe për një kohë të pacaktuar.

Duke marrë parasysh këto rrethana, është e rëndësishë më të madhe që të kihet një qasje e shumanshme ndaj rindërtimit të jetës duke ia garantuar secilit kushtet themelore për një të ardhme të lirë dhe të papenguar në Kosovë. Jeta nuk mund të degradohet në një mbi-jetesë të thjeshtë.

Edhe pse situata e të drejtave të njeriut është përmirësuar deri në një masë në disa fusha të caktuara, me duhet t'i përsëris përfundimet e mia nga raporti i kaluar vjetor që niveli i përgjithshëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut është ende nën nivelin minimal të standardeve ndërkombëtare. Duhet bërë shumë për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes së tillë. Parlamentarët e Këshillit të Evropës propozuan dhe më vonë miratuan një listë të gjerë të rekomandimeve për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, të cilat jam përpjekur t'i ndaj me shumë udhëheqës të saj. Në fakt, propozimet do të ndihmojnë në ndërtimin e një infrastrukture të fortë të të drejtave të njeriut – diçka që të gjithë faktorët në Kosovë e konsiderojnë të jetë shumë e nevojshme dhe që nuk ishte arritur me vite të administrimit të Kosovës nga ana e Kombeve të Bashkuara.

Institucioni i Ombudspersoni i përgjigjet nevojave të situatës dhe është qenësor forcimi i kapacitetit të tij për të qenë në gjendje t'i ndihmojë këta njerëz. Gjatë këtij viti, Ombudspersoni themeloi entitete të reja për t'u marrë me çështjet e diskriminimit, të drejtat e fëmijëve dhe çështjet gjinore. Përveç kësaj, zyrat rajonale të Institucionit janë zgjeruar në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë komuniteteve të Kosovës nëpër tërë rajonin.

Si pasojë e të qenit në hap me bartjen graduale të pushtetit në Kosovë, Institucioni i Ombudspersoni gjithnjë e më shumë punon me rastet që kanë të bëjnë me entitetet qeveritare



vendore. Sido që të jetë, si pjesë e normave demokratike në zhvillim e sipër, është për t'u pritur që raportet mes Ombudspersoni dhe organeve qeveritare vendore të jenë të vështira dhe të tendosura, së paku në këtë fazë.


Të kuptuarit e drejtë të organeve të tilla si Institucioni i Ombudspersonit nga ana e udhëheqësve politik, qeverisë dhe njerëzve në mjedisin modern demokratik duhet të konsiderohet si parakusht për ta mirëmbajtur dhe zhvilluar rolin e Institucionit – me fjalë tjera, të kuptuarit e drejtë të të drejtave të posaçme të Institucionit dhe rëndësia e tij si një mjet i veçantë dhe i fuqishëm në dispozicion të publikut për ta mbikëqyrur autoritetin ekzekutiv. Megjithatë, e konsideroj që për një periudhë të caktuar kohore, vetëm një Ombudsperson ndërkombëtar do të mund ta garantonte funksionimin e duhur që mbulon si strukturat qeveritare ndërkombëtare, ashtu edhe ato vendore, duke pasur në të njëjtën kohë konsideratën e duhur ndaj interesave të të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë.

Ky raport është, në fakt, fillimi i lamtumirës sime me Kosovën. Në periudhën e afërt kohore, angazhimi im do të përqendrohet në masë të madhe në përgatitjen e kornizës për një fazë tjetër të re të Institucionit “pa mua”.

Pesë vitet e fundit si Ombudspersoni e kanë forcuar raportin tim me këtë vend dhe këta njerëz. Kam qenë në dijeni për të fshehtat e tij më intime dhe problemet e qarta, duke pasur në të njëjtën kohë privilegjin e dalluar të takoj një numër të madh të njerëzve që jetojnë këtu si dhe të atyre që janë detyruar të shkojnë diku tjetër.

Puna ime këtu ka pasur gjithnjë për qëllim të mirën e popullatës së përgjithshme dhe ndihmën për strukturat qeveritare. Edhe nëse përfundimet e mia kanë qenë mjaft të ashpra, duhet që megjithatë të kihet parasysh që këto përfundime vijnë prapë se prapë nga një mik i përhershëm i Kosovës dhe popullit të saj.

**Marek Antoni Nowicki**  
**Ombudspersoni në Kosovë**  
**Korrik 2005**



# HYRJE

Ky Raport vjetor është publikuar në pajtim me Nenin 17.1 të Rregullores Nr. 2000/38 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, dhe Rregullën 22.1 të Rregullave procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Raporti i pestë vjetor mbulon vitin e katërt të plotë të veprimeve të Ombudspersonit, nga 1 korriku 2004 deri më 30 qershor 2005. Ai ka tri pjesë kryesore. Pjesa e parë është një prezantim i Institucionit të Ombudspersonit, punonjësve të tij dhe punës së tij. Pjesa e dytë përbën një analizë të shkurtë të aspekteve të caktuara të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nga këndvështrimi i Ombudspersonit, kurse e treta ofron informacione rreth aktiviteteve dhe veprimeve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet

## FAKTET LIDHUR ME INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT

### *Prezantim i Institucionit të Ombudspersonit*

I themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38, Institucioni i Ombudspersonit është një institucion i pavarur, roli i të cilit është që të shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autorizimeve nga administrata e përkohshme civile apo të çdo institucioni qendror ose lokal që do të krijohet. Institucioni i Ombudspersonit është hapur zyrtarisht më 21 nëntor 2000 dhe përbëhet nga Ombudspersoni, dy zëvendësit e tij vendor, juristët për të drejtat e njeriut dhe punonjësit përkrahës administrativ. Që nga fillimi më i hershëm, struktura e punonjësve të Institucionit të Ombudspersonit ka qenë shumetnike – shumica e punonjësve është e përkatësisë etnike shqiptare, kurse pjesa tjetër janë të përkatësisë serbe, turke dhe rome.

Institucioni i Ombudspersonit pranon ankesa nga çdo person që beson të ketë qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut apo keqpërdorimit të autorizimeve dhe zhvillon hetimet mbi këto ankesa. Gjuhët zyrtare të punës në Institucion janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze. Institucioni do të përpiqet që t'u ofrojë ankuesve shërbimet në gjuhën e tyre edhe nëse kjo gjuhë nuk është një nga ato të lartpërmendurat. Përmes punës së tij, Institucioni ndihmon në promovimin e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë në Kosovë dhe jep kontribut që administrata të bëhet transparente dhe e hapur ndaj qytetarëve. Shërbimet e ofruara nga ana e Institucionit të Ombudspersonit janë falas.

Nëse informohet rreth një situatë ose veprimi që mund të ketë përfshirë një shkelje të të drejtave të njeriut, Ombudspersoni mund të hapë hetimet edhe në mungesë të ankesës

individuale (të ashtuquajturat “hetime *ex officio* apo hetimet sipas detyrës zyrtare). Kompetencat e Ombudspersonit gjithashtu përfshijnë mbikëqyrjen e veprimeve dhe ligjeve të aprovuara nga ana e autoriteteve për të siguruar që ato i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe kërkesat e qeverisjes së mirë. Me rastin e pranimit të një ankese ose nëse bindet që një situatë e caktuar kërkon veprim të menjëhershëm, Ombudspersoni fillon letërkëmbimin me autoritetet publike përkatëse që janë objekt i ankesës apo informatave që janë pranuar. Nëse problemi në fjalë nuk kërkon ndërmjetësim ose nuk mund të zgjidhet në mënyrë shoqërore, Ombudspersoni do të nxjerrë raportin pas hetimeve, në të cilin analizon nëse kishte pasur shkelje të të drejtave të njeriut të personave të ndikuar nga ai problem. Në rast se ka pasur shkelje të tillë, raporti i Ombudspersonit gjithashtu do të përmbajë rekomandimet e tij drejtuar PSSP-së si autoritet më i lartë civil në Kosovë, në të cilat do përshkruhet mënyra si të garantohet që në të ardhmen të garantohet pajtimi me të drejtat e njeriut. Në rastet kur Ombudspersoni konsideron që një praktikë ose situatë e përgjithshme ndikon jo vetëm në një individ ose një grup të tyre por në tërë qytetarët si tërësi dhe në të njëjtën kohë nuk është na pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ai do të nxjerrë të ashtuquajturin Raport Special, i cili gjithashtu do të përfshijë rekomandimet drejtuar PSSP-së.

Juridiksioni i Ombudspersonit është i kufizuar vetëm për Kosovë, që do të thotë që ai mund të hapë hetimet, të nxjerrë raportet apo të ndërmarrë hapa të tjerë vetëm në lidhje me sjelljen e autoriteteve publike në Kosovë. Në rastet që kanë të bëjnë me ankesat e kosovarëve drejtuar autoriteteve publike jashtë Kosovës, Ombudspersoni mund të ofrojë shërbimet e tij të mira dhe/ose mund t'i përcjellë ato raste te Ombudsmani kompetent vendor ose ndonjë institucion tjetër i natyrës së njëjtë në shtetin përkatës.

Gjithashtu, Ombudspersoni nuk zëvendëson gjykatën dhe nuk mundet që në mënyrë të drejtpërdrejtë të hetojë krimet, ndryshojë aktvendimet e gjykatës apo të lëshojë vendime detyruese. Ombudspersoni nuk merret me kontestet mes administratës ndërkombëtare dhe punonjësve të saj apo me kontestet mes personave privatë. Ai nuk ka juridiksion mbi KFOR-in.

Rastet në të cilat kërkohet reagim i menjëhershëm janë të quajtura “rastet për reagim” (Rastet CR) dhe zakonisht regjistrohen dhe arkivohen ndaras nga shkresat e rregullta të lëndëve që hetohen. Në raste të tilla, është më e rëndësishme që të intervenohet se sa të hapen hetimet në pajtim me procedurën e rëndomtë, edhe pse këto raste, në një fazë të mëvonshme, mund të bëhen raste të rregullta që hetohen dhe me këtë rast i nënshtrohen procedurës së rregullt.

Duke marrë në konsideratë lëndueshmërinë e grupeve të caktuara të njerëzve, në veçanti fëmijëve, si dhe personave që vuajnë nga trajtimi diskriminues në përgjithësi dhe diskriminimi në bazë të gjinisë në veçanti, Ombudspersoni ka nisur projektet speciale qysh prej periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, për të ndihmuar këta njerëz, respektivisht Grupin për të Drejtat e Fëmijëve, Grupin kundër Diskriminimit dhe Njësinë për Barazi Gjinore, brenda Departamentit të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit. Juristët

që punojnë në këto grupe dhe njësi janë të specializuar në subjektin e çështjeve të sipërpërmendura.

## ***Ombudspersoni***

Ombudspersoni i tanishëm, z. Marek Antoni Nowicki, u emërua Ombudsperson në Kosovë më 11 korrik 2000, nga ana e z. Bernard Kouchner, PSSP në atë kohë, në pajtim me rekomandimin e Kryesuesit të radhës të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Më 11 korrik 2002, z. Michael Steiner, PSSP i dikurshëm, e vazhdoi mandatin e z. Nowicki si Ombudsperson në Kosovë edhe për dy vite tjera deri më 10 korrik 2004. Më 26 maj 2004, z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë, e vazhdoi mandatin e Ombudspersonit edhe për një vit, deri më 10 korrik 2005. Më 15 qershor 2005, z. Soren Jessen-Petersen, PSSP i tanishëm, vendosi ta vazhdojë mandatin e z. Nowicki deri më 31 dhjetor 2005.

Z. Nowicki ka lindur në vitin 1953 dhe është i nacionalitetit polak. Prej vitit 1987, është anëtar i Odës së Avokatëve të Polonisë. Ai ka një histori të gjatë të aktiviteteve për të drejtat e njeriut që filloi në vitin 1982, kur, gjatë periudhës së qeverisjes ushtarake në Poloni, veprroi si kolumnist i shtypit të rezistencës dhe bashkëpunëtor i lëvizjes “Solidarnosc”. Gjithashtu, në këtë kohë, z. Nowicki bashkë-themloi Komitetin e Helsinkit në Poloni. Gjatë periudhës mes 1990 – 1993, ai ishte anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (IHF) në Vjenë, kurse gjatë 1992 – 1993 ishte ushtrues i detyrës së kryetarit të këtij Fondacioni.

Gjatë periudhës mes viteve 1993 – 1999, z. Nowicki ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Njëkohësisht me pozitën e tij si Ombudsperson në Kosovë, ai është kryetar i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe anëtar i Rrjetit të Bashkimit Evropian të Ekspertëve të Pavarur për të Drejtat Themelore.

## ***Zëvendësit e Ombudspersonit***

Ombudspersoni ka dy zëvendës vendor, që e ndihmojnë në drejtimin e suksesshëm të punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe e zëvendësojnë në mungesë të tij. Ata janë z. Ljubinko Todorovic dhe z. Hilmi Jashari.

Z. Ljubinko Todorovic është lindur në vitin 1951 në Graçanicë. Ai është emëruar zëvendës i Ombudspersonit më 15 shtator 2000 nga ana e z. Bernard Kouchner, PSSP i dikurshëm. Posti i tij si zëvendës i Ombudspersonit është zgjatur disa herë, kurse herën e fundit më 14 mars 2004 nga ana e z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë.



*Zt. Ljubinko Todorović*



*Zt. Hilmi Jashari*

Z. Todorovic diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1981. Më 1991, ai dha provimin e judikaturës. Ai tashmë ka punuar në profesione të ndryshme. Mes tjerash, z. Todorovic ka qenë përfaqësues ligjor i një korporate, inspektor pune dhe avokat publik i vetëqeverisjes për komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu ka qenë sekretar i Bordit Ekzekutiv të Këshillit Komunal të Prishtinës, si dhe sekretar i Këshillit Komunal të Prishtinës.

Para vendosjes së Administratës Ndërkombëtare të UNMIK-ut në Kosovë, z. Todorovic ka punuar si drejtor në Qendrën Gjykatore në Prishtinë.

Z. Hilmi Jashari është lindur në vitin 1969 në Mazgit. Ai u emërua zëvendës i Ombudspersonit më 14 mars 2004 nga ana e z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë.

Z. Jashari diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1993 dhe filloi të punojë si sekretar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Obiliq. Pas vitit 1994, ishte i përfshirë në aktivitetet e shoqatave të ndryshme shqiptare nga jashtë vendit. Mes viteve 1996 – 1998, z. Jashari punoi si asistent ligjor në zyrën e një avokati në Prishtinë. Ai është duke punuar në Institucionin e Ombudspersonit prej fillimit të punës së tij në tetor të vitit 2000 dhe ka qenë drejtor i hetimeve prej korrikut të vitit 2001.

### ***Qasja në Institucionin e Ombudspersonit***

Qasja në Institucionin e Ombudspersonit ofrohet përmes zyrës së tij qendrore në Prishtinë dhe zyrave në terren në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe, prej shkurtit 2005, në Graçanicë. Zyrat në terren janë zakonisht të përbëra nga një ose dy juristë dhe një asistent ligjor/përkthyes. Zyra rajonale në Mitrovicë gjithashtu ka nën-zyrën e saj në pjesën veriore të qytetit.

Siç u përmend më lart, në shkurt të vitit 2005 u hap një zyre e re në Graçanicë, që ka për qëllim t'u ofrojë qasje më të lehtësuar në Institucionin e Ombudspersonit personave të shu-

mtë të bashkësive minoritare. Kjo zyrë filloi punën më 1 mars 2005 dhe u themelua falë një donacioni zemërgjerë nga Agjencia për Zhvillim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austrisë.

Derisa Institucioni i Ombudspersonit më herët ishte në përgjithësi i hapur për publikun gjatë tërë orarit të punës në ditët e javës, numri në rritje të vazhdueshme i aplikantëve e detyroi atë që ta riorganizojë punën e tij në mënyrë që të ruhet efikasiteti i Institucionit. Prej prillit të vitit 2005, u vendos orari i ri i pranimit të aplikantëve, i cili tani ua mundëson juristëve që në mënyrë efektive ta ndajnë kohën e tyre mes pranimit të aplikantëve dhe punës me rastet.

Zyra qendrore në Prishtinë tani është e hapur për publikun katër ditë në javë, respektivisht prej të hënës deri të enjten mes orës 10:00 dhe 14:00. Zyrat në terren pranojnë aplikantët dy herë në javë mes orës 10:00 dhe 14:00, respektivisht të hënën dhe të enjtën në Gjiilan, Pejë, Mitrovicë dhe Graçanicë. Zyra e terrenit në Prizren pranon aplikantët të hënën dhe të mërkurën. Natyrisht, aplikantët janë të mirëseardhur që në rastet urgjente të vijnë edhe jashtë orarit të pranimit të aplikantëve.

Juristët e zyrës qendrore dhe ata që punojnë në zyrat e terrenit rregullisht vizitojnë komunitet, enklavat, zonat në të cilat gjenden bashkësi të konsiderueshme etnike joshqiptare, si dhe burgjet dhe qendrat e paraburgimit në komunitet e rajoneve të tyre përkatëse. Orari i tyre është i rregulluar në atë mënyrë që çdo vend i tillë të vizitohet së paku një herë në muaj, kurse burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vizitohen çdo dy javë.

Zyra qendrore e Institucionit dhe Zyrat e terrenit rregullisht organizojnë të ashtuquajturën "Ditë e Hapur", që ua mundëson aplikantëve të takohen personalisht me Ombudspersonin ose zëvendësin e tij. Në zyrën qendrore në Prishtinë, Dita e Hapur organizohet çdo të enjte të dytë. Në Zyrat e terrenit në Gjiilan, Pejë Mitrovicë dhe Prizren, ajo organizohet një herë më muaj në rajonet e tyre përkatëse dhe në Gjakovë. Pas themelimit të Zyrës së re të terrenit në Graçanicë, Dita e parë e hapur është mbajtur atje në qershor të vitit 2005.

Në rajonet që mbulohen nga ana e Zyrave të terrenit të Institucionit, banorët informohen rreth datave të këtyre ditëve të hapura përmes listave që publikohen në ndërtesat e komunave të ndryshme, lajmërimeve në mediat lokale si dhe përmes datave që publikohen në prezantimin e Institucionit të Ombudspersonit në internet.

Ombudspersoni dhe zëvendësit e tij gjithashtu vizitojnë personalisht vende të ndryshme të Kosovës edhe në raste tjera. Në të njëjtën kohë, juristët e zyrës qendrore vizitojnë rregullisht vendet afër Prishtinës, siç janë Lipjani, Glligoci apo Podujeva, për t'u takuar me banorët e këtyre vendeve dhe për të mbledhur ankesat e tyre.

Komunikimi mes Ombudspersonit dhe kosovarëve që janë duke qëndruar përkohësisht në Serbi dhe në masë më të vogël në Mal të Zi vazhdon të përmirësohet përmes bashkëpunimit me Komisionarin e Serbisë për Refugjatë dhe përmes marrëveshjes së nënshkruar mes Ombudspersonit dhe Organizatës humanitare spanjolle "Movimento por la Paz, el Desarme y la Libertad (Lëvizja për Paqe, Çarmatosje dhe Liri – MPDL). Institucioni dhe MPDL rishtas

vazhduan marrëveshjen e nënshkruar gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, sipas të cilës MPDL u pajtua që të ndihmojë aplikantët në plotësimin e formularëve të ankesës dhe kontaktimin me Institucionin e Ombudspersonit. Në mirëmbajtjen e kontaktit me grupin e mësipërm ndihmojnë edhe Institucionet tjera të Ombudsmanëve si dhe organizatat që merren me personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV).

Duke marrë parasysh kufizimet në qasje të vendosura mbi personat e burgosur dhe të paraburgosur në Kosovë, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit vizitojnë rregullisht burgjet dhe qendrat e paraburgimit në mbarë Kosovën. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të burgjeve, ka vazhduar procesin e komunikimit të drejtpërdrejt me të burgosurit dhe të paraburgosurit përmes kutive postare speciale të vendosura në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë. Vetëm punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit kanë qasje në këto kuti dhe i zbrazin ato çdo dy ose tri javë. Shpesh herë ndodh që përmes këtyre kutive postare të burgosurit dhe të paraburgosurit ta bëjnë kontaktin e parë me juristët e Institucionit – letrat e postuara në kutitë postare zakonisht sjellin deri te takimi i parë, gjatë të cilit të burgosurit dhe të paraburgosurit në fjalë mund të informojnë juristët rreth situatës së tyre dhe rreth çfarëdo ankese apo kërkesë që mund ta kenë. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu informohet rreth kërkesave të të burgosurve dhe të paraburgosurve për ta parë një jurist të Institucionit përmes formularëve që i shpërndan administrata e qendrave të paraburgimit dhe burgjeve përkatëse. Kur një i burgosur apo i paraburgosur të mbushë një formular të tillë dhe ta shprehë dëshirën për ta kontaktuar Institucionin e Ombudspersonit, administrata kompetente ia përcjell këta formularë Institucionit dhe në atë qendër të paraburgimit apo burg dërgohet një jurist për t'u takuar me të paraburgosurin ose të burgosurin përkatës.

Një herë në muaj, një jurist i Institucionit të Ombudspersoni gjithashtu e viziton edhe Entin për Kujdesin Social në Shtime, ku është vendosur një kuti e posaçme postare për ta përmirësuar qasjen në Institucion.

Pas themelimit të Grupit për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) dhe Grupit për Mosdiskrimimin (GMD) gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, si dhe themelimit të Njesisë për Barazi Gjinore (NjBGj) gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, janë rritur përpjekjet për vetëdijesimin publik rreth këtyre grupeve, në veçanti sa i përket GDF-së dhe NjBGj-së.

Në mënyrë që të shpërndahen informatat rreth punës së këtyre grupeve nëpër Kosovë, si GDF ashtu edhe NjBGj bashkëpunojnë me OJQ-të, shkollat (në rastin e GDF-së) dhe organizatat tjera që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe barazinë gjinore dhe marrin pjesë në seminare dhe konferenca të ndryshme të organizuara në Kosovë dhe jashtë saj lidhur me këto çështje apo të tjera të përafërta. Në ngjarje të tilla janë shpërndarë fletushkat e botuara dhe të dy grupet planifikojnë të publikojnë edhe pllakatet. Në të dy rastet janë filluar fushatat e rritjes së njohurisë së publikut për GDF-në dhe NjBGj-në, duke i informuar ata për punën e këtyre grupeve. Dy organizatat që kanë bashkëpunuar ngushtë me këto dy grupe dhe u kanë ofruar përkrahjen dhe ndihmën shumë të vlefshme janë UNICEF-i,

respektivisht UNIFEM-i.

Në rastin e NjBGJ-së, për shkak të temës shpesh herë të ndjeshme të lëndëve, fushata planifikohet të realizohet përmes OJQ-ve që punojnë në këtë fushë. Nëse këtë e lejon buxheti, Institucioni planifikon që në të ardhmen ta punësojë një psikolog për të ju ndihmuar ankuesve dhe juristëve në rastet e tilla.

Fushata për rritjen e njohurisë së publikut mbi GDF-në, e lajmëruar në disa gazeta të përditshme në Kosovë në qershor të vitit 2005, është e drejtuar kryesisht në shkolla, duke kërkuar nga to hollësi të caktuara lidhur me lokalet e tyre dhe numrin e nxënësve. Pasi që të ketë pranuar këto informacione, GDF planifikon të vizitojë shkollat apo të thërrasë klasat për ta vizituar Institucionin për t'i informuar fëmijët lidhur me të drejtat e tyre. Një pjesë e prezantimit të Institucionit në internet do të jetë i dedikuar për të drejtat e fëmijëve dhe planifikohet që informacionet mbi GDF-në të përfshihen edhe në programet televizive lidhur me çështjet në këtë fushë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka pasur përpjekje të shtuara për ta informuar publikun për punën e Institucionit të Ombudspersonit. "Informatori Periodik", që është prezantuar në fund të periudhës së kaluar për të cilën është raportuar për të informuar publikun rreth ngjarjeve dhe rasteve të rëndësishme pranë Institucionit të Ombudspersonit, vazhdon të publikohet çdo tre muaj në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë dhe në gjuhën turke. Informatori ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për një njohuri më të gjerë publike në Kosovë dhe posaçërisht jashtë saj për punën e Institucionit të Ombudspersonit.

Gjithashtu, vazhdimisht është duke u përmirësuar dhe zgjeruar prezantimi i Institucionit të Ombudspersonit në internet. Prezantimi përmban informacione të përgjithshme mbi Institucionin si dhe versionet elektronike të të gjitha raporteve, letrave të rëndësishme dhe komunikatave për shtyp, si dhe informacione mbi aktivitetet tjera të Ombudspersonit.

Linja telefonike për raste urgjente në zyrën qendrore të Institucionit të Ombudspersonit që filloi të funksionojë gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, ka përmirësuar në masë të madhe qasjen në Institucionin e Ombudspersonit. Kjo linjë për raste urgjente është e lidhur drejtpërdrejt me zyrën kryesore të juristëve pa kaluar nëpër centralin telefonik të Institucionit të Ombudspersonit. Gjatë vitit të kaluar, përdorimi i linjës ka shënuar rritje të përhershme. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu është duke pranuar gjithnjë më shpesh ankesat përmes postës elektronike nga banorët e Kosovës dhe kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Ne fillim të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit pati mundësinë që për herë të parë ta informojë publikun për punën e tij përmes video klipëve. Me ndihmën e UNMIK-ut, video klipë të shkurta që përmbanin përshkrimin e shkurtër të punës së Institucionit dhe informacione kontakti, si dhe një prezantim të shkurtër nga vetë Ombudspersoni, u emetuan në terminin kryesor për gati një muaj në stacionet televizive më të mëdha në Kosovë dhe në Serbi. Kjo ishte përcjellë edhe me radio lajmërimi që vazhduan të emetohen rregullisht në shumë radio stacione të Kosovës gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet.



# ASPEKTE TË CAKTUARA TË SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

## *Aspektet e përgjithshme*

Çfarëdo diskutime rreth situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nuk do të ishin të plota nëse nuk kihen parasysh rrethanat e veçanta të kësaj shoqërie, e cila ende vuan nga pasojat e konfliktit të armatosur ndëretnik që përfundoi para gjashtë viteve.

Një nga efektet më të mëdha të këtij konflikti është fakti që raportet mes shumicës etnike shqiptare dhe grupeve të caktuara minoritare, posaçërisht serbëve dhe romëve, që ishin përkeqësuar një kohë të shkurtë para, gjatë dhe pas përfundimit të luftimeve, nuk janë përmirësuar shumë prej vitit 1999.

Për këtë ka shumë arsye. Një nga to është fakti që shumë persona janë ende të pagjetur nga të dy anët, kryesisht nga ajo shqiptare, kurse në të njëjtën kohë shumë kryerës të veprave penale të kryera gjatë dhe pas konfliktit ende nuk janë sjellë para drejtësisë. Problemi që shumë trauma të pësuar në të kaluarën nuk janë trajtuar as privatisht, as publikisht, shpesh herë duket të harrohet nga bashkësia ndërkombëtare në përpjekjet e saj për ta ndërtuar një Kosovë shumetnike.

Arsyet tjera janë më pak emocionale, por mund të shihen si efekte tipike anësore të një situatë pas konfliktit të armatosur – një mungesë e përgjithshme e pushtetit të fortë ekzekutiv dhe gjyqësor, korrupsioni i përhapur dhe krimi i organizuar duken të paraqiten deri në një masë në të gjitha shoqëritë kalimtare. Forcat ende të reja policore të Kosovës nuk janë në pozitë të ballafaqohen me një kriminalitet të tillë të fortë dhe përfshirës apo me një mospërfillje të një vëllimi të tillë ndaj ligjeve ekzistuese. Si rrjedhim Kosova vuan nga një paligjshmëri e përgjithshme që shtrin ndikimin në shumë fusha të ndryshme.

Megjithatë, ka shumë aspekte të përgjithshme në kontekstin e Kosovës që vlejné veçanërisht për situatën këtu. Fakti që statusi i Kosovës ende nuk është zgjidhur ka pasur deri më tani shumë pasoja, si ligjore ashtu edhe ekonomike, që sollën deri te një ekonomi pothuajse jo ekzistuese dhe si rrjedhim edhe deri te një nivel i lartë i papunësisë. Derisa Kosova, sipas moshës, ka një ndër popullsitë më të reja në Evropë, shumë nga këta të rinj nuk kanë ndonjë perspektivë, jo vetëm për shkak të ngecjes së ekonomisë por edhe për shkak të asaj që askush nuk e di kur do të marrë fund gjendja e papërcaktuar politike e Kosovës. Varfëri ka tej mase – sipas raportit të nxjerrë nga Banka Botërore në vitin 2004, 37% e popullsisë konsiderohen të të jenë duke jetuar në varfëri, kurse 15% të popullsisë konsiderohen të jenë duke jetuar në varfëri të skajshme.

Pasi që situata e të drejtave të njeriut në një shoqëri të caktuar është e lidhur patjetër me situatën e shoqërisë në përgjithësi, aspektet në vijim të të drejtave të njeriut do të duhej të lexohen duke pasur parasysh prapavijën sociale dhe politike të Kosovës së sotme. Në të njëjtën kohë, përzgjedhja në vijim e çështjeve të të drejtave të njeriut nuk pretendon të

jetë e plotë, por më shumë përqendrohet në ato aspekte që janë më të pranishme në jetën e përditshme të shumicës së njerëzve në Kosovë, si dhe në ato aspekte që janë subjekte të ankesave që i janë parashtruar Institucionit të Ombudspersonit.

### ***Zhvillimet në sektorin ligjor***

Në diskutimet publike rreth implementimit të standardeve, çështja e të drejtave të pakicave, lirisë së lëvizjes dhe kthimeve janë duke u shikuara tërë kohën nga kënde të ndryshme. Megjithatë, shumica e këtyre diskutimeve duket ta anashkalojnë pikën kryesore – respektivisht, që një sistem koherent dhe efikas i ligjeve dhe zbatimi i tyre i plotë dhe i drejtë është janë bazë e çdo shteti funksional. Nëse sistemi ligjor i Kosovës vazhdon të ngecë prapa standardeve ndërkombëtare në mënyrën në të cilën kjo ka ndodhur gjatë gjashtë viteve të fundit, duke e privuar me këtë rast tërë popullsinë nga disa të drejtat e tyre më themelore, atëherë bëhet i kotë çfarëdo diskutimi rreth kthimeve të qëndrueshme dhe pranimit të pakicave si pjesë e kësaj shoqërie.

Deri më tani, UNMIK-u dhe përfaqësuesit kompetentë të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes nuk i kanë kushtuar vëmendje sa duhet kritikës që i referohet “kaosit ekzistues ligjor” të përshkruar në Raportin e kaluar Vjetor, duke preferuar në vend të kësaj të përqendrohen në çështjet që gëzojnë më shumë debat publik, siç janë këto që u përmendë më lart. Duke bartur gjithnjë e më shumë të pushtetit të tij administrativ në pjesët përkatëse të IPVQ-ve, UNMIK-u ka gjithashtu ka bartur edhe shumë probleme të pazgjidhura dhe mangësi ligjore. Nëse vazhdon kjo praktikë, atëherë ajo do të shkaktojë probleme në vitet që po vijnë, pasi që baza ligjore në të cilën do të jetë e mbështetur Kosova do të jetë përplot zbrazëtira.

Çështja kryesore në këtë kontekst është ajo që tani gjashtë vite pas marrjes së nënkuptuar të pushtetit në dorë nga ana e UNMIK-ut, as gjykatësit kompetent, as ekzekutivi, qoftë ndërkombëtar ose vendor, nuk janë të sigurt cilat nga ligjet e vjetra të RSFJ-së janë ende të zbatueshme apo jo. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, ashtu si është e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, vendos që çdo gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i Rregulloreve të UNMIK-ut apo ligji në fuqi më 22 mars 1989, mirëpo është e mbuluar nga një ligj tjetër në fuqi pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj. Megjithatë, në në atë Rregullore nuk ofrohet sqarimi se cili organ është përgjegjës për ta përcaktuar nëse një ligj është diskriminues apo në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pasi që nuk ekziston ndonjë organ i pavarur gjyqësor të cilit do të mund t'i drejtoheshin lidhur me çështje të tilla, ato organe që i zbatojnë ligjet janë të lira që vetë të vendosin se cilin ligj do ta ndjekin,

duke krijuar kështu një situatë që e hap rrugën për një nivel të konsiderueshëm dhe të përhapur të arbitraritetit.

Njëkohësisht, ligjet momentalisht në fuqi në Serbi janë gjithashtu duke u zbatuar në ato zona që mbulohen me sistemin paralel të gjykatave. Kjo krijon një konfuzion të konsiderueshëm, në veçanti në mesin e pakicës serbe dhe rome, për shumicën e të cilëve sistemi paralel i Serbisë është i ligjshëm, e jo sistemi i themeluar nga UNMIK-u.

Derisa të gjitha ligjet e shpallura nga Kuvendi dhe të gjitha Rregulloret e UNMIK-ut përmbajnë një dispozitë përmbledhëse që thekson që ai ligj shfuqizon të gjitha ligjet tjera mbi të njëjtën çështje, nuk përmendet fare se cilat ligje nuk do të zbatohen më. Kjo mungesë e precizitetit kontribuon në masë të madhe në kaosin dhe konfuzionin e lartpërmendur në sistemin ligjor. Në kontekst të Kosovës, ku popullsia janë duke u prezantuar një valë e parimeve të reja dhe të panjohura ligjore Brenda një afati jashtëzakonisht të shkurtër kohor, dispozita të tilla të paqarta krijojnë shumë probleme shtesë, pasi që njerëzit “në terren” dhe ata të paramenduar të zbatojnë ligjet e reja e kanë shpesh herë të paqartë se çfarë të bëjnë lidhur me këtë. Ky problem nxiti Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës që ta ngrit atë në Rezolutën e saj 1417 të nxjerrë në janar të vitit 2005, në të cilën mes tjerash rekomandoi që Rregulloret e UNMIK-ut ta theksojnë qartë se cilat instrumente po i anulojnë apo ndryshojnë, nëse ky është rasti, dhe në çfarë mënyre po i ndryshojnë ato.

Njëkohësisht, UNMIK-u vazhdon të kontribuojë në situatën problematike ligjore duke u përpjekur, për shembull, që përmes dispozitave të përmbajtura në Udhëzimet Administrative të ndryshojë dispozita të caktuara të Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e shërbimeve komunale. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/49 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale Publike vetëm sa e lajmëron themelimin e këtij departamenti dhe e autorizon atë për nivelet, çmimet dhe shërbimet e rregullta të ofruesve të shërbimeve komunale publike në Kosovë, por nuk ndryshon periudhat e parashkrimit të përmbajtura në ligjin e RSFJ-së, në veçanti një dispozitë të caktuar sipas të cilës pas kalimit të një viti, është e parashkruar e drejta për të detyruar konsumatorët që të paguajnë borxhet për shërbimet komunale publike. Në vend të kësaj, kjo detyrë e krijimit të një ligji të ri i është ngarkuar Udhëzimit Administrativ nr. 2002/19 mbi Pagesën e borxheve për shërbimet e energjisë elektrike, që zbaton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/49, sipas të cilit të gjithë konsumatorët e shërbimeve të energjisë elektrike janë të detyruar që të paguajnë shumën e plotë të papaguar për shërbimet e tilla gjatë periudhës së borxhit, respektivisht prej 1 tetorit 1999 deri më 20 shtator 2002.

Derisa Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, ashtu si është e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, u jep Rregulloreve të UNMIK-ut të njëjtin status ligjor sikur ligjet e RSFJ-së në fuqi më 22 mars 1989, Udhëzimet Administrative përbëjnë “instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to” dhe sipas përcaktimit janë ligje dytësore. Prandaj, shikuar nga këndi ligjor, ato nuk kanë fuqinë për të ndryshuar apo zëvendësuar ligjet ekzistuese, që do të thotë që në këtë rast, dispozitat përkatëse të Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet janë ende në fuqi. Fakti që në këtë rast, nga

konsumatorët e energjisë elektrike momentalisht kërkohet të paguajnë më shumë se që duhet sipas ligjit ngrit çështje serioze lidhur me parimet themelore të sundimit të ligjit. Edhe pse ky problem është ngritur pranë UNMIK-ut në nëntor të vitit 2004, PSSP nuk u pajtua me këtë argument, duke deklaruar që Udhëzimi Administrativ nr. 2002/19 vetëm zbatonte Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/49, kështu që dispozitat e reja që përmbahen në të kishin fuqinë t'i zëvendësojnë dispozitat përkatëse të Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet.

Do të duhej të mirëpritet fakti që më 12 maj 2005, PSSP më në fund shpalli Ligjin mbi Gazetën Zyrtare, të miratuar paraprakisht nga Kuvendi. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Kosovës ka filluar të paraqesë ligjet e miratuara në prezantimin e tij në internet në të tri gjuhët zyrtare në Kosovë. Në maj të vitit 2004, ishte prezantuar një bazë e të dhënave, e themeluar nga Zyra e Kryeministrit në atë kohë, që përmbante një numër të madh të versioneve në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe të ligjeve në fuqi në Kosovë, mirëpo ajo nuk gëzoi shumë publicitet. Qasja në të është ende e mundshme vetëm për anëtarë të caktuar të cilët e dinë çfarë të kërkojnë, që është një fatkeqësi pasi që kjo bazë e të dhënave do të përmirësoonte në masë të madhe njohurinë e publikut lidhur me ligjet në fuqi në Kosovë, si dhe të drejtat dhe obligimet që përmbahen në to. Sipas informacioneve nga qershori i vitit 2005, baza e të dhënave do të prezantohej përsëri menjëherë pas themelimit të zyrës së re të teknologjisë së informatikës pranë Zyrës së Kryeministrit pasi që, deri më tani, mungesa e një eksperti të teknologjisë së informatikës i kishte pamundësuar punonjësit në atë zyrë që ta mirëmbajnë programin e bazës së të dhënave dhe ta përmirësojnë qasjen publike në të.

Përkundër përmirësimeve të mësipërme të mundësuar përmes teknologjisë moderne, do të nevojitet një kohë e konsiderueshme deri kur qasja në një nivel të mjaftueshëm në ligjet në fuqi do t'i ofrohet të gjitha pjesëve të publikut, posaçërisht personave që nuk kanë qasje në internet. Pasi që përkthimet me kualitet të pranueshëm në të tri gjuhët punuese në Kosovë, respektivisht më gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, janë ende tepër të ngadalshme (në disa raste, vetëm tani rishtas janë ofruar versionet e duhura në gjuhën shqipe dhe serbe të disa Rregulloreve të UNMIK-ut, në mesin e të cilave ka edhe të tilla nga viti 2001), pjesë të mëdha të popullsisë në Kosovë mbesin pa njohuri për përmbajtjen e ligjeve në fuqi. Problemi i mësipërm u njoh nga Asambleja Parlamentare të Këshillit të Evropës në Rezolutën e saj 1417, ku mes tjerash rekomandoi që UNMIK-u të garantojë që të gjitha instrumentet ligjore të publikohen dhe t'u shpërndahen në mënyrë të shpejtë dhe efikase të gjitha palëve të përfshira, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e teknologjisë së informatikës, bashkë me përkthimet të kualitetit të lartë në të njëjtën kohë në të gjitha gjuhët zyrtare.

Një problem që fatkeqësisht nuk ka ndryshuar, përveç përjashtimeve të caktuara prej periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, është mungesa e vazhdueshme e *vacatio legis* për të gjitha ligjet e Kuvendit apo Rregulloret e UNMIK-ut të nxjerra gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet. *Vacatio legis* është vonesa e caktuar mes shpalljes së ligjit dhe zbatimit të tij që është e paramenduar që t'i japë publikut dhe institucioneve që e zbatojnë ligjin rastin për t'u adaptuar dhe përgatitur për situatën e re ligjore. Nevoja për të garantuar periudhën e duhur *vacatio legis* për ligjet është një nga parimet kyçe të një shteti ku

sundon ligji.

Derisa në periudhën e fundit për të cilën është raportuar, një numër i kufizuar i ligjeve ka lejuar një periudhe të caktuar kalimtare, të gjitha ligje të shpallura gjatë vitit të kaluar kanë hyrë menjëherë në fuqi. Në disa raste, këto ligje të reja kanë efekt të drejtpërdrejtë praktik në të drejtat e grupeve të prekura të individëve, siç ishte rasti me Ligjin e ri mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 shtator 2004 dhe të shpallur nga PSSP më 19 nëntor 2004. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës gjithashtu e njohu rëndësinë e vacatio legis në Rezolutën 1417 të saj dhe kërkoi nga UNMIK-u që të lejojë një vacatio legis përkatës pas shpalljes së të gjitha instrumenteve ligjore.

Në situata të caktuara, ligjet e vjetra të RSFJ-së janë ende në fuqi pasi që ligje të reja nuk janë shpallur në ndërkohë, mirëpo ato injorohen në tërësi. Një shembull i kësaj është ligji që mundëson pensionet invalidore për invalidët e Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse ky ligj është ende në fuqi, invalidët e Luftës së Dytë Botërore ankohen që nuk kanë marrë pensionet e tyre prej vitit 1999. Në fillim të qershorit 2005, kjo çështje iu adresua Kryeministrit.

Një shembull tjetër ku së paku një pjesë e ligjit në fuqi nuk është duke u zbatuar është neni 180 i Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet, i cili cakton përgjegjësinë e shtetit për dëmin e krijuar nga vdekja ose për lëndimin trupor, si dhe për dëmin apo shkatërrimin e pronës private, të pësura për shkak të akteve të dhunës ose të terrorit, si dhe me rastin e demonstratave dhe manifestimeve publike. Edhe pse ende i zbatueshëm, pasi që vetëm pjesë të caktuara të ligjit ishin zëvendësuar me Rregullore të UNMIK-ut, nuk ka pasur përpjekje për ta zbatuar këtë nen. Një korrespondencë e shkurtër por intensive me UNMIK-ut lidhur me këtë temë e dëftoi qartas një mungesë të vullnetit për ta marrë në konsideratë këtë dispozitë ligjore. Kjo nuk është për t'u befusuar kur të merret parasysh fakti që ajo do ta hapte rrugën për një numër shtërmadh të kërkesave për kompensim, shumica e të cilave në lidhje me ngjarjet e dhunshme të marsit të vitit 2004. Megjithatë, në praktikë, imuniteti procedural i UNMIK-ut dhe punonjësve të tij edhe ashtu do ta parandalonte procedimin e një numri të madh të këtyre kërkesave.

Ligjet tjera në fuqi nuk injorohen edhe aq sa zbatohen në mënyrë selektive. Një shembull i kësaj janë ligjet mbi ndërtimin. Ka shumë ankesa lidhur me mënyrën arbitrare në të cilën autoritetet i zbatojnë këto ligje. Shpërthimi i përgjithshëm i ndërtimeve në tërë Kosovën – deri më tani 45 000 shembuj të ndërtimeve të paligjshme – fatkeqësisht, tepër shpesh zhvillohet në një mënyrë tërësisht të paligjshme, duke treguar një mospërfillje shqetësuese ndaj ligjeve ekzistuese. Komunat dhe gjykatat duket ta përkrahin këtë fenomen duke mos i ngacmuar shumë ndërtues të ndërtesave të paligjshme por duke i dënuar kohë pas kohe të tjerët të cilët nuk kanë as para, as fuqi të mjaftueshme për t'u mbrojtur.

Në disa fusha, nuk ka kurrfarë ligji që rregullon situata të caktuara. Për shembull, ende nuk ekziston kurrfarë ligji i përgjithshëm që ofron kompensim për viktimat e krimeve që kanë përfshirë dhunën. Kjo çështje iu referua Kryeministrit në atë kohë gjatë periudhës së

fundit për të cilën është raportuar, por nuk u pranua ndonjë përgjigje lidhur me të. Çështja u ngrit përsëri në rastin e një personi të përkatësisë etnike ashkali, shtëpia e të cilit ishte shkatërruar nga persona të maskuar një kohë të gjatë përfundimit të konfliktit të vitit 1999 dhe i cili nuk kishte mjete për ta rindërtuar shtëpinë e tij pasi që ende ishte duke e paguar kredinë në bankë që ia kishte mundësuar të pothuajse plotësisht ta rindërtojë shtëpinë e tij në vitin 1989. Në letrën që iu dërgua Kryeministrit dhe PSSP më 27 prill 2005 lidhur me këtë çështje ende nuk është pranuar kurrfarë përgjigje.

Një shembull tjetër i mungesës së ligjeve është fakti që ende nuk ka ndonjë ligj që ofron ndonjë mjet juridik lidhur me procedurën e stërzgatur gjyqësore. Kjo çështje u ngrit në të gjitha raportet e Ombudspersoni në të cilat erdhi deri te përfundimi që procedura të caktuar gjyqësore kishin zgjatur aq shumë sa për ta shkelur të drejtën e një personi që çështja i tij të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme. Edhe pse UNMIK-u vazhdimisht përgjigjet që kjo çështje është “duke u marrë në konsideratë në mënyrë aktive”, duket që deri më tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprime për ta përgatitur një ligj të tillë.

Edhe pse përgatitja dhe zbatimi i një ligji mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore të Kosovës është një nga standardet që bashkësia ndërkombëtare i ka caktuar për Kosovën, si dhe përkundër përpjekjeve që gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar t'i drejtohet vëmendja e Kryeministrit të mëparshëm ndaj këtij problemi, një ligj i tillë ende nuk ekziston. Mbetet të shihet nëse planet e Qeverisë që në shpejtësi të implementohen standardet do të zgjidhin këtë çështje në mënyrë të shpejtë dhe njëkohësisht të kënaqshme.

Gjatë periudhës së fundit për të cilën është raportuar, UNMIK-u, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse vendore ka premtuar që të përpilojë ligjet e caktuara lidhur me shëndetin mental dhe të përmirësojë lokalet për të pranuar personat me sëmundje psikike. Deri më datën e këtij raporti, ligji i premtuar as që është përpiluar, e jo më të shpallet. Kjo do të thotë që ky grup i personave është ende i pambrojtur në një mënyrë që do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ombudspersoni e ngriti këtë çështje në dy raporte të nxjerra në tetor të vitit 2004 dhe maj të vitit 2005, si dhe në një letër drejtuar Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi në prill të vitit 2005. Në fillim të qershorit të vitit 2005, Zëvendës PSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjigj në njërin nga raportet e Ombudspersonit dhe e informoi atë që Ministria e Shëndetësisë ishte e angazhuar bashkë me UNMIK-un për ta përgatitur një projektligj për shëndetin mendor, që kur njëherë të hynte në fuqi do të përgjigjej në mënyrë të hollësishme në shumicën nga brengat që Ombudspersoni i kishte shprehur në këtë drejtim.

Derisa një ligj mbi tubimet publike është në fuqi prej kohës së RSFJ-së, ai nuk merret në mënyrë adekuate me çështjen e garantimit të të drejtës për tubim. Ky ligj nuk përcakton parimet që qeverisin ushtrimin e kontrollit efektiv mbi tubimet publike dhe i mungon çfarëdo forme e ndonjë mjeti ligjor që do të ia mundësonte një personi të kontestojë mënyrën ose përmasat e një mase që kufizon të drejtën për lirinë e tubimit, duke pasur mangët me këtë rast kualitetin e kërkuar për ligje të tilla sipas standardeve ndërkombëtare

për të drejtat e njeriut. Ky problem u ngrit në një raport që Ombudspersoni e publikoi në qershor të vitit 2004. Në përgjigjen e tij, Zëvendës i atëhershëm i PSSP-së për Polici dhe Drejtësi nuk e ndau këtë mendim, kështu që momentalisht nuk ka plane për ta ndryshuar ligjin e lartpërmendur.

Në të njëjtën kohë, ende duhet të implementohen si duhet ato ligje të reja që janë shpallur përafërsisht gjatë vitit të kaluar. Disa shembuj për këto ligje, që deri në një masë të konsiderueshme kanë ekzistuar vetëm në letër, janë Ligji mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare i shpallur më 6 nëntor 2003, Ligji mbi Barazinë Gjinore i shpallur më 7 qershor 2004 dhe Ligji kundër Diskriminimit i shpallur në gusht të vitit 2004.

Edhe në rastet kur ligjet janë zbatuar, vështirësitë teknike parandaluan pjesë të caktuar të këtyre ligjeve që ta kenë efektin e dëshiruar në praktikë. Një shembull i kësaj është Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, e shpallur më 22 dhjetor 2001, e cila thekson që ankesat kundër vendimeve të marra nga autoritetet punëdhënëse publike mund të parashtrihen pranë një Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës. Ky Këshill u inaugurua zyrtarisht në nëntor të vitit 2004, tri vite pasi të ishte themeluar. Fatkeqësisht, ai ende nuk ka filluar të veprojë. Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil, Ministria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për përgatitjen e Rregullave Procedurale të Këshillit Mbikëqyrës. Ministria nuk ka përgatitur projekt propozimin e parë për Rregullat e tilla Procedurale deri në fillim të marsit të vitit 2005, kur këto Rregulla i janë përcjellë PSSP-së. Në fillim të qershorit të vitit 2005, zyra e PSSP-së ia ktheu Rregullat Procedurale Ministrisë me disa përmirësime të caktuara. Mbetet vetëm të shpresohet që tani procedura do të vazhdojë në këtë drejtim, ashtu që Këshilli Mbikëqyrës i Pavarur më në fund do të mund ta fillojë punën e tij.

Në Raportin e fundit Vjetor, një problem i ngritur kishte qenë fakti që kodet e reja penale të shpallura në mes të vitit 2004 nuk i kishin mbuluar të gjitha aspektet në fusha të caktuara që më parë kishin qenë të mbuluara me ligjet penale të RSFJ-së, në veçanti lidhur me vendosjen kryerëse të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar qenësisht nën mjekim të detyrueshëm psikiatrik. Ky problem tani është zgjidhur me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/34 mbi Procedurën Penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore. Në përgjithësi, pas vështirësive fillestare, gjykatësit në Kosovë tani janë adaptuar ndaj kodeve të reja penale dhe janë duke u diskutuar ndryshimet e nevojshme ashtu që së paku sa i përket çështjeve penale tani ka më shumë qartësi dhe siguri ligjore se sa në pjesën tjetër të sistemit ligjor.

Siç u përmend më herët, situata ligjore në Kosovë në shumë aspekte mbetet konfuze dhe në mospajtim me parimet themelore të sundimit të ligjit. UNMIK-u dhe IPVQ-të deri më tani kanë të kënaqura të përqendrohen vetëm në çështje të caktuara të zgjedhura, pa u marrë në mënyrë adekuate me problemet tjera themelore.

## **Gjyqësori në Kosovë**

Fatkeqësisht, situata problematike e gjyqësorit në Kosovë nuk është përmirësuar shumë prej nxjerrjes së Raportit të Katërt Vjetor në korrik të vitit 2004, edhe pse strukturat kompetente të UNMIK-ut janë bërë gjithnjë e më të vetëdijshme për problemet ekzistuese dhe janë duke kërkuar mënyra shtesë për të përmirësuar efikasitetin e administrimit të drejtësisë.

Gjyqësori ende nuk është plotësisht i pavarur në kuptimin e rëndomtë të fjalës, në veçanti sa i përket administrimit të gjykatave, që vazhdon të bëhet nga Departamenti i UNMIK-ut për Administrimin Gjyqësor, një organ ekzekutiv. Kështu, çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me lokalet e gjykatave dhe pagat, jo vetëm të punonjësve në gjykatë por në një masë edhe të gjykatësve, vazhdojnë të vendosen nga ana e ekzekutivit, që në këtë mënyrë vazhdon ta ushtrojë një ndikim të konsiderueshëm në aspektet praktike të punës së gjykatave.

Në të njëjtën kohë, derisa Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës (KGjPK) këshillon lidhur me emërimin dhe largimin nga detyra të gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë, prapë se prapë mbetet mbi PSSP-në që ta janë fjalën e fundit lidhur me atë se kush të emërohet dhe largohet. Njëkohësisht, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/7 mbi Emërimin dhe Largimin nga Detyra të Gjykatësve dhe Prokurorëve, ashtu si është e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/57, nuk ofron ndonjë afat të caktuar kohor për kohëzgjatjen e emërimit për gjykatësit, që gjithashtu ngrit çështje të caktuara lidhur me pavarësinë e gjykatësve.

Një problem tjetër që vazhdon ta rrezikojë pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor në Kosovë është niveli shumë i vogël i pagave për gjykatësit dhe prokurorët vendorë, pasi që kjo e bën të vështirë që ata t'u rezistojnë formave të ndryshme të presionit që e ushtrojnë palët në procedurë dhe të tjerët që janë të interesuar për vendimet lidhur me raste të caktuara. Numri i rasteve kur personat tani ankohen për gjykatësit e korruptuar në Kosovë është alarmant sa duhet për ta konsideruar këtë çështje si një problem serioz

Në anën tjetër, sa i përket gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, nuk ka shumë ankesa lidhur me arbitraritetin apo korrupsionin e tyre. Sido që të jetë, mungesa e mbikëqyrjes të KGjPK-së dhe Njësisë së Inspeksionit Gjyqësor të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut duket të jetë një shkak për t'u brengosur, pasi që kjo nënkupton që qytetarët e Kosovës nuk kanë ndonjë mjet apo rrugë juridike drejt një organi rregullues që do të hetonte dhe gjykonte pohimet për sjelljen e keqe profesionale në lidhje me gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë. Derisa Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/6 mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë, ashtu si është e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/34, qartas thekson që gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë mund të shkarkohen nga detyra për arsye të sjelljes shumë të keqe, dështimit në kryerjen e detyrës dhe/ose vënies së tij, për arsye të sjelljes personale ose ndonjë shkak tjetër, në pozitë e cila është e papajtueshme me



kryerjen e duhur të detyrës, nuk ekziston kurrfarë organi për të zhvilluar hetimet mbi pohimet për një sjellje të tillë të keqe dhe, si rrjedhim, nuk ekziston kurrfarë organi që do të mund të vlerësonte nëse janë plotësuar kushtet për ta shkarkuar një gjykatës ose prokuror ndërkombëtar nga detyra e tij. Ky është vetëm një shembull i mungesës së mekanizmave ligjor në Kosovë sa i përket sjelljes së punonjësve ndërkombëtarë që punojnë për UNMIK-un apo organet lidhur me të. Në një letër drejtuar Ombudspersonit në shkurt të vitit 2005, Drejtori i Departamenti të Drejtësisë pranë UNMIK-ut e siguroi Ombudspersonin që departamenti i tij ishte duke e marrë në konsideratë themelimin e një organi të tillë rregullator. Shpresohet që një organ i tillë do të themelohet së shpejti dhe ta plotësojë zbrazëtirën momentale lidhur me përgjegjësinë.

Shumë gjykata në tërë Kosovën vazhdojnë të vuajnë nga ngarkesa gjithnjë në rritje me raste derisa numri i gjykatësve vazhdon të jetë jo proporcionalisht i vogël. Kjo nuk vlen për të gjitha gjykatat – gjatë bisedave me kryetarët e gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë, disa nga ta theksuan që nuk kishin raste sa duhet për të punuar kurse të tjerët dukej të vuajnë nga problemi i kundërt. Një aspekt pozitiv i kësaj çështje është fakti që gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, procedimi i rasteve administrative pranë Gjykatës Supreme të Kosovës është përmirësuar dukshëm në krahasim me të kaluarën.

Një nga pasojat e mungesë së gjykatësve në gjykata të caktuara është fakti që kur një gjykatë e qarkut e kthen një rast për rishqyrtim pranë ndonjë gjykate komunale, rasti shpesh herë rishqyrtohet nga i njëjti kolegji i gjykatësve që e ka nxjerrë fillimisht vendimin e kontestuar. Kjo ngrit probleme lidhur me paanshmërinë objektive të gjykatësve dhe shpesh sjell deri te bartja e vazhdueshme e rasteve nga njëra instancë në tjetrën, pasi që gjykatësit e komunës komunale nuk do ta shohin të arsyeshme të vendosin ndryshe nga hera e parë.

Shume gjykata ankohen të mos kenë mjaft gjykatës apo referentë përmbarues për të garantuar që aktgjykimet të përmbarohen pa vonesa të mëtejshme, përkundër rritjes së kohës së fundit të numrit të tyre. Derisa është përmirësuar bashkëpunimi me bankat private në mënyrë që të mund të kryhet përmbarimi në llogaritë bankare, komuna të caktuara në disa raste kanë zgjedhur që plotësisht t'i injorojnë aktgjykimet masat e përkohshme të gjykatave që i urdhërojnë ato që ta kryejnë apo të përmbahen nga kryerja e ndonjë veprimi. Në shumë raste, vonesat në përmbarimin e aktgjykimeve gjithashtu e pengojnë efikasitetin e përmbarimit, pasi që u jep kohë të mjaftueshme individëve të caktuar që të gjejnë mënyra si t'i ikin drejtësisë. Situata e përkohshme në Kosovë gjithashtu dëshmohet të jetë problematike në këtë drejtim, pasi që shumë persona nuk kanë vende të caktuara të banimit.

Një mungesë tjetër që shpesh sjell deri te zvarritjet e procedurave gjyqësore është mungesa e ekspertëve në fusha të ndryshme në Kosovë. Kjo situatë është më kritike lidhur me ekspertët e mjekësisë ligjore. Edhe nëse ka ekspertë të tillë, ata shpesh herë nuk posedojnë pajisjet e nevojshme për të përgatitur ekspertizat. Si rezultat i kësaj, ekspertizat duhet të sigurohen nga jashtë Kosovës. Mirëpo, në të njëjtën kohë, nuk ka mjete financiare për t'i paguar ekspertët e tillë. Në raste të caktuara, ka ndodhur që gjykatësit vetë të paguajnë

përkohësisht shërbimet e tilla për t'iu shmangur zvarritjes së procedurës. Në disa raste të kryera sipas detyrës zyrtare, ky problem ka shkuar aq larg sa që është kërkuar nga viktimat e krimeve që të paguajnë ekspertët e mjekësisë ligjore, përkundër faktit që kurrfarë ligji i zbatueshëm në Kosovë nuk e përkrah një hap të tillë. Pasi që Ombudspersoni e kishte ngritur këtë çështje lidhur me një ankesë të veçantë që i ishte drejtuar atij, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut e informoi atë që e kishte kontaktuar Departamentin e Administratës Gjyqësore pranë UNMIK-ut. si autoritet kompetent në çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e shpenzimeve lidhur me ekspertizat në procedurat penale, dhe kishte kërkuar nga ky departament që ta gjejë një zgjidhje për këtë problem sa më shpejt që të jetë e mundshme.

Gjykatësit në përgjithësi ankohen për mungesën e lokaleve adekuate, që e bën të pamundshme për gjykatat që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të duhur. Gjatë një takimi me gjykatësit nga gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë, një kryetar i një gjykate të qarkut i tha Ombudspersonit që ata ishin të vetëdijshëm që ishin duke shkelur vazhdimisht parimet e procesit të rregullt dhe të drejtë gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mirëpo, është e pamundshme të respektohen standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nëse, për shembull, thjeshtë nuk ka salla sa duhet për t'u mbajtur seancat e dëgjimit për të gjitha rasteve. Shpesh, gjykatësit detyrohen që seancat e dëgjimit t'i mbajnë në zyrat e tyre.

Sa i përket procedurave penale, një problem tjetër qëndron në faktin që dëshmitarët, në veçanti ata të përfshirë në lëndët që kanë të bëjnë me ngjarjet që kanë ndodhur menjëherë para, gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të vitit 1999, shpesh herë nuk ndihen të sigurt për të ndihmuar gjykatësit dhe prokurorët në zgjidhjen e rasteve. Në Kosovë, në veçanti, ku shoqëria është e ndërtuar në lidhjet e ngushta familjare dhe me ndikim të fortë dhe ku lulëzon krimi i organizuar, shumë njerëz kanë pak shpresë që agjencitë e zbatimit të ligjit do të jenë në gjendje t'i mbrojnë ata në rast se deklaratat që ata ia kanë dhënë gjykatës do t'i sjellin te një rrezik i qartë dhe i menjëhershëm për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre. Në anën tjetër, programet e mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë fatkeqësisht ekzistojnë më shumë në letër se sa në jetën normale dhe, sido që të jetë, ato nuk do të ishin mënyra e duhur për t'u marrë me një problem kaq të përhapur.

Përmbarimi i dënimeve më pak të rënda penale në shumë raste nuk është kryer ende për shkak të mungesës së vendeve në burgje. Një problem i ngjashëm ekziston në lidhje me të burgosurit në pritje të gjykimit, të cilët shpesh herë nuk vendosen në qendrat e paraburgimit që janë më afër gjykatës kompetente por shpërndahen nëpër qendra të paraburgimit në mbarë Kosovën. Si pasojë e kësaj, organizimi i transportit për këta të paraburgosur për të marrë pjesë në seancat e dëgjimit shpesh herë paraqitet si problem. Ende ka shumë ankesa lidhur me atë se kryerësit e mitur të veprave penale, të burgosurit me aftësi të kufizuara mendore dhe të burgosurit dhe të paraburgosurit "normal" vazhdojnë të mbahen në lokale të njëjta.

Gjatë muajve të fundit, KGJPK, bashkë me Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut,

kanë filluar ta shqyrtojnë çështjen se çka mund të bëhet në mënyrë që të përmirësohet dhe shpejtohet puna me lëndët. Këto organe kanë gjetur që zgjatja e tepruar e procedurës pranë gjykatave në Kosovë varet nga një numër i çështjeve, mes tjerash, nga numri dhe natyra e lëndëve me të cilat punohet, situata lidhur me punonjësit, jo vetëm me gjykatësit por edhe me prokurorët dhe punonjësit administrativ, procedurat që rregullojnë punën e gjykatës sipas ligjit dhe kapaciteti real i gjykatësve të përfshirë për të menaxhuar lëndët në mënyrë efikase (jo vetëm në kuptim të zgjidhjes së lëndëve, por edhe në kuptim të dhënies së prioritetit sipas nevojës). Si KGjPK, ashtu edhe Departamenti i Drejtësisë, duket të kenë punuar rishtas në përmirësimin e kapacitetit të gjykatësve dhe prokurorëve për të zgjidhur ngarkesat me lëndë në mënyrë efikase dhe kanë filluar të punojnë në plane të reja lidhur me punonjësit që, duke u bazuar në kritere objektive dhe përmbledhëse, do të pasqyronin më mirë si vëllimin, ashtu edhe natyrën e ngarkesave me lëndë me të cilat përballen gjykatat. Në mënyrë që të arrihet kjo, Departamenti i Drejtësisë ka filluar disa projekte dhe vlerësime që pastaj do të shqyrtohen nga ana e grupeve punuese legjislative. Në fillim të vitit 2005, një grup i ekspertëve evropian dhe amerikan gjithashtu përgatitën një vlerësim të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në Kosovë që gjithashtu ofroi një plan të ri të punonjësve për të tërë sistemin e gjykatave në Kosovë. Duket që azhurnimi i planit të tanishëm lidhur me punonjësit duket të jetë në vazhdim e sipër.

Një problem që deri më tani nuk është shqyrtuar nga ana e strukturave kompetente ndërkombëtare është mungesa e vazhdueshme e ndonjë mjeti efektiv juridik për të fituar çfarëdo forme të kompensimit lidhur me procedurat e stërzgatura gjyqësore.

Një çështje tjetër që nuk ka ndërruar shumë prej raportit të kaluar vjetor është fakti që, për arsye të ndryshme, pjesëtarët e komuniteteve minoritare ende nuk janë të përfaqësuar sa duhet në gjyqësorin. Në një Raport që UNMIK-u ia dorëzoi Këshillit të Evropës më 2 qershor 2005 lidhur me përmbushjen e obligimeve të UNMIK-ut sipas Kornizës së Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, numri i përgjithshëm i komuniteteve minoritare që shërbejnë për gjyqësorin është shënuar të jetë 10.5%, në mesin e prokurorëve 9.4%. Vetëm 5.2% të gjykatësve dhe 2.3% të prokurorëve janë serbë kosovarë. Sipas këtij raporti, punësimi i gjykatësve edhe prokurorëve nga grupet minoritare rrezikohet seriozisht nga pagat e dobëta, përfitimet dhe kushtet e punës, si dhe nga një numër shumë i kufizuar i kandidatëve të mundshëm. Sa i përket gjykatësve dhe prokurorëve serbë kosovarë, të drejtat e fituara pensionale dhe të përfitimeve duket të mos i nxisin ata që të paraqiten në konkurset për poste në gjykatat e themeluara nga UNMIK-u. Përfaqësimi i ulët i lartpërmendur i komuniteteve minoritare është përshkruar të jetë më i keqi në mesin e punonjësve tjerë nëpër gjykata, ku ata përbëjnë vetëm 4.4% të numrit të përgjithshëm të të gjithë punonjësve në gjykata në Kosovë.

Në të njëjtën kohë, gjykatat paralele serbe, të administruara dhe paguara nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë dhe që gjenden në Serbi ose në enklavat serbe në territorin e Kosovës, vazhdojnë të funksionojnë sikur UNMIK-u të mos ekzistonte fare. Njëlloj si aktvendimet dhe aktgjykimet e tyre nuk pranohen nga strukturat e UNMIK-ut, ashtu edhe gjykatat në Kosovë të themeluara nga UNMIK-u nuk pranohen as nga gjykatat dhe zyrat admi-

nistrative paralele, as nga gjykatat dhe zyrat administrative të rregullta në Serbi. Viktimat e një shtate të tillë janë, si zakonisht, banorët e Kosovës, posaçërisht ata të komuniteteve minoritare serbe dhe rome.

Sipas Raportit të mësipërm të UNMIK-ut të 2 qershorit 2005, qasja në drejtësi për pjesëtarët e komuniteteve minoritare në Kosovë pengohet përmes pengesave të drejtpërdrejta që rrjedhin nga mungesa e sigurisë duke përfshirë edhe atë fizike, transporti, gjuha, varfëria dhe shpenzimet gjyqësore. Qasjen gjithashtu e pengojnë edhe pengesat më pak të drejtpërdrejta siç janë zvarritjet, paqartësia e ligjit, mungesa e besimit në zbatimin e drejtë të ligjit dhe njohuria e kufizuar e komuniteteve minoritare lidhur me ligjin dhe të drejtat ligjore. Faktorë të tjerë siç është përfaqësimi ligjor, më së shumti për shkak të mungesës së mjeteve financiare të klientëve si dhe mos vullnetit për të përfaqësuar pjesëtarë të komuniteteve minoritare, i vendos grupet minoritare në një mospërparësi serioze, duke nxitur mospjesëmarrjen e tyre dhe duke zvogëluar besimin e tyre në sistemin gjyqësor. Këto gjetje i pasqyrojnë në masë të madhe konkludimet e arritura nga Ombudspersoni pas ankesave dhe diskutimeve me pjesëtarët e komuniteteve minoritare.

Problemet dhe pengesat e mësipërme, bashkë me dyshimet e përgjithshme lidhur me legjitimitetin e UNMIK-ut në tërësi, shkakton që shumë nga pjesëtarët e bashkësive minoritare, në veçanti ata me origjinë serbe dhe rome, i favorizojnë gjykatat paralele. Ka edhe aspekte praktike lidhur me këtë, siç është qasja e lehtësuar dhe fakti që të gjithë gjykatësit e flasin gjuhën serbe.

Siç e theksoi Drejtori i departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut në një intervistë të dhënë një gazete vendore në qershor të vitit 2005 – sa më mirë që të punojë UNMIK-u dhe sistemi gjyqësor i Kosovës, aq më pak do të ketë nevojë për një sistem paralel. Fatkeqësisht, kjo ende nuk ka ndodhur. Një përpjekje e kohës së fundit e UNMIK-ut për ta përmirësuar këtë shtatë ishte hapja e një dege të Gjykatës komunale në Prishtinë në enklavën serbe të Graçanicës, në dhjetor të vitit 2004. në fund të majit të vitit 2005, pas vonesave të shkaktuar me parregullsi lidhur me procedurën e emërimit të punonjësve, konfliktit institucional mes Gjykatës komunale dhe Departamentit të UNMIK-ut për Administrimin Gjyqësor dhe vdekjes së një gjykatësi të lartë të përkatësisë etnike minoritare të Gjykatës komunale, ky departament i Gjykatës komunale dikur filloi punën me stafin përkatës administrativ dhe një gjykatës dhe prokuror në dispozicion sipas nevojës. Megjithatë, në fund të periudhës për të cilën raportohet, ende nuk kishte linje telefonike dhe e vetmja mënyrë për ta kontaktuar gjykatën ishte përmes telefonit mobil të një roje të sigurimit.

Problemi më i madh me të cilin ballafaqohet kjo degë e Gjykatës komunale të Prishtinës në Graçanicë është fakti që ajo nuk mund të nxjerrë aktvendime apo të përmbarojë aktgjykime. Funkcioni i saj i vetëm është që të pranojë lëndë, t'i mbledhë ato dhe pastaj t'i dërgojë në Gjykatën komunale në Prishtinë.

Megjithatë, ajo i ndihmon pjesëtarëve të caktuar të komunitetit serb që të kenë qasje në Gjykatën komunale në Prishtinë. Në përgjithësi, qasja në gjykatë është më e vështira për

pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom, që konsiderohen të jenë pjesët më se paku të integruara të shoqërisë në Kosovë. Qasja në gjykatë dallon nga komuna në komunë – sipas informatave të pranuar nga UNMIK-u në maj të vitit 2005, pjesëtarët e komunitetit minoritar serb dhe rom që jetojnë në zona të dominuara me shqiptarë u qasen gjykatave vetëm nëse i përcjellin anëtarët e Zyrës lokale të Ndërlidhjes të Gjykatës. Në komunat e Skenderajt dhe Malishevës në Kosovën qendrore dhe komunën e Kaçanikut në Kosovën juglindore, zona ku konflikti i vitit 1999 u zhvillua pandërprerë dhe kujtimet janë ende të freskëta, ata u qasen gjykatave vetëm nën përcjelljen e ndërkombëtarëve. E njëjta vlen deri në një masë edhe për shqiptarët etnikë që dëshirojnë t'i qasen gjykatave në Mitrovicë që gjenden në pjesën veriore të qytetit të dominuar me serbë, që mund t'i qasen kësaj gjykate vetëm përmes transportit me autobus të organizuar nga UNMIK-u i cili mban lidhjen mes pjesës veriore dhe jugore të këtij qyteti të ndarë. Në zonat ku një grup minoritar etnik jeton i rrethuar nga një shumicë e një grupi tjetër etnik, siç janë serbët në një numër të zonave nëpër Kosovë dhe shqiptarët në dhe rreth Mitrovicës veriore, pjesëtarët e komunitetit minoritar gjithashtu nuk marrin guximin të sjellin para gjykatës rastet kundër pjesëtarëve të komunitetit shumicë për shkak të frikës nga hakmarrja.

Por edhe nëse njerëzit e grupeve minoritare kanë mundësinë t'i qasen gjykatës, nganjëherë ka pengesa tjera në administrimin efikas të drejtësisë në rastet e tyre. Lidhur me kërkesa të caktuara për kompensim që i janë parashtruar gjykatave në Kosovë të shumtën nga paditësit serbë lidhur me dëmet e shkaktuara pas hyrjes së KFOR-it në Kosovë më 1999 dhe gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, gjykatat përkatëse ishin penguar t'i procedojnë këto raste nga ana e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut i, cili më 26 gusht 2004 e nxjerr një qarkore për të gjitha gjykatat në Kosovë përmes të cilës kërkoi nga gjykatësit që të mos caktojnë paditë civile për kompensim lidhur me dëmet në pronë pas vitit 1999 të ngritura nga ana e paditësve serbë derisa Departamenti i Drejtësisë dhe gjykatat në Kosovë ta përcaktonin mënyrën më të mirë të procedimit të këtyre rasteve. Kjo kërkesë dukej të ishte bërë për shkak të numrit të madh të padive civile – rreth 14,000 – që ishin ngritur nga paditësit etnik serbë lidhur me dëmet në pronë që kishin ndodhur pas hyrjes së NATO-s në Kosovë në vitin 1999. Sipas Departamentit të Drejtësisë, një fluks i tillë i padive do të shkaktonte probleme për gjykatat, gjithashtu edhe nga pikëpamja e logjistikës, pasi që për paditësit do të nevojitej të sigurohet përcjellja për në gjykata, që vetëm si e tillë do të kërkonte planifikim dhe koordinim të konsiderueshëm. Kjo praktikë dukej të jetë zbatuar edhe për paditësit e përkatësisë etnike rome dhe ashkali.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, duket që UNMIK-u planifikon të suspendojë periudhën e parashkrimit për kërkesat e parashtruara gjykatave nga ana e pjesëtarëve të përkatësive të caktuara etnike minoritare menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur në vitin 1999, të cilat nuk kishin mundur të procedohen për shkak se në fillim, gjykata të caktuara ende nuk kishin filluar punën në atë kohë kurse më vonë, kërkuesit vazhduan të kenë probleme për qasje në gjykata. Një rregullore është përgatitur për këtë qëllim, e cila i është dërguar selisë së KB-ve në Nju Jork për aprovim.

Derisa ekziston mundësia që një numër i madh i padive i ngritur brenda një afati të shkurt-

tër kohor si dhe pengesa tjera lidhur me rrethanat të përmendura në qarkore mund ta kishin penguar administrimin e drejtësisë, një situatë e tillë nuk i liron autoritetet nga përgjegjësia e tyre për të ofruar qasje në gjykatë dhe vendimet e gjykatës. Në të njëjtën kohë, nuk duket të kishte përparësi në atë që të gjitha rastet e mësipërme të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Gjykatës të caktuar u ankuan që po të mos ishte qarkorja e lartpërmendur, disa raste tashmë do të ishin zgjidhur, posaçërisht ato që kishin të bëjnë me atë që ka ndodhur në mars të vitit 2005, ku dëshmitarët në dispozicion dhe fakti që nuk kishte kaluar shumë kohë do ta kishte lehtësuar bërjen e një vlerësimi më të saktë të dëmeve. Fakti që procedimi normal i rasteve të tilla tani ishte suspenduar për një kohë kaq të gjatë përmes një qarkoreje të nxjerrë nga Departamenti i Drejtësisë, duke mos lënë vend për vlerësimin individual të gjykatësve të secilit rast, ngrit çështje serioze lidhur me të drejtën e ankuesve për qasje në gjykatë.

Në dy letra të dërguara në shkurt dhe qershor të vitit 2005, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë është pyetur nëse është gjetur ndonjë zgjidhje lidhur me atë se si të trajtohet ky grup i rasteve, mirëpo në to deri tani nuk është dhënë ndonjë përgjigje.

Përkundër faktit që nisma të caktuar janë në zhvillim e sipër për ta përmirësuar funksionimin e përgjithshëm të administrimit të Drejtësisë, ende duhet të bëhet shumë në këtë drejtim. Mbetet të shihet se si veprimet që bëhen tani do të kenë ndikim pozitiv në problemet e vazhdueshme të gjyqësorit.

### ***Papërshtatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe roli i Ombudspersonit***

Kur të merret parasysh sasia e ligjeve mbi të drejtat e njeriut që janë shpallur në vitet e fundit dhe fakti që instrumentet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në vend, duket që, së paku në letër, Kosova gëzon një nga sistemet më kompakte dhe më të plota të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Fatkeqësisht, siç është përmendur në Raportin e kaluar vjetor, praktika e vërtetë shpesh herë nuk korrespondon aspak me atë që është e kërkuar me ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të përmendura më lart. Në vend të kësaj, banorët e Kosovës vazhdojnë të jenë të privuar nga mbrojtja efikase e të drejtave të njeriut, të cilën të tjerët që jetojnë në vendet tjera të Evropës për një kohë të gjatë e konsiderojnë si gjë të rëndomtë.

Një nga problemet kryesore në këtë drejtim është papërshtatshmëria e përgjithshme e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që është i vendosur në Kosovë. Siç është theksuar në Raportin e kaluar vjetor, Ombudspersoni vazhdon të jetë i vetmi organ për të drejtat e njeriut që ka kompetencë të shqyrtojë vendimet dhe veprimet e strukturave të IPVQ-ve dhe UNMIK-ut. Gjykatat që kanë mandate ta zbatojnë dhe mbrojnë sundimin e ligjit dhe me këtë, deri në një masë, edhe ligjin për të drejtat e njeriut, janë kompetente për

të shqyrtuar veprimet e strukturave vendore por jo edhe atyre të UNMIK-ut.

Një brengë në rritje e sipër gjatë periudhës për të cilën raportohet ishte fakti që IPQV-ve u mungonte kapaciteti dhe resurset për të garantuar zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Zyra këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit është e paraparë për ta këshilluar qeverinë dhe për të shqyrtuar dhe zhvilluar vijat e veprimit lidhur me të drejtat e njeriut. Megjithatë, zyra duket të ketë resurse dhe kapacitet të vogël si dhe autoritet të kufizuar mbi ministritë e qeverisë dhe strukturat e vetëqeverisjes lokale, duke rezultuar me pak njëtrajtësi në qëndrimin e qeverisë ndaj të drejtave të njeriut. Ministria për Komunitete dhe Kthime e formuar rishtas duket të jetë plotësisht e përqendruar në projektet për kthimet e personave të zhvendosur brenda vendit që kanë të bëjnë vetëm me rindërtimin e shtëpive. Ajo nuk punoi aktivisht për të promovuar të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve, përkundër asaj që ky obligim është i theksuar në mandatin e saj.

Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta në Kosovë, ligjet që rregullojnë juridiksionin dhe kompetencat e Ombudspersonit duhet të jenë më të forta. Ombudspersoni do të duhej që, sikur një numër i Ombudsmenëve nëpër botë, të jetë i lejuar të nisë apo të marrë pjesë në procedurën në gjykatë apo procedurat tjera gjyqësore. Në të njëjtën kohë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit do të duhej të obligojë autoritetet publike që të përgjigjen në intervenimet e Ombudspersonit brenda një afati të caktuar kohor. Autoritetet publike gjithashtu do të duhej të jenë të obliguara që të ofrojnë arsyet për çfarëdo vonese për t'u përgjigjur në shkresat apo raportet e Ombudspersonit. Asambleja Parlamentare e përkrahu këtë ide në Rezolutën 1417 mbi Mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë të janarit të vitit 2005, kur e UNMIK-un që ta ruajë dhe forcojë autoritetin e Institucionit të Ombudspersonit, mes tjerash, duke kërkuar nga PSSP dhe IPVQ-të që të japin përgjigje përfundimtare në rekomandimet e Ombudspersonit brenda një afati të arsyeshëm kohor ose të arsyetojnë në mënyrë të duhur çfarëdo refuzimi për t'i pranuar ato.

Pas bartjes së kompetencave të caktuara në IPVQ-të, qëndrimi shpesh herë i shprehur indiferent i UNMIK-ut ndaj punës së Institucionit të Ombudspersonit është zëvendësuar me një qëndrim të paqartë varësisht nga Ministria apo Komuna e kontaktuar nga ana e Ombudspersonit. Në disa raste, strukturat përkatëse të IPVQ-ve shprehën një vullnet të dalluar për të bashkëpunuar, edhe pse shpesh nuk e kishin të qartë si të përgjigjen në kërkesat e Ombudspersonit në një mënyrë adekuate. Në të njëjtën kohë, pjesë tjera të IPVQ-ve kanë pasur një sjellje përjashtuese dhe nganjëherë qartas jo bashkëpunuese. Në një rast të kohës së fundit lidhur me hetimet mbi praktikën e dhënies së ndihmave financiare për dëmet e pësuarat të banorëve të caktuar të Gjilanit gjatë një tërmeti në vitin 2002, Ombudspersoni në fund u detyrua që ta kërkojë intervenimin e PSSP-së pas refuzimit të Komunës së Gjilanit për t'ia mundësuar qasjen në dokumentet përkatëse. Në të njëjtën kohë, Komuna e Prishtinës nuk është përgjigjur në asnjë nga letër intervenimet që i janë dërguar gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet.

Një problem i veçantë në lidhje me raportin e ri mes Ombudspersonit dhe strukturave vendore u dallua me rastin e kërkesave për caktimin e masës së përkohshme: më parë, Ombudspersoni gjithmonë ia kishte dërguar kërkesat e tilla PSSP-ve, shumica e të cilëve reagues në një mënyrë ose tjetër në këtë kërkesa. Në një rast që kishte të bëjë me ndërtimin e paligjshëm të një ndërtese banesash që ishte duke i dëmtuar pronat në afërsi, Ombudspersoni ia dërgoi PSSP-së dy kërkesa për caktimin e masës së përkohshme, në gusht dhe shtator të vitit 2004, por nuk morri kurrfarë përgjigje. Në fund, Zëvendës PSSP për Administratën Civile e informoi Ombudspersoni që, pas bartjes së kompetencave, me refuzimin e shërbyesve civil komunal për të ndërmarrë veprimet e kërkuara nga zyrat e tyre tani do të merren IPVQ-të, apo më hollësisht Ministria e Shërbimeve Publike. Pas kësaj, Ombudspersoni ia dërgoi kërkesat për caktimin e masës së përkohshme Ministres së Shërbimeve Publike, e cila nuk reagoi në asnjërin nga to. Ai pastaj filloi t'i dërgojë njëkohësisht kërkesat për caktimin e masës së përkohshme PSSP-së dhe Ministres së Shërbimeve Publike, duke kërkuar nga PSSP që ta informojë se cilit organ duhet t'ia drejtojë këtë lloj të kërkesave në të ardhmen. Deri më datën e këtij Raporti, ai nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje në këtë pyetje. Si rrjedhim, gjatë periudhës për të cilën raportohet janë dërguar disa kërkesa për caktimin e masës së përkohshme me të cilat nuk është marrë askush, pasi që as PSSP as Ministria e Shërbimeve Publike nuk e konsiderojnë të jenë përgjegjëse për atë punë.

Kritika e mësipërme e UNMIK-ut, megjithatë, nuk do të duhej ta krijojë bindjen që UNMIK-u në përgjithësi nuk bashkëpunon me Ombudspersonin. Në të kundërtën, muajt e kaluar treguan që pjesë të caktuar të strukturës së UNMIK-ut kanë përmirësuar në masë të madhe bashkëpunimin e tyre me Institucionin e Ombudspersonit. Një shembull për këtë është Policia e UNMIK-ut, që ka kaluar nëpër një përmirësim të pamatshëm që nga ardhja në pushtet e PSSP-së së tanishëm në gusht të vitit 2004 dhe emërimi i Komisionarit të ri të Policisë së UNMIK-ut në tetor të vitit 2004. Tani më nuk është problem qasja Policisë së UNMIK-ut lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe keqpërdorimin e autorizimeve dhe në shkresat që i dërgohen Komisarit të Policisë së UNMIK-ut zakonisht pranohet përgjigja brenda një afati të arsyeshëm kohor, derisa mbahen takime të rregullta mes përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit dhe personit kontaktues pranë Policisë së UNMIK-ut. Në të njëjtën kohë, më nuk mohohet qasja në shkresat e lëndëve dhe në raste të caktuara ato edhe ofrohen parapakisht nga ana e vetë Policisë së UNMIK-ut në shkresat që ia dërgojnë Ombudspersonit. Ky raport bashkëpunimi me Policinë e UNMIK-ut ia mundëson punonjësve të Institucionit të Ombudspersonit që të procedojnë dhe zgjidhin rastet e tilla në mënyrë më të shpejtë se më herët.

Në të njëjtën kohë, ka shumë individë që punojnë për UNMIK-un dhe të cilët e ndihmojnë Ombudspersonin në shumë fusha të ndryshme të punës. Megjithatë, bartja e vazhdueshme e kompetencave është duke krijuar konfuzion, jo vetëm sa i përket kërkesave për caktimin e masës së përkohshme, por edhe në fushat tjera. Administrata ndërkombëtare tani shikon që me shpejtësi të konsiderueshme të vendosë përgjegjësitë e caktuara të bartura mbi supet e strukturave vendore. Megjithatë, duke e bërë këtë, UNMIK-u dështon të vërejë që përgjegjësitë që i janë ngarkuar atij me Rezolutën 1244 të Këshillit të Siguri-



mit kanë mbetur të njëjta, me dallim që institucionet që e ndihmojnë UNMIK-un për të përmbushur këto përgjegjësi udhëhiqen tani nga kosovarët në vend të ndërkombëtarëve. Si rrjedhim, përgjegjësia e UNMIK-ut për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut në territorin e Kosovës mbetet e pandryshuar dhe vlen si për UNMIK-un, ashtu edhe për strukturat vendore. Në rastet kur IPVQ-të nuk e kanë të qartë se si të ndjekin apo të përgjigjen në rekomandimet e Ombudspersonit, UNMIK-u mbetet i obliguar që t'i udhëzojë si të veprojnë në pajtim me obligimet e përmbajtura në marrëveshjet për të drejtat e njeriut që janë të zbatueshme në Kosovë. Fatkeqësisht, derisa gjithnjë e më shumë fusha të punës po barten në IPVQ, ky aspekt i mandatit shpesh herë nuk përfilllet nga ana e UNMIK-ut.

Në këtë kontekst, një rrugë tjetër pa dalje është përpjekja për të mbrojtur të drejtat e njeriut në një entitet që i ngjan shtetit dhe që udhëhiqet nga një organizatë ndërkombëtare që gëzon imunitet pothuajse të plotë për vetën dhe punonjësit e saj. Derisa Ombudspersoni mund të ngrit çështje të caktuara pranë UNMIK-ut lidhur me veprimet e punonjësve të tij, i vetmi organ kompetent për t'u përgjigjur në ankesat e tij është vetë UNMIK-u. Në rastet kur ankesat kanë të bëjnë me pohime të veprave penale, ato nuk mund t'i përcillen as prokurorëve vendorë, as atyre ndërkombëtarë, dhe prapë mbetet mbi UNMIK-un të zgjedhë nëse do të heqë dorë nga imuniteti në raste të tilla dhe nëse do ta kthejë atë punonjës në shtetin prej nga ka ardhur për ta pritur gjykimin atje. Në të njëjtën kohë, nga imuniteti mund të hiqet dorë nëse sistemi ligjor lejon që rastet të vijnë deri të ajo pikë ku imuniteti duhet të deklarohet apo, si mund të jetë rasti, të hiqet dorë nga ai. Në Kosovë, gjykatat kompetente e preferojnë që fillimisht të deklarohen të mos jenë kompetente për të vendosur mbi rastet që kanë të bëjnë me imunitetin e UNMIK-ut, kështu që çështja nëse nga imuniteti do të hiqet dorë apo jo në një rast të caktuar as që mund të diskutohet.

Një shembull tjetër që e demonstroi problemin e përgjithshëm të imunitetit kishte të bëjë me vendimin e Hekurudhave të UNMIK-ut për të larguar nga puna një numër të punonjësve vendorë, të cilët tani nuk kanë kurrfarë mundësie ta kontestojnë këtë vendim pranë asnjë gjykate në Kosovë. Rasti i Hekurudhave të UNMIK-ut është vetëm një shembull i mungesës së mbrojtjes së drejtpërdrejt ligjore të paraparë, në veçanti, për punonjësit vendor të UNMIK-ut. Problemet e shkaktuara nga imuniteti i UNMIK-ut gjithashtu janë ngritur në Rezolutën 1417, në të cilën Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandoi që UNMIK-u ta rishqyrtojë gjendjen e imuniteteve, në veçanti duke e revizionuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e UNMIK-ut dhe KFOR-it dhe Personelit të tyre në Kosovë, në mënyrë që të garantojë që imuniteti i UNMIK-ut dhe KFOR-it të mos e pengojë zbatimin efikas të rekomandimeve të Asamblesë Parlamentare. Asambleja Parlamentare gjithashtu ia rekomandoi UNMIK-ut që të garantojë që të gjithë zyrtarët ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe policët, të jenë gjithnjë nën juridiksionin efektiv penal dhe civil vendor ose të shtetit prej nga kanë ardhur.

Punonjësit vendor të UNMIK-ut nuk janë grupi i vetëm i njerëzve që cilët janë të privuar nga mundësia për të shfrytëzuar mjetet juridike në çështjet lidhur me punësimin. Së paku në letër, nëpunësit civil mund të ngritin çështje të tilla pranë një Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i cili ishte themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbi-

min Civil të Kosovës. Megjithatë, në praktikë, ky Këshill ende nuk ka filluar të veprojë dhe nëpunësit civil, tani për katër vitet e fundit, janë të privuar nga të drejtat që i gëzojnë punonjësit tjerë në Kosovë. Sekretarët e përhershëm të Ministrive, udhëheqësit kryesorë të agjencive ekzekutive dhe poste të tilla të larta publike momentalisht e ndajnë të njëjtin fat, pasi që Komisioni i lartë publik për emërimet, i paraparë me të njëjtën Rregullore, ende nuk ka filluar të veprojë.

Imuniteti i UNMIK-ut dhe mungesa e pjesshme e bashkëpunimit me UNMIK-un dhe IPVQ-të, bashkë me legjislacionin e dobët përkrahës, e bën shumë të vështirë që Ombudspersoni ta kryejë punën e tij në një mënyrë adekuate dhe efikase. Ky fakt, po të merrej si i vetëm, nuk do të kishte ndikim aq të madh në situatën e përgjithshme të të drejtave të njeriut në Kosovë po të kishte edhe struktura tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Derisa prej vitit 1999, janë paramenduar dhe diskutuar shumë organe tjera për të drejtat e njeriut, asnjë nga to ende nuk është themeluar. Një shembull i kësaj është Kolegji i Veçantë për Çështjet e Kornizës Kushtetuese i paraparë me Kornizën Kushtetuese të shpallur në vitin 2001. Katër vite më vonë, mungesa e një kolegji të tillë është kritikuar përsëri nga ana e Asamblesë Parlamentare e Këshillit të Evropës përmes Rezolutës 1417, por autoritetet kompetente të UNMIK-ut nuk janë më afër themelimit të tij se sa kanë qenë në vitin 2001. Në rezolutën e saj, Asambleja Parlamentare gjithashtu përkrahu idenë e themelimit të një Gjykate për të Drejtat e Njeriut, një ide që ishte diskutuar në të kaluarën, mes tjerash, edhe në Raportin e fundit Vjetor të Ombudspersonit. Asambleja Parlamentare gjithashtu rekomandoi themelimin e një këshilli/komisioni këshillues për të drejtat e njeriut, të cilin do ta propozonte Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe do ta emëronte PSSP. Një këshill/komision i tillë do të ishte i ngarkuar me vlerësimin e pajtueshmërisë së projekt-Rregulloreve të UNMIK-ut dhe instrumenteve përkrahëse ligjore me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Derisa ekziston rreziku që aktivitetet e një këshilli/komisioni të tillë këshillues për të drejtat e njeriut do të kryqëzoheshin me punën e Institucionit të Ombudspersonit, duke krijuar me këtë rast një konfuzion të caktuar, themelimi i një Kolegji të Veçantë për çështjet e kornizës kushtetuese dhe një Gjykate për të Drejtat e Njeriut do të ndihmonte tepër për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë duke forcuar dhe plotësuar punën e Institucionit të Ombudspersonit. Fatkeqësisht, deri më tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë hapa për të zbatuar rekomandimet e Asamblesë Parlamentare, që duket të mos jenë përfshirë në listën e prioritetëve të UNMIK-ut.

Në të njëjtën kohë, personat të drejtat e të cilëve janë paraparë të mbrohen shpesh herë as që kanë njohuri për këto të drejta. Edhe pse drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, tekstet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ), Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e saj apo Konventës për Eliminimin e Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, vetëm sa për të emëruar disa, bëhen të pakuptimta duke marrë parasysh një mospërfillje të përhapur lidhur me përmbajtjen dhe efektet e tyre nga ana e shumicës së popullsisë dhe pjesë të mëdha të autoriteteve qeveritare si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë komunal. Kohë pas kohe organizohen seminare mbi rëndësinë e këtyre

marrëveshjeve për të drejtat e njeriut në Kosovë, por ato kalojnë pavërejtur nga shumica e popullsisë. Në mungesë të përpjekjeve të harmonizuara të autoriteteve ndërkombëtare dhe vendore për t'i informuar banorët e Kosovës rreth të drejtave që u takojnë sipas këtyre instrumenteve të të drejtave ligjore, Ombudspersoni dhe OJQ të caktuara dhe institucione tjera bëjnë çfarë është e mundur për ta plotësuar këtë zbrazëti, por nuk kanë as mjetet as kompetencat për ta bërë këtë në një nivel më të gjerë.

Në gusht të vitit 2004, UNMIK-u dhe Këshilli i Evropës i nënshkruan marrëveshjet lidhur me dy instrumente për të drejtat e njeriut, respektivisht Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe Konventën Evropiane kundër Torturës dhe Keqtrajtimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar apo Degradues ose Ndëshkues.

Në rastin e Kornizës së Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, nga autoritetet kompetente në Kosovë u kërkua që në shkurt të vitit 2005 ta nxjerrin raportin e parë mbi zbatimin e Konventës. Pas zgjatjes së këtij afati, raporti i është dorëzuar Këshillit të Evropës më 8 qershor 2005.

Sa i përket zbatimit të Konventës kundër Torturës, ende ekzistojnë probleme të caktuara praktike që e vonojnë zbatimin e marrëveshjes mes UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës. Derisa kjo Konventë ia lejon Komisionit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajtimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar apo Degradues ose Ndëshkues të drejtën që në çfarëdo kohe ta vizitojë çdo burg ose qendër të paraburgimit në Kosovë, KFOR-i deri më tani ka refuzuar t'ia lejojë këtij Komisioni qasjen e pakufizuar në qendrën e paraburgimit që gjendet në kampin "Bondsteel" të KFOR-it të Shteteve të Bashkuara. Momentalisht, janë duke u zhvilluar negociatat mes Këshillit të Evropës dhe NATO-s për ta gjetur një zgjidhje për këtë çështje.

Në tetor të vitit 2004, Komisioni i KB-ve për të Drejtat e Njeriut kërkoi nga UNMIK-u që të përgatisë një raport mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Sipas informatave të kohës së fundit, ky raport ende nuk është përgatitur.

Mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë vazhdon t'i mungojë efikasiteti i njëjtë me atë të vendeve tjera të Evropës, më së shumti për shkak të faktit që këtu ende nuk ekziston një sistem i mirëfilltë i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në një situatë të tillë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në Rezolutën 1453 mbi situatën momentale në Kosovë, të miratuar më 21 qershor 2005, kërkoi nga UNMIK-u që ta ruajë juridiksionin e Institucionit të Ombudspersonit mbi autoritetet ndërkombëtare për aq kohë sa ato të mbesin në Kosovë dhe të garantojë që organet përkrahëse të tregojnë përmirësime të dukshme për sa i përket pavarësisë dhe efikasitetit.

## ***Situata e komuniteteve minoritare në Kosovë***

Në Kosovë, përkufizimi i grupeve të caktuara etnike si minoritete nganjëherë varet mjaft shumë nga rajoni. Në shumicën e komunave, komuniteti etnik shqiptar përbën shumicën dërmuese dhe të gjithë joshqiptarët janë pakicë. Megjithatë, kjo situatë është e kundërt në vende të caktuara në Kosovën veriore siç janë Mitrovica veriore, komunat e Zveqanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit si dhe komuna e Shtërpçës në jug. Në këto komuna, shumica e banorëve janë të përkatësisë etnike serbe, kështu që të gjitha komunitetet tjera, duke përfshirë edhe shqiptarët etnikë, janë pakicë.

Gjithashtu, ka disa komunitete të caktuara të rëndësishme siç janë grupet etnike ashkali, boshnjak, egjiptian, goran, rom dhe turk, të cilat janë pakicë në të gjitha pjesët e Kosovës.

Roli politik i Serbisë në kontekst të problemeve të caktuara me të cilat përballet komuniteti serb në Kosovë duket të jetë më i thirruri publikisht kur të diskutohen komunitetet minoritare në Kosovë. Një fakt interesant lidhur me këtë grup që shumica e serbëve të Kosovës ende e konsiderojnë Kosovën të jetë pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi, edhe pse e okupuar, dhe nuk e konsiderojnë veten të jenë pakicë dhe për këtë arsye ende kontestojnë shpesh herë në një pikë qëndrimi e një grupi shumicë që jeton në një rajon të banuar me pakicën.

Lidhur me serbët dhe romët që jetojnë në rajonet e dominuar me shqiptarë, ende ka shumë shenja që kujtojnë trazirat që ndodhën atje në mars të vitit 2004, duke rezultuar me vdekjen e 11 shqiptarëve dhe 8 serbëve dhe lëndimin e më shumë se 1000 personave. Gjatë këtyre ngjarjeve të dhunës, u shkatërruan ose dëmtuan 36 kisha, manastire dhe objekte tjera kulturore dhe religjioze ortodokse, si dhe 730 shtëpi që u takonin serbëve dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera minoritare në vend. Si pasojë e kësaj, rreth 4100 njerëz mbetën pa shtëpi.

Pas trazirave, pati shumë reagime publike si ndërkombëtare ashtu edhe vendore, edhe pse shumë politikanë shqiptarë u deklaruan kundër dhunës vetëm pasi të ishin nxitur që ta bëjnë këtë. Fatkeqësisht, shumë probleme që rrodhën nga ngjarjet e dhunës së marsit të vitit 2004 nuk janë zgjidhur ende në tërësi. Përafërsisht një e katërta e personave që u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre është ende e zhvendosur. Derisa para të ashtuquajturave “ngjarje të marsit”, raportet mes shqiptarëve etnikë dhe grupeve të caktuara minoritare, posaçërisht serbëve dhe romëve, ishin të tensionuara, dhuna e vitit të kaluar e rriti edhe më shumë mosbesimin dhe tensionin mes këtyre grupeve. Komuniteti serb dhe ai rom e përjetuan në veçanti një ndjenjë të rritur të pasigurisë, pasi që ngjarjet e marsit u treguan që ngjarje të tilla mund të ndodhin brenda një afati prej vetëm disa ditësh dhe që nëse kjo ndodh përsëri, grupet e tyre etnike do të ishin caqet kryesore.

Në raportin e tij për UNMIK-un drejtuar Këshillit të Sigurimit të KB-ve më 14 shkurt 2005, Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve vërejtë që Qeveria e Kosovës e kishte bërë prioritet të programit të saj avancimin e të drejtave të minoriteteve dhe që Kryeministri u ishte drejtuar serbëve të Kosovës në shumë deklarata publike. Ai gjithashtu theksoi që

në Kosovë nuk kishte pasur krime serioze ndëretnike – dhe asnjë vrasje e një serbi kosovar – prej qershorit të vitit 2004 dhe që UNMIK-u dhe KFOR-i vazhdonin të merren me frikën e komuniteteve minoritare lidhur me sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, në veçanti përmes bashkëpunimit në autoritetet në nivelin komunal dhe nismave për mbarëvajtjen e komuniteteve. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve, siguria për komunitetet ishte përmirësuar prej dhunës së marsit të vitit 2004, duke lejuar që pikat e kontrollimit të largohen nga shumica e rrugëve kryesore dhe që përcjelljet e policisë të minimizohen. Sidoqoftë, liria e lëvizjes mbetet e pasigurt. Derisa serbët kosovarë në njërën anë e konsideronin veten të rrezikuar dhe për këtë arsye kanë mëdyshje të largohen nga komuniteti i tyre apo të ndërveprojnë me komunitetin shumicë (dhe anasjelltas), IPVQ-të ende nuk ishin angazhuar plotësisht në nismat për dialogun mes komuniteteve. Niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare në sektorin publik mbetet më pak se gjysma e nivelit të përcaktuar dhe nevoja për nuk ishte shqyrtuar nevoja për një sistem transportimi për të përbashkët për të gjitha komunitetet.

Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve gjithashtu e konfirmoi që frika e grupeve të caktuara etnike ushqehet me incidente të izoluara të cilat autoritetet vendore nuk i dënonin apo nuk u përvisheshin përherë, siç ishin hedhja e gurëve në shërbimet e transportit për pakicat, shkrimet me urrejtje nëpër ndërtesat komunale, plaçkitja e shtëpive të pabanuara të pakicave dhe mosrespektimi i të drejtave gjuhësore të pakicave. Shenjat jashtë ndërtesave dhe dokumentet zyrtare shpesh herë ishin vetëm në gjuhën e grupit dominues etnik. Këta dhe faktorë tjerë shkaktuan një situatë ku besimi i komuniteteve minoritare në sistemet administrative dhe politike të Kosovës është i vogël dhe përfshirja e tyre në proceset politike dhe në nivelet e larta të shërbimeve publike mbetet marginal.

Nuk ka ndryshuar shumë prej shkurtit të vitit 2005. Liria e përgjithshme e lëvizjes për serbët dhe romët në rajonet e dominuar me shqiptarë vazhdon të përmirësohet ngadalë por është ende larg nga niveli i kënaqshëm. Ende ka shumë zona ku fshatrat e izoluara të banuara me serbë mund të arrihen vetëm duke kaluar nëpër pika kontrollimi të KFOR-it.

Derisa një tren që qarkullon mes Kosovën qendrore dhe Leshakut që gjendet në Kosovën veriore përdoret si nga pjesëtarët e komuniteteve minoritare ashtu edhe nga shqiptarët etnik, vetëm autobusë të posaçëm qarkullojnë mes enklavave të ndryshme apo mes enklavave dhe Mitrovicës veriore, me ose pa përcjellje të policisë apo KFOR-it, pasi që autobusët publik kalojnë nëpër enklava mirëpo nuk ndalen në to. Në disa pjesë të Kosovës perëndimore, autobusët e KFOR-it që dërgojnë njerëz jashtë enklavave qarkullojnë vetëm një herë në javë. Autobusët e shkollave për nxënësit serbë dhe romë qarkullojnë nëpër zona të caktuara të banuara me shqiptarë me përcjellje të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) ose të Policisë së UNMIK-ut. Derisa në Kosovën qendrore serbët qarkullojnë të lirë në automjetet e tyre me tabela regjistrimi të Kosovës, situata dallon për fshatra të caktuara serbë në Kosovën perëndimore ku banorët vendas nuk marrin guxim të largohet nga fshatrat e tyre pa përcjelljen e SHPK-së ose KFOR-it. Në zonat e tilla, liria e lëvizjes së banorëve varet në masë të madhe nga trupat përkatëse të KFOR-it. Sipas ICRC-së dhe institucioneve tjera, sulmet kundër serbëve dhe romëve më nuk ishin edhe aq serioze, por

në ndërkohë ishte rritur numri i incidenteve të tilla kështu që viktimat e veprimeve të tilla rregullisht i nënshtrohen rregullisht ngacmimeve dhe talljes.

Pyetja nëse kufizimet mbi lirinë për të lëvizur nëpër tërë Kosovës janë reale apo vetëm të paramenduara nga komuniteti serb dhe rom është ende temë e shumë diskutimeve dhe për këtë arsye nuk mund të ofrohet ndonjë përgjigje e qartë lidhur me të. Një numër i rrethanave duke përfshirë edhe praninë e pikave të kontrollimit të KFOR-it në disa zona dhe shqetësimi i rregullt i këtyre komuniteteve minoritare tregon që ende ekziston një mungesë e përbashkët i besimit mes shumicës shqiptare dhe pakicave serbe dhe rome. Fakti që shumë kryerës të veprave penale të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur të vitit 1999 ende nuk janë sjellë para drejtësisë dhe që enda ka shumë persona të pagjetur nga të dy anët, por kryesisht shqiptarë, vetëm sa e forcon këtë mosbesim, derisa udhëheqësit shqiptarë nuk janë gjithnjë të hapur për të dënuar sulmet ndaj pjesëtarëve të grupeve minoritare. Derisa për momentin është bërë në përgjithësi më e lehtë për pjesëtarët e komuniteteve të lartpërmendura që të lëvizin më të lirë, realiteti dallon nëpër Kosovë, posaçërisht në disa pjesë qendrorë dhe në pjesën perëndimore të saj. Në përgjithësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm, situata e përgjithshme në terren vazhdon të jetë jostabile, siç e kanë pranuar edhe UNMIK-u dhe KFOR-i.

Në të njëjtën kohë, fshatrat serbe dhe rome janë kryesisht të mbyllura ndaj tregjeve dhe tregtisë vendore. Shpesh herë, njerëzit që jetojnë në këto fshatra nuk mundën ta punojnë tokën e tyre nëse nuk gjendet në afërsinë e menjëhershme të shtëpive të tyre për shkak të brengave për sigurinë e tyre apo për shkak se ajo tokë është uzurpuar dhe punohet nga fqinjët shqiptarë. Edhe nëse mund ta punojnë tokën, këta njerëz janë rrallë në gjendje që të shesin prodhimet e tyre bujqësore në tregjet vendore. Është e përhapur vjedhja e kafshëve shtëpiake dhe pajisjeve bujqësore, derisa në zonat malore prehen drunjat në masë të madhe dhe livadhet e kullosës gropohen në kërkim të rërës nga persona shpesh herë të armatosur. Shumica e viktimave nuk mund të ndalin veprimet e tilla dhe shpesh herë nuk marrim guximin që ta thërrasin policinë. Edhe nëse e bëjnë këtë, gjasat që këto raste të procedohen dhe zgjidhen janë shumë të vogla, që vetëm sa forcon ndjenjën e rritur të pasigurisë të pjesëve të caktuara të popullsisë minoritare vendore.

Sa i përket shumicës së rasteve kur enklavat e shqiptarëve etnik gjenden në zonat e dominuar me serbë, liria e përditshme e lëvizjes nuk është ndonjë çështje e madhe. Kjo situatë dallon në mënyrë drastike kur të shikohet qyteti i Mitrovicës, që prej përfundimit të konfliktit të vitit 1999 është i ndarë në pjesën veriore të dominuar me serbë dhe pjesën jugore të dominuar me shqiptarë. Posaçërisht pas sulmeve të dhunës kundër shqiptarëve në shkurt të vitit 2000, shumë nga këta njerëz janë larguar nga pjesa veriore, derisa popullsia serbe në këtë pjesë të qytetit u rrit pas fluksit të PZhBV-ve serbë nga pjesët tjera të Kosovës. Shqiptarëve që dëshirojnë të shkojnë në Mitrovicës veriore apo kanë nevojë të marrin pjesë në seancat gjyqësore në gjykatat që gjenden atje u duhet të mbështeten në transportin e KB-ve për të shkuar atje dhe anasjelltas.

Në gjysmën e parë të qershorit të vitit 2005, UNMIK-u vendosi që për herë të parë për

më shumë se një vit ta hapë për qarkullim civil urën mbi lumin Ibër që ndan dy pjesët e Mitrovicës. Ideja ishte që ura fillimisht të hapej një orë në ditë dhe pastaj çdo javë të rritej për një numri i orëve gjatë të cilave ura është e hapur. Për shkak të protestave masive të popullsisë serbe në Mitrovicën veriore dhe hedhjes së gurëve në automjetet e shqiptarëve që tentonin të kalojnë në Mitrovicën veriore, por edhe në automjetet e serbëve që po tentonin të kalojnë në Mitrovicën jugore, hapja e urës për qarkullim civil deri më tani nuk kanë ka arritur të shkojë ashtu si ishte planifikuar.

Kur të shikohen aspektet tjera të jetës së përditshme, mund të duket befasuese që enklava të caktuara serbe siç janë Graçanica në Kosovën qendrore, Shtërpca në Kosovën juglindore dhe fshatrat serbe në komunën e Gjilanit, si dhe Mitrovica veriore dhe zonat rreth saj ende shfrytëzojnë shërbimin postar dhe linjat telefonike që kanë vazhduar të funksionojnë në këto zona gjatë tërë konfliktit të armatosur e deri në ditën e sotme, derisa Shërbimi i Postës dhe Telekomunikacionit i Kosovës (PTK) ende nuk funksionon në ato zona. Si diçka absurde, është e mundshme që nga Graçanica të telefonohet në Prishtinën e afërt, por jo edhe e kundërta. Gjithashtu, është më lehtë që letrat të dërgohen tej oqeanit se sa në pjesët tjera të Kosovës.

Megjithatë, sa i përket furnizimit me energji elektrike, enklavave dhe fshatrave serbe u ofrohet ky shërbim nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Në dhjetor të vitit 2004 dhe janar të vitit 2005, kur temperaturat ishin shumë të ulëta, shume fshatra serbe u ankuan që u ishte ndërprerë furnizimi me energji elektrike sepse KEK-u refuzonte të riparonte dëmet në sistemit elektrik nëse njerëzit refuzonin të paguanin energjinë elektrike. Ky ishte një problem i përgjithshëm me ndikim jo vetëm në fshatrat serbe, por edhe në zona tjera duke përfshirë edhe pjesë të caktuara të Prishtinës – dështimi i një numri të banorëve të këtyre vendeve për t'i paguar shpenzimet e energjisë elektrike kishte rezultuar me një strategji të dyshimtë të vendosjes së “dënimit kolektiv” në zona të caktuara. Megjithatë, në rastin e fshatrave serbe, situata ishte përkeqësuar nga fakti që frika për sigurinë personale i ndalte banorët e fshatrave që të largohen më larg fshatit për të kërkuar dru për ngrohje për ta dhe familjet e tyre. Në të njëjtën kohë, niveli jashtëzakonisht i lartë i papunësisë dhe një varësi e rritur nga ndihmat humanitare e bën të pamundshme për shumicën e këtyre njerëzve që të paguajnë shpenzimet e energjisë elektrike apo të shërbimeve tjera. Ombudspersoni e ngriti këtë çështje me PSSP-në, duke theksuar që ishte e vështirë për individët e përfshirë që të paguajnë shërbimet e energjisë elektrike në mungesë të një sistemi përkatës të matjes së shpenzimit nëpër fshatra dhe që sipas tij, Ligjit i RSFJ-së mbi Detyrimet ishte ende i zbatueshëm, sipas të cilit me kalimin e një viti parashkruhet e drejta për të obliguar konsumatorët për të paguar borxhet e shërbimeve publike komunale. PSSP u përgjigj që KEK-u ishte përpjekur shumë herë për të instaluar sistemet e tilla matëse, por që teknikët përkatës të KEK-ut ishin penguar që të hyjnë në disa fshatra serbe. Sa i përket zbatimit të Ligjit mbi Detyrimet, ai vërejtje që ky ligj ishte zëvendësuar me Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut lidhur me shërbimet publike.

Fakti që shumë pjesëtarë të komuniteteve të caktuara minoritare kanë frikë që të lëvizin lirisht nëpër Kosovë gjithashtu ndikon në mundësitë e tyre për të pasur qasje në forma të

ndryshme të shërbimeve mjekësore. Një numër i fshatrave kanë qendrat e tyre mjekësore që ofrojnë shërbimet themelore mjekësore. Megjithatë, sa i përket shërbimeve tjera mjekësore, shumë pjesëtarë të komuniteteve minoritare, posaçërisht serbët dhe romët, rrallë vizitojnë spitalet në zonat e banuara kryesisht me popullsinë shumicë shqiptare. Një arsye tjetër për mëdyshjen e këtyre personave për të shkuar në këto spitale qëndron në mungesën e lartpërmendur të besimit mes këtyre grupeve etnike, që rezulton me atë serbët dhe romët që jetojnë në afërsi të Prishtinës t'i shmangen spitalit që gjendet aty, kurse të parburgosurit e caktuar shqiptarë në Mitrovicën veriore të refuzojnë të trajtohen nga ana e mjekëve dhe motrave medicinale të përkatësisë serbe. Nëse është e mundshme, pjesëtarët e grupit serb ose rom preferojnë që të shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore në enklava që përkrahen në disa raste nga UNMIK-u dhe Ministria e Shëndetësisë e Serbisë, në disa raste vetëm nga Ministria e Shëndetësisë e Serbisë, që mbikëqyr qendrat e përkujdesjes themelore mjekësore në enklava, siguron pagat e punonjësve dhe mbulon të gjitha shpenzimet tjera përkatëse në lidhje me funksionimin e tyre.

Në Kosovën qendrore, në enklavën e Graçanicës, në afërsi të Prishtinës ka një spital që ofron shërbimet themelore mjekësore, përfshirë edhe repartin e gjinekologjisë dhe akusherisë. Megjithatë, për shkak të mungesës së hapësirës, lehonat zakonisht dërgohen në shtëpi menjëherë pas lindjes së fëmijës. Në rastet e komplikuar siç është transfuzioni i gjakut, edhe më tutje pacientët dërgohen në spitalin e Mitrovicës veriore, me vetura që kanë targa me regjistrim të Kosovës ose në Beograd apo Nish në Serbi. Fshatrat që ende janë nën mbrojtje të KFOR-it mbështeten në përcjellje të KFOR-it për t'i dërguar rastet serioze në spitalin e Mitrovicës veriore por mundësia e sigurimit dhe fleksibiliteti i një përcjellje të tillë varet shumë nga njësitë e ndryshme të KFOR-it. Po ashtu, ekziston një klinikë e brendshme mjekësore në Llapna Sellë, në afërsi të Graçanicës, me repartin e kompletuar për rastet urgjente, ku pacientëve u ofrohen shërbimet themelore mjekësore dhe pastaj dërgohen në spital në Graçanicës ose në atë të Mitrovicës veriore. Po ashtu, në raste urgjente, klinika në Llapna Sellë mundet të akomodojë disa persona në të njëjtën kohë.

Shumë pjesëtarë të komunitetit rom jetojnë në banesa ku nuk kanë ose kanë vetëm pajisjet themelore sanitare dhe shpeshherë nuk kanë as ujë, kështu që këta njerëz janë në rrezik nga disa sëmundje ose infeksione. Në disa kampe ku jetojnë romët e që gjinden në pjesën e Kosovës veriore gjendja paraqitet me e keqe se në Plemetin në Kosovën qendrore, në veçanti kur afërsia e minierës së plumbit të Trepçës paraqet rrezik për shëndetin e këtyre e banorëve të këtyre kampeve. Ndonëse ka pasur shumë plane se si të evakuhon kampet, ende nuk ka plan konkret për evakuimin. Aspekti pozitiv i kësaj çështje është fakti se për herë të parë që nga viti 1999 është bërë një projekt konkret për rindërtimin e shtëpive të mëparshme të shumicës së këtyre njerëzve në mëhallën e romëve në pjesën jugore të Mitrovicës.

Romët zakonisht kanë qasje vetëm në shërbimet themelore shëndetësore, pasi që shumica e tyre nuk janë të mbuluar me asnjë lloj të sigurimit shëndetësor dhe nuk kanë të holla të paguajnë për trajtimet mjekësore në spitale. Anëtarët shqipfolës të komuniteteve së ashkali



dhe egjiptian kanë më pak probleme por ankohen se shpeshherë janë të ofenduar ose nuk trajtohen mirë kur shkojnë në qendrat shëndetësore ose spitale.

Anëtarët e grupeve goran dhe boshnjak nuk kanë probleme sa i përket qasjes së shërbimit shëndetësor por ankohen për mosgatishmërinë e punëtorëve shqiptar në qendrat mjekësore për t'i ndihmuar atyre dhe shpeshherë ata nuk mund të lexojnë se çka shkruan mjeku në receta, pasi që ato shkruhen vetëm në gjuhën shqipe. Në të njëjtën kohë situata duket të jetë përmirësuar kohëve të fundit.

Gjendja e vështirë ekonomike në Kosovë ka bërë që grupet më të cenueshme siç janë pakicat në përgjithësi por gjithashtu edhe familjet e varfra pa ndonjë përkrahje nga të afërmit dhe miqtë të vuajnë më shumë se pjesa tjerë popullatës. Një ndër pasojat negative e gjendjes së cenueshme në të cilën gjinden shumica e grupeve të pakicave është shkalla e lartë e papunësisë, që tashmë kryeson me nivelin më të lartë të papunësisë në gjithë Kosovën. Serbët praktikisht nuk janë as pjesë normale e tregut të punës në Kosovë dhe arrijnë shkallën e papunësisë deri në 80 % ose më tepër. Në disa vendbanimet e të kthyerve, papunësia arrin shkallën 100%. Këto zona shpeshherë mbijetojnë vetëm nga ndihmat humanitare që i marrin nga donatorët ndërkombëtar dhe nga Serbia ose nga ndihma sociale që e marrin nga Serbia. Anëtarët e grupeve të pakicave, në veçanti serbët, romët, ashkalitë, dhe egjiptianët nuk janë të përfaqësuar aq sa duhet.

Në situatat kur bëhen përpjekje për të informuar anëtarët e komuniteteve të caktuara minoritare për vende të lira të punës ose për të drejtat e tyre për pjesëmarrje në procesin e privatizimit të ish kompanive të tyre shoqërore, kjo shpeshherë nuk bëhet nëpërmjet mediave të shkruara që shpërndahen p.sh. në mesin e serbëve të Kosovës. Shumë nga këto shpallje publikohen në të përjavshmen “Jedinstvo” që shpërndahet në enklavat dhe fshatrat serbe nëpër Kosovë. Megjithatë, në shumë raste, shpalljet janë publikuar vetëm në të përditshmet shqipe në gazetat serbi siç është “Danas” ose “Blic” që përveç në Graçanicë, në disa pjesë të komunës së Gjilanit, Shtërpcë, Rahovec, dhe Mitrovicën veriore nuk mund të gjinden në zonat tjera serbe ose në vendbanimet e PZHVB-ve në Mal të Zi. Fshatrat serbe në pjesën perëndimore të Kosovës pothuajse nuk marrin shtypin në gjuhën serbe dhe për ngjarjet aktuale informohen vetëm nëse kanë antenat satelitore që i lidhin ata me Serbi ose nëse mund të kuptojnë lajmet në gjuhën shqipe.

Por, liria e lëvizjes, qasja shëndetësore dhe papunësia nuk janë problemet e vetme me të cilat përballen zonat e banuara me pakica. Ndonëse pas gjuhës angleze, gjuha shqipe dhe serbe konsiderohen të jenë gjuhë zyrtare në Kosovë, Ombudspersoni ka pranuar ankesa ku pohohet se kjo shpeshherë nuk reflektohet në dokumentet publike ose në korrespondencat ndërmjet komunave dhe autoriteteve qendrore, komunave ndërmjet veti, ose organeve të ndryshme ndërmjet komunave. Sipas informacioneve në dispozicion, disa ministri ose komuna kanë mungesë të njësive të përkthimit dhe buxheti përkatës nuk parasheh ndonjë pozitë të tillë. Letrat që dërgohen nga zonat ku gjuha shqipe përdoret më shumë gjoja nuk përkthehen në gjuhën serbe, madje edhe nëse i adresohet komunës ku më tepër fliet gjuha serbe dhe anasjelltas. Me sa duket e njëjta gjë zbatohet edhe në dokumentet komu-

nale që në disa raste, pa marr parasysh gjuhën që flitet në komunën ku letra është adresuar dokumentet e udhëtimit, regjistrimi i automjeteve dhe dokumentet tjera të rëndësishme lëshohen vetëm në gjuhën që e flet shumica e popullsisë. Disa njoftime dhe fatura varësisht nga komuna lëshohen vetëm në gjuhën shqipe. Ndonëse, sipas ligjit, shenjat publike në tërë Kosovën që tregojnë emrat e qyteteve dhe fshatrave duhet të jenë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, ka zona ku shenjat janë të vendosura vetëm në gjuhën që e flet shumica në atë zonë. Shpeshherë, reagimi i disa komunave është e pamjaftueshëm lidhur me zëvendësimin e shenjave ku emrat në gjuhën e pakicave janë ngjyrosur ose janë gërvishtur. Po ashtu bashkësia turke, ankohet që, në komunën e Prizrenit, në Kosovën jugore ku jeton shumica e anëtarëve të kësaj bashkësie, shenjat nuk janë të shkruara në gjuhën turke. Gati të gjithë grupet e pakicave që jetojnë në zonat të banuara me shumicë që flet gjuhë tjetër ankohen që dokumentet publike, emrat e tyre shqiptohen sipas shqiptimit të gjuhës së shumicës. Aktualisht, Ombudspersoni është duke bërë hetimet lidhur me të gjitha aspektet e lartpërmendura mbi përdorimin gjuhëve zyrtare nëpër Kosovë dhe në një të ardhme të afërt, do të lëshoj një raport mbi këtë çështje.

Në televizion, koha e ndarë për programet e pakicave është rritur. Kanali televiziv vendor RTK disa herë në ditë ofron programe të lajmeve në gjuhë të ndryshme. Megjithatë, këto programe ende nuk paraqesin metodën ku përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme mund ta informojnë publikun pakicë mbi ngjarjet e rëndësishme ose për çështjet e bashkësive tjera. Kjo nuk zbatohet as shumë në radio stacione, që zakonisht përdoren për këto qëllime. Më 1 qershor 2005, në përkrahje financiare nga ana e OSBE-së Misioni në Kosovë, katër radio stacione të reja në rajonin e Mitrovicës kanë filluar përgatitjen dhe transmetimin e programeve të lajmeve të ditës në gjuhën rome, boshnjake dhe turke. Programet e lajmeve përgatiten dhe ankorohen nga gazetarët e bashkësive përkatëse, që shpresohet se do të rrisin qarkullimin e informatave brenda këtyre bashkësive.

Në të njëjtën kohë, komuniteti rom dhe turk kryesisht ankohet se nuk ka shtyp në gjuhët e tyre.

Një tjetër problem që mund të ndërlihet me gjuhën është edhe problemi i shkollimit të fëmijëve të komuniteteve minoritare në gjuhën e tyre. Derisa fëmijët serb që kanë shkollat në afërsi zakonisht ndjekin mësimin në shkolla paralele që punojnë dhe financohen nga Ministria për Arsim dhe Sport e Serbisë dhe nxënësit turq mund të vijojnë mësimin në shkollat ku flitet gjuha turke, bashkësitë tjera nuk kanë përkrahje dhe mbështetje të tillë.

Lidhur me këtë, romët kanë problemin më të madh, pasi që nuk ka as shkolla e as tekste shkollore me të cilët fëmijët e tyre mund të mësojnë në gjuhën rome. Sa i përket çështjeve të tjera, komuniteti rom në Kosovë nuk është as i fort e as e fuqishme sa duhet për të përfituar fonde ose përkrahje tjetër për libra ose së paku për një klasë të shkollës fillore. Në të njëjtën kohë, pa marr parasysh nëse ata vijojnë mësimet në shkollat shqipe ose serbe në Kosovë, shumë nxënës rom ankohen se ata ngacmohen dhe ofendohen nga shokët e tyre të klasës ose arsimtarët, gjë që i shkakton që disa nga ta ndërprejnë vijimin e shkollimit së bashku. Shpeshherë romët nuk kanë mjete financiare që ti dërgojnë fëmijët në shkollë ose

ti pajisin ata me mjetet themelore.

Ndonëse ashkallitë dhe egjiptianët që flasin shqip ndjekin shkollat shqipe, anëtarët e këtyre bashkësive ankohen që grupet e tyre etnike nuk identifikohen si të tilla, e as që përmenden në mësim në shkollë.

Ka disa shkolla në gjuhën boshnjake sipas programit mësimor të Kosovës dhe dy nën degë të Universitetit të Prishtinës të veçanta për studentët boshnjak që gjinden në Pejë dhe Prizren. Ndërsa ka pasur plane që studentët boshnjak të lejohet të vazhdojnë studimet tjera universitare në gjuhën shqipe dhe pastaj të lejohen që provimet t'i mbajnë në gjuhën boshnjake, kjo nuk është ndjekur nga ana e universitetit, kështu që për studentët boshnjak ende mbeten vështirësi që të ndjekin studimet e tyre nëpër vendet tjera të rajonit. Po ashtu ka mungesë edhe të teksteve mësimore – derisa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerrë disa prej tyre, ato deri tani nuk kanë qenë të mjaftueshme.

Nxënësit goranë vazhdojnë të kenë probleme të mëdha lidhur me shkollimin në gjuhën e tyre. Derisa për nxënësit goranë do të ishte e mundshme që të vijnë shkollimin në gjuhën serbe për shkak të ngjashmërisë që ajo e ka me gjuhën gorane, shumica e shkollave serbe që gjenden në Kosovën qendrore dhe veriore janë tepër larg për pjesëtarët e komunitetit goran që jetojnë kryesisht në komunën e Dragashit e cila gjendet në jugun e skajshëm të Kosovës. Derisa disa nxënës goranë vijnë shkollat në afërsi në gjuhën shqipe, të tjerët ende shpresojnë të gjejnë ndonjë mënyrë për të shkolluar fëmijët e tyre në një gjuhë të përafërt me atë gorane.

Problemi kryesor në këtë drejtim është fakti që viteve të fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, filloi zbatimin e reformave arsimore që kishin për qëllim adaptimin e sistemit shkollor në Kosovë me standardet e shumicës së shteteve tjera evropiane, reforma që shtetet tjera në rajon ishin më të ngadalshme për t'i zbatuar. Prandaj, ndjekja e plan programit të Kosovës do ta bënte vështirë për nxënësit goranë për ta vazhduar shkollimin e tyre në shkollat dhe universitetet në gjuhën sllave në vendet siç janë Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe IRJM.

Në vitet e fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është pajtuar që prej klasës së nëntë t'i lirojë nxënësit goranë nga vijimi i plan programit të ri. Disa përfaqësues të komunitetit goran pyetën nëse ky libër do të mund të zgjatej deri në vitin 2006, përkatësisht deri sa të zbatohen reformat arsimore në disa nga shtetet në rajon ku flitet gjuha sllave. Deri më tani, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk e ka aprovuar një hap të tillë.

## ***Situata e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës dhe perspektivat për kthimin e tyre***

Me përfundimin e konfliktit të armatosur në Kosovë më 1999 dhe tërheqjes pasuese të ushtrisë jugosllave dhe policisë serbë, mijëra persona, kryesisht serbë dhe të tjerë të përkatësive etnike joshqiptare, u larguan nga shtëpitë e tyre për shkak të frikës nga hakmarrja. Disa nga ta shkuan në fshatrat dhe enklavat serbe në territorin e Kosovës, në Mitrovicës veriore ose për të jetuar në qendrat kolektive. Shumë shkuan në Serbi dhe një numër i konsiderueshëm në Mal të Zi dhe IRJM. Prej vitit 2000, një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve etnik që më parë kishin jetuar në pjesën veriore të Mitrovicës ikën për në Mitrovicën jugore dhe rajone tjera të banuara kryesisht me shqiptarë.

Pas ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, rreth 4 100 jo-shqiptarë mbetën të pashtëpi dhe në nevojë për strehim dhe përkujdesje, nga të cilët, sipas statistikave të UNHCR-së, 1 467 persona ende mbesin të zhvendosur në fund të majit 2005. Shumë nga ta jetojnë në banime të improvizuara në shkolla dhe kontejnerë, derisa një numër i vogël i serbëve të zhvendosur nga Prizreni është ende duke jetuar në kampin e KFOR-it gjerman në Prizren.

Në fund të gushtit të vitit 2004, situata e vështirë e një numri të personave të komunitetit ashkali nga Vushtrria që në atë kohë ishin duke qëndruar në bazën e KFOR-it francez në Novosellë, u zgjidh falë përpjekjeve të koordinuara të institucioneve dhe strukturave të ndryshme, duke përfshirë Ombudspersonin, UNMIK-un, KFOR-in francez dhe Qendrën Koordinuese Serbe për Kosovë dhe Metohi. Disa muaj më parë, disa ashkali u kthyen në Vushtrri ku tani janë duke jetuar nën mbrojtjen e përhershme të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Disa janë shpërndarë për të jetuar në pjesë tjera të Kosovës, derisa një numër i kufizuar është vendosur në një motel në afërsi të Vushtrrisë, lokalet të cilit faktikisht janë shndërruar në qendër kolektive. Shumë nga këta njerëz gjithashtu janë larguar për në pjesë tjera të Evropës.

Një numër i konsiderueshëm i PZhbV-ve romë që ende jetojnë në territor të Kosovës vazhdojnë të qëndrojnë në kampin e Plemetinit në afërsi të Obiliqit dhe në katër kampe në pjesën veriore të Kosovës. Dy nga këto kampe, Kabllar dhe Çesmin Llug, janë në Mitrovicën veriore, një është në Leposaviq dhe një tjetër në Zhitkovc në komunën e Zveqanit. Kushtet në këto kampe janë të mjera dhe të shënjuara me varfëri, ushqim të dobët dhe mungesë të shërbimeve më themelore higjienike dhe shëndetësore. Të gjitha kampet fillimisht u paramenduan si zgjidhje të përkohshme për shumë romë kosovarë që ishin nga shtëpitë e tyre më 1999, mirëpo ato janë ende aty, tani gjashtë vite më vonë.

Sa i përket kampit të Plemetinit në afërsi të KEK-ut, Komuna e Obiliqit, rishitas lajmëroi planin e saj për ta rrënuar këtë banim dhe për të ndërtuar strehime sociale në të njëjtin vend për banorët e mëparshëm të kampit. Banorët e Plemetinit deri më tani e kanë kundërshtuar këtë plan pasi që nuk duan të vazhdojnë të jetojnë aq afër KEK-ut dhe kanë frikë që do të marginalizohen edhe më tej nëse banorët e kampit thjeshtë barten në një strehim

tjetër pa u përzier me pjesën tjetër të popullsisë. Shumë nga këta njerëz janë të detyruar të mbesin në kamp për shkak të mungesës së çfarëdo mundësie për të rindërtuar shtëpitë e tyre të rrënuara në vitin 1999. Disa personave nga komunitat tjera në Kosovë u është ofruar strehim tjetër në komunitat përkatëse dhe për këtë arsye tashmë janë larguar nga kampi. Megjithatë, sa i përket kampeve në Kosovën veriore, ende nuk ka ndonjë plan konkret për t'i mbyllur ato, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme në këtë drejtim.

Shumica e personave të zhvendosur që jetojnë në kampet në Mitrovicën veriore janë nga lagjja e Mëhallës së Romëve në pjesën veriore të qytetit, që ishte shkatërruar në tërësi më 1999. Gjatë viteve të fundit, ka pasur përpjekje për ta rindërtuar Mëhallën e Romëve, të shumtën nga ana e Këshillit Danez për Refugjatë dhe UNMIK-un, por këto përpjekje ishin bllokuar nga mungesa e qartë e bashkëpunimit nga autoritetet komunale në Mitrovicë. Vetëm tani vonë ka pasur përparim real në këtë drejtim, siç është treguar më 18 prill 2005, kur Përfaqësuesi rajonal i UNMIK-it dhe Kryetari i Këshillit Komunal të Mitrovicës e nënshkruan një Marrëveshje për kthim në Mëhallën e Romëve, të cilën e bashkë-nënshkruan edhe faktorë tjerë ndërkombëtarë, dhe që parashihte fillimin e procesit të rindërtimit të shtëpive të para në Mëhallën e Romëve në vitin 2005. Më 5 maj 2005, UNMIK-u dhe IPVQ-të organizuan një informim të donatorëve dhe kërkesë për fonde për ta përkrahur rindërtimin e Mëhallës së Fabrikës, ku morën pjesë përfaqësues qeveritarë të shteteve të ndryshme si dhe përfaqësues të Këshillit të Evropës/EU dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Në ndërkohë, ka pasur takime tjera mes palëve të përfshira me qëllim të koordinimit të veprimeve të institucioneve të ndryshme dhe, së paku në letër, duket të ketë zotim të fortë që në këto angazhime të përfshihen edhe përfaqësuesit e komunitetit rom. Në praktikë, disa qeveri, bashkë me UNMIK-un dhe IPVQ-të, janë pajtuar që të ofrojnë përkrahje financiare për këtë projekt por, duke pasur parasysh vëllimin e këtij projekti, këto kontribute deri më tani mbulojnë vetëm një pjesë të shpenzimeve të përfshira.

Megjithatë, do të nevojitet kohë për rindërtimin e Mëhallës së Romëve, që tashmë është përshkruar si projekti më i madh i kthimeve që deri më tani është sipërmarrë në Kosovë. Edhe kur të jenë zgjidhur detajet lidhur me organizimin, fondet dhe eventualisht rindërtimin, ende mbesin të zgjidhen çështjet praktike, siç është për shembull çështja se çka do të ndodhë me banorët e kampeve të cilët nuk janë nga Mëhalla e Romëve dhe që përbëjnë 30% të popullatës së kampeve. Një pyetje tjetër që s'mund të mos shtrohet është nëse kthimi i njerëzve në Mëhallën e rindërtuar faktikisht do të funksionojë, respektivisht nëse do të jetë e mundshme që të kthyerit ta jetojnë një jetë të qetë dhe normale në mesin e shumicës së përbërë nga shqiptarët etnik.

Por, duke iu kthyer të tashmes, përpjekjet e çmueshme për ta rindërtuar Mëhallën nuk ndihmojnë në problemin e atyre personave që ende jetojnë në kampe.

Banorët e kampit të Zhitkovcit, si dhe personat tjerë që jetojnë në kampet në Kabllar dhe Çesmin Llug në Mitrovicën veriore, janë në situatë më të keqe se ata në Leposaviq, të shumtën për shkak të asaj se gjenden tejet afër deponive të mbeturinave që i takojnë asaj që

ka mbetur nga kompleksi i minierave të Trepçës, që ishte pjesë e prodhuesit më të madh të plumbit dhe zinkut në Jugosllavi.

Lidhur me kampin e Zhitkovcit, në muajt e fundit është rritur raportimi i mediave për kushtet atje, në veçanti për faktin që afërsia e deponive të mbeturinave të Trepçës shkaktonte probleme serioze shëndetësore për banorët e kampeve. Për çudi, raportimet e mediave janë përqendruar ekskluzivisht në këtë kamp, përkundër faktit që edhe kampet në Mitrovicën veriore vuajnë nga të njëjtat probleme. Edhe pse shumë zëra, disa edhe nga vetë UNMIK-u, janë ankuar për kushtet e këqija shëndetësore në këto kampe, deri më tani nuk ka pasur ndonjë plan konkret dhe të realizueshëm për të evakuuar njerëzit që jetojnë atje.

Në vitin 2004, Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) e përshkroi situatën në Zhitkovc si “urgjente” dhe KNKK bëri thirrje për evakuimin e menjëhershëm të kampit, mirëpo të dy thirrjet deri më tani ishin të kota. Në mesin e vitit të kaluar, WHO i bëri analizat e dymbëdhjetë fëmijëve që ishin duke jetuar në kamp dhe gjeti nivel jashtëzakonisht të lartë të plumbit në gjakun e tyre. Gjashtë nga këto raste u konsideruan të jenë urgjenca mjekësore. Këto gjetje vetëm sa shtuan dyshimin e përgjithshëm dhe gjithnjë në rritje që banorët e kampeve në Mitrovicën veriore janë duke u helmuar me mbeturina toksike, që sipas të shumtëve është janë duke e ndotur vetë tokën në të cilën është ndërtuar kampi.

Në shkurt të vitit 2005, u propozua i ashtuquajti Plan për Menaxhimin e Rrezikut, që kishte për qëllim zvogëlimin e ekspozimit ndaj plumbit për banorët e kampeve në Zhitkovc, Kabllare dhe Çesmin Llug. Ky plan në fund u zbatua në prill të vitit 2005 dhe duke filluar prej majit, Këshilli Danez për Refugjatë dhe komunitat kishin filluar të shpërndajnë pako higjienike, shporete druri, qumësht të përforcuar me yndyrë të ulët dhe shtesa ushqimore si dhe të sigurojnë qasje të rritur në ujë të pijshëm. Kjo solli deri te përmirësimi i konsiderueshëm i sanacioneve në kamp dhe rreth tij. Dymbëdhjetë fëmijë u dërguan në Beograd për t’u testuar dhe trajtuar, me qëllim të dislokimit të tyre të përhershëm diku tjetër. Megjithatë, këto masa nuk u përkujdesën për problemin kryesor me të cilin përballen të gjithë banorët e këtij kampi dhe kampeve tjera në Mitrovicën veriore, respektivisht që gjendja e tyre shëndetësore do të vazhdojë të keqësohet nëse vazhdojnë të jetojnë në këto kampe.

Kur të kihet parasysh fakti që do të nevojiten vite për rindërtimin e Mëhallës së Romëve, është e rëndësishme që çështja e evakuimit të njerëzve nga Zhitkovci, Kabllari dhe Çesmin Llugu të shqyrtohet ndaras. Lënë anash pyetjen përse këto kampe janë ndërtuar fillimisht në një rajon me rrezik të tillë të lartë, është thelbësore që UNMIK-u, bashkë me autoritetet vendore dhe entitetet tjera të përfshira, të ndërmarrë hapa të harmonizuar dhe të menjëhershëm për të dislokuar këta njerëz. Sipas informacioneve të fundit, autoritetet dhe institucionet e përfshira ndërkombëtare dhe vendore janë duke shkuar para dhe prapa në përpjekjet për ta zgjidhur këtë çështje sa më parë që të jetë e mundur.

Paragrafët e mësipërm patën të bëjnë me personat e zhvendosur që ende jetojnë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, mijëra persona të zhvendosur, kryesisht të përkatësisë etnike serbe

dhe romë, vazhdojnë të jetojnë në vendbanime në rajonet fqinje, kryesisht në Serbi, Mal të Zi dhe IRJM. Ombudspersoni është në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e këtyre grupeve të njerëzve dhe ngriti problemet e tyre pranë Kryeministrave të Serbisë dhe të Malit të Zi gjatë periudhës së fundit për të cilën është raportuar, megjithëse pa sukses në atë kohë.

Sipas një raporti të nxjerrë nga KNKK mbi PZhBV-të në Serbi dhe Mal të Zi në maj të vitit 2005, momentalisht ka 230,000 PZhBV nga Kosova që ende qëndrojnë atje. Një nga problemet kryesore që e ndajnë si PZhBV-të në Serbi ashtu edhe ata në Mal të Zi është fakti që sipas të drejtës ndërkombëtare ata nuk konsiderohen të jenë refugjatë dhe për këtë arsye nuk i gëzojnë të drejtat dhe përkrahjen e njëjtë sikur personat që vijnë nga Kroacia apo Bosnja, derisa vuajnë nga problemet e njëjta. Në të njëjtën kohë, ata nuk i kanë të drejtat e njëjta me banorët e vendeve ku ata janë duke qëndruar edhe pse kanë nevojë për mbrojtje shtesë për shkak të situatës së tyre më të lëndueshme – sipas raportit të KNKK-së, është më vështirë për PZhBV-të që të marrin dokumentet personale, të ushtrojnë të drejtat pronësore apo t'i qasen përkujdesjes shëndetësore dhe mirëvajtjes sociale.

Duket që qendrat kolektive në të cilat shumë nga këta PZhBV janë ende duke qëndruar – sipas informatave të fundit, afër 7,000 njerëz ende jetojnë në qendrat kolektive në Serbi – tani kanë mbetur me pak ose aspak ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare. Kushtet atje janë shumë të vështira dhe ndërtesat, që në shumicën e rasteve nuk janë mirëmbajtur me vite, vështirë që ofrojnë kushte të pranueshme të jetës. Situata e PZhBV-ve romë është edhe më e vështirë pasi që ata shpesh herë nuk janë të mbuluar me kurrfarë forme të sistemit të sigurimit social.

Në shtator të vitit 2004, Ombudspersoni përsëri ngriti çështjen e statusit dhe të drejtave të PZhBV-ve në Serbi në një letër që ia dërgoi Kryeministrit të Serbisë. Ai gjithashtu e informoi Kryeministrin e Serbisë për problemin e romëve të zhvendosur nga Kosova të cilëve u kanosej rreziku që të dëbohen nga barakat e caktuara në Beograd. Nuk ka pasur kurrfarë përgjigje në këtë letër.

Gjithashtu në shtator të vitit 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër të ngjashme Kryeministrit të Malit të Zi, duke kërkuar nga ai që t'ua japë personave të zhvendosur nga Kosova që ishin duke qëndruar në Mal të Zi të drejtat e njëjta me ato të refugjatëve. Në tetor të vitit 2004, Kryeministri i Malit të Zi dërgoi një përgjigje ku e informoi Ombudspersonin që 18, 196 PZhBV nga Kosova që ende ishin duke qëndruar në Mal të Zi ishin duke pranuar mbrojtje dhe përkrahje maksimale nga Qeveria. Sipas tij, refugjatët dhe PZhBV-të ishin duke u trajtuar njëjtë dhe pranonin mbrojtje adekuate në kuptim të shëndetësisë dhe arsimit, si dhe ndihmës sociale për grupet më të lëndueshme të njerëzve. Në të njëjtën kohë, Kryeministri i Malit të Zi u ankua që shumë organizata dhe OJQ ndërkombëtare që më para u kishin ndihmuar këtyre njerëzve ishin larguar nga Mali i Zi, kështu që tani i mbetej vetëm Qeverisë që t'u ndihmojë atyre.

Përshkrimi pozitiv i dhënë nga Kryeministri i Malit të Zi është në kundërshtim të plotë

me situatën e PZhBV-ve nga Kosova që jetojnë në Mal të Zi ashtu si është përshkruar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) në raportin e tij të majit të vitit 2005. Sipas KNKK-së, autoritetet malaziasë kanë qëndrime te ndryshme lidhur me refugjatët dhe PZhBV-të nga Kosova. Për shkak se këta të fundit konsiderohen të jenë banorë të Serbisë, ndihmat për ta konsiderohen të jenë përgjegjësi e Serbisë. Në anën tjetër, qeveria e Serbisë konsideron që nevojat e PZhBV-ve që jetojnë në Mal të Zi janë nën mandatin e Malit të Zi, për shkak të unionit të ekziston mes Serbisë dhe Malit të Zi. Në një situatë të tillë ku asnjëra nga qeveritë nuk e konsideron vetën të jetë përgjegjëse, PZhBV-të në Mal të Zi nuk mund të regjistrohen si duhet, as nuk mund të marrin ndihmat për të papunët. Grupe të caktuara të lëndueshme siç janë të moshuarit, të paafët, jetimët apo nënat vetu-shqyese gjithashtu nuk marrin kurrfarë përfitimesh shtesë. Megjithatë, do të duhej të mirëpritet fakti që qeveria e Malit të Zi ka miratuar rishtas një strategji të re për refugjatët dhe PZhBV-të, që mes tjerash parashih edhe integrimin e këtyre personave në Mal të Zi. Nëse zbatohet si duhet, kjo strategji do t'u ndihmojë këtyre njerëzve që ta kenë një perspektivë të re për jetën e tyre në të ardhmen.

Ombudspersoni i ka ngritur çështjet e mësipërme shumë herë në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe Këshillin e Evropës.

Sa i përket personave të zhvendosur nga Kosova që janë duke qëndruar në IRJM, Ombudspersoni vëren që këta persona janë të shumtën me origjinë rome. Shumica e këtyre njerëzve kanë kërkuar azil nga autoritetet maqedone, mirëpo janë refuzuar menjëherë ose nuk kanë pranuar ende ndonjë përgjigje në këto kërkesa. Vendbanimeve të tilla në IRJM duket t'u mungojnë mbrojtja përkatëse shëndetësore dhe nevoja tjera themelore, që është të shumtën për shkak se IRJM është duke u përballur me probleme të rënda ekonomike dhe strukturore dhe për këtë arsye shpesh herë duket të mos jetë në gjendje t'u ndihmojë as personave të saj të zhvendosur.

Çështja nëse të gjithë personat e zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës do të kthehen në shtëpitë e tyre dhe kur do të ndodhë kjo varet nga një numër i faktorëve, por më së shumti nga ajo nëse këta njerëz do të ndihen që do të mund ta zhvillojnë përsëri një jetë të rëndomtë në rrethana normale. Momentalisht, kjo nuk është gjithnjë e mundshme. Një nga arsyet është fakti që Kosova është duke jetuar në një paqartësi politike tani gjashtë vite. Në të njëjtën kohë, një situatë gjithnjë më e keqe ekonomike që shkakton rritjen e varfërisë dhe papunësisë dhe ndjenjës së cenueshmërisë së tërë popullsisë rezulton me atë që shumë njerëz të kenë mëdyshje nëse vendi ia vlen që të kthehen.

Sa i përket atyre që kanë vendosur të kthehen, është vështirë të flitet për kthime të qëndrueshme në kuptimin e plotë të fjalës, posaçërisht në disa pjesë të Kosovës perëndimore. Edhe nëse janë rindërtuar shtëpitë, në veçanti pas ngjarjeve të marsit të vitit 2004, rindërtimi i jetës nuk mund të arrihet aq lehtë.

Në përgjithësi, atje ku personat e përkatësisë etnike serbe apo rome kthehen në vendet e rrethuara me rajonet e banuara me popullsinë shumicë, situata e tyre është çfarëdo tjetër



përveç e qëndrueshme. Shpesh herë, toka që u ka takuar atyre më parë është e zënë, ekziston vetëm një liri e kufizuar e lëvizjes kurse niveli ekzistues i papunësisë vetëm sa vështirëson mbijetesën. Disa fshatra të të kthyerve siç është Bellopoja ende mbështeten vetëm në ndihmat humanitare, përfshirë këtu edhe furnizimin me ushqim. Kjo mungesë e nevojave themelore, bashkë me mungesën e lokaleve themelore arsimore dhe mësimdhënësve, shkakton që shumë gra dhe fëmijë të vazhdojnë të qëndrojnë në Serbi ose në Mal të Zi edhe nëse bashkëshortët e tyre tani jetojnë në fshatrat e të kthyerve në Kosovë.

Fatmirësisht, gjatë muajve të fundit, UNMIK-u e ka ndërruar qëndrimin e tij lidhur me riatdhësimin e të kthyerve. Derisa më parë, programet e kthimeve përqendroheshin në kthimin e personave në bashkësitë ku ata kishin jetuar më parë, tani ka më shumë përqendrim në dëshirat e të kthyerve – ata tani duket të kenë më shumë zgjidhje nëse dëshirojnë të kthehen në bashkësitë e tyre të mëparshme, nëse ende ekzistojnë, apo dëshirojnë të kthehen në vende tjera të Kosovës të banuara me pjesëtarë të grupit të tyre etnik.

Kryesisht, numri i PZhBV-ve nga Kosova që kanë vullnet apo mund të kthehen në rajonet e populluara kryesisht me një grup tjetër etnik vazhdon të jetë tepër i vogël. Sipas vështrimeve mujore të bëra nga UNHCR, mes korrikut të vitit 2004 dhe majit të vitit 2005, përafërsisht 1882 persona të përkatësisë etnike minoritare u kthyen nga zhvendosjet e brendshme apo të jashtme. Kjo përfshin edhe personat e zhvendosur të përkatësisë etnike shqiptare që u kthyen në rajonet ku ata janë minoritet, kryesisht në Kosovën veriore. Megjithatë, gjatë periudhës së lartpërmendur, janë kthyer vetëm katër persona që i takojnë këtij grupi.

Në të njëjtën kohë, është vështirë të thuhet sa është e besueshme një statistikë e tillë, pasi që thashethemet qarkullojnë që një numër i caktuar i personave të zhvendosur serbë kthehen për disa ditë vetëm sa për t'u regjistruar në Kosovë dhe për të pasur të drejtë për përfitime të caktuara, siç janë për shembull pensionet. Pasi të jenë regjistruar, ata kthehen në vendbanimet e tyre të ndryshme nëpër Serbi.

Më shumë përqendrim se më parë do të duhej të vendoset në përmirësimin e fatit të PZhBV-ve që qëndrojnë jashtë Kosovës. Fatkeqësisht, UNMIK-u ende përqendrohet kryesisht në kthimet, siç mund të shihet edhe nga bisedimet e kohës së fundit me UNMIK-ut dhe IPVQ-ve në njërën anë, dhe IRJM-së dhe Malit të Zi në anën tjetër, lidhur me themelimin e mekanizmave përkatës për lehtësimin e kthimeve vullnetare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë. Protokollat e Bashkëpunimit mes UNMIK-ut dhe të dy qeverive të lartpërmendura janë momentalisht duke u përgatitur, me përfshirjen dhe konsultimin e vazhdueshëm të IPVQ-ve.

Në vend se të lëvizin vazhdimisht si gurë shahu në një përpjekje të pafund për të arritur standardet e larta të vendosura nga UNMIK-u për Kosovën, PZhBV-të duhet të jenë të lirë në çdo aspekt që të zgjedhin nëse do të kthehen apo të rrinë aty ku janë duke jetuar. Nëse ata marrin një përkrahje të caktuar nga UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës për t'u kthyer, atëherë nuk ka kurrfarë arsye pse të mos e marrin një përkrahje të tillë nëse vendosin të

mos kthehen, aq sa për t'ua mundësuar ta rindërtojnë jetën e tyre jashtë Kosovës. Duket e pakuptueshme që nuk ka përkrahje për shumë njerëz që janë të detyruar të jetojnë në kushte çnjerëzore në vendbanimet e PZhBV-ve derisa shpenzohen miliona për të rindërtuar shtëpitë për të cilat ekziston mundësia që do të shiten pas një kohe shumë të shkurtër.

Një qëndrim i tillë do të pasqyroste më shumë realitetin në Kosovën e sotme, përkatësisht që emigrimi vazhdon rregullisht edhe pse në një masë relativisht më të vogël. Vetëm gjatë vitit 2004, Komisionari i Serbisë për Refugjatët regjistroi zyrtarisht 277 persona që u larguan nga Kosova për në Serbi. Edhe pse ky numër është gjysma e numrit të personave që u larguan nga Kosova për në Serbi në vitin 2003, një vështirësi e bërë rishtas nga "Riinvest" tregoi që dëshira e njerëzve për të qëndruar në Kosovë ishte në përgjithësi e vogël, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të personave të anketuar. Megjithatë, është interesante që, si proporcion, më shumë shqiptarë etnikë janë të gatshëm të emigrojnë nga Kosova se sa persona të përkatësisë etnike serbe. Derisa të parët e bazonin vullnetin e tyre për të ikur për arsye ekonomike, këta të fundit nuk dëshironin të qëndrojnë në vend për arsye politike.

Kur të shqyrtohet mundësia që PZhBV-të nga Kosova të zgjedhin të lirë nëse dëshirojnë të kthehen apo që të rrinë aty ku janë, është e rëndësishme që kjo zgjedhje të bazohet në njohurinë adekuate për situatën e sotme në Kosovë dhe për prospektet e tyre atje në të ardhmen. Është për të dyshuar nëse fushatat e informimit të nisura nga UNMIK-u e përshkruajnë situatën të kthyerve në Kosovë në tërësi. Në veçanti, duket të ketë vetëm informacione të kufizuara për vendin e të kthyerve në shoqërinë kosovare në të ardhmen, kur njëherë të jetë zgjidhur statusi i Kosovës. Gjatë bisedave me PZhBV-të që momentalisht qëndrojnë jashtë Kosovës, duhet t'u bëhet shumë e qartë që Kosova në të cilën nga ata kërkohet që të kthehen, si dhe roli që ata do ta luajnë në shoqërinë e saj, duket që do të jetë shumë më e ndryshme nga Kosova nga e cila u larguan më 1999.

Në përgjithësi, qëndrimi ndaj PZhBV-ve dhe prospekteve për kthimin e tyre në Kosovë do të duhej të bëhet më fleksibil. Në vend se të mendohen mënyra të reja për t'i bindur njerëzit që të kthehen, UNMIK-u, IPVQ-të dhe qeveritë e vendeve në rajon që momentalisht strehojnë PZhBV-të nga Kosova do të duhej ta kuptojnë që shumë PZhBV serbë dhe romë ndoshta kurrë nuk do të dëshirojnë të kthehen apo nuk do ta kenë atë mundësi fare. Në një situatë të tillë, të gjitha qeveritë dhe entitetet e përfshira do të duhej të mendojnë për mënyra si të përmirësohet jeta e këtyre njerëzve ashtu që një ditë të jenë në gjendje që ta zhvillojnë një jetë normale dhe të qëndrueshme në një vend sipas zgjedhjes së tyre.

### ***Personat e pagjetur***

Problemi i personave ende të pagjetur prej kohës para dhe pas konfliktit të vitit 1999 vazhdon të jetë i pranishëm në mendjen e banorëve të Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë apo prapavijën e tyre etnike.

Sipas informatave të pranuar nga KNKK në mes të qershorit të vitit 2005, momentalisht ka 2 716 persona që ende janë të raportuar të pagjetur. Ka përafërsisht 1 000 raste ku të mbeturat e kufomave janë gjetur dhe të cilat ende pritet të identifikohen, kurse në 1 700 rastet tjera ende nuk ka kurrfarë gjurmësh të atyre që janë të raportuar të pagjetur. Derisa mbesin shpresat që ende pritet të zbulohen edhe më shumë varreza, ende është shumë e lartë mundësia që të mbeturat e kufomave të këtyre njerëzve të jenë shkatërruar dikur.

Çështje e trupave të shqiptarëve kosovarë që fillimisht janë varrosur në Kosovë dhe pastaj, pak kohë para përfundimit të konfliktit të vitit 1999, janë ekshumuar dhe dërguar në Serbi, vazhdon të mbetet një çështje emocionale. Momentalisht, ky numër është diku rreth 300 kufoma, kështu që mbulon vetëm një pjesë të numrit të përgjithshëm të personave që ende janë të pagjetur. Kjo tregon që zemërimi dhe mllefi që ndihet nga opinioni kosovar në këtë drejtim nuk ka të bëjë vetëm me numra si të tillë por të shumtën me faktin që kthimi i këtyre kufomave familjeve të tyre është vonuar pa arsye për një kohë kaq të gjatë, më së shumti për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e autoriteteve serbe në të kaluarën.

Pas shumë vitesh të mënjanimi të çështjes së personave të pagjetur, ajo për herë të parë u ngrit përsëri në tetor të vitit 2003, në takimin e parë mes qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Serbisë, që u mbajt në Vjenë, Austri. Në këtë takim, të dy palët vendosën të themelojnë grupet punuese për t'u marrë me këtë çështje dhe me "çështje tjera teknike".

Takimi i parë i Grupit Punues për Personat e Pagjetur, i kryesuar nga KNKK dhe i përbërë nga përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë, përfaqësuesit e qeverisë së Serbisë, ekspertët e mjekësisë ligjore nga të dy palët dhe UNMIK-u, u mbajt në mars të vitit 2004, dy javë para se trazirat e 17 – 19 marsit 2004 ndërprejnë përkohësisht të gjitha kontaktet deri në mars të vitit 2005, kur Grupi Punues u takua për herë të dytë. Prej atëherë, Grupi mbajti takime më të rregullta – takimi i radhës u mbajt në qershor të vitit 2005 dhe në vijim u caktua takimi i tjetër që do të mbahet në fund të qershorit të vitit 2005.

Takimi i këtij Grupi Punues theu shumë tabu në të njëjtën kohë – së pari, ishte hera e parë që çështja e personave të pagjetur u ngrit publikisht në një dimension të tillë sa i përket të shumtën të mbeturave të kufomave të shqiptarëve etnik që ende ishin në Serbi, si dhe çështjes së personave të pagjetur të përkatësisë etnike joshqiptare. Në të njëjtën kohë, kjo ishte hera e parë që shqiptarët kosovarë u përfshinë në këtë proces në një nivel publik politik, pasi që deri atëherë kjo ishte konsideruar në masë të madhe si fuqi e rezervuar e UNMIK-ut për shkak të lidhjes së saj me hetimet penale. Në fund, gjatë këtyre takimeve dhe si duket për herë të parë, palët e përfshira filluan ta njohin përgjegjësinë e tyre për ta ndihmuar UNMIK-un dhe faktorët tjerë të përfshirë për të gjetur të mbeturat e kufomave të personave që ende janë të raportuar të pagjetur.

Megjithatë, kjo ndjenjë e përbashkët e përgjegjësisë vetëm sa ka filluar të paraqitet. Momentalisht, faktorët e përfshirë ndërkombëtar janë burimi i shumicës së nismave. Infor-

macionet vazhdojnë të arrijnë më shumë si rrjedhime të procesit në zhvillim e sipër të hetimeve të mjekësisë ligjore, se sa nga palët e dikurshme të përfshira në konfliktin në Kosovë.

Sidoqoftë, bashkëpunimi në përgjithësi është rritur dhe ka sjellë deri te rezultatet më konkrete brenda një kohë shumë më të shkurtër se më herët, të shumtën për shkak se gjithnjë e më shumë palë të përfshira e kanë kuptuar nevojën për të arritur përparim të mirëfilltë lidhur me këtë çështje që s'hiqet nga mendja. Mbetet vetëm të shpresohet që përparimi i arritur deri më tani do të vazhdojë ashtu që një numër në rritje i njerëzve në Kosovë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, më në fund do të jenë të qetë lidhur me anëtarët e tyre të pagjetur të familjes.

### ***Kthimet me forcë***

Një nga problemet që gjithnjë e më shumë i është rritur rëndësia gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet është situata e mjerë e atyre kosovarëve që kanë jetuar si refugjatë për shumë vite nëpër shtetet e Evropës perëndimore, ku shumë nga ta fillimisht shkuan si refugjatë, dhe tani po kthehen me forcë në Kosovë pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999 dhe stabilizimit vijues të situatës në Kosovë.

Derisa personat të cilët kthehen vullnetarisht në Kosovë zakonisht janë në gjendje ta përgatisin kthimin e tyre para se të arrijnë në Kosovë, të kthyerit me forcë zakonisht vijjnë këtu plotësisht të papërgatitur, shpesh herë pa të holla dhe strehim. Shumica e tyre kanë probleme t'i adaptohen Kosovës së re, e cila është qenësisht e ndryshme nga vendi prej nga u larguan dhjetë, e shpesh herë edhe njëzet vite më parë.

Me të arritur në Kosovë, këta njerëz shpejt mësojnë që, përkundër premtimeve që u janë dhënë në shtetet e tyre të dikurshme mikpritëse, nuk ka institucione për të ju ndihmuar në shoqërinë kosovare dhe nuk ka qendra informative apo asistencë sociale, strehim apo trajtime mjekësore dhe psikologjike, si dhe nuk kurse të gjuhës për fëmijët e tyre, të cilët shpesh herë e flasin vetëm gjuhën e shtetit të tyre të mëparshëm mikpritës. Problemi më i madh nga të gjithë është që, edhe pse kanë qenë të informuara shumë më herët lidhur me dëshirën e shteteve mikpritëse për të kthyer sa më shumë refugjatë që të jetë e mundur brenda një afati sa më të shkurtër kohor, deri më tani nuk ka pasur përpjekje adekuate për t'u marrë me problemin e të kthyerve me forcë nga ana e autoriteteve në Kosovë, si ndërkombëtare ashtu edhe vendore. Ky dështim për ta njohur problemin e kthimeve me forcë ka shumë pasoja praktike, prej të cilëve më e madhja është mungesa e buxhetit për ta zhvilluar një infrastrukturë adekuate për t'i ndihmuar këta njerëz.

Edhe pse udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (ONM) përcaktojnë që të kthyerit paramendohet t'i kthehen "komunitetit amë" të tyre, shumë nga "komunitetet amë" të tilla shpesh herë nuk ekzistojnë më. Në raste të tilla, njerëzit lehen në rrugë dhe

detyrohen të shkojnë në çfarëdo strehime që mund të ekzistojnë. Derisa në të kaluarën, UNHCR ka dalë jashtë mandatit të saj për të paguar strehimin e personave veçanërisht të lëndueshëm, ajo tani ka ndërprerë këtë praktikë, të shumtën për shkak të arsyeve që kanë të bëjnë me buxhetin.

Por ky problem nuk ka vetëm pasoja humanitare. Një pasojë tjetër e madhe e mungesës së asistencës për të kthyerit me forcë në Kosovë është fakti që shumë nga ta do të përpiqen të kthehen në shtetet e tyre të dikurshme mikpritëse, duke krijuar me këtë rast një situatë të një “dere rrotulluese” të pafund, në të cilët ata arrestohen përsëri dhe kthehen prapa, vetëm sa për të kërkuar mënyra tjera si të kthehen. Lënia e një numri gjithnjë në rritje të personave pa përkrahje apo strehim gjithashtu do të mund ta krijonte një forcë të madhe destabilizuese në Kosovë, që tanimë është duke u përballur me problemet e krijuara nga ekonomia e dobët, papunësia vijuese dhe një popullsi tejet e re.

Këto pasoja, megjithatë, janë injoruar nga shtete të caktuara evropiane, të cilat gjatë muajve të fundit kanë kthyer kosovarët, nganjëherë me shumë pak përfillje ndaj standardeve të të drejtave të njeriut. Derisa Norvegjia dhe Gjermani në disa raste kanë insistuar të dëbojnë për në Kosovë personat pa marrë parasysh nëse këta persona janë në mes të trajtimit mjekësor apo psikologjik, Finlanda në një rast e ktheu me aeroplan një familje përkundër faktit që nëna e asaj familje ishte në muajin e tetë të shtatzënisë, kurse në një rast tjetër e dëboi një grua që ende kishte gjakderdhje një muaj pasi që të kishte kaluar nëpër një lindje të ndërlikuar ky ishte nevojitur intervenimi kirurgjik. Në rastin e parë, UNMIK-u nuk ishte informuar me kohë, por pasi që Finlanda kishte refuzuar që ta pranojë familjen përsëri, administrata ndërkombëtare nuk mundi të bëjë më shumë se sa ta shqyrtojë këtë çështje në mënyrë retrospektive me autoritetet e Finlandës.

Sa i përket kthimit të personave që janë në mes të trajtimeve të tilla mjekësore apo psikologjike, shtetet përkatëse e lehtësojnë ndërgjegjen e tyre duke pohuar që trajtimi i njëjtë mund të ofrohet edhe në Kosovë. Edhe pse informata të tilla janë duke iu dorëzuar gjykatave në shtete të caktuara mikpritëse, këto raporte nuk e përmbajnë tërë të vërtetën. Një shënim i përgatitur nga Zyra e UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete dhe Ministria e Shëndetësisë në janar të vitit 2005 dhe që ishte paramenduar të shërbejë si këshillë për qeveritë dhe OJQ-të, theksoi që problemet kryesore që rrezikojnë kapacitetin e Kosovës për të trajtuar me sukses çrregullimin e stresit post-traumatik janë mungesa e profesionistëve të shëndetit mendor në Kosovë, posaçërisht të atyre që mund të trajtojnë njerëzit me nevoja të posaçme, resurset e pamjaftueshme financiare dhe mungesa e qasjes në shërbime për personat që jetojnë në zonat rurale. Derisa nevojat e popullsisë lidhur me shëndetin mental janë shumë të mëdha, resurset humanitare dhe institucionale në këtë fushë janë shumë të vogla, kështu që personat në shtetet e azilit që vuajnë nga çrregullimi i stresit post-traumatik do të duhej ta përfundojnë trajtimin e tyre para se të kthehen në Kosovë, ku çrregullimet e tilla nuk mund të trajtohet duke e përdorur psikoterapinë ose socio-terapinë. Potencialisht, në mungesë të trajtimit të tillë, statusi shëndetësor i të kthyerve me forcë në Kosovë para përfundimit të trajtimit të tyre në shtetet mikpritëse do të vazhdojë të keqësohet edhe nëse ata janë aq fatlum sa të kenë mjaft të holla për të blerë barnat e tyre.

Deri dikur vonë, janë kthyer kryesisht personat e përkatësisë etnike shqiptare. Kjo ndryshoi, pas një qëndrimi të nxjerrë nga UNHCR-ja në mars të vitit 2005, në të cilin mes tjerash ishte theksuar që personat e përkatësisë etnike ashkali, egjiptiane, gorane dhe boshnjake duket të jenë më të toleruar tani në Kosovë dhe që derisa këto grupe do të mund të kishin kërkesa individuale për vazhdim të mbrojtjes ndërkombëtare, atyre më nuk u nevojitej mbrojtja ndërkombëtare në përgjithësi. Kjo ishte një shenjë për shumë shtete evropiane që, pas marrëveshjeve të caktuara me UNMIK-un për të kthyer pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe egjiptian kishin suspenduar këtë kthim pas trazirave të marsit të vitit 2005, por që përsëri kishin filluar përgatitjet për të kthyer personat e grupeve etnike ashkali dhe egjiptian sa më shpejt që të jetë e mundur. Qysh në prill të vitit 2005, Gjermani dhe UNMIK-u e nënshkruan të ashtuquajturën “Letër Marrëveshje” për këtë qëllim, në të cilën Gjermania propozoi që përafërsisht 300 persona të përkatësisë etnike ashkali dhe egjiptiane të kthehen me forcë për çdo muaj duke filluar prej majit të vitit 2005. Duke filluar prej korrikut të vitit 2005, ky numër do të pritët të rritët deri në 500 kurse prej fillimit të vitit 2005, numri i personave të propozuar për kthim me forcë më nuk do të ketë kurrfarë kufizimesh. Sipas palëve nënshkruese të kësaj “Letër Marrëveshje”, pas një përzgjedhje individuale, realisht nuk pritej që në Kosovë të kthehen më shumë se 20% të personave të propozuar për kthim, por ky vlerësim nuk kishte përfshirë më shumë se njëqind persona të përkatësisë etnike ashkali dhe egjiptiane të cilët ishin zgjedhur për t’u dëbuar kohë më herët, mirëpo kjo nuk kishte ndodhur për arsye të ndryshme

Ndoshta pjesa më shqetësuese e kësaj “Letër Marrëveshje” ka të bëjë me kthimin e romëve të caktuar në Kosovë. Pasi që UNMIK-u si duket prët përmirësime të konsiderueshme të situatës së romëve në Kosovë, ai u pajtua për mundësinë që ta lejojë kthimin e një numri të vogël të kryerësve të veprave penale të komunitetit rom që ishin dënuar me së paku dy vjet burg në Gjermani dhe për të cilët nuk ishte e nevojshme mbrojtja ndërkombëtare. Lënë anash pyetja nëse për këta romë nuk është e nevojshme mbrojtja ndërkombëtare vetëm pse ata janë kryerës të veprave penale, është shumë befusuese dhe jo edhe aq e sigurt kur të merret parasysh situata shpërthyesë në Kosovë, që kthimi i një komuniteti që sipas UNHCR-së është në nevojë të vazhdueshme për mbrojtje ndërkombëtare fillohet me romët që janë dëshmuar të jenë kriminelë të rëndë.

Më 1 qershor 2005, kjo çështje u ngrit pranë PSSP-së. Përmes letrës së 15 qershorit 2005, ai u përgjigj duke konfirmuar faktet e mësipërme dhe duke theksuar që fluturimi i parë që kishte kthyer 5 ashkali në Kosovë nga Gjermani ishte bërë më 19 maj 2005, derisa fluturimet e caktuara që kishin sjellë të kthyerit në Kosovë në maj dhe fillim të korrikut kishin pasur 14 ashkali dhe egjiptianë. PSSP vërejti që, derisa raportimet e gabueshme të mediave e kishin kritikuar kthimin masiv të romëve në Kosovë, ai nuk e parashihte një dëbim të tillë në të ardhmen e afërt as nga Gjermania as nga ndonjë shtet tjetër mikpritës në Evropë, dhe as UNMIK-u nuk ishte pajtuar për një gjë të tillë.

PSSP pranoi që derisa Kosova nuk kishte kapacitet të absorbojë një numër të kufizuar të komunitetit ashkali dhe egjiptian, ajo edhe më vështirë do të ishte në gjendje të absorbojë numra më të mëdhenj, një fakt që UNMIK-u vazhdimisht ia kishte theksuar qeverive.

Ai premtoi që këtë ta bëje përsëri gjatë një takimi të nivelit të lartë me qeveritë e shteteve mikpritëse, që do të mbahej më 16 qershor 2005.

PSSP në vazhdim u pajtua që nevojiteshin përpjekje të përbashkëta për të zhvilluara kapacitetin integruar në Kosovë. Derisa vërejtja që përgjegjësia përfundimtare për të integruar dhe ndihmuar të kthyerit në aspektin social qëndronte mbi administratën qendrore dhe lokale të IPVQ-ve, ai theksoi që UNMIK – me shpresë të jetë i përkrahur nga agjencitë e specializuara dhe donatorët – do të ndihmonte në zhvillimin e një skeme për t'u përgjigjur në nevojat e menjëhershme të të kthyerve duke përfshirë këtu edhe të kthyerit me forcë. Një skemë e tillë do të mund të përfshinte strehim të përkohshëm në pritje të rindërtimit të shtëpive, qendra të pranimit apo qasje në strehim dhe shërbime sociale. Si hap i parë, ONM ishte pajtuar ta ndihmojë UNMIK-un në pranimin dhe procedimin e të kthyerve me forcë nga shtetet e Evropës perëndimore me rastin e arritjes së tyre në Kosovë dhe tashmë ishin mbajtur bisedimet e para në këtë temë. Sipas PSSP-së, ONM ishte momentalisht duke e përgatitur një projekt propozim që do t'i dorëzohej qeverive mikpritëse për përkrahje financiare në këtë fushë. Një nga qëllimet e këtij projekti ishte që të ndërtohej një kapacitet i qëndrueshëm në IPVQ-të, në veçanti nëpër komuna, për të pranuar dhe absorbuar të kthyerit e tillë.

Në fund, PSSP ishte duke e konsideruar që së shpejti ta organizojë një takim lidhur me këto çështje ku do të përfshiheshin ministrat dhe komunat përkatëse si dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që faktorët përkatës të informohen për nevojat e të kthyerve dhe të sqarohen rolet dhe përgjegjësitë lidhur me integrimin e tyre social në nivel komunal

Kjo letër e PSSP-së tregon që UNMIK-u është i vetëdijshëm për problemin dhe që është duke u përpjekur që bashkë me IPVQ-të dhe organizatat tjera ndërkombëtare ta gjejë një zgjidhje për këtë çështje.

### ***Të drejtat pronësore***

Si në shumë fusha tjera, mungesa e zbatimit të fortë dhe të vazhdueshëm të ligjeve në Kosovë sjell deri te një situatë ku pronarët e pronave janë të mbrojtur vetëm nëse janë në gjendje ta mbrojnë veten. Në një situatë ku as komunat shpesh herë nuk ndihen të jetë të obliguara t'u përmbahen ligjeve mbi pronën dhe ndërtimet, vazhdon përhapja e ndërtimeve të paligjshme. Ankesat lidhur me mosveprimin dhe korrupsionin e autoriteteve kompetente komunale injorohen ose refuzohen, derisa sistemi ekzistues gjyqësor shpesh herë nxjerr vendime të caktuara në letër që në fund nuk është i fortë sa duhet që t'i zbatojë apo përmbarojë si duhet.

Të parët që pësojnë në një situatë të tillë janë ato pjesë të popullsisë që janë më të lëndueshmet pas që kanë pak përkrahje apo lidhje politike dhe të tjera, për shembull njerëzit e

varfër apo pjesëtarët e komuniteteve të caktuara minoritare. Derisa janë të kufizuar me ligjet në fuqi, ato ligje të njëjta pothuajse nuk ju ofrojnë atyre mbrojtjen që u takon në letër. Në rastet që kanë të bëjnë me ndërtimet e paligjshme ku dëmtohen pronat e fqinjëve apo thjeshtë injorohen planet e zhvillimit, sa për të përmendur disa shembuj, komunat shpesh herë nuk veprojnë kurse kërkesat për caktimin e masës së përkohshme që Ombudspersoni ia dërgon UNMIK-ut ose Ministrive kompetente të IPVQ-ve mbesin pa përgjigje. Vendimet për caktimin e masës së përkohshme të nxjerra nga gjykatat shpesh herë e ndajnë të njëjtin fat.

Ata pjesëtarë të komunitetit serb dhe rom që jetojnë në zonat rurale janë faktikisht plotësisht të pambrojtur. Derisa është shpesh herë e vështirë për pronarët që t'i qasen pronave të tyre për shkaqe të sigurisë apo tjera, personat që i kanë uzurpuar këto prona në mënyrë të paligjshme refuzojnë të largohen dhe ndodh të kërcënojnë pronarët e ligjshëm kur të përpiqen të kthejnë këto prona në posedim, derisa fushat në fshat shpesh herë punohen dhe shfrytëzohen nga ana e fqinjëve shqiptarë pothuajse pa kurrfarë pasojash.

Sa i përket uzurpimeve të paligjshme të banesave dhe shtëpive, duhet të vërehet që DÇPB është organi përgjegjës për vendosjen mbi kërkesat e personave që kanë qenë pronarë, posedues ose mbajtës të drejtës së banimit të pronave të paluajtshme banesore para 24 marsit 1999 dhe që kanë humbur këto të drejta si pasojë e diskriminimit. Prej vitit 1999, këto kërkesa kanë qenë jashtë juridiksionit të gjykatave vendore. DÇPB planifikon që ta përfundojë punën në fund të vitit 2005. Derisa vazhdon të ketë shumë ankesa kundër DÇPB-së lidhur me vonesat për të marrë dhe ekzekutuar vendimet mbi kthimin e pronës në posedim, duket që shumica e rasteve do të zgjidhen deri në fund të vitit. Sido që të jetë, problemet e tilla tani mbeten nën hijen e asaj se çka do të ndodhë pas përfundimit të mandatit të DÇPB-së. Derisa çështja e kthimit në posedim të banesave dhe shtëpive pritet t'u bartet gjykatave vendore, ekzistojnë plane për ta themeluar një lloj agjencie për t'u marrë me administrimin e objekteve të caktuara që u takojnë personave që për arsye të ndryshme ende nuk janë kthyer për t'i kthyer në posedim pronat e tyre. Natyra e saktë e kësaj agjencie duket të mos jetë përcaktuar ende.

Ato shtëpi që u takonin pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare që ishin shkatërruar gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004 tani të shumtën janë rindërtuar. Fatkeqësisht, ky rindërtim shpesh herë është nuk është bërë në mënyrë të vëmendshme dhe të duhur. Në të njëjtën kohë, ndërtesat ndihmëse siç janë stallat apo hambarët kanë filluar të rindërtohen vetëm tani vonë. Kërkesat për kompensim lidhur me shkatërrimin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme janë ende në pritje për t'u zgjidhur pranë gjykatave në Kosovë dhe për shkak të suspendimit të menjëhershëm të rasteve të tilla që e urdhëroi Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut, ende mbetet e paqartë nëse ato do të vazhdojnë të procedohen dhe çfarë do të jetë përfundimi në lidhje me to.

Në fund, dëmet e shkaktuara në pronat pas përfundimit të konfliktit të armatosur të vitit 1999 dhe që nuk ishin shkatërruar gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, momentalisht nuk janë duke u kompensuar fare. Personat që dëshirojnë të rindërtojnë



shtëpitë që nuk janë shkatërruar gjatë këtyre ngjarjeve, por nuk kanë të holla që këtë ta paguajnë vetë, shpesh herë përfundojnë duke shkuar nga njëra zyre administrative në tjetrën pa marrë kurrfarë përgjigje në kërkesën e tyre për ndihmë.

### ***Efektet negative të nivelit ende të pamjaftueshëm të bashkëpunimit mes UNMIK-ut dhe qeverisë së Serbisë***

Përkundër përmirësimeve të caktuara gjatë viteve të fundit, bashkëpunimi mes UNMIK-ut dhe autoriteteve në Serbi ende nuk është në nivel e duhur. Kjo shkakton probleme për shumë nga banorët e Kosovës që gjenden në mes të këtij kontesti politik.

Një nga pasojat kryesore të këtij problemi është fakti që shumë persona të akuzuar të kenë kryer vepra penale në Kosovë dhe që pohohet të jenë duke u fshehur në Serbi ende nuk janë sjellë para drejtësisë. Në fillim të periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni e ngriti këtë çështje te Ministri i Drejtësisë i Serbisë lidhur me një rast, mirëpo kurrë nuk pranoi ndonjë përgjigje në këtë letër

Kontesti politik mes UNMIK-ut dhe Serbisë gjithashtu krijon probleme praktike për shumë banorë të Kosovës. Një nga këto ka pasoja negative për të gjithë banorët e Kosovës – shumë dokumente që i lëshon UNMIK-u ende nuk njihen plotësisht në Serbi dhe disa shtete tjera. Zyrat administrative në shtetet e jashtme shpesh herë kërkojnë dokumentet e vjetra jugosllave, që shkakton probleme për shumë banorë të Kosovës pasi që shumica e këtyre dokumenteve janë të arkivuara në Serbi dhe për këtë arsye të paarritshme. Në raste individuale, që zakonisht përfshinin juristë shumë të vendosur apo institucione tjera siç është, për shembull, Institucioni i Ombudspersonit, njerëzit kanë mundur të marrin dokumentet civile, mirëpo kjo më shumë përbën përjashtim se sa rregull.

Në mënyrë që të udhëtojnë në Serbi dhe në disa shtete tjera të rajonit, banorëve të Kosovës ende u duhet që të shkojnë në institucionet paralele që veprojnë në enklava apo në Serbi dhe të kërkojnë pasaportë apo patentë shoferi. Tabelat “KS” të regjistrimit të automjeteve të nxjerra nga UNMIK-u nuk pranohen në Serbi dhe disa shtete tjera të rajonit dhe atyre që dëshirojnë të shkojnë në Kosovën veriore u nevojitet që t’i ndërrojnë apo edhe t’i heqin tabelat e regjistrimit të automjeteve pasi të kenë kaluar pikat e kontrollimit të KFOR-it. Procedura e njëjtë mund të shihet edhe nëpër kufijtë administrativ mes Kosovës dhe Serbisë.

Në anën tjetër, problemi i tabelave të regjistrimit të automjeteve të lëshuara nga institucionet paralele në pjesën tjetër të Kosovës duket që tani është zgjidhur. UNMIK-u ka nxjerrë një Rregullore ku ka theksuar qartas që tabelat e regjistrimit të automjeteve të lëshuara nga institucionet e papranuara nga UNMIK-u mund të ndërrohen falas me tabelat e lëshuara nga UNMIK-u deri në 1 korrik 2005. Rishtas, ky afat është zgjatuar deri në dhjetor të vitit 2005. Megjithatë, personat që dëshirojnë të udhëtojnë në Serbi dhe shtete tjera që nuk i

pranojnë tabelat dhe dokumentet e automjetit të lëshuara nga UNMIK-u do të mund t'i mbajnë tabelat e regjistrimit të automjetit, tani të paligjshme, për t'i përdorur në ato vende jashtë Kosovës. Fatkeqësisht, përmbajtja e këtij ligji duket të mos u jetë bërë e qartë policëve të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), shumë prej të cilëve filluan që para 1 korrikut 2005 të konfiskojnë tabelat e regjistrimit dhe dokumentet e automjeteve të lëshuara nga institucionet paralele. Në disa raste, ata gjithashtu konfiskuan tabelat e regjistrimit të automjeteve që i kishte lëshuar ligjërisht administrata normale dhe jo paralele civile në Serbi dhe që ende mund të qarkullojnë nëpër Kosovë.

Përveç SHPK-së, pjesë të caktuara të popullsisë që e flasin gjuhën serbë gjithashtu patën vështirësi ta kuptojnë rregulloren e re pasi që, së paku deri në fillim të qershorit të vitit 2005, ajo ende nuk ishte përkthyer në gjuhën serbe.

Një problem tjetër i shkaktuar nga raportet e vështira mes autoriteteve në Kosovë dhe atyre në Serbi është fakti që deri më tani nuk ka qenë e mundur për shqiptarët kosovarë që të kenë qasje në llogaritë e tyre të kursimeve në "Jugobankën" e dikurshme. Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Ombudspersoni i ka shkruar disa herë për këtë autoriteteve kompetente në Serbi. Fatkeqësisht, deri më tani nuk ka pasur ndonjë rezultat lidhur me këtë çështje. Informata e fundit nga ana serbe ishte që sipas Ligjit mbi shlyerjen e borxhit publik të Republikës Federative të Jugosllavisë përmes kursimeve devizore të qytetarëve si dhe rregulloreve të qeverisë të nxjerra në lidhje me të, të gjithë personave që ia paguajnë tatimin Administratës Tatimore të Serbisë u lejohet që të kthejnë kursimet e tyre. Pasi që banorët e Kosovës, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, nuk i paguajnë më tatimet shtetit të Serbisë, ligji në fuqi nuk ofron ndonjë mënyrë tjetër përmes të cilët ata do të mund t'i kthejnë të hollat e tyre. Duke marrë parasysh numrin e njerëzve në Kosovë të ndikuar nga ky problem, Ombudspersoni e shqyrtoi këtë me PSSP-në dhe kërkoi nga ai që atë ta ngrit këtë çështje në takimin e ardhshëm me autoritetet e Serbisë.

Në disa raste ku policia vendore kishte arrestuar individë për shkak të posedimit të patentë shoferit ose dokumenteve të regjistrimit të automjetit të lëshuara nga strukturat paralele serbe, prokurorët publik kishin filluar procedurën penale kundër këtyre individëve për përdorim të dokumenteve të falsifikuara. Fatkeqësisht, në këto raste ata nuk duket ta bëjnë dallimin mes dokumenteve të falsifikuara dhe dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e papranuara nga UNMIK-u. Kjo situatë ishte përmirësuar deri në një masë pas publikimit të raportit të Ombudspersonit mbi këtë në fund të vitit 2003. Mirëpo, kohëve të fundit, Ombudspersoni përsëri ka filluar të pranojë ankesa lidhur me këtë problem.

# AKTIVITETET DHE VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT

## *Aktivitetet kryesore*

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ishte aktiv në një numër të fuqshave të ndryshme. Në shumë raste, ai bëri përpjekje të përmirësive sistemin ekzistues të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë duke propozuar aprovimin apo korigjimin e ligjeve apo një zbatim të përmirësuar të ligjeve të zbatueshme në këtë drejtim. Ankesat e individëve apo grupeve të individëve ishin ngritur me autoritetet kompetente ndërkombëtare apo lokale, në veçanti, por jo të kufizuara vetëm në situatat e komuniteteve minoritare, të kthyerve, pensionistëve apo grupeve të tjera të cenueshme në kuadër të shoqërisë kosovare. Ombudspersoni shpesh herë ka vepruar si një ndërmjetësues në mes të individëve të ndikuar dhe autoriteteve publike. Për këtë arsye, ai udhëtoi nëpër Kosovë dhe zonat tjera në rajon dhe pati shumë takime dhe diskutime me persona të ndryshëm të përfshirë në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë Kosovës.

Bashkëpunimi me zyrat e ndryshme në kuadër të UNMIK-ut ka vazhduar gjatë periudhës për të cilën raportohet, në veçanti me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), personat që punojnë në zyrën e tij, Zëvendësin e tij dhe Zëvendësit përgjegjës për Administratën civile, Polici dhe Drejtësi, Demokratizim dhe Ndërtim të Institucioneve dhe Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik për të diskutuar çështje të caktuara që përputhen me mandatet e tyre përkatëse. Gjithashtu, kishte kontakte të shpeshta në mes Institucionit të Ombudspersonit dhe Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, si dhe mes mes të Institucionit dhe Drejtorit Ekzekutiv të DÇPB-së. Ombudspersoni mirëmbajti bashkëpunimin me Koordinatorin e UNMIK-ut për Standarde, kryesisht duke e informuar atë lidhur me të gjitha intervenimet e rëndësishme, raportet apo letrat e të drejtuara UNMIK-ut dhe IPVQ-ve. Së voni, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit bashkë me Zyrën e OSBE-së, Zyrën e Komisionarit të lartë të KB-ve për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë dhe Kuvendin e Kosovës është përfshirë në një grup punues si rrjedhim i idesë së PSSP-së për kosovarizimin e Institucioni të Ombudspersonit.

Përgjatë periudhës raportuese, Ombudspersoni gjithashtu ka pasur takime me shumë përfaqësues të IPVQ-së në nivelin qendror duke përfshirë edhe Presidentin e Kosovës, Kryeministrin e Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe udhëheqësit e partive kryesore opozitare në kuvend, për të diskutuar çështjet e ndryshme të të drejtave të njeriut dhe të ardhmen e Institucionit të Ombudspersonit. Ai ka mbajtur kontakte me shumë Ministra të ndryshëm të Qeverisë së tashme të Kosovës, si dhe me një numër të udhëheqësve komunal.

Ombudspersoni gjithashtu ka themeluar bashkëpunim me Këshillin e Kuvendit të Kosovës për Çështje Juridike, Legjislative dhe të Kornizës kushtetuese, me nën-këshillat për

Barazi gjinore, Peticione dhe Ankesa Publike dhe Personat e Pagjetur, në vazhden e të cilave, deri në muajin maj të vitit 2005, ky këshill rregullisht ia ka përcjellë Ombudspersonit ankesat që i kishte pranuar.

Sikur në periudhat paraprake për të cilat është raportuar, Ombudspersoni ka mirëmbajtur kontakte të rregullta me misionet diplomatike të shteteve të ndryshme si në Prishtinë, ashtu edhe në Beograd.

Ai ka pasur konsultime të dyanshme të rregullta me shumë organe në kuadër të Këshillit të Evropës dhe sekretariatit të tij, se dhe me OSBE-në.

Edhe pse Institucioni i Ombudspersonit nuk ka juridiksion mbi KFOR-in, bashkëpunimi me KFOR-in në raste të caktuara ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Ombudspersoni dhe personeli i Institucionit të Ombudspersonit kanë pasur disa takime apo forma tjera të kontakteve me Komandantin e KFOR-it, Këshilltarin Ligjor të KFOR-it dhe komandantët e ndryshëm rajonal të KFOR-it. Poashtu një bashkëpunim i tij i konsiderueshëm kishte qenë edhe me njësitë e ndryshme të KFOR-it në lidhje me çështjet e ndryshme të lidhura më së shumti me sigurinë dhe ndihmën humanitare, në veçanti lidhur me pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe serb ende të zhvendosur pas trazirave të 17 – 20 Marsit 2004.

Me qëllim të kryerjes së hulumtimeve në aspektet e caktuara ligjore që kanë të bëjnë me ngjarjet e dhunshme në Kosovë gjatë muajit mars 2004, Ombudspersoni ka krijuar lidhjet me Qendrën ndërkombëtare për mbrojtjen ligjore të të drejtave të njeriut (INTERIGHTS) në Londër, e cila ka përgatitur një dokument hulumtues për të drejtën lëndore të organeve të ndryshme ndërkombëtare vendimmarrëse lidhur me problemet e caktuara të të drejtave të njeriut që u shfaqën gjatë dhe pas ngjarjeve të marsit.

Ombudspersoni poashtu ka vazhduar të jetë në kontakt më Kryesuesin e Qendrës Koordinuese për Kosovë e Metohi të Qeverisë serbe, në veçanti lidhur me sigurimin e dokumenteve për pjesëtarët e komunitetit ashkali që janë duke qëndruar në kampin francez të KFOR-it pas ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004. Ombudspersoni më tutje ka vazhduar një bashkëpunim të frytshëm më Zyrat e Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut në Beograd dhe Prishtinë, një bashkëpunim që kishte filluar gjatë periudhave të mëparshme për të cilat është raportuar.

Dy herë gjatë periudhës për të cilën raportohet, një delegacion nga Institucioni i Ombudspersonit është takuar me udhëheqësit politik të minoritetit ashkali, rom, boshnjak, goran dhe turk me qëllim të vlerësimit të situatës së këtyre minoriteteve. Këto takime u mbajtën në Zyrën qendrore të Institucionit në Prishtinë. Ndaras nga takimet e tilla, Ombudspersoni ka mirëmbajtur kontakte të përditshme me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të minoriteteve dhe i ka vizituar ato rregullisht.

Në gjysmën e parë të periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka vizituar disa herë dy kampe të personave të zhvendosur brenda vendit në Kosovën veriore dhe prej atëherë ka pasur kontakte të rregullta me OJQ-të e përfshira në ndihmën për të përmirë-

suar kushtet jetësore të këtyre romëve, siç janë Këshilli Danez për Refugjatë dhe Qendra Informativ e PZhBV-ve në Mitrovicë. Ai ngriti këtë çështje me shumë persona jashtë Kosovës, duke përfshirë përfaqësuesit e Këshillit të Evropës dhe anëtarët e Shtëpisë së Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar, të cilët u përgjigjën duke e diskutuar këtë dhe duke kërkuar një raport qeveritar lidhur me këtë çështje.

Lidhur me situatën e PZhBV-ve që janë duke qëndruar në Serbi, Ombudspersoni ka mbajtur kontaktin me Komisionarin Serb për refugjatë. Ai gjithashtu ka ngritur çështjen e të drejtave dhe statusit PZhBV-ve që janë duke qëndruar në Serbi dhe në Mal të zi me kryeministrat e këtyre vendeve.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni gjithashtu ka qenë i angazhuar edhe në çështjen e personave të kthyer me forcë, në veçanti atyre të përkatësive etnike të caktuara minoritare, duke ngritur problemet me të cilat ballafaqohen këta njerëz në Kosovë me shtetet nikoqire dhe me PSSP-në, si dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Sikur edhe gjatë periudhës së fundit për të cilën është raportuar, Ombudspersoni i ka vizituar të gjitha Zyrat e Gjykatave dhe Prokurorive të Qarkut në Kosovë, si dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, me qëllim të vlerësimit të situatës së tanishme të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë.

Ombudspersoni ka vazhduar të bashkëpunojë dhe komunikojë me OJQ-të e caktuara ndërkombëtare që punojnë në Kosovë, në veçanti me “Human Rights Watch” dhe Organizatën humanitare spanjolle “Lëvizja për paqe, çarmatim dhe liri”. Përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu u takuan rregullisht me anëtarët e Misionit monitorues të BE-së, për të diskutuar dhe për t’i informuar ata lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe zbatimin e standardeve në këtë drejtim.

Gjithashtu, Ombudspersoni në masë të madhe ka përforcuar kontaktet e tij me Qendrën e të Drejtës Humanitare në Beograd dhe zyrën e saj në Prishtinë, me të cilat ka realizuar shkëmbime të rregullta të informacioneve. Ai është takuar me kryesuesin e Zyrës KNKK-së në Prishtinë, si dhe me kryesuesin e Zyrës së Komisionarit të Lartë të KB-ve për refugjatë në Prishtinë dhe me përfaqësuesit e OBSH-së, dhe ka mbajtur kontakte me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe me Qeveritë e Evropës perëndimore dhe regionit të Ballkanit duke i informuar ato lidhur me veprimet e Institucionit të Ombudspersonit.

Institucioni i Ombudspersonit poashtu ka krijuar kontakte me Komitetin Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Stokholm dhe me zyrën e tij në Beograd.

Gjithashtu në këtë periudhë për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka vazhduar të interesohet për problemet me të cilat janë ballafaquar personat e përkatësive etnike shqiptare të cilët kanë dëshiruar të kenë qasje në llogaritë e tyre të kursimit në “Jugobankën” e Serbisë. Ai ka mbajtur korrespondencë lidhur me këtë çështje me Bankën Kombëtare

të Serbisë dhe me Administratën Tatimore të Serbisë, dhe ka kërkuar nga PSSP-ja që të intervenojë në lidhje këtë, duke pasur parasysh numrin e madh të shqiptarëve kosovarë të ndikuar nga kjo çështje.

Në të njëjtën kohë, çështja e njohjes dhe mundësia e kompensimit nga ana e NATO-s për viktimat që kanë ndodhur kur NATO kishte bombarduar aksidentalisht një autobus me udhëtarë në urën afër Luzhanit dhe rastet e ngjashme mbesin një çështje e rëndësishme në agjendën e Ombudspersonit. Me qëllim të avancimit të kësaj çështjeje, ai u takua me familjet e viktimave dhe Shefin e zyrës së programit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut për personat e zhdukur dhe mjekësinë ligjore.

Në lidhje me Ligjin mbi qasjen në dokumentet zyrtare (Nr. 2003/12), që ishte publikuar nga PSSP-ja në periudhën e fundit për të cilën është raportuar, juristët e Ombudspersonit morën pjesë në nismat për ta promovuar këtë ligji. Në një rast një jurist i Institucionit të Ombudspersonit ishte mori pjesë në një seminar për mbrojtjen e të dhënave në Bruksel të Belgjikës, ku e prezantoi ligjin në Kosovë dhe rolin e Ombudspersonit në këtë kontekst.

Në janar të vitit 2005, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e miratoi një rezolutë dhe rekomandimet për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë pas një raporti të përgatitur nga Komisioni për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut. Ky raport ishte rezultat i shume kontakteve dhe shkëmbimeve të informacioneve të Raportuesit të Komisionit të lartpërmendur dhe Ombudspersonit, nga i cili u kërkuar që të komentonte draftin e raportit para se t'i parashtrohet Asamblesë Parlamentare. Ombudspersoni gjithashtu ishte ftuar që të japë një deklaratë gjatë debatit që i parapriu miratimit të rezolutës dhe rekomandimeve të mësipërme.

Gjatë majit dhe qershorit të vitit 2005, studentë nga Fakulteti Juridik i Prishtinës kanë kryer mësimin praktik në Institucionin e Ombudspersonit. Mësimi praktik në Institucionin e Ombudspersonit ishte poashtu një nga shpërblimet për fituesin e Sfidës së Rasteve të Kosovës 2004, një ushtrim simulimi i seancës gjyqësore në të cilën nga pjesëmarrësit kërkohej që të simulojnë procedurat para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Një student i cili merr pjesë në Programin rajonal evropian për Magjistraturë në Demokraci dhe të Drejtat e njeriut në Evropën juglindore, i koordinuar nga Universitetet e Sarajevës dhe të Bolonjës, ka vizituar Institucionin e Ombudspersonit për një kohë të shkurtër.

Me caktimin e një Këshilltari ndërkombëtarë për media në Institucionin e Ombudspersonit në Korrik 2004, është përmirësuar në masë të madhe bashkëpunimi dhe paraqitja e Ombudspersonit në mediat brenda dhe jashtë Kosovës, në veçanti përmes spoteve televizive dhe atyre të radios. Prezantimi i Ombudspersonit në internet është zgjeruar dhe përmirësuar. Kështu, Gjatë, publiku kështu ishte më mirë i informuar gjatë periudhës për të cilën raportohet për secilin intervenim dhe për aktivitetet e tjera të Ombudspersonit, si dhe në lidhje me vizitat e tij të ndryshme dhe takimet brenda dhe jashtë Kosovës.

Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të publikojë Informatoren Periodik, i cili ofron

informacione lidhur me aktivitetet kryesore të Institucionit çdo tre muaj. Informatori Perioidik, i publikuar në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe turke, ishte shpërndarë në masë të madhe brenda dhe jashtë Kosovës – vetëm në gjuhën angleze janë shpërndarë 1500 kopje për persona dhe institucione të ndryshme në Kosovë dhe në botë.

Në shtator të vitit 2004, Ombudspersoni filloi ta publikojë rubrikën “Në besim” në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe “Koha Ditore”, si dhe në gazetën ditore në gjuhën serbe “Danas”. Kjo rubrikë publikohet çdo të premte të dytë dhe mbulon probleme të ndryshme ekzistuese të të drejtave të njeriut në Kosovën e sotme. Temat e mëparshme të kësaj rubrike kanë qenë, mes tjerash, problemet e PZhbV-ve romë në Kosovën veriore, mungesa e pensioneve adekuate, problemi i kthimeve të qëndrueshme, gjyqësori në Kosovë, çështjet e diskriminimit, çështja e komuniteteve në faljes së ndërsjellë të komuniteteve për të këqijat e së kaluarës, problemi i personave të pagjetur dhe ambienti i ndotur në Kosovë. Që nga fillimi, rubrika është publikuar rregullisht në gjuhën angleze dhe frënge në shumë shërbime të lajmeve në internet që kanë të bëjnë me çështjet e Ballkanit, siç janë “Transitions Online” dhe “Le Courier des Balkans”.

Në ato të premte kur botohet rubrika “Në besim”, Ombudspersoni ka filluar që prej 15 qershorit të vitit 2005, të publikojë në “Kohën Ditore” përmbledhjet të hollësishme të të drejtës lëndore të rasteve të zgjedhura të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që do të mund të jenë relevante edhe për Kosovën. Këto përmbledhje shoqërohen me analiza të shkurta që lidhin subjektin e lëndës në fjalë me situatën në Kosovë.

Një edicion i ri i dokumenteve ligjore të Ombudspersonit, respektivisht që përmban bazën ligjore dhe rregullat procedurale të Institucionit, është publikuar në janar të vitit 2005 në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

### ***Grupi për të Drejtat e Fëmijëve***

I themeluar më 8 mars 2004, me qëllim të përmirësimit të punës së Institucionit të Ombudspersonit në fushën e të drejtave të fëmijëve, Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) ishte lansuar zyrtarisht në muajin maj 2004. Aktivitetet primare të këtij grupi përfshijnë hetimet në aspektin e përgjithshëm të shkeljes të të drejtave të fëmijëve si dhe ankesat individuale nga fëmijët apo nga ata që përfaqësojnë fëmijët, gjithmonë duke marrë parasysh interesin më të mirë për fëmijët e përfshirë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përveç hetimeve, GDF-ja kishte përqendruar përpjekjet e veta në ngritjen e prezencës në mesin e shoqërisë kosovare. Këto aktivitete kishin përfshirë fillimisht publikimin e fletushkave që përmbanin informacione themelore për rolin e GDF-së dhe ishin adresuar për të gjithë aplikantët potencial, në veçanti për fëmijët, sikur edhe për institucionet dhe OJQ-të që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. GDF gjithashtu ka krijuar kontakte me OJQ-të ndërkombëtare dhe lokale që punojnë në

këtë fushë, ndërsa një nga juristët që punon në këtë grup rregullisht ka marrë pjesë në takimet e Forumit për të drejtat e fëmijëve. Juristi dhe Koordinator i GDF-së kanë marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe programe televizive për të drejtat e fëmijëve, apo për çështjet lidhur me këto të drejta. Në të njëjtën kohë, personeli i GDF-së ka marrë pjesë në trajnime, seminare dhe vizita studimore jashtë vendit.

Kohët e fundit, GDF lansoi fushatën për vetëdijësimin mbi të drejtat e fëmijëve, me qëllim të shpërndarjes të informacioneve në lidhje me aktivitetet e GDF-së në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit drejtpërdrejtë tek fëmijët. Si hap i parë, janë planet për përforsimin e bashkëpunimit me shkollat, ashtu që përfaqësuesit e GDF -së të jenë në gjendje që të vizitojnë shkollat dhe të informojnë fëmijët drejtpërdrejtë lidhur me punën e GDF -së në këtë drejtim.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, personeli kryesor i GDF -së ka procesuar hetimet në rastet që kanë lidhje me aspektet e ndryshme të të drejtave të fëmijëve, siç janë besimi në ruajtje dhe edukimi i fëmijëve, shërbimet dhe kujdesi shëndetësor, ribashkimi i anëtarëve të familjes, arsimimi, keqtrajtimi i fëmijëve dhe siguria e fëmijëve. Në veçanti, GDF ka filluar hetimet e çështjeve që kanë të bëjnë me problemet me të cilat ballafaqohen shumë prindër në rajonin e Kosovës, të cilët nuk janë në gjendje të blejnë librat shkollore për fëmijët e tyre që vijnë në mësimet në shkollën fillore, rastet e pohuara të keqtrajtimit të fëmijëve në shkolla dhe rasti i vendeve “të zeza” në komunikacion rrugor, përkatësisht zona të rrezikshme të komunikacionit për fëmijët. GDF poashtu ka kryer hetimet lidhur me kushtet jetësore dhe shëndetësore të fëmijëve romë të cilët janë duke qëndruar në kampet në pjesën veriore të Kosovës, si dhe në situatën e shkollave të shumta nëpër Kosovë në të cilat uji nuk është i pijshëm.

Në gusht 2004, njëzet e shtatë fëmijë nga Kosova kanë vizituar qytetin Napoli në Itali ku kanë qëndruar një javë. Ky udhëtim ishte organizuar nga Institucioni i Ombudspersonit dhe nga komuna e Napolit. Fëmijët të moshës mes 10 dhe 14 vjeçare, ishin me përkatësi etnike shqiptar, serb, rom, turk dhe ishin nga Prishtina dhe Graçanica.

### ***Grupi për mos-diskriminim***

GMD-ja ishte themeluar më 8 mars 2004, me qëllim të përmirësimit të punës së Institucionit të Ombudspersonit në fushën e mos-diskriminimit.

GMD-ja kryen hetime në të gjitha llojet e diskriminimit, duke përfshirë, por jo e kufizuar në diskriminimin në bazë të fesë, origjinës, mendimit politik apo në lidhje me pakicat kombëtare apo moshën.

Ligji kundër diskriminimit, i shpallur më 20 gusht 2004, përmes rregullores së UNMIK-ut Nr. 32/2004, e autorizon Ombudspersonin që të parnojë dhe hetojë ankesa lidhur me



shkeljen e të drejtave të bazuara në diskriminim. Në pajtueshmëri me nenin 4 të Ligjit kundër diskriminimit, Ombudspersoni gjithashtu mund të kryejë hetime në ankesat lidhur me diskriminimin në sektorin privat.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, punonjësit kyç të GMD-së kanë procesuar hetime në rastet në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në kuadër të IPVQ-ve, si dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare në procedurat gjyqësore ku përfshihen palët e një komuniteti i cili nuk e flet gjuhën që e flet shumica. GMD-ja gjithashtu ka filluar të shqyrtojë se a kanë qenë kushtet jetësore në kampet e romëve në veri të Kosovës në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe për praktikën për të cilat pohoet të ketë pasur diskriminim në procedurat që përfshijnë dhënien e ndihmave për viktimat e termetit i cili kishte goditur komunën e Gjilanit më 2002. GMD-ja gjithashtu është marrë me rastet që përfshijnë ankesat për diskriminim në lidhje me rezultatet e procedurave të ndarjes së banesave të zhvilluara nga komuna e Obiliqit. Grupi për mos-diskriminim ka publikuar një raport mbi diskriminim në moshë në konkurset për punësim në sektorin publik.

GMD-ja gjithashtu ka monitoruar procesin e kthimit të romëve, që jetonin në kampet në veri të Kosovës, në shtëpitë e tyre të dikurshme që gjenden në anën jugore të lumit Ibër në Mitrovicë, e njohur si lagjja e romëve.

Përveç kësaj, GMD-ja ka punuar në një rast që përfshinte një trajtim, për të cilin pohoet të ketë qenë diskriminues, të ish punëtorëve shqiptarë në kompleksin e minierës së Trepçës. Punëtorët ankoheshin se ishin përjashtuar nga një marrëveshje e nënshkruar mes UNMIK-ut dhe përfaqësuesve të ish punëtorëve serb të kompleksit të Trepçës, sipas të cilës këta të fundit do të pranonin kompenzim nga Buxheti i Kosovës.

Gjithashtu, GMD ka ekzaminuar ankesat e paranuara prej civilëve të plagosur gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët prej përfundimit të konfliktit të vitit 1999, ankohen se nuk kanë marrë pensionet e tyre invalidore civile apo ndonjë formë tjetër të ndihmës që u takonte atyre. Gjithashtu, GMD është marrë me ankesat e pranuar nga personat me paafësi fizike të cilët kanë deklaruar se autoritetet kompetente nuk u kishin lëshuar atyre patentë shoferin.

Në të njejtën kohë, deri në themelimin e NJBGJ-së, juristët që punojnë për GMD-në kanë qenë të angazhuar në gjetjen e zgjidhjeve dhe në ofrimin e asistencës për viktimat e dhunimit gjatë konfliktit të vitit 1999.

### ***Njësia për barazi gjinore***

NJBGJ është themeluar më 2 korrik 2004 me qëllim të implementimit të nenit 6 të Ligjit për barazi gjinore të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/18, më 7 qershor 2004. Në pajtueshmëri me nenin 6, çështjet e diskriminimit që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me

gjininë “do të trajtohen nga njësia për barazi gjinore në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit [...], i cili po ashtu ka përgjegjësi të rishikojë projektligjet, të japë komente lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe legjislacionit ekzistues kur ka të bëjë me çështjet gjinore”.

Dispozita e lartpërmendur zgjeron mandatin e Ombudspersonit për rishikimin e draftit dhe legjislacionit ekzistues kur janë në pyetje çështjet gjinore dhe për të komentuar lidhur me implementimin e ligjit për barazi gjinore. Për më tepër, në pajtueshmëri me dispozitën në fjalë, Institucioni i Ombudspersonit është institucioni i vetëm në Kosovë me mandat për të pranuar ankesa për diskriminimin e bazuar në gjini.

Për shkak të fondeve të pamjaftueshme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, NJBGJ ka filluar të veprojë më 1 shkurt 2005. Njëra nga rastet që i ka kaluar kësaj njësie nga GMD ka të bëjë me një ankesë nga një grup i viktimave të dhunimit gjatë konfliktit të vitit 1999, të cilat nuk kishin marrë kurrfarë përkrahje sociale nga autoritetet përgjegjëse.

Gjithashtu, NJBGJ ka hapur hetime në diskriminimet e mundshme të bazuara në gjini në qasjen në punësim në institucionet publike, si dhe në problemet e caktuara me të cilat ballafaqohen shtetasit e huaj të martuar me kosovarë në marrjen e lejeve të qëndrimit. Në të njëjtën kohë, NJBGJ është duke monitoruar një rast gjyqësor ku përfshihet largimi i një gruaje nga puna për të cilin pohoet të jetë bërë bazuar në gjini. Rasti tjetër në lidhje me largimin, për të cilin pohoet të ketë qenë i paligjshëm, nga puna të një mësueseje femër e cila kishte refuzuar të ndjekë rregullat e shkollës që synonin ndalimin e mbajtjes së shamive të kokës në shkollë dhe në një rast tjetër pengimin e një nxënëseje për të vijuar mësimet në shkollë për shkak të mbajtjes së ferexhes në klasë.

## ***Ndërmjetësimi***

Njëra nga detyrat e Ombudspersonit është ndërmjetësimi dhe ofrimi i zyreve të mira në rastet kur ka gjasë që të zgjidhen mosmarrëveshjet apo konfliktet në këtë mënyrë. Kjo pjesë e punës së Institucionit të Ombudspersonit konsiderohet të jetë një pjesë shumë e rëndësishme e aktiviteteve të këtij institucioni pasi që shumica e rasteve, në veçanti rastet CR (rastet për reagim) kanë një aspekt ndërmjetësimi.

Rastet në vijim janë shembuj të ndërmjetësimit të sukseshëm në të cilat Institucioni i Ombudspersonit ka ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Ombudspersoni ishte i përfshirë në fazat e ndryshme lidhur me problemet me të cilat ballafaqoheshin pjesëtarët e komunitetit ashkali nga Vushtrria. Si pasojë e sulmeve ndaj shtëpive të tyre gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit 2004, të gjithë ashkalitë nga Vushtrria ishin evakuuar në bazat e KFOR-it francez. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme për organizimin e transferimit të ashkalive në një motel afër Vushtrrisë, por secilën herë, ata kishin refuzuar këtë mundësi. Pas intervenimeve të Institucionit të Ombudspersonit,

në bashkëpunim me UNMIK-un, KFOR-in francez dhe Qendrën koordinuese serbe për Kosovë e Metohi, familjet e ashkalive kishin marrë dokumentet e udhëtimit dhe ato të identifikimit nga qeveria e Serbisë në shtator të vitit 2004, kështu që ata ishin në gjendje të lëshojnë kampin. Shumë prej tyre e lëshuan Kosovën derisa të tjerët u shpërndanë për të jetuar në pjesët e tjera të Kosovës. Para disa muajve, disa u kthyen në shtëpitë e tyre të rindërtuara, ku ata janë duke jetuar tash nën mbrojtjen e përhershme të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Një numër i kufizuar i tyre janë vendosur në motelin e lartpërmendur, objektet e të cilit ishin shëndërruar *de facto* në qendër kolektive.

Ombudspersoni, poashtu ishte i angazhuar në bisedime në mes banorëve të Batushës, një fshat serb, dhe autoriteteve të ndryshme lidhur me problemet e rrymës elektrike në të cilat kishin hasur banorët e këtij fshati për gati tre muaj gjatë dimrit. Pas takimit me Ombudspersonin, Kryetari i komunës së Fushë Kosovës vendosi të nënshkruajë një kontratë me KEK-un në emër të fshatit dhe të paguajë një depozit për borxhet në mënyrë që fshati të rikyçet në furnizimin me rrymë elektrike.

Për më tepër, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë ndërhyrë në një rast ku përfshiheshin fëmijët pa prindër apo pa kujdestar, të cilët nuk merrnin ndihmë sociale. Pasi që Ombudspersoni kishte kontaktuar me Drejtorin e qendrës për mirëqenie sociale në Prishtinë, fëmijëve u ishin dhënë të gjitha dokumentacionet e nevojshme me qëllim që të merrnin ndihmën sociale. Përveç kësaj, Qendra për mirëqenie sociale vizitonte fëmijët rregullisht dhe njëri prej tyre kishte filluar të vijojë mësimet me ndihmën e qendrës së lartpërmendur.

### ***Bashkëpunimi me Institucionet tjera të Ombudspersonit dhe organet e ngjashme***

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë me Institucionet e ngjashme në shtetet tjera në rastet ku angazhimi i autoriteteve të këtyre shteteve ishte i nevojshëm për të zgjidhur problemet me të cilat ishin ballafaquar individët nga Kosova. Bashkëpunimi për qëllime të tilla ishte bërë, për shembull, me Ombudsmanin e Bosnjës dhe Hercegovinës, të IRJM-së, Danimarkës, Norvegjisë dhe Suedisë, Ndërmjetësuesin në Francë, si edhe me Komisionet për Ankesa të Bundestagut Gjerman dhe të Parlamenteve të Shteteve Federale të caktuara gjermane. Disa nga rastet kanë përfshirë ankesat e personave të kthyer me forcë apo kundër trupave kombëtare të KFOR-it.

Gjatë vitit të fundit, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë bërë prezantime për punën e Institucionit të Ombudspersonit në “Ombudsmani në Evropën jug-lindore - Konferencë për Përmirësimin e Bashkëpunimit Rajonal” në Serbi dhe Mal të Zi, në Tryezën e Rrumbullakët të Ombudsmanëve Evropianë në Danimarkë, si dhe në një seminar mbi “Trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me ambientin nga Ombudsmani” në

Greqi, të organizuar nga Ombudsmeni i Greqisë dhe të financuar nga Programi Eonomia për promovimin e Institucioneve të Ombudsmanit në Evropën jug-lindore.

Në shtator të vitit 2004, një delegacion nga Institucioni i Ombudspersonit i bëri një vizitë Institucionit të Ombudsmanit në Slloveni për të shkëmbyer përvojat, kryesisht në fushën e TI-së, veprimeve financiare dhe administrative dhe në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Kjo ishte përcjellë nga një vizitë e Zëvendës Ombudsmanit të Sllovenisë në Zyrën Qendrore të Institucionit të Ombudspersonit në Prishtinë. Ombudspersoni gjithashtu pranoi një vizitë nga Ombudsmeni i Luksemburgut.

Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu ka bashkëpunuar me Institucionet e Ombudsmanit në rajonin e Ballkanit duke iu falënderuar një Programi të Shkëmbimit Rajonal të bazuar në një projekt të përbashkët të ZIDDNJ-së (Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut - ZIDDNJ) në kuadër të OSBE-së dhe Institucionit të Ombudspersonit. Ky program, i themeluar në tetor të vitit 2004, përfshin programet e shkëmbimit të juristëve në mes të Institucioneve të Ombudsmanit në Shqipëri, IRJM dhe Mal të Zi. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, programet e tilla të shkëmbimit u realizuan në mes të Institucionit dhe Institucioneve të Ombudspersonit në Shqipëri, IRJM dhe Mal të Zi. Ky program, ku juristët vizitorë janë të obliguar të marrin pjesë në aktivitetet ditore të Institucioneve që i presin, në veçanti duke punuar në rastet e ndara për juristin të cilin ata e zëvendësojnë, synon që anëtarëve të përfshirë të personelit t'ua mundësojë të shtojnë njohuritë e tyre dhe të shkëmbejnë informacione me Institucionin që i pret. Për më tepër, një bashkëpunim i fortë në mes të Institucioneve të Ombudsmanit në rajon do të ndihmojë në bashkëveprimin dhe avancimin e përkrahjes së të drejtave të njeriut në këtë pjesë të Evropës.

Institucioni i Ombudspersonit ka vendosur kontakte me Zyrën e Popullit (Narodna Kancelarija) në Beograd në kuadër të Zyrës së Presidentit të Serbisë. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i ka dërguar disa raste në Zyrën e Popullit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me Administratën Publike në Serbi.

Përveç kësaj, Institucioni u ka shpërndarë Informatorin Periodik tremujor të gjitha Institucioneve të Ombudsmanit në Evropë për t'i informuar ato lidhur me aktivitetet e tij të fundit dhe për të shkëmbyer përvojën e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

### ***Përmbledhja e rasteve***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht katër mijë njerëz kanë kontaktuar në mënyrë individuale Institucionin e Ombudspersonit në Prishtinë si dhe zyrat në terren për të paraqitur ankesat formale apo për të kërkuar këshilla dhe ndihmë.

Gjatë tetëdhjetë “ditëve të hapura” për periudhën për të cilën raportohet, përafërsisht një

mijë e shtatëqind njerëz janë takuar personalisht me Ombudspersonin apo zëvendësin e tij në Prishtinë apo në gjashtë zyret në terren në pjesët e ndryshme të Kosovës.

Në periudhën mes 1 korrikut 2004 dhe 30 qershorit 2005, Ombudspersoni ka regjistruar përkohësisht katërqind e katërdhjetë e gjashtë raste të aplikimit. Njëqind e tridhjetë e gjashtë raste ishin deklaruar si të papranueshme për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike, dhe se kërkesat kishin qenë të pabazuara apo për shkak të faktit se ato ishin jashtë juridiksionit të Ombudspersonit. Dyqindë e gjashtëmbëdhjetë raste të tjera ishin larguar nga lista – Njëqind e tridhjetë e tetë prej tyre ishin zgjidhur pozitivisht dhe shtatëdhjetë e tetë ishin mbyllur, *inter alia*, për shkak të mos interesimit të kandidatëve në vazhdimin e hetimeve.

Shumica e rasteve të hetuara nga Institucioni i Ombudspersonit lidhur me çështjet procedurale, siç është zgjatja e procedurave para gjykatave civile dhe DÇPB-së, aktet administrative apo lënja pas dore e tyre nga autoritetet publike kompetente, çështjet e pronës, ankesat për keqpërdorim të autoritetit, e drejta në çështjet gjyqësore, ankesat lidhur me punësim apo çështjet e pandëshkueshmërisë (shih shtojcën 1). Përveç këtyre aplikacioneve, Ombudspersoni ka publikuar njëzet e dy raporte, prej të cilave shtatëmbëdhjetë ishin raporte të rasteve dhe pesë ishin publikuar pas hetimeve *ex officio* (shih Aneksin 3 për përmbledhjet e këtyre raporteve). Disa nga raportet e lartpërmendura kishin të bëjnë me zgjatje të çështjeve procedurale, derisa të tjerat ishin në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të personave të sëmurë mental në repartin psikiatrik, hetimet penale joadekuate, diskriminimi sipas moshës gjatë shpalljeve të konkurseve për punësim në sektorin publik, diskriminimi sipas gjinisë dhe keqtrajtimit që pohoet të jenë bërë nga Policia e UNMIK-ut.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka bërë gjashtë kërkesa për masa të përkohshme dhe i ka dërguar gjashtë letra urgjente për intervenim PSSP-së apo Ministrisë të Shërbimeve Publike. Tri nga këto kërkesa ishin të sukseshme ndërsa nëntë të pasukseshme (shih Aneksin 2). Shumica e këtyre kërkesave kishin të bëjnë me largimet me forcë dhe rrënimi i objekteve, si dhe me mosveprimin e autoriteteve publike në shfaqjen e veprimeve ilegale apo keqpërdorim të autoritetit.

Ombudspersoni ka regjistruar pesëqind e shtatëdhjetë e tre raste CR, që nënkuptojnë rastet të cilat nuk kërkojnë hetime të plota formale por kërkojnë më shumë intervenime të caktuara apo aktivitete të ndërmjetësimit, prej të cilave tetëdhjetë e tre ishin të sukseshme dhe njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë të tjera ishin mbyllur për shkak të arsyeve të ndryshme. Shumica e rasteve CR të trajtuara nga Institucioni i Ombudspersonit kishin të bënin më probleme që përfshinin rindërtimin e shtëpive, çështjet e mirëqenies sociale, ankesat lidhur me mundësitë e akomodimit dhe çështjet lidhur me punësimin.

## ***Përkrahja financiare dhe në të mira***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka shfrytëzuar fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, si dhe nga donatorët bilateral në vijim: Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Polonia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara. Projekte speciale janë financuar nga Këshilli i Evropës, ODIHR-ja, UNICEF-i dhe UNIFEM-i.

Në qershor të viti 2004, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) miratoi projektin për arsimim të avancuar për punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit në fushën e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, administratës së përgjithshme, pajtimit dhe ndërmjetësimit. Metodatat për ta arritur këtë do të përfshijnë trajnime të avancuara në fushën e të drejtave të njeriut ose në fusha të ngjashme, kurse të gjuhës angleze, trajnime për administratën dhe menaxhimin e zyrës, si dhe vizita studimi në institucione të ndryshme të Ombudsmanit. Partneri zbatues i SIDA-së në këtë projekt është menduar të jetë Këshilli i Evropës, i cili do ta nënshkruajë në një të ardhme të afërt një marrëveshje zbatimi me SIDA-në.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Këshilli i Evropës ka organizuar dhe financuar, mes tjerash, një vizitë studimi për 15 juristë të Institucionit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Këshillin e Evropës në Strasburg, Francë, vizita konsultimi të Ombudspersoni në Strasburg në shtator të vitit 2004, janar të vitit 2005 dhe maj të vitit 2005, si dhe pjesëmarrjen e Zëvendës Ombudspersonit në Tryezën e rrumbullakët të Ombudsmanëve në Kopenhagë të Danimarkës.

Në shtator të vitit 2004, Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka financuar një vizitë studiuuese të tre juristëve nga Institucioni i Ombudspersonit në shkollën verore të Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë të Polonisë.

Në tetor të vitit 2004, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve ka organizuar dhe financuar, me mbështetjen e Ministrisë Mbretërore të Norvegjisë për Çështje të Jashtme, pjesëmarrjen e dy juristëve nga Institucioni i Ombudspersonit në një seminar mbi “Institucionet e Ombudsmanit dhe të drejtat e minoriteteve” që u mbajt në Ohër, IRJM.

Në nëntor të vitit 2004, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve ka organizuar dhe financuar pjesëmarrjen e dy punonjësve të Institucionit të Ombudspersonit në një “Vizitë studimi rajonit kufitar mes Gjermanisë dhe Danimarkës (Schleswig-Holstein)”, në Flensburg, Gjermani, për një shkëmbim të përvojave në mes të Institucioneve të Ombudsmanit në lidhje me çështjet e minoriteteve dhe të drejtat e njeriut. Gjatë të njëjtit muaj, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri ka organizuar dhe mbështetur financiarisht pjesëmarrjen e dy punonjësve të Institucionit në një kurs trajnimi lidhur me mjetet e sistemeve ndërkombëtare të klasifikimit të informatave dhe dokumentacionit për të drejtat e njeriut në Tiranë, Shqipëri.

Në dhjetor të vitit 2004, Avokati i Popullit në Shqipëri e financoi pjesëmarrjen e Drejtorit

të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit në Konferencën Kombëtare për të Drejtat e Punës në Tiranë, Shqipëri.

Në janar të vitit 2005, Komisioni Evropian ka financuar pjesëmarrjen e një juristi nga Institucioni i Ombudspersonit në një “Seminar mbi mbrojtjen e të dhënave” në Bruksel, Belgjikë.

Në shkurt të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit ia arriti të hapë një zyrë të re në terren në Graçanicë duke iu falënderuar ndihmës speciale të siguruar nga ana e Agjencisë për Zhvillim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austrisë.

Në qershor 2005, pjesëmarrja e Zëvendës drejtorit të Hetimeve për programet speciale të Institucionit të Ombudspersonit në një takim të Ombudspersonit në Prespa, Greqi, ishte financuar nga projekti Eunomia, një projekt i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Ombudsmanit të Greqisë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ZIDDNJ ka financuar Programin e shkëmbimit rajonal që kishte përfshirë shkëmbimin e juristëve të Institucionit të Ombudspersonit dhe juristëve të Institucioneve të Ombudsmanit në Shqipëri, IRJM dhe Mal të Zi.

Duke iu falënderuar mbështetjes së UNIFEM-it, Njësia për Barazi Gjinore në kuadër të Institucionit pati mundësinë të shtypë broshurat në gjuhën shqipe, serbe dhe turke për ta informuar publikun lidhur me diskriminimin e bazuar në gjini në mënyrë që t`ua mundësojë personave që ndihen të jenë viktima të diskriminimit të tillë që ta kontaktojnë Institucionin.

Si rezultat i marrëveshjes për bashkëpunim në projekte mes UNICEF-it dhe Institucionit të Ombudspersonit, UNICEF-i ka financuar pagën e juristit i cili punon në Grupin për të Drejtat e Fëmijëve në kuadër të Institucionit, si dhe në aktivitete tjera në lidhje me realizimin e projektit, siç janë trajnimet, vizitat studimi dhe materiali informues.

### ***Perspektivat e ardhshme për Institucionin e Ombudspersonit***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet është treguar një përparim i mëtejshëm në përgatitjen e Institucionit për kosovarizimin komplet të tij.

Pas vendimit të tij për të zgatur mandatin e Ombudspersonit të tanishëm edhe një herë deri në fund të dhjetorit të vitit 2005, PSSP theksoi në letrën e tij të datës 15 qershor 2005 për Ombudspersonin që ai pret nga ky i fundit që ta shfrytëzojë pjesën e mbetur të vitit 2005 për të kryer të gjithë hapat e nevojshëm, në bashkëpunim të ngushtë me UNMIK-un, IPVQ-të dhe OSBE-në, për arritjen e një kalimi të qetë në një udhëheqje të Institucionit nga një kosovar, duke përfshirë edhe gjetjen e një pasuesi kosovar për Ombudspersonin.

Siç është përmendur në raportin vjetor paraprak, sikur edhe në shumë biseda me PSSP-

në, kryesuesit e misioneve diplomatike në Prishtinë dhe Beograd, kryesuesin e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe përfaqësuesit e ndryshëm të Këshillit të Evropës, Ombudspersoni konsideron se është akoma shumë herët që një hap i tillë të zbatohet në tërësi. Megjithatë, duke marrë parasysh vendosjen e PSSP-së që kjo të bëhet, ai është pajtuar që të ofrojë çfarëdo mbështetje që është e nevojshme në fazën përfundimtare të procesit të kosovarizimit dhe synon që të lërë Institucionin në një pozitë që të mund të përballet me sfidat e reja dhe të vazhdojë të kryej rolin e veçantë që edhe pritet nga njerëzit e Kosovës.

Lidhur me këtë, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit ishte thirrur që të marrë pjesë në një grup punues të themeluar nga OSBE-ja dhe të përbërë nga përfaqësuesit e OSBE-së, Kuvendit të Kosovës dhe Zyrës së Komisionarit të lartë të KB-së për të drejtat e njeriut. Grupi punues filloi të takohet kah fundi i majit të vitit 2005 dhe adoptoi një orar kohor sipas të cilit parashihej që, me qëllim që t'i mundësohet Institucionit që të bëhet një Institucion i plotë vendor deri me 1 janar 2006, identifikimi i një grupi të kandidatëve vendor potencial për vendet udhëheqëse në kuadër të Institucionit duhet të fillojë deri në muajin korrik 2005, derisa një projektligj për Institucionin duhet të përgatitet dhe parashtrohet te organet përgjegjëse deri në muajin shtator 2005.

Në të njëjtën kohë, Ombudspersoni ka vazhduar të dërgojë punonjës të ndryshëm vendor në trajnime të ndryshme, konferenca, seminare dhe vizita studimi. Në takimet e ndryshme ndërkombëtare të Ombudsmanëve, Institucioni i Ombudspersonit ishte përfaqësuar nga zëvendësit e tij vendor apo nga punonjësit tjerë të lartë. Trajnimet e mëtejshme të avancuara janë planifikuar, në veçanti një projekt special i financuar nga SIDA që përfshinte programe të ndryshme me Këshillin e Evropës si një partner zbatues.

Megjithatë, të gjitha përpjekjet e mësipërme për të siguruar se Ombudspersoni dhe personeli i tij do të jenë të gatshëm të bëhen pjesë e strukturave vendore në Kosovë lënë anash pyetjen kryesore në këtë kontekst –më saktë, nëse Kosova është gatshme për një tranzicion të tillë.

Një nga problemet më të mëdha lidhur me këtë është fakti se nuk ka shumë gjasa që administrata ndërkombëtare në Kosovë do ta lejojë Ombudspersonin vendor që të kontrollojë punën e saj nga perspektiva e të drejtave të njeriut, ashtu që qytetarët të cilët ankohen kundër strukturave të caktuara të UNMIK-ut apo strukturave të ngjashme ndërkombëtare të ardhshme nuk do të jenë më në gjendje që të dërgojnë ankesat e tyre në Institucionin i Ombudspersonit. Për momentin, Institucioni i Ombudspersonit me një Ombudsperson ndërkombëtarë në krye të tij, është i vetmi institucion i pavarur mbikëqyrës ndërkombëtar që është kompetent që merret me ankesat që kanë të bëjnë me prezencën ndërkombëtare në Kosovë. Pas përfundimit të mandatit të një Ombudspersoni ndërkombëtar, nuk është e qartë se cili entitet, nëse ekziston ndonjë, do të jetë në pozitë që të plotësojë këtë vakum.

Gjetja e një apo më shumë kandidatëve të përshtatshëm do të jetë gjithashtu një sfidë të madhe. Ombudspersoni i Kosovës duhet të jetë një individ i cili nuk ka qenë i implikuar në konfliktin e Kosovës dhe i cili duhet të qëndrojë qartë mbi zënkat ndër-politike që domi-




nojnë në horizontin politik në Kosovë. Ai apo ajo duhet të ketë autoritet personal, një nivel të lartë të shkollimit dhe përvojës në fushën e të drejtave të njeriut. Ajo më e rëndësishmja është se Ombudspersoni vendor do të duhet të jetë dikush që do të mund ta gëzonte besimin e banorëve të Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, si dhe besimin e bashkësisë ndërkombëtare.

Në të njëjtën kohë, çfarëdo plani për kosovarizimin e Institucionit të Ombudspersonit në tërësi do të duhet të llogarisë në rolin e veçantë të Institucionit. Pjesët e caktuara të Institucionit sikur zyra në terren në Graçanicë dhe Njësia për Barazi Gjinore, të cilat tani janë duke u financuar nga donatorët ndërkombëtarë, në rast të tillë do të kenë nevojë për financim të ardhshëm nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, derisa atyre projekteve që ishin filluar para kosovarizimit duhet t' u mundësohet që të vazhdojnë dhe të zhvillohen. Pagat e punonjësve të Institucionit do të duhej të përcaktohen në një mënyrë të qëndrueshme dhe duhet të jenë të një niveli i cili do të siguronte një të ardhme profesionale solide për të Institucionit. Në të njëjtën kohë, me qëllim të mirëmbajtjes së një niveli të qëndrueshëm të trajnimit dhe arsimimit në fushat e ndryshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe kapacitetit për t' u zhvilluar më tutje, Institucioni nuk duhet të mbetet pa një mbështetje të mjaftueshme ndërkombëtare.

Këto dyshime ishin ndarë nga shumë të tjerë, për shembull në Këshillin e Evropës, Asambleja Parlamentare e të cilit ka përfshirë të ardhmen e Ombudspersonit në dy nga rezolutat e saj respektivisht në Janar dhe Qershor të vitit 2005. Në të dy rezolutat, Asambleja Parlamentare e kishte nxitur UNMIK-un që të mirëmbajë statusin “ndërkombëtar” të Institucionit të Ombudspersonit apo së paku juridiksionin e Ombudspersonit mbi autoritetet ndërkombëtare për aq kohë sa ato do të mbesin në Kosovë.

Do të jetë një sfidë e madhe për të gjitha entitetet e përfshira që të tejkalojnë të gjitha këto vështirësi në mënyrë që të sigurohet që edhe në të ardhmen, Ombudspersoni dhe punonjësit e Institucionit do të jenë në pozitë që ndihmojnë ata të cilët i drejtohen Ombudspersonit si mundësi e fundit për të kërkuar ndihmë në ballafaqimin e tyre me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe keqpërdorimit të autoriteteve. Së paku në këtë periudhë kalimtare në shumë aspekte, Ombudspersoni frikohet që e gjithë kjo nuk mund të garantohet nga një Institucion i cili nuk ka një “spirancë” ndërkombëtare, derisa është një pjesë përbërëse e strukturave vendore në Kosovë. Megjithatë, duke marrë parasysh vendosjen e administratës ndërkombëtare për kosovarizimin e Institucionit së shpejti, ai është i përkushtuar që të mundohet të sigurojë sa më shumë që të jetë e mundur rrethanat e përshtatshme lidhur me këtë dhe shpreson, edhe pse me jo edhe aq bindje, se dyshimet e tij lidhur me këtë do të dëshmojnë të kenë genë të kota.

**Marek Antoni Nowicki**  
**Ombudspersoni në Kosovë**



# Aneksi 1: Përmbledhje statistikore e rasteve (1 korrik 2004 - 30 qershor 2005)

<b>ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËRKOHËSISHT (APLIKACIONET):</b>	<b>446</b>
<b>PËRKATËSIA ETNIKE E APLIKANTËVE:</b>	
Shqiptarë:.....	323
Serbë:.....	104
Të tjerë:.....	23
<b>PALËT PËRGJEGJËSE:</b>	
UNMIK:.....	297
IPVQ:.....	103
DÇPB:.....	42
KFOR:.....	1
Të tjera:.....	7
<b>ÇËSHTJET E SHPALLURA TË PAPRANUESHME</b>	<b>136</b>
<b>ÇËSHTJET E FSHIRA NGA LISTA:</b>	
ÇËSHTJET E ZGJIDHURA POZITIVISHT:.....	138
ÇËSHTJET E NDËRPRERA GJATË PROCEDURËS PËR ARSYE TJERA:.....	78
<b>HETIMET E HAPURA</b>	
HETIMET E BAZUARA NË APLIKACIONE:.....	12
HETIMET <i>EX OFFICIO</i> :.....	8
<b>RAPORTET PËRFUNDIMTARE TË PUBLIKUARA</b>	
RAPORTE MBI RASTET:.....	22
RAPORTE SPECIALE:.....	0
<b>KËRKESAT PËR MASA TË PËRKOHSHME:</b>	
<b>RASTET PËR VEPRIM (GJITHSEJT)</b>	<b>573</b>
RASTET E ZGJIDHURAA POZITIVISHT:.....	83
RASTET E NDËRPRERA GJATË PROCEDURËS PËR ARSYE TJERA:.....	166
<b>KORRESPONCA E PRANUAR:</b>	
<b>KORRESPONDENCA E DËRGUAR:</b>	<b>1840</b>
<b>1876</b>	

## **Tema e lëndëve të aplikacioneve formale** **( 1 korrik 2004 - 30 qershor 2005)**

Zgjatja e procedurës civile në gjykatë: .....	131
Çështjet e pronës dhe lidhur me të (DÇPB):.....	144
Çështjet e pronës dhe lidhur me të ( të tjera):.....	66
Mungesë e hetimeve efikase mbi veprat penale:.....	4
Keqpërdorim i autorizimeve:.....	28
Heshtja administrative dhe çështjet lidhur me të:.....	51
Çështjet lidhur me të drejtën për gjykatë:.....	84
Çështjet lidhur me punësimin:.....	27
Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore: .....	20
E drejta për liri:.....	4
Zgjatja e procedurës penale në gjykatë:.....	14
Të ndryshme:.....	10

## **Aneksi 2: Masat e Përkohshme dhe kërkesa të tjera për veprime urgjente (1 korrik 2004 – 30 qershor 2005)**

### ***Dështimi për ta përmbuar një vendim që kishte suspenduar ndërtimin e paligjshëm në Pejë***

*Më 13 maj 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikanti ankohej për mos përmbarimin e vendimit të nxjerrë më 13 prill 2004 nga ana e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Rural të Komunës së Pejës, përmes të cilit e kishte urdhëruar palën e tretë që ta ndalë ndërtimin e paligjshëm të objektit banesor në largësi prej dhjetë metrash nga shtëpia e aplikantit. Gërmimet për themelin e objektit banesor ishin bërë aq afër garazhit së aplikantit sa që garazhi kishte rrëshqitur në gropë, duke paraqitur kështu rrezik të caktuar edhe për shtëpinë e aplikantit. Më 11 qershor 2004, Ombudspersoni i dërgoi Ushtruesit të detyrës së PSSP-së një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ai që të garantojë që Komuna e Pejës ta ndalë ndërtimin e paligjshëm që ishte duke dëmtuar pronën e aplikantit në afërsi.*

**Më 20 korrik 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut në Pejë, përmes të cilës e informonte atë që i kishte shkruar Komunës së Pejës për të pyetur çfarë ajo planifikonte të bënte për ta zgjidhur këtë çështje. Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut shkroi që edhe pse Drejtoria për Planifikim Urban dhe Rural të Komunës së Pejës, në letrën e saj të datës 2 korrik 2004, i kishte përfshirë një seri të veprimeve që Komuna i kishte ndërmarrë, Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut e kishte vizituar vendin në fjalë dhe kishte gjetur që ndërtimet dukej të ishin ndalur, mirëpo në atë vend ende gjendej një ekskavator. Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut e siguroi Ombudspersonin që do të vazhdonte ta mbikëqyrë situatën dhe, nëse e nevojshme, do ta mbante Ombudspersonin të azhurnuar në lidhje me rastin. Ai gjithashtu e informoi Ombudspersonin që, nën autorizimin e tij, punonjësit e kishin përpiluar një listë të keqadministrimeve prej shtatorit të vitit 2003, të cilën ia kishin dorëzuar Komandantit Rajonal të Policisë më 7 korrik 2004 dhe për këtë e kishin lajmëruar Këshillin Komunal në Pejë. Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut përfundoi që ishte një listë e gjatë e rasteve, pesëmbëdhjetë prej të cilave kishin qenë pikat qendrore për zyrën e tij, ku Kryeshefi Ekzekutiv i kishte tejkaluar autorizimet e tij, nuk kishte vepruar në pajtim me procesin e kërkuar dhe kishte shpenzuar fonde komunale pa ju përmbajtur procedurave të drejta. Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut e mbylli letrën e tij duke shtuar që Komandanti Rajonal i Policisë e kishte informuar atë që dosja i ishte përcjellë prokurorit ndërkombëtar në Pejë dhe që ai shpresonte sinqerisht që do të zhvillohen hetimet e duhura dhe të ngritën aktakuzat kundër zyrtarëve të ndryshëm të Komunës.

## **Mosveprimi i Komunës së Gjakovës ndaj ndërtimeve të paligjshme**

*Më 24 gusht 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikanti dhe të tjerët ankoheshin që Komuna e Gjakovës nuk kishte ndërmarrë kurrfarë veprimi në përgjigje të ankesave të shumta kundër një ndërtimi të pohuar të paligjshëm të një objekti banesor në afërsi të shtëpisë së aplikantit.*

**Më 26 gusht 2004**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ai që të reagojë ndaj mungesës së intervenimit nga ana e Komunës. Ombudspersoni përshkroi se si, me vazhdimin e ndërtimit, shtëpitë e aplikantit dhe fqinjëve të tij kishin pësuar dëme. Ombudspersoni shtoi që aplikanti iu kishte drejtuar disa herë autoriteteve komunale me kërkesa për të dalë vendin e ngjarjes dhe për ta vërtetuar dëmin e shkaktuar dhe rrezikun që kanosej nga punët ndërtimore. Megjithatë, kërkesat e tij drejtuar Komunës për të ndaluar punët ndërtimore mbetën pa përgjigje. Ombudspersoni kërkoi nga PSSP që të ndërmarrë veprime urgjente për të garantuar që ndërtimi i objektit banesor në fjalë të ndalet, në pritje të përfundimit të hetimeve të Ombudspersonit lidhur me rastin, si dhe kërkoi nga PSSP që ta informojë lidhur me çfarëdo veprimi të ndërmarrë lidhur me këtë çështje.

**Më 10 shtator 2004**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë të dytë për caktimin e masës së përkohshme, duke theksuar që nuk ishte informuar për çfarëdo veprimi që ishte ndërmarrë në këtë çështje, si dhe nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje në letrën e tij të dërguar dy javë më herët. Ombudspersoni përsëriti kërkesën e tij për të garantuar që ndërtimi i objektit banesor në Gjakovë të ndalet dhe që të informohet lidhur me çfarëdo mase që ndërmerret në këtë drejtim.

**Më 17 shtator 2004**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga PSSP ku theksohej që vëmendjen e tij për këtë çështje së pari ia kishte drejtuar Peshkopi Artemije i Rashkës dhe Prizrenit, gjatë një takimi me të më 25 gusht 2004. PSSP shkroi që ai pastaj e kishte diskutuar këtë çështje me Kryeministrin e Kosovës, Kryetarin e Gjakovës, Kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Kryesuesin e Shtyllës II të UNMIK-ut dhe Përfaqësuesin Rajonal të UNMIK-ut për Rajonin Jug-Perëndimor. PSSP shtoi që çështjen e konsideronte të jetë nën hetime, por e ndjente një nevojë që ta vizitonte atë lokacion personalisht pas 27 shtatorit 2004 për t'u informuar sa më mirë rreth situatës.

**Më 29 shtator 2004**, Ombudspersoni iu përgjigj PSSP-së, duke e informuar atë që UNMIK-u ndoshta i kishte keqkuptuar rrethanat e këtij rasti. Ombudspersoni e bashkëngjiti një letër të shkruar nga aplikanti në të cilën ai e kishte shprehur befasinë ndaj përgjigjes së pranuar nga PSSP, pasi që personalitetet e përmendura në këtë përgjigje kurrë nuk kishin qenë të përfshirë në rastin e tij. Në të njëjtën kohë, sipas aplikantit, ndërtimi i paligjshme kishte vazhduar dhe paraqiste rrezik për të shkaktuar dëme të reja pronës së tij. Ombudspersoni i bëri thirrje PSSP-së që të ndalë ndërtimet në afërsi të pronës së aplikantit në pritje të hetimeve të mëtejshme të tij lidhur me rastin.

**Më 3 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Zëvendës PSSP për Administratën Civile, përmes të cilës e informoi që IPVQ-të, posaçërisht Ministria e Shërbimeve Publike, do të merreshin tani me refuzimin e shërbyesve komunal civil për të ndërmarrë veprimet e kërkuara nga zyra e tyre. Zëvendës PSSP e informoi Ombudspersoni që kërkesa e tij ishte përcjellë Ministrisë së Shërbimeve Publike.

**Më 10 dhjetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi Ministres së Shërbimeve Publike një kërkesë për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ajo që të garantojë që ndërtimi i objektit banesor në fjalë të ndalet, në pritje të përfundimit të hetimeve të Ombudspersonit lidhur me rastin. Ombudspersoni gjithashtu kërkoi që të informohet lidhur me çfarëdo veprimi të ndërmarrë lidhur me këtë çështje.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë kërkesë.**

### ***Eksproprijimi i pohuar i paligjshëm i tokës për Aeroportin e Prishtinës***

*Më 26 tetor 2004, Ombudspersoni e pranoi një aplikacion, nga i cili kuptohej që aplikanti ankohej rreth vendimit të marrë nga PSSP përmes të cilit 4.90,70 hektarë të tokës së tij pohohej të ishin eksproprijuar pa bazë ligjore për nevojat e Aeroportit Civil të Prishtinës. Gjashtë ditë më herët, aplikanti ia kishte dërguar një letër PSSP-së ku kishte kërkuar rishqyrtimin e këtij vendimi, duke pohuar që ai nuk ishte në përputhje me kërkesën për eksproprijim që e kishte bërë Aeroporti i Prishtinës lidhur me eksproprijimin e 24,28 ari tokë të aplikantit. Aplikanti nuk kishte marrë kurrfarë përgjigje në kërkesën e tij.*

**Më 27 tetor 2004**, Ombudspersoni kërkoi PSSP-së një kërkesë për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga PSSP-ja që të ndalë të gjitha punët ndërtimore për Aeroportin Civil të Prishtinës që kishin lidhje me tokën e aplikantit deri sa të nxirrej një vendim lidhur me kërkesën e aplikantit për rishqyrtimin e vendimit të mëhershëm të gjykatës për të eksproprijuar 4.90,70 hektarë të tokës së tij.

**Më 29 prill 2005**, Ombudspersoni dërgoi një letër përkujtimi PSSP-së, duke e informuar që aplikanti në ndërkohë kishte marrë një vendim nga Gjykata Komonale në Lipjan, përmes të cilit ajo e kishte urdhëruar ndaljen e të gjitha punëve ndërtimore në tokën e aplikantit. Gjithashtu, Ombudspersoni kërkoi informacione lidhur me veprimet që PSSP i kishte ndërmarrë apo planifikonte t'i ndërmarrë në lidhje me këtë rast.

**Më 10 qershor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga aplikanti në të cilën ai e kishte theksuar që rasti ishte zgjidhur në mënyrë të kënaqshme për të dy palët. Aplikanti e falënderoi Ombudspersonin për ndihmën dhe intervenimin e tij në këtë rast.

## **Rrënimi i një shtëpi që gjendej në tokën që pohohej të jetë pronë e Komunës së Prizrenit**

Më 20 tetor 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion, përmes të cilit aplikanti ankohej rreth një njoftimi për përmbarimin e vendimit përfundimtar të nxjerrë nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Juridike pranë Komunës së Prizrenit, me të cilin kishte urdhëruar rrënimin e shtëpisë së tij që gjendej në tokën që pohohej të jetë pronë e Komunës së Prizrenit. Aplikanti, që aty ishte duke jetuar prej vitit 1975, kishte bërë kërkesë pranë Gjykatës Komunale në Prizren në prill të vitit 2004 për ta vërtetuar të drejtën e tij pronësore mbi tokën në fjalë. Në shtator të vitit 2004, ai kishte kërkuar nga Gjykata Komunale që të nxjerrë vendim mbi caktimin e masës së përkohshme.

**Më 5 nëntor 2004**, Ombudspersoni dërgoi PSSP-së një kërkesë për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ai që të garantojë suspendimin e vendimit përmbarues që urdhëronte aplikantit që ta rrënojë shtëpinë e tij, në pritje të hetimeve të tij mbi rastin si dhe deri sa nxirret aktgjykimi i formës së prerë lidhur me vërtetimin e të drejtës pronësore të aplikantit mbi tokën e lartpërmendur.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë kërkesë.**

## **Dëbimi me forcë nga barrakat e kompanisë “Kablar”**

Më 22 nëntor 2004, përfaqësuesit e më shumë se njëqind personave që ishin duke jetuar në barrakat që gjendeshin në Dardani të Prishtinës e që më parë kishin qenë pronë e kompanisë serbe “Kablar”, erdhën te Ombudspersoni për ta informuar që të nesërmen do të dëboheshin nga këto baraka, ku ata ishin duke qëndruar pasi që shtëpitë e tyre ishin shkatërruar gjatë konfliktit të vitit 1999. Dëbimi ishte bazuar në një vendim të Gjykatës komunale në Prishtinë, të konfirmuar në Gjykatën e qarkut në Prishtinë, përkundër dyshimeve të shprehura nga aplikantët dhe personat e tretë lidhur me ligjshmërinë e këtij dëbimi. Atëherë rasti ishte dërguar në Gjykatën supreme të Kosovës, ku ishte në pritje për t'u zgjidhur.

**Më 22 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë urgjente për masa të përkohshme dhe kërkoi nga ai që të përdorë autorizimet e tij për të garantuar që procedura e dëbimit të suspendohet në pritje të përfundimit të hetimeve të Ombudspersonit mbi këtë çështje, si dhe në pritje të përfundimit të procedurës pranë Gjykatës Supreme. Një kopje e kësaj kërkesë i ishte dërguar edhe kryetarit të komunës së Prishtinës.

**Më 23 nëntor 2004**, përfaqësuesit e aplikantëve erdhën në Insitucionin e Ombudspersonit dhe e informuan që policia kishte ardhur për t'i dëbuar nga barrakat. Edhe pse aplikantët ia kishin treguar policisë kopjen e kërkesës së Ombudspersonit për masa të përkohshme, punëtorët fizik e kishin nxjerrë pronën e tyre të luajtshme dhe e kishin lënë në rrugë. Aplikantët u ankuan që gjësende me vlerë u ishin vjedhur gjatë këtij procesi dhe që, përkundër

temperaturavë nën zero gradë celzius, nuk kishin ku të shkojnë.

Në pasditën e së njejtës ditë, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit i vizituan barakat dhe panë që mobiljet e aplikantëve ishin ende nëpër rrugë. Derisa rojet e sigurimit që ishin duke ruajtur dyert që shpënin te barakat thanë që pothuajse të gjithë njerëzit ishin strehuar, aplikantët i informuan përfaqësuesit e Ombudspersonit që Komuna, deri atëherë, nuk kishte ndërmarrë kurrfarë masa për të siguruar strehim për ta.

Më vonë gjatë të njejtës ditë, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë të dytë urgjente për masa të përkohshme, në të cilën e informoi atë për situatën dhe pyeti për atë që autoritetet përgjegjëse ndërkombëtare dhe vendore planifikonin ta bëjnë për të parandaluar të ndodhë një krizë humanitare në qendër të Prishtinës. Ai përsëri e nxiti PSSP-në të garantojë që veprimet përkatëse për ta zgjidhur këtë çështje të ndërmerren pa vonesë të mëtejshme. Kjo letër gjithashtu iu dërgua edhe kryetarit të Komunës së Prishtinës. Gjithashtu më 23 nëntor 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër koordinatorës së Njesisë për Inspektion Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë, përgjegjëse për të hetuar sjelljet e pahijshme të gjykatësve dhe prokurorëve, përmes së cilës kërkoi nga kjo Njësi që të fillojë procedurën disiplinore kundër gjykatësve që kishin qenë të përfshirë në aktgjykimet që kishin sjellë deri te dëbimi. Ombudspersoni kërkoi nga koordinatorja që këtij rasti t'i japë prioritet.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nga ana e përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit dhe përfaqësuesve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, të cilët ofruan edhe të paguajnë dhomat e hotelit për fëmijët dhe gratë për atë natë, personat e dëbuar e kaluan natën e 23 nëntorit 2004 në kafenetë dhe restorantet përreth, që pronarët i lanë hapur për atë qëllim.

Gjatë ditëve në vijim, Ombudspersoni pati shumë takime me aplikantët dhe përfaqësuesit e Komunës. Në fund, komuna ofroi strehim për aplikantët, që ata e konsideruan të pamjaftueshëm për të akomoduar vetën dhe mobiljet e tyre.

**Më 3 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga koordinatorja e Njesisë për Inspektion Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë, përmes së cilës e informoi Ombudspersonin që Njësia e saj i kishte filluar hetimet mbi rastin e mësipërm dhe që atij do t'i jepej prioritet.

**Më 6 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër të datës 2 dhjetor 2004 nga zëvendësi kryesor i PSSP-së, përmes së cilës ai u përgjigj në kërkesën e Ombudspersonit për masa të përkohshme. Në letrën e tij, zëvendësi kryesor i PSSP-së, e informoi Ombudspersonin që faktet lidhur me situatën nuk përputheshin me disa nga vlerësimet në letrën e Ombudspersonit, pasi që familjet në fjalë nuk i ishin drejtuar kurrë Komunës për ndihmë gjatë pesë muajve sa kishte qenë në pritje procedura e dëbimit. Megjithatë, zëvendësi kryesor i PSSP-së konsideroi që autoritetet komunale, në bashkëpunim me stafin e UNMIK-ut, ishin angazhuar në këtë çështje mënjëhere pasi që ishin informuar për atë. Më 25 nëntor 2004, u ofrua strehimi të cilin e refuzuan familjet e dëbuara. Zëvendësi kryesor i PSSP-së e



mbylli letrën e tij duke konsideruar që vlerësimi i Ombudspersonit se nuk ishte ndërmarrë asgjë për të iu përgjigjur rrethanave ekzistuese ishte “i gabueshëm dhe i padenjë”. Ai sugjeroi që, në të ardhmën, Ombudspersoni të kontaktojë zyret e IPVQ-ve dhe UNMIK-ut para se të “sulmojë përpjekjet e punëtorëve të zellshëm që ishin të angazhuar për t’i shërbyer Kosovës dhe popullit të saj”. Sipas zëvendësit kryesor të PSSP-së, “besueshmëria e Institucionit të Ombudspersonit dhe efikasiteti i tij në emër të atyre që kërkojnë ndihmën e tij do të përmirësohen përmes hetimit serioze paraprake dhe përmes dialogut të matur”.

**Më 10 dhjetor 2004**, Ombudspersoni u përgjigj në letrën e zëvendësit kryesor të PSSP-së duke e informuar atë që, sipas informatave që i kishte në dispozicion, aplikantët kishin kontaktuar disa herë Komunën, në veçanti kryetarin e Komunës, Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, pasi që kishin marrë informatat që ishte filluar procedura e dëbimit kundër tyre. Secilën herë, personat përkatës u kishin thënë që nuk kishin arsye të brengosen pasi që dëbimi nuk do të ishte i mundshëm në një të ardhme të parashikueshme. Prandaj, pohimet e Komunës që nuk kishte pasur informata mbi rastin nuk dukej të jenë të sakta. Ai vërejti që me faktet gjithashtu nuk përputhej pohimi që autoritetet komunale ishin angazhuar menjëherë në çështjen e lartpërmendur menjëherë pasi që ishin informuar për të, pasi që kopjet e letrave të Ombudspersonit drejtuar PSSP-së më 22 dhe 23 nëntor 2004 i ishin dërguar edhe Komunës, por nuk kishin marrë përgjigje. Vetëm pas letrës nga përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut në Prishtinë drejtuar zëvendës kryetarit të Këshillit Komunal dhe kryeshefit ekzekutiv të Komunës, dhe pas një numri të thirrjeve të përfaqësuesve të Insitucionit drejtuar zëvendës kryetarit të Këshillit Komunal, që Komuna në fund u angazhua në këtë çështje. Lidhur me strehimin e ofruar nga ana e Komunës, Ombudspersoni e informoi z. Rossin që aplikantët e kishin konsiderur si tepër të vogël për të vendosur të gjithë njerëzit dhe gjësendet e tyre dhe shtoi që plotësisht e kuptonte mosdashjen e tyre të plotë që të ndahen nga mobiljet dhe gjësendet tjera të tyre, që ishin të vetmet që tani u kishin mbetur. Në fund, Ombudspersoni e kundërshtoi fuqimisht kritikën e zëvendësit kryesor të PSSP-së lidhur me punën e Institucionit të Ombudspersonit në këtë rast, në veçanti komentin e tij që intervenimi i Ombudspersonit në këtë çështje ishte i gabueshëm dhe i padenjë. Në një situatë të tillë, Ombudspersoni e konsideroi të jetë obligim i tij ta informojë UNMIK-un dhe të kërkojë nga PSSP që garantojë që autoritetet kompetente komunale t’i dhënë fund një shkelje të tillë të rëndë të të drejtave të njeriut. Ombudspersoni gjeti të ishte për të ardhur keq që në vend që Institucioni i Ombudspersonit dhe UNMIK-u të kenë një bashkëpunim të frytshëm dhe të nevojshëm, intervenimi i tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut në Kosovë ishte keqinterpretuar si sulm ndaj “përpjekjeve të punëtorëve të zellshëm që ishin të angazhuar për t’i shërbyer Kosovës dhe popullit të saj”. Sa i përket vërejtjes së zëvendësit kryesor të PSSP-së lidhur me besueshmërinë e Institucionit të Ombudspersonit, ai gjeti që, përkundër qëndrimit të shprehur në letrën e zëvendësit kryesor të PSSP-së, besueshmëria e Institucionit do ta pësonte nëse ai nuk do të kishte intervenuar në këtë çështje. Në ndërkohë, aplikantët u strehuan te shokët dhe të afërmit e tyre. Deri më këtë datë, atyre nuk u është siguruar ndonjë strehim tjetër nga Komuna e Prishtinës.

**Më 24 shkurt 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë i cili theksonte, në mes tjerash, se nuk kishte pasur kurrfarë ankese kundër vendimit për dëbimin e aplikantëve. Për më tepër, ai vërejti që Njësia e Inspektionit Gjyqësor nuk kishte mandat për të vlerësuar vendimet gjyqësore dhe gabimet ligjore apo në fakte që mund të jenë bërë nga Gjykatat. Ai e përfundoi letrën e tij duke thënë se Njësia e Inspektionit Gjyqësor nuk kishte gjetur kurrfarë prova për sjellje të pahijëshme në punën e gjykatësve që janë marrë me këtë rast.

### ***Ndërtimi i një Qendre për Punë Sociale mbi disa varreza në qytetin e Podujevës***

*Më 2 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikantët dhe të tjerët ankoheshin ndaj një vendimi të Këshillit Komunal në Podujevë për ta filluar ndërtimin e Qendrës për Punë Sociale në një pjesë toke ku ishin varrosur anëtarët e familjes të aplikantëve. Në vitin 1946, kjo tokë ishte konfiskuar nga ana e regjimit të mëparshëm jugosllav.*

**Më 13 dhjetor 2004**, Ombudspersoni ia dërgoi Zëvendës Kryetarit të Kuvendit Komunal në Podujevë një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ai që të garantojë që ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale të suspendohet menjëherë dhe që Ombudspersoni të informohet për çfarëdo veprimi që merret në lidhje me këtë çështje.

**Më 1 mars 2005**, Ombudspersoni, pasi që nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje nga Këshilli Komunal, e dërgoi edhe një letër përkujtuese.

**Më 18 mars 2005**, Ombudspersoni e pranoi një letër nga Këshilli Komunal në Podujevë, përmes të cilës e informonin që duke marrë parasysh që ajo pjesë e tokës ishte konfiskuar nga regjimi i mëparshëm komunist, aplikanti do të merrte në të ardhmen ndonjë lloj kompensimi. Lidhur me ndërtimin e Qendrës për Punë Sociale, Komuna ia bashkëngjiti letrës së saj një kopje të kontratës së nënshkruar mes Komunës dhe Qendrës për Punë Social, në të cilën Qendra lejohej ta shfrytëzojë tokën në fjalë përkohësisht dhe për këtë arsye lejohej që mbi të ta ndërtojë vetëm ndonjë ndërtesë të përkohshme.

### ***Hatixhe Rexhaj Avdyli kundër Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB-së)***

*Më 11 shkurt 2005, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga e cila dukej se aplikantja ankohej kundër një vendimi të DÇPB-së me të cilin është urdhëruar të lirojnë banesën në Prishtinë që i ishte ndarë nga “Fabrika e Amortizerave” në vitin 1987. Në vitin 1990, pas konfirmimit nga Këshilli i Punëtorve të fabrikës se banesa i ishte ndarë aplikantës, ajo nënshkroi kontratën*

dhe u vendos në banesë. Në shtator të 1990, pas zbatimit të masave të dhunshme nga autoritetet publike, aplikantja është pushuar nga puna. Në vitin 1994 aplikantja u dëbua nga banesa e saj pa ndonjë urdhër paraprak gjyqësor. Pasi që aplikantja si dhe banuesi i mëhershëm kishin paraqitur kërkesa për kthim të banesës në posedim pranë DÇPB-së, Komisioni për Kërkesa pranë DÇPB-së nxjerrti një vendim në vitin 2003 me të cilin kishte vendosur që banesa i takon personit që kishte jetuar aty deri më vitin 1999 si dhe e urdhëroi aplikantën që të lirojë banesën. Më 21 qershor 2004, aplikantja kërkoi nga Komisioni për Kërkesa që të rishqyrtojë vendimin. Në shkurt 2005, aplikantja pranoi një vendim që urdhëronte dëbimin e saj, i cili u konfirmua pas ankesës së saj.

**Më 15 shkurt 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një kërkesë shumë urgjente PSSP-së, duke kërkuar nga ky i fundit që të shfrytëzojë autorizimet e jashtëzakonshme që i janë ngarkuar atij si PSSP për të ndaluar përmbarimin e procedurës së mundshme të paligjshme të dëbimit, derisa të mos largohen të gjitha dyshimet lidhur me validitetin e këtyre veprimeve.

**Më 25 shkurt 2005**, Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë PSSP-së në lidhje me këtë dhe raste të ngjashme kundër DÇPB-së, me të cilën, në mes tjerash, e informoi atë se sipas pohimeve të aplikantes, procedurat e dëbimit ishin suspenduar.

### **Osman Kozmaqi, Avni Kumnova, Fatmir Dragaj, Hamdi Zenelaj dhe Asim Rragoni kundër Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB-së)**

Më 14 shkurt 2005, Ombudspersoni pranoi disa aplikacione, nga të cilat dukej se aplikantët ankohen kundër vendimeve të DÇPB-së me të cilat urdhëroheshin që të lirojnë banesat në Prishtinë të cilat u ishin ndarë aplikantëve nga punëdhënësi i tyre i mëparshëm, ndërmarja “Ibër Lepenci” në vitin 1986. Në shkurt 1991, pasi që Kosova humbi autonominë, këshilli kompetent i sapoemëruar në atë kohë në ndërrmarje kishte vendosur që të anuloi vendimet për ndarje të banesave. Në një vendim të nxjerrë më nëntor 1991, Gjykata e Punës në Prishtinë kishte konfirmuar vendimin për ndarjen e banesave dhe e urdhëroi ndërrmarjen që t’ua kthej banesat aplikantëve. Ndërrmarja “Ibër Lepenci” ishte ankuar ndaj këtij vendimi, dhe ankesa ishte refuzuar nga Gjykata kompetente e instancës së dytë në vitin 1992. Një kërkesë që ishte bërë nga “Ibër Lepenci” pranë Prokurorit të Republikës së Serbisë ku kërkohet nga ai që të fillojë procedurën e jashtëzakonshme kundër vendimit të gjykatës ishte refuzuar. Në tetor 1996, Gjykata komunale në Prishtinë i kishte urdhëruar personat që në atë kohë jetonin në banesa që ti lirojnë ato. Për arsye të konfliktit në Kosovë, ky vendim i gjykatës nuk ishte përmbaruar kurrë. Pas konfliktit në vitin 1999, banesat ishin lënë të lira, sepse personat që babonin aty më parë kishin ikur, dhe aplikantët u vendosën në këto banesa. Pasi që aplikantët si dhe banuesit e mëhershëm kishin paraqitur kërkesa për kthim të banesës në posedim pranë DÇPB-së, Komisioni për Kërkesa pranë DÇPB-së nxjerrti dy vendime të përbashkëta në vitin 2003 me të cilin kishte vendosur që banesa i takon personit që kishte jetuar aty deri më vitin 1999 si dhe e urdhëroi aplikantët që të lirojnë banesat. Aplikantët kërkuan nga Komisioni

*për Kërkesa që të rishqyrtojë vendimin. Pas këtyre kërkesave, disa nga aplikantët pranuan vendime negative ku urdhëroheshte dëbimi i tyre deri më 21 shkurt 2005, përkatsisht më 10 mars 2005.*

**Më 17 shkurt 2005,** Ombudspersoni i dërgoi një kërkesë urgjente PSSP-së, duke kërkuar nga ky i fundit që të shfrytëzojë autorizimet e jashtëzakonshme që i janë ngarkuar atij si PSSP për të ndaluar përmbarimin e procedurës së mundshme të paligjshme të dëbimit, derisa të mos largohen të gjitha dyshimet lidhur me validitetin e këtyre veprimeve. Për më tepër, Ombudspersoni bashkëngjiti në letrën e tij një listë me raste të ngjashme dhe kërkoi nga PSSP që gjithashtu të suspendojë procedurat e dëbimit në këto raste.

**Më 25 shkurt 2005,** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë PSSP-së në lidhje me numrin në rritje të ankesave kundër procedurave të dëbimit të filluara pranë DÇPB-së. Në letrën e tij, ai theksoi se kishte pranuar shumë kërkesa të ngjashme gjatë javës së fundit dhe se pas kontaktimit me DÇPB-në kishte kuptuar se kishte më tepër se pesëqind raste të tilla ishin në pritje për tu zgjidhur pranë DÇPB-së.

Ombudspersoni rekomandoi që të ndalen të gjitha procedurat e dëbimit në pritje për t'u përmbaruar në rastet që kishin të bëjnë me vendimet mbi ndarjen e banesave që ishin marrë në vitet '80 dhe anuluar më vonë gjatë regjimit të Millosheviqit, dhe që këto raste të rishqyrtohen

**Më 7 qershor 2005,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendës PSSP për Administratë Civile me të cilën e informonte se ankesat rrjedhnin nga disa keqkuptime të natyrës së mandatit të DÇPB-së dhe Komisionit për Kërkesa të DÇPB-së si dhe mungesës së njohjes të ligjit të aplikueshëm. Ai theksoi se sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 mbi themelimin e Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banësore dhe Komisionit për Kërkesa, DÇPB ishte themeluar për të pranuar kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banësore të të cilëve u është revokuar pas datës 23 mars 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij". Zëvendës PSSP theksoi që definicioni ligjor i të drejtës për banim nënkupton si vendimin mbi ndarjen ashtu edhe banimin fizik në pronë. Për më tepër, ai theksoi se sipas nenit 11 të Ligjit Jugosllav mbi Marrëdhëniet Banësore, të vitit 1986, "qytetari do të fitojë të drejtën e banimit që nga dita kur ligjshmërisht vendoset në banesë". Edhe pse kërkesit e lartpërmendur kishin vendimet për ndarje të banesës, ata nuk kishin arritur ta fitojnë të drejtën për banim sepse nuk ishin vendosur kurrë në pronë. Prandaj, kërkesat e tyre ishin nuk ishin në juridiksionin e DÇPB-së. Zëvendës PSSP-ja vërejtë se aplikantët kishin shfrytëzuar të drejtën e tyre për plotësimin e kërkesave për rishqyrtimin e vendimeve të DÇPB-së, të cilat ishin refuzuar. Zëvendës PSSP e përfundoi letrën e tij duke e informuar Ombudspersonin se prej njëbëdhjetë mijë vendimeve të zbatuara deri më 31 dhjetor 2004, janë plotësuar vetëm 800 kërkesa për rishqyrtim pranë DÇPB-së. Prandaj, shkalla e pranimit të vendimeve të DÇPB-së ishte e lartë.

## **Largimi me forcë i punëtorive/dyqaneve në Gllgovc**

*Më 29 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikantët ankoheshin ndaj vendimeve të lëshuara nga Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gllgovcit, në lidhje me përmbarimin e vendimeve të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i të njëjtës komunë, e që kanë të bëjnë me rrënimin dhe largimin e dyqaneve/punëtorive të cilat ndodhen në rrugën “Skënderbeu” në Gllgovc.*

**Më 1 mars 2005**, Ombudspersoni i dërgoi Ministres së Shërbimeve Publike një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ajo që të garantojë që Komuna e Gllgovcit të suspendojë largimin dhe rrënimin e paraparë të punëtorive/dyqaneve të aplikantëve, pasi që Ombudspersoni e konsideronte që një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me një aktvendim të mëparshëm të gjykatës që, si masë e përkohshme, kishte ndaluar Komunën që t'i rrënojë pronat në fjalë në pritje të një aktvendimi të gjykatës të formës së prerë në lidhje me pengim posedimin e pohuar mbi pronën e tyre nga ana e Komunës e Gllgovcit.

**Më 2 mars 2005**, Ombudspersoni, pasi që nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje nga Ministria e Shërbimeve Publike, ia dërgoi një kërkesë të ngjashme PSSP-së. Në letrën e tij, Ombudspersoni shprehu dyshimin që Ministria e Shërbimeve Publike kishte ndërmarrë ndonjë veprim në këtë çështje, pasi që dhjetë aktivitete afariste tashmë ishin shkatërruar kurse pritej të vazhdojë edhe rrënimi i aktiviteteve tjera afariste. Sipas Ombudspersonit, ai për këtë arsye kishte vendosur që këtë çështje t'ia drejtojë drejtpërdrejt PSSP-së, duke kërkuar nga ai që të vejë në shfrytëzim autorizimet e tij të jashtëzakonshme për të garantuar që të mos vazhdohet me rrënimet e ndërtesave tjera, së paku derisa Gjykata Komunale në Gllgovc të mos nxjerrë një aktvendim të formës së prerë. Në letrën e tij, Ombudspersoni gjithashtu theksoi që e konsideronte sjelljen e tillë të Komunës së Gllgovcit si të papranueshme dhe si mospërfillje të qartë të parimeve të sundimit të ligjit, dhe kërkoi nga PSSP të marrë parasysh ndikimin social të kësaj çështjeje, që do ta dëmtonte në mënyrë të papërmirësueshme emrin e institucioneve qeveritare vendore po të lejohej të vazhdohet në këtë mënyrë.

**Më 5 maj 2005**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së edhe një letër PSSP-së, përmes të cilës kërkoi informacione lidhur me veprimet që UNMIK-u apo autoritetet kompetente vendore i kishin ndërmarrë apo planifikonin t'i ndërmerrnin lidhur me këtë çështje.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë kërkesë.**

## **Dëbimi me forcë i familjeve të zhvendosura nga banesat në Komunën e Prizrenit**

*Më 9 shtator 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikanti, i cili me autorizim i përfaqësonte banorët e fshatit Milaj, ankohej për shkak të pamundësisë*

*së qasjes në pronat e tyre. Pasi që fshati ishte bombarduar tërësisht në vitin 1999, ai nuk ishte rindërtuar për shkak se 80% të fshatit ishte ende e minuar kurse Komuna nuk kishte buxhet të mjaftueshëm për ta pastruar fshatin nga minat. Kur Ombudspersoni e kishte pranuar kërkesën, 43 familje ishin ende të zhvendosura.*

**Më 15 prill 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Këshillit Komunal në Prizren, duke kërkuar nga ata që ta gjejnë një zgjidhje.

**Më 29 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Drejtorisë për Ndërtim, Zhvillim dhe Investime Publike, përmes të cilës e informonte atë që për shkak se terreni në fshat dhe përreth tij ende nuk ishte pastruar nga minat, nuk kishte qenë e mundur që të gjinden donatorë që do ta përkrahnin financiarisht rindërtimin e fshatit. Në ndërkohë, shumica e familjeve kishin marrë si dhuratë apo kishin blerë pjesë të tokës në lagjen Arbana në Prizren dhe ishin duke kërkuar ndihmë për të ndërtuar shtëpitë apo banesat, pasi që shumica e tyre ende ishin duke jetuar në strehime të përbashkëta apo shtëpi dhe banesa të uzurpuara. Për më tepër, Drejtori shtoi që Këshilli Komunal i kishte ndarë 100 mijë euro për rindërtim që do të fillonte së shpejti.

**Më 29 prill 2005**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ai që të garantojë që ekzekutimi i vendimit të lëshuar nga Komisioni për Kërkesa i DÇPB-së të suspendohet dhe, nëse kjo është e mundur, të gjendet ndonjë strehim tjetër për këto familje derisa rrethanat t'i lejojnë ata të kthehen në fshatin Milaj. Për më tepër, Ombudspersoni rekomandoi që të formohet një komision që do të jetë i përbërë nga përfaqësuesit e Komunës së Prizrenit, Qeverisë së Kosovës dhe DÇPB-së, për qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje afatgjatë për familjet e fshatit Milaj.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë kërkesë.**

### ***Rrënimi i lokaleve afariste në një tokë për të cilën pohoet të jetë pronë e Komunës së Prizrenit***

*Më 14 shtator 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej se parashtruesi i kërkesës ankohet kundër aktvendimit të Drejtorisë për çështje pronësore-juridike të komunës së Prizrenit që urdhëronte rrënimin e objektit-lokal afarist i cili gjendet në Prizren. Objekti kontestues është ndërtuar nga aplikanti në pronën e tij, e cila i është eksproprijuar de jure nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit në vitin 1983. Në qershor 2001, aplikanti ka ngritur padi për vërtetimin e pronësisë të ngastrës së lartpërmendur pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Në dhjetor 2004, Gjykata Komunale kishte nxjerrë një aktvendim me të cilin urdhërohej ndërprerja e çdo veprimi lidhur me ngastrën e lartpërmendur deri sa të përfundojë kontesti civil, i filluar nga parashtruesi i kërkesës, pranë kësaj gjykate. Më 14 prill 2005, aplikanti pranoi një njoftim, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektorateve të Kuvendit Komunal në Prizren, me të cilin lajmërohej se më 21 prill 2005 do të bëhet ekzekutimi i dhunshëm i*

*aktvendimit për rrënimin e lokalit afarist, në pajtim me vendimin për ekzekutim të datës 13 prill 2005.*

**Më 20 prill 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një kërkesë për masa të përkohshme Ministres për Shërbime Publike duke e informuar atë për rastin dhe njëhokësisht duke kërkuar nga ajo që të sigurojë suspendimin e vendimin për ekzekutim deri në përfundim të hetimeve të Ombudspresonit në këtë rast.

Në të njejtën ditë, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke e informuar atë për kërkesën për masa të përkohshme që i kishte drejtuar Ministres për Shërbime Publike. Duke e pasur parasysh se Ministria e Shërbimeve Publike nuk ishte përgjegjur asnjëherë në kërkesa të tilla që i janë dërguar më parë, Ombudspersoni kishte shfrytëzuar rastin për të kërkuar sqarime në lidhje me çështjen se cilit organ duhet drejtuar kërkesat për masa të përkohshme në të ardhmen.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë kërkesë nga Ministria apo nga PSSP. Sipas informatave të marra nga parashtruesi i kërkesës, rrënimi i lokalit afarist ishte suspenduar.**

### ***Rrënimi i shtëpive që gjendeshin në një pjesë të tokës që ishte pronë e Komunës së Prishtinës***

*Më 25 prill 2005, Ombudspersoni pranoi një aplikacion nga i cili kuptohej që aplikantët ankoreshin kundër një vendimi të marrë nga Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Prishtinës për të rrënuar shtëpitë e aplikantëve të ndërtuara në tokën që ishte pronë e Komunës pa lejen e nevojshme të ndërtimit. Pas nxjerrjes së vendimit më 18 prill 2005, Komuna filloi rrënimin e shtëpive më 23 prill 2005. Aplikantët ankoreshin që në kohën kur kishte filluar rrënimi, dy fëmijë ishin duke fjetur në njërin nga shtëpitë dhe kishin shpëtuar vetëm falë ndihmës së një fqinji.*

**Më 25 prill 2005**, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së dhe Ministres së Shërbimeve Publike një kërkesë urgjente për caktimin e masës së përkohshme, duke kërkuar nga ta që të garantojnë që rrënimi i shtëpive të aplikantëve të suspendohet, së paku deri sa familjeve në fjalë t'u jetë dhënë koha e duhur për t'i liruar shtëpitë dhe për të kërkuar strehim tjetër. Pasi që Ombudspersoni deri atëherë nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje në kërkesën e tij për t'i ofruar sqarime rreth asaj se cilit organ t'i drejtohej me atë lloj të kërkesës, ai vendosi që atë t'ia drejtoj si strukturave ndërkombëtare ashtu edhe atyre vendore për t'iu shmangur humbjes së mëtejshme të kohës.

**Më 26 prill 2005**, Ushtruesi i detyrës së Përfaqësuesit Komunal të UNMIK-ut ia dërgoi një letër Kryeshëfit të Ekzekutivit në Prishtinë, duke kërkuar nga ai që ta suspendojë ekzekutimin e rrënitit në mënyrë që ta mundësojë dislokimin e familjeve në fjalë.

**Më 18 maj 2005**, Ombudspersoni, pasi që nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga Krye-

shefi i Ekzekutivit në Prishtinë, ia drejtoi Kryeministrit të Kosovës një kërkesë të ngjashme urgjente për caktimin e masës së përkohshme. Në këtë letër, Ombudspersoni u pajtua me faktin që Komuna kishte filluar të ndërmarrë masa kundër ndërtimeve të paligjshme por nuk u pajtua me mënyrën si ishte bërë kjo. Ombudspersoni theksoi që edhe pse vendimi në fjalë e kishte paraparë afatin për ankesë prej tridhjetë ditësh nga dita e marrjes së vendimit, komuna kishte filluar rrënimin e shtëpive vetëm pesë ditë pasi që kishte nxjerrë vendimin dhe që njerëzit për këtë arsye nuk patën kohë të gjejnë ndonjë strehim tjetër.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë kërkesë.**

### ***Evakuimi me forcë i banorëve të fshatit Hade***

*Më 29 mars 2004, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) nxjerri një vendim ekzekutiv për evakuimin e banorëve të fshatit Hade, që gjendet mbi një minierë qymyri dhe për arsye të gërmimeve të bëra më parë, i cili ishte në rrezik të rrëshqas poshtë bregut mbi të cilin është ndërtuar. Në këtë vendim, PSSP gjithashtu urdhëroi Institucionet e Përkohshme kompetente të Vetëqeverisjes (IPVQ) të përgatisin dhe të paraqesin një raport mbi veprimet e ndërmarra për zbatimin e planit të evakuimit jo më vonë se më 2 prill 2004. Megjithëse, Ministria kompetente e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte bërë marrëveshje për kompensim me disa nga banorët e fshatit të Hades, një raport i tillë nuk ishte dorëzuar kurrë. Më 3 qershor 2005, pas vendimit të Ministrisë që të evakuojë me forcë familjet që kishin mbetur, fillojë me rrënimin e shtëpive në Hade, pavarësisht nga fakti që në atë kohë ishte siguruar strehim tjetër vetëm për disa nga familjet e fshatit.*

**Më 6 qershor 2005,** Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë për masa të përkohshme me të cilën kërkonte që të suspendohet zbatimi i vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor deri në përfundimin e hetimeve të Ombudspersonit në këtë rast.

**Më 14 qershor 2005,** Ombudspersoni pranoi një përgjegjje nga PSSP, i cili e përkujtonte se vendimi ekzekutiv i 29 marsit 2004 në lidhje me planin e evakuimit ishte bazuar në vlerësimin teknik profesional që kishte konkluduar se kishte kërcënim serioz dhe të menjëherëshëm të jetës së banorëve që jetonin në një zonë të caktuar të fshatit Hade. Ai theksoi që, në mënyrë që të lehtësohet procesi i evakuimit, është nxjerrë edhe një vendim ekzekutiv tjetër më 13 maj 2004, sipas të cilës një pjesë e tokës është vendosur nën administrim të UNMIK-ut dhe në të njejtën kohë është ndarë për zhvendosjen e banorëve të fshatit Hade. Për më tepër, ky vendim ekzekutiv gjithashtu u siguronte fshatarëve përkatës një kompensim të arsyeshëm. PSSP e informoi Ombudspersonin se është nxjerrë edhe një vendim tjetër ekzekutiv më 18 nëntor 2004, në të cilin qeveria e Kosovës kishte deklaruar, në mes tjerash, fshatin Hade si zonë e intersit të veçantë ekonomik. Këto vendime ekzekutive e përkujtuan edhe një herë rrezikun e pashmangshëm për banorët e këtij fshati. PSSP theksoi që vlerësimet teknike periodike kishin treguar shenja të vazhdueshme të mundësisë për rrëshqitje të fshatit, prandaj plani i evakuimit dhe zhvendosjes ka qenë i bazuar. Sipas PSSP-së, pas



përpyjekjeve të panumërta të qeverisë për të arritur një marrëveshje me banorët e fshatit Hade, mbi njëqind e njëzet familje ishin larguar vullnetarisht që nga nëntori 2004, derisa njëzet e nëntë familje kanë refuzuar që të zhvendosen. Sidoqoftë, zhvendosja pa vullnetin e këtyre njëzet e nëntë familjeve e 2 qershorit 2005 kishte pasqyruar planifikim intenziv që është bërë gjatë një periudhe kohore të gjatë dhe ishte e organizuar mirë dhe zbatuar me kujdes. Pagesat për kompensim tashmë kishin filluar për dëmet apo humbjet e pronave nga ky proces. Në të njëjtën kohë, oferta për zhvendosjen e këtyre familjeve vlenë ende. PSSP përfundoi letrën e tij duke theksuar mbështetjen e plotë të UNMIK-ut ndaj punës së Qeverisë në këtë çështje.

## **Aneksi 3: Përmbledhjet e raporteve**

### **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1112/03

#### ***Gani Thaçi kundër Gjykatës Supreme të Kosovës***

Më 17 shtator 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ky rast kishte të bëjë me një nga çështjet e ngritura në një rast të mëparshëm të aplikantit të njëjët, respektivisht ankesën e aplikantit ndaj asaj që nuk kishte qenë në gjendje të ankohe kundër shkarkimit të tij nga puna në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Hetimet në këtë rast rezultuan me publikimin e raportit të Ombudspersonit më 17 prill 2003. Në këtë raport, Ombudspersoni gjeti që të gjitha organet kompetente, respektivisht TMK, organet disiplinore të TMK-së dhe PSSP (në kapacitetin e tij si autoriteti i fundit administrativ në çështjet lidhur me TMK-në), kishin dështuar t'i ofrojnë aplikantit një vendim të arsyetuar me shkrim lidhur me shkarkimin e tij nga TMK ose ta shqyrtojnë ankesën e tij kundër këtij shkarkimi. Gjykata kompetente për të vendosur mbi temën e lëndës së këtyre çështjeve kishte nxjerrë vendimin formal në të cilin kishte deklaruar që nuk ishte në gjendje ta shqyrtojë rastin e aplikantit derisa ai të mos shfrytëzonte të gjitha rrugët për shqyrtim administrativ, deri në vendimin e PSSP-së dhe duke përfshirë edhe atë vendim. Gjykata Supreme e Kosovës, që kishte juridiksion ta urdhërojë PSSP-në të nxjerrë vendimet me shkrim të kërkuara me ligj, gjithashtu kishte dështuar të ndërmarrë këtë veprim. Kjo kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për proces të rregullt gjyqësor, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në rastin në fjalë, aplikanti ishte ankuar që përkundër raportit të Ombudspersonit të datës 17 prill 2003, Gjykata Supreme e Kosovës ende nuk kishte vendosur mbi kërkesën e tij për të vendosur mbi rastin e tij ose për ta urdhëruar PSSP-në të marrë një vendim të tillë. Ombudspersoni konsideroi që shkelja e të drejtës së aplikantit për gjykatë, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është ende duke vazhduar për shkak të dështimit të Gjykatës Supreme për të vendosur mbi kërkesën e aplikantit.

Ombudspersoni rekomandoi që Gjykata Supreme e Kosovës do të duhej që, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, një vendim mbi rastin e aplikantit të nxjerrët pa vonesë të mëtejshme.

**Më 29 tetor 2004, Ombudspersoni pranoi një shkresë nga Zëvendës PSSP për Polici dhe Drejtësi, duke u përgjigjur që ia kishte përcjellë letrën Njësisë së Inspeksionit**

Gjyqësor (NjIGj) pranë Departamentit të Drejtësisë, e cila kishte hapur hetimet mbi rastin e lartpërmendur. NjIGj pastaj do ta informonte Ombudspersonin lidhur me rezultatet e hetimeve të saj.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 497/02

### ***Lidhur me dështimin e DÇPB-së për të marrë dhe dorëzuar vendimet në rastet e kërkesit Nazim Korqa dhe të tjerëve***

Më 29 shtator 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ombudspersoni konsideroi që dështimi i Komisionit për Ankesa të DÇPB-së për të marrë dhe dorëzuar vendimet në rastet e aplikantëve kishte përbërë shkelje të të drejtave të aplikantëve për respektimin e vendbanimit të tyre, siç është e garantuar përmes nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të sigurojë, përmes masave ligjore përkatëse dhe praktikave administrative, që vendimet Komisionit për Ankesa të DÇPB-së, që kishin të bëjnë me të drejtën për respekt për vendbanimin dhe pronën e aplikantëve, si dhe të personave tjerë në situatë të ngjashme, të merren dhe t'u dorëzohen aplikantëve dhe kërkesve tjerë në mënyrë të shpejtë dhe në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut.

Më 20 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP, në të cilën theksohej që çështja e ngritur në këtë raport ishte duke u shqyrtuar me seriozitet nga ana e UNMIK-ut. PSSP theksoi që falë përparimit të konsiderueshëm të arritur në dy vitet e fundit, pritej që 80% e ngarkesës me raste pranë DÇPB-së do të përfundohej deri në fund të vitit 2005. Ai gjithashtu vërejti, në fillim, që veprimet e DÇPB-së fillimisht kishin pësuar për shkak të pengesave financiare, para se ajo të bëhej plotësisht funksionale; megjithatë, kërkesat momentale pranë DÇPB-së ishin duke u proceduar me një shpejtësi të pranueshme. Duke përkujtuar korrespondencën e mëparshme mes Ombudspersonit dhe organit të pavarur juridik të DÇPB-së, në prill të vitit 2004, në të cilën Ombudspersonit i ishin sqaruar çështjet rreth procedurës në rastin e numrit të madh të kërkesave, PSSP mbetej në dyshim nëse Ombudspersoni ia kishte kushtuar vëmendjen e duhur këtij faktori. PSSP gjithashtu shkroi që zgjidhja e kërkesave lidhur me pronën e banimit ishte ende duke pësuar nga efektet shkatërruese të konfliktit të vitit 1999 dhe që kjo do të duhej të merrej në konsideratë gjatë vendosjes rreth pajtueshmërisë me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas PSSP-së, përfundimi

i detyrës së procedimit të kërkesave brenda pesë viteve në një ambient të pasluftës, nuk mund të konsiderohej objektivisht si shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për më tepër, një vonesë në procedim mund të mos ishte shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, posaçërisht kur një mbingarkesë me raste kishte qenë e papritur dhe e përkohshme. PSSP e mbylli letrën e tij duke e informuar Ombudspersonin që çështjet kyçe të ngritura në raportin e tij ishin duke u mbikëqyrur me kujdes nga ana PSSP-së dhe palëve tjera përkatëse.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit *ex officio* 28/04

### ***Lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit të personave me sëmundje psikike në Klinikën e Neuropsikiatrisë pranë Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë***

Më 7 tetor 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë raport, Ombudspersoni shqyrtoi ligjshmërinë e paraburgimit të personave me sëmundje psikike në Klinikën e Neuropsikiatrisë pranë Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Raporti ishte rezultat i i hetimeve *ex officio* të zhvilluara rishtas dhe të nxitura nga vizitat e mëhershme këtyre lokaleve, si dhe duke u bazuar në informata tjera të pranuar nga Ombudspersoni.

Në këtë raport, Ombudspersoni vërejtí që vendosja e këtyre personave në Klinikën e Neuropsikiatrisë nuk ishte e bazuar në kurrfarë procedure administrative apo gjyqësore, edhe pse kjo kërkohet me dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Jashtëkontestimore. Për më tepër, Ombudspersoni vërejtí që pacientët janë plotësisht të painformuar për ekzistimin e procedurës të cilën ata mund ta ndjekin për të shqyrtuar ligjshmërinë e burgimit të tyre. Duke marrë parasysh këtë, Ombudspersoni konkludoi që vendosja e këtyre personave përbente një mohim të tërësishëm të garancive të përmbajtura në nenin 5 të Konventës, i cili e mbron të drejtën e secilit person për liri. Prandaj, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të sigurojë që ligjet ekzistuese lidhur me vendosjen e personave me sëmundje psikike në organizatat përkatëse shëndetësore të zbatohen pa vonesë të mëtejshme.

Më 15 qershor 2005, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Zëvendës PSSP për Administratën Civile lidhur me raportin e lartpërmendur. Zëvendës PSSP e informoi Ombudspersonin që ia kishte ofruar informacionet mbi çështjet e përfshira mjekësore Zyrës së Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut në mënyrë që “qëndrimi i drejtë ligjor të

mund t'i komunikohet [Ombudspersonit]". Për më tepër, Zëvendës PSSP theksoi që raporti kishte ngritur disa çështje të sigurisë publike të cilat nuk bien nën juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ai gjithashtu shkroi që Ministria e Shëndetësisë tashmë kishte ndërmarrë disa hapa tashmë për t'u marrë me disa nga çështjet e ngritura në raport, siç ishte përpilimi i udhëzimeve administrative mbi shëndetin mendor dhe institucionet përkatëse lidhur me shëndetin mendor. Zëvendës PSSP e mbylli letrën e tij duke e informuar Ombudspersonin që Ministria e Shëndetësisë ishte u angazhuar me punonjësit e Qendrës Klinike Universitare për ta përmirësuar punën me pacientët. Si rezultat, kishte përmirësime të dukshme lidhur me vendosjen e pacientëve në klinikat përkatëse psikiatrike nëpër Kosovë.

Më 27 qershor 2005, Ombudspersoni pranoi një letër tjetër nga Zëvendës PSSP për Administratën Civile. Në letrën e tij, Zëvendës PSSP e informoi Ombudspersonin që i kishte shkruar Ministrin të Shëndetësisë duke kërkuar nga ai që ta informojë Drejtorin e Qendrës Klinike Universitare për rëndësinë e respektimit të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse që garantojnë të drejtat e njerëzve me sëmundje psikike.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 598/02

### ***Fadil Ramadani dhe të tjerët kundër UNMIK-ut***

Më 8 tetor 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni konsideroi në dy nga rastet nën hetime për keqtrajtim në kundërshtim me të drejtën për të qenë i lirë nga keqtrajtimi sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, trajtimi ndaj të cilit u ankuan aplikantët nuk kishte qenë i rëndë sa duhet për të rënë nën mbrojtjen e ofruar me nenin 3. Në dy raste tjera, aplikantët nuk kishin ofruar ndonjë dëshmi për të përkrahur pohimet e tyre. Vetëm në një rast, pohimet e aplikantit të përkrahura me raportin mjekësor, terapinë e dhënë nga mjeku dhe fotografitë dukej të jenë nën nenin 3. Ombudspersoni gjeti që kishte pasur shkelje të të drejtës së aplikantit për të qenë i lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, siç është e theksuar me nenin 3 të Konventës. Në katër raste, Ombudspersoni konkludoi që sa i përket ankesave të kontestueshme për keqtrajtim, kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në kuptim të pamundësisë së autoriteteve kompetente të UNMIK-ut për të zhvilluar hetimet e duhura mbi këto ankesa në pajtim me kërkesat procedurale që i përmban ky nen. Ombudspersoni gjithashtu gjeti që urdhrat për të paraburgosur dy nga aplikantët nuk u ishin dorëzuar aplikantëve në pajtim me procedurën e kërkuar me ligj në kuptim në

paragrafit 1 të nenin 5 të Konventës, që përbën shkelje të këtij neni. Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që të zhvillohen hetimet adekuate dhe efektive mbi ankesat e aplikantëve për keqtrajtim nga ana e policëve të Policisë së UNMIK-ut. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që Zëvendës PSSP për Polici dhe Drejtësi të ndërmarrë hapat përkatës për të përfshirë çështjet e ngritura në këtë raport në programet e trajnimit të SHPK-së.

**Më 16 nëntor 2004**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga PSSP përmes së cilës e informoi Ombudspersonin që një vlerësim i Njësisë për hetime të brendshme të Policisë së UNMIK-ut kishte zbuluar që hetimet përkatëse dhe efektive ishin duke u zhvilluar nga ana e Zëvendës Komisarëve të Policisë, Komisarit të Policisë dhe Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi. PSSP theksoi që ia kishte siguruar kopjet e raportit Policisë së UNMIK-ut, për ta përcaktuar se si do të mund të mbuloheshin me trajnime çështjet e caktuara të ngritura në raport.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1063/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Zenë Sahitit***

Më **28 tetor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës komunale në Prishtinë për ta zgjidhur rastin e aplikantit brenda një kohe të arsyeshme kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Në rastin në fjalë ku aplikanti kishte paraqitur një padi pranë Gjykatës komunale për të dëbuar uzurpuesit e paligjshëm nga banesa e tij, Ombudspersoni vërejtë që Gjykata komunale nuk kishte ndërmarrë kurrfarë veprimi lidhur me rastin prej 16 shtatorit 2002, kur aplikanti kishte paraqitur padinë, deri më 23 tetor 2003 kur u mbajt seanca e parë gjyqësore. Nuk duket të ketë pasur ndonjë arsye për këtë vonesë.

Ombudspersoni gjithashtu vërejtë që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën komunale në Prishtinë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që

ofron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Më 27 janar 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Njësia e Inspeksionit Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë, përmes së cilës e informoi Ombudspersonin që pas pranimit të raportit të tij, Njësia e Inspeksionit Gjyqësor kishte hapur hetimet mbi këtë çështje për të vlerësuar nëse kishte pasur ndonjë sjellje të keqe nga ndonjë anëtar i gjyqësorit.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 636/02

### ***Lidhur me zgjatjen e procedurës pranë Komisionit për Ankesa të DÇPB-së në rastin e Ismet Ukqës dhe të tjerëve***

Më **12 nëntor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ombudspersoni gjeti që dështimi i Komisionit për Ankesa të DÇPB-së për të vendosur në rastet e aplikantëve brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtave të aplikantëve për respektimin e vendbanimit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke vërejtur që DÇPB ishte e vetmja mundësi përmes së cilës aplikantët mund të përpiqeshin të kthejnë në posedim vendbanimet e tyre, Ombudspersoni konkludoi që hapat e ndërmarrë nga ana DÇPB-së për të zgjidhur rastet e aplikantëve nuk kishin qenë të shpejtë sa duhet për të përmbushur kërkesat e nenit 8 të Konventës. Problemi i mungesës së fondeve dhe si pasojë e kësaj numri i vogël i punonjësve të mbingarkuar me raste të pazgjidhura do të mund të shërbente si arsytim për ngecje të tilla të procedurës vetëm nëse një mbingarkesë e tillë ishte e papritur dhe e përkohshme. Megjithatë, në rastin në fjalë, autoritetet kompetente të UNMIK-ut kishin qenë të vetëdijshme për një kohë të gjatë lidhur me mbingarkesën me raste pranë Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së, por nuk kishin bërë aq sa duhet për të riorganizuar DÇPB-në dhe për të përmirësuar veprimet e këtij institucioni në atë mënyrë që do t'ia mundësonte DÇPB-së të merret me ngarkesën e madhe me raste në një mënyrë më të shpejtë.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë, përmes masave përkatëse ligjore dhe praktikave administrative, që të drejtat për vendbanim dhe pronë të aplikantëve, si dhe të gjithë personave tjerë në të njëjtën situatë, të zbatohen në një mënyrë të shpejtë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut të vendosura me nenin 8 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Pas publikimit të raportin në rastin Milena Ristic dhe të tjerët kundër DÇPB-së, të publikuar më 29 qershor 2004, ky është raporti i dytë lidhur me zgjatjen e procedurës pranë Komisionit për Ankesa të DÇPB-së.

**Më 29 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP-ja lidhur me këtë raport. Përgjigja ishte identike me atë të pranuar më 20 dhjetor 2004 lidhur me raportin e lartpërmendur mbi rastin e Nazim Korqës dhe të tjerëve.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1082/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Kadri Sefedinit***

Më **12 nëntor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës komunale në Mitrovicë dhe i organeve kompetente të UNMIK-ut për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të garantuar zgjidhjen e rastit të aplikantit brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt për një kohë të arsyeshme të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë rast, në të cilin aplikanti kishte kërkuar lejen që të kthehet në vendin e tij të mëparshëm të punës, nga i cili ishte larguar në vitin 1991, Ombudspersoni vërejtë që shkelja nuk ishte shkakuar nga çfarëdo mosveprimi i gjykatës, duke marrë parasysh faktin që katër vendime të gjykatës ishin marrë gjatë periudhës së procedurës. Në vend të kësaj, vonesat ishin shkakuar nga rishqyrtimet e përsëritura të rastit, duke pasqyruar defekte serioze në hierarkinë ekzistuese të sistemit vendor gjyqësor.

Ombudspersoni gjithashtu vërejtë që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai vërejtë që edhe pse kjo çështje ishte ngritur në shumë raporte të mëparshme, nuk kishte kurrfarë dëshmie që UNMIK-u kishte ndërmarrë ndonjë hap për ta krijuar një mjet të tillë juridik.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP, do të duhej që, jo më vonë se më 31 dhjetor 2004, të sigurojë që Gjykata komunale, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, të nxjerrë një aktgjykim në rastin e aplikantit pa vonesë të mëtutjeshme. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën komunale në Mitrovicë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të ga-



rantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. PSSP gjithashtu do të duhej të garantojë që Njësia për Inspektim Gjyqësor brenda Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut të pranojë aq punonjës sa duhet për të garantuar që ata të mund të merren me rastet pa vonesë të tepruar. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që ofron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1167/03

### ***Lidhur me dështimin e DÇPB-së për të marrë dhe dorëzuar vendimet në rastet e kërkuarit Jusuf Gashi dhe të tjerëve***

Më **16 nëntor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në dhjetë raste, Ombudspersoni hetoi nëse vonesat në marrjen dhe dorëzimin e vendimeve të Komisionit për Ankesa të DÇPB-së për kërkuarit përkatës kishin ngritur çështje të caktuara sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me ankesën rreth zgjatjes së procedurës pranë Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së, Ombudspersoni iu referua raportit të tij mbi një temë identike të lëndës në rastin e Milena Ristić dhe të tjerëve kundër DÇPB-së, të publikuar rishtas, më 28 qershor 2004, në të cilin kishte gjetur që vonesat e tilla për të marrë vendimet mbi rastet e aplikanteve kishin përbërë shkelje të së drejtave të tyre për respektimin e vendbanimit të tyre. Lidhur me vonesat në marrjen dhe dorëzimin e vendimeve për aplikantët, Ombudspersoni konkludoi që autoritetet kompetente të UNMIK-ut kishin dështuar ta riorganizojnë DÇPB-në dhe përmirësojnë veprimet e saj në një mënyrë që do ta mundësonte që vendimet e saj t'u dorëzohen kërkuarëve në mënyrë më të shpejtë.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 31 dhjetor 2004, përmes masave përkatëse ligjore dhe praktikave administrative, të garantojë që vendimet e Komisionit për Ankesa që kanë të bëjnë me të drejtën për respektimin e vendbanimit dhe pronës së aplikantëve, si dhe të gjithë personave tjerë në të njëjtën situatë, t'u dorëzohen të gjithë kërkuarëve pranë DÇPB-së në një mënyrë të shpejtë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut të vendosura me nenin 8 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Pas publikimit të raportin në rastin e Nazim Korqës kundër DÇPB-së, të publikuar më

29 shtator 2004, ky është raporti i dytë lidhur me vonesën në dorëzimin e vendimeve të Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së kërkuesve.

**Më 23 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga PSSP lidhur me këtë raport. Kjo përgjigje ishte identike me atë të pranuar më 20 dhjetor 2004 lidhur me raportin e lartpërmendur në rastin e Nazim Korqës.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1082/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Dobrivoje Micić***

Më 17 dhjetor 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për ta zgjidhur rastin e aplikantit brenda një kohe të arsyeshme kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Në rastin në fjalë që kishte të bëjë uzurpimin dhe shfrytëzimin e pronës së aplikantit përmes personave të tretë, Ombudspersoni vërejti që pas ankesës së aplikantit pranë Gjykatës së qarkut më 17 dhjetor 2003, kjo Gjykatë nuk e kishte ndërmarrë kurrfarë veprimi lidhur me rastin e aplikantit. Duke e konsideruar rastin të jetë jo edhe aq i ndërlikuar dhe me rëndësi të posaçme për aplikantin që ishte duke marrë vetëm një pension të vogël mujor, Ombudspersoni konkludoi që vonesat nuk mund të arsyetoheshin me një mungesë të fuqisë njerëzore. Prandaj, ato kishin përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni në fund iu referua një përgjigje të UNMIK-ut në një raport të tij të mëhershëm, përmes të cilës Ombudspersoni u informua që pesëmbëdhjetë pozita gjyqësore të ndara për Gjykatën e qarkut ishin plotësuar dhe që në mes të majit të vitit 2004, një gjykatës shtesë ishte transferuar në Gjykatën e qarkut nga Gjykata komunale në Podujevë për të ndihmuar në lehtësimin e ngarkesës me raste. Derisa çmoi përpjekjet e autoriteteve përgjegjëse për ta shtuar numrin e gjykatësve në Gjykatën e qarkut në mënyrë që të zvogëlohet numri i rasteve në pritje për t'u zgjidhur, Ombudspersoni vërejti që këto masa deri më tani nuk kishin arritur ta përshpejtojnë nxjerrjen e një vendimi në rastin e aplikantit.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së

të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai vërejt i që edhe pse mungesa e një mjeti të tillë juridik ishte ngritur në shumë raporte të mëparshme të Ombudspersonit drejtuar PSSP-ve të ndryshëm, nuk ishte ndërmarrë ndonjë hap i dukshëm për ta ndryshuar këtë, përkundër garancive të vazhdueshme që kjo çështje ishte duke “u shqyrtuar në mënyrë aktive”.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP, do të duhej që, jo më vonë se më 2 shkurt 2005, të sigurojë që Gjykata e qarkut, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, të nxjerrë një aktgjykim në rastin e aplikantit pa vonesë të mëtutjeshme. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën e qarkut në Prishtinë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjyqimeve brenda një afati të arsyeshëm. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që ofron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 792/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Mark Gojanit***

Më **28 shkurt 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale në Klinë për ta zgjidhur rastin e aplikantit prej 10 janarit 2002, kur aplikanti filloi procedurën civile për ta zgjidhur çështjen e pronësisë mbi një pronë, nuk kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni vërejt i që paragrafi 1 i nenit 6 është i zbatueshëm vetëm në procedurat që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile që ishin në kontest. Pasi që Gjykata Komunale në Klinë kishte vendosur mbi çështjen e pronësisë mbi pronën në fjalë qysh në vitin 1996, kjo çështje më nuk ishte në kontest. Prandaj, procedura e filluar nga aplikanti në vitin 2002 më nuk përfshinte “përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile”. Sipas të drejtës lëndore të organeve të Konventës, neni 6 me këtë rast nuk është i zbatueshëm në procedurën që është duke u shqyrtuar.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1170/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Ramadan Mamushës***

Më 7 mars 2005, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që vonesat në Gjykatën Komunale në Gjakovë për ta zgjidhur rastin e aplikantit, në veçanti dështimi i gjykatës për ta dorëzuar vendimin e saj të 26 qershorit 2003 deri më 12 dhjetor 2003, nuk kishin përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni e bazoi këtë konkludim në faktin që, përkundër vonesës prej pesë muaj e gjysmë për t'ia dorëzuar aktgjykimin aplikantit, procedura në përgjithësi ishte zhvilluar në mënyrë të shpejtë. Për më tepër, e gjithë procedura gjyqësore në dy instanca nuk kishte zgjatur më shumë se dy vite e gjysmë.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 953/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Emine Buzës dhe të tjerëve***

Më 22 mars 2005, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ombudspersoni gjeti që vonesat e Gjykatës Komunale në Prizren për ta zgjidhur rastin e aplikantëve që kishte të bëjë me kërkesën e aplikantëve për kthimin e pronës familjare që ishte ekspropriuar më 1946, kishin përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm siç është e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rastin në fjalë, Ombudspersoni gjeti që kishte pasur dy ngecje të mëdha të procedurës deri në nëntor të vitit 2004, kur Gjykata Komunale ishte deklaruar të jetë jo kompetente për të vendosur mbi rastin pas themelimit të Dhoma së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim. Derisa pranoi që rasti mund të kishte qenë i komplikuar deri në një masë dhe vonesa e parë do të mund të arsyetohej deri në një masë përmes efekteve afatgjata të konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, Ombudspersoni vërejtë që

pas themelimit të Dhomës së Posaçme, çështja relativisht e thjeshtë parësore e asaj nëse rasti ishte nën kompetencën e Gjykatës Komunale apo jo do të kishte mundur të zgjidhej në mënyrë më të shpejtë. Duke theksuar që ishte përgjegjësi e UNMIK-ut që të garantojë që rastet të zgjidhen në mënyrë të shpejtë, por edhe që sistemi i menaxhimit të gjykatave do të mund të përmirësohej, Ombudspersoni vërejti që UNMIK-u dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës, një organ përgjegjës, mes tjerash, edhe për emërimin e gjykatësve, duket t'i kishin dhënë prioritet problemit të zvarritjes së procedurës pranë gjykatave në Kosovë. Megjithatë, mbetet të shihet nëse nismat momentale që i kishin ndërmarrë këto dy organe do t'i ofronin gjykatave në Kosovë zgjidhje të përhershme afatgjata dhe të përkohshme afatshkurta për t'u përgjigjur në ngarkesën gjithnjë në rritje me raste në një mënyrë që do të ishte më shumë në përputhje me kërkesat e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti që mungesa e ndonjë mjeti juridik në formë të të kompensimit për shkelje të të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai vërejti që edhe pse PSSP-së i ishte drejtuar vëmendja kah mungesa e një mjeti juridik në raste të tilla përmes raporteve të shumta të Ombudspersonit, deri më atëherë nuk kishte pasur ndonjë veprim të dukshëm nga ana e autoriteteve ligjvënëse për ta ndryshuar këtë, përkundër të garantuarit e vazhdueshëm që kjo çështje ishte “duke u konsideruar aktivisht”. Derisa nismat e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut për ta zgjidhur çështjen e zvarritjes së procedurës gjyqësore mund të konsideroheshin zhvillime pozitive, Ombudspersoni vërejti që përsëri ishte duke u lënë anash çështja e kompensimit përkatës për shkeljet e pësuar nga ana e aplikantëve për shkak të zvarritjeve të tilla.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhet të garantojë që Gjykata Komunale të procedojë me rastin e aplikantit pa ndonjë vonesë të mëtutjeshme dhe ta rishikojë dhe mundësisht përmirësojë sistemin e saj të brendshëm të organizimit. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që iniciativat e ndërmarra nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës dhe nga Departamenti i Drejtësisë të vazhdoen në mënyrë të shpejtë me qëllim që problemi i procedurave të stërzgjatura gjyqësore në tërë Kosovën të mund të zgjidhen sa më shpejtë. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të nxjerrë një rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësimin në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Më 27 prill 2005, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë në të cilën theksohej që UNMIK-u nuk ishte i gatshëm të pranonte konkludimet dhe rekomandimet e raportit pa analiza të mëtejshme. Ai vërejti që pas shqyrtimit të raportit, nuk ishte e qartë nëse kishte pasur ngecje të paarsyeshme në këtë rast dhe nuk ishin hetuar në mënyrë adekuate shkaqet e këtyre ngecjeve. Derisa shprehu lëvdatën për gjykatën e themeluar përsëri pas një konflikti ushtarak që kishte arritur të mbajë**

seanca mbi një rast që dukej të jetë relativisht i ndërlikuar dhe i natyrës jo urgjente, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë vërejtë që do të ishte e rëndësishme të vërtetohet nëse vetë aplikantët kishin qenë përgjegjës për ngecjet. Për më tepër, do të duhej që gjithashtu të merret në konsideratë rriemërimi i një gjykatësi nga Gjykata Komunale në atë të Qarkut. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë gjithashtu theksoi që departamenti i tij nuk kishte mundur të gjejë asnjë vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku ishte e theksuar që një ngecje e ngjashme në rrethana të përafërta kishte përbërë shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që rastet që i kishte cituar Ombudspersoni në raportin e tij ishin të një natyre tjetër. Nëse konkludimet e Ombudspersonit do të përkraheshin me hetime shtesë, atëherë do të merreshin në konsideratë rekomandimet e tij lidhur me mjetet efektive juridike. Lidhur me rekomandimin e Ombudspersonit që të garantohet që Gjykata komunale ta procedojë rastin pa vonesë të mëtejshme, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë vërejtë që fuqitë e UNMIK-ut në këtë drejtim ishin shumë të kufizuara, pasi që çfarëdo qëndrimi tjetër do të rrezikonte ta komprometojë pavarësinë e gjyqësorit dhe mund të ndodhte vetëm pas ndonjë ankesë pranë Njësisë së Inspeksionit Gjyqësor dhe hetimeve pasuese. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë e siguroi Ombudspersonin që nismat e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut ishin ende duke u ndjekur dhe që të dy organet, pas pranimit të rekomandimeve për shpërndarjen e gjykatësve brenda secilit nivel të gjykatave, do të fillonin të veprojnë në pajtim me këto rekomandime gjatë verës dhe vjeshtës të vitit 2005. Në të njëjtën kohë, ai e konsideroi si të parakohshme të kërkohet nga Gjykata Komunale që ta ndërrojë procedurën e saj para se të jetë e qartë pse kanë ndodhur ngecjet. Momentalisht, sistemi organizativ i Gjykatës Komunale u jepte përparësi çështjeve urgjente, siç ishin procedurat penale dhe kontestet e punës dhe mbetëj sfidë të zbatohet një sistem që do të përshpejtonte çështjet e thjeshta në një mënyrë që nuk do të vononte ato çështje për të cilat nevojitej urgjenca. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë që shqyrtimet e nisura do të ofronin një lloj udhëzimi për Këshillin Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës mbi atë se si të tejkalohet kjo sfidë.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 752/02

### ***Lidhur me hetimet e UNMIK-ut mbi pohimet e Jusuf dhe Sabrie Bekës për lëndimet e rënda trupore të pësuar***

Më **13 prill 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që hetimet joadekuate mbi pohimet e aplikantëve për lëndimet e rënda të pësuar trupore kishin përbërë shkelje të të drejtave të aplikantëve për të qenë të lirë nga tortura dhe dënimet ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni vërejti që neni 3 në përmbajtje kërkon zhvillimin e hetimeve efikase mbi pohimet për lëndimet e rënda të pësuar trupore dhe që këto hetime duhet të shpijnë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës për këto vepra penale.

Në këtë rast, autoritetet policore duket ta kenë treguar vëmendjen e duhur në fillim të hetimeve, mirëpo dy vonesa të gjata në procedurën vijuese penale të zhvilluar nga ana e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe prokurorit përgjegjës, duke marrë parasysh vështirësitë për të gjetur të dyshuarit e caktuar dhe moskuptimin e prokurorit për legjislacionin e ri penal të shpallur në prill të vitit 2004, kishin dështuar të përmbushin garancitë e përmbajtura në nenin 3 të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që autoritetet kompetentë të vazhdojnë hetimet e tyre mbi pohimet e Jusuf dhe Sabrie Bekës për lëndimet e rënda të pësuar trupore, në kuptim të ngritjes së kallëzimit penal dhe ndjekjes penale të personave përgjegjës për këto vepra penale. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhet të garantojë që gjykatësit dhe prokurorët në Kosovës të kalojnë trajnime të mëtejshme mbi efektet praktike të legjislacionit të ri penal.

Përmes letrës së 17 majit 2005, ushtruesi i detyrës së Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi e informoi Ombudspersonin që Njësia e Inspeksionit Gjyqësor e Departamentit të Drejtësisë do të hapte hetimet mbi këtë rast. Për më tepër, ai shtoi që Instituti Gjyqësor i Kosovës kishte mbajtur një numër të trajnimeve me përqendrim kryesor në aspektet përmbajtëse dhe procedurale të sistemin të ri të të drejtës penale dhe do të vazhdonte të mbajë trajnime me qëllim të përmirësimit të standardeve të profesionalizmit të gjykatësve dhe prokurorëve në shërbim si dhe kandidatëve që paraqiten për pozita të tilla.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1130/03

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Ramë Dreshës***

Më **15 prill 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për të vendosur brenda një afati të arsyeshëm kohor mbi rastin e tij që kishte të bëjë me një ankesë kundër një vendimi të marrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Derisa e pranoi që dështimi i aplikantit për ta informuar Gjykatës Supreme rreth ndërrimit të vendbanimit kishte shkaktuar vonesë në dorëzimin e aktvendimit, Ombudspersoni gjeti që mungesa e gjykatësve të punësuar në Gjykatën Supreme dhe numri i madh i rasteve në pritje për t'u zgjidhur pranë kësaj Gjykate nuk e arsyetonte një vonesë prej një vit e gjysmë or të vendosur nëse Gjykata Supreme ishte kompetente për t'u marrë me këtë çështje apo jo. Ombudspersoni gjithashtu vërejt që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhet të garantojë që Gjykata e Qarkut në Pejë, me të pranuar lëndën e aplikantit nga Gjykata Supreme e Kosovës, ta procedojë këtë lëndë pa ndonjë vonesë të mëtejshme. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që iniciativat e ndërmarra nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës dhe nga Departamenti i Drejtësisë të vazhdojnë në mënyrë të shpejtë me qëllim që problemi i procedurave të stërzgjatura gjyqësore në tërë Kosovën të mund të zgjidhen sa më shpejtë. Ai më tutje sugjeroi që PSSP do të duhej të nxjerrë një rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësimin në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

Më **20 qershor 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit të UNMIK-ut pranë UNMIK-ut. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë vërejt që nuk ishte në gjendje të pranojë gjetjet e Ombudspersonit. Hetimet e zhvilluar nga Njësia e Inspeksionit Gjyqësor kishin zbuluar që aplikanti nuk ia kishte prezantuar të gjitha faktet relevante zyrës së Ombudspersonit. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë e informoi Ombudspersoni që aplikanti si duket nuk i kishte treguar atij që më **22 janar 2005**, ai e kishte ngritur një padi paralele pranë Gjykatës komunale lidhur



me vendimin substantiv të Ministrisë. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë vazhdoi të përshkruajë procesin e këtyre procedurave, që përfundoi me refuzimin e padisë së aplikantit nga ana e Gjykatës komunale më 17 tetor 2003. Pas ankesës së aplikantit, Gjykata e qarkut e konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës komunale më 5 prill 2005. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë e theksoi që aplikanti i ishte ankuar Ombudspersonit lidhur me zvarritjen e pohuar të procedurës pranë Gjykatës Supreme pasi që padia e tij ishte refuzuar nga Gjykata komunale, por para se të ankohej pranë Gjykatës së qarkut. Ai shtoi që metoda e shqyrtimit të lëndëve e Gjykatës supreme duke u bazuar në kohën kur janë parashtruar, duke marrë në të njëjtën kohë parasysh nevojën për të shqyrtuar më parë lëndët që janë më urgjente se tjerat, ishte ndjekur si duhet në rastin e aplikantit dhe Njësia për Inspeksion Gjyqësor nuk kishte gjetur ndonjë ngecje të tepruar të procedurës lidhur me këtë lëndë.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i regjistrimit *ex officio* 29/04

### ***Lidhur me ligjshmërinë e mbajtjes së personave me aftësi të kufizuara mendore në Entin për Kujdesin Social në Shtime***

Më 5 maj 2005, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, ka publikuar raportin e lartpërmendur

Ky raport shqyrton nëse praktika e mbajtjes së personave me aftësi të kufizuara mendore në Entin për Kujdesin Social në Shtime ishte në pajtim me standardet relevante ndërkom-bëtare për të drejtat e njeriut të vendosura me nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Ombudspersoni së pari vlerësoi se për shkak të karakterit detyrues, vendosja e këtyre individëve në Entin për Kujdesin Social përbën heqje të lirisë në kuptim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një nen që mbron lirinë e çdo individ. Ndonëse çështja nëse heqja e lirisë së këtyre personave ka qenë domosdoshmëri e vazhdueshme mjekësore tashmë ngritë disa dyshime sa i përket ligjshmërisë së mbajtjes së tyre, sidoqoftë, Ombudspersoni konkludon që heqja e lirisë nuk ka qenë në pajtim me parimet themelore të nenit 5. Sipas tij, Ligji mbi Mbrojtjen Sociale që ndër të tjerash rregullon vendosjen e personave me aftësi të kufizuara mendore në Entin për Kujdesin Social nuk ka rregulla të caktuara procedurale për të përcaktuar saktësisht se në çfarë rrethana dhe në çfarë kohëzgjatje vendosja e tillë mund të ketë ndikim, kështu që nuk përmban mbrojtje adekuate procedurale për të mbrojtur individët përkatës kundër heqjes së lirisë në mënyrë arbitrare.

Për më tepër, Ombudspersoni konkludoi që dispozitat e Ligjit mbi Mbrojtjen Sociale lidhur me mundësin e paraqitjes së ankesës nuk ishin të qarta për të ofruar mbrojtje për personat në fjalë dhe nuk parashohin në mënyrë të drejtpërdrejt mundësin e shqyrtimit të rastit nga ana e gjykatës ose ndonjë organi të ngjashëm gjyqësor dhe as nuk parasheh ndonjë formë të procedurës gjyqësore ose të ngjashme. Pra, ato nuk përbënin mjetet e duhura ligjore për shqyrtimin e ligjshmërisë së heqjes së lirisë së personave të lartpërmendur në kuptim të para. 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP-ja dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale do të duhej që sa më shpejt të jetë e mundur të sigurojnë që Ligji mbi Mbrojtjen Sociale të ndryshohet në mënyrë që procedura e vendosjes së personave me aftësi të kufizuara mendore në Entin për Kujdesin Social dhe mundësia e shqyrtimit gjyqësor të mbajtjes së personave të tillë të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

**Nuk ka përgjigje në këtë raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1450/04

### ***Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Shefki Ramadanit***

Më **1 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë për të ndërmarre veprimet e nevojshme për të garantuar zgjidhjen e rastit të aplikantit brenda një kohe adekuate kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë rast që kishte të bëjë me pohimet e aplikantit që fqinjët e tij ishin duke e penguar në qasje dhe shfrytëzim të pronës së tij, Ombudspersoni vërejt që dy aktgjykime ishin nxjerrë mes korrikut të vitit 2000 dhe prillit të vitit 2001, prandaj duket që gjykatat e kishin trajtuar lëndën me vëmendjen e duhur gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, pasi që rasti ishte kthyer për rishqyrtim pranë Gjykatës Komunale në prill të vitit 2001, kjo Gjykatë nuk kishte nxjerrë aktgjykim të ri deri në prill të vitit 2004. Ombudspersoni konkludoi që kjo vonesë e madhe pasqyrore një mosfunksionim serioz në organizimin dhe menaxhimin e rasteve pranë Gjykatës Komunale. Në të njëjtën kohë, fakti që Gjykata e Qarkut ia ktheu lëndën për rishqyrtim Gjykatës Komunale dy herë gjatë një procedure të njëjtë zbulon një të mungesë serioze të cilësisë në sistemin ligjor vendor. Ombudspersoni më tutje vërejt që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të

drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai shtoi që edhe pse e kishte ngritur këtë problem në shumë raporte të mëparshme, nuk dukej që UNMIK-u kishte ndërmarrë ndonjë hap për ta krijuar një mjet të tillë.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, Gjykata Komunale të bëjë një vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe duke u bazuar në këtë vërtetim të nxjerrë një aktgjykim mbi lëndën e aplikantit pa vonesë të mëtejshme. Ombudspersoni me tutje rekomandoi që Gjykata Komunale të ndërmarrë masat përkatëse, duke përfshirë, por duke mos qenë e kufizuar vetëm në të, edhe trajnimin përkatës për ta përmirësuar organizimin e menaxhimit të lëndëve pranë saj. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit *ex officio* 15/01

### ***Lidhur me keqtrajtimin e pohuar të z. Rexhep Kurtaj***

Më **16 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.3 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe paragrafëve 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni së pari analizoi nëse ishin të vërteta pohimet e aplikantit të ishte rrahur nga një polic i UNMIK-ut. Duke marrë parasysh provat përkrahëse siç ishin raportet mjekësore dhe një artikull në gazetë bashkë me një foto të ngjarjes, Ombudspersoni konsideroi që këto pohime ishin të vërteta dhe që kishte ndodhur shkelja e të drejtës së aplikantit për të qenë i lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor apo degradues, siç është e garantuar me nenin 3 të Konventës. Ombudspersoni më tutje gjeti që dështimi i autoriteteve kompetente policore për të zhvilluar hetimet përkatëse mbi pohimet e aplikantit për keqtrajtim, përkundër faktit që për to ishin informuar disa herë, mes tjerash edhe nga Institucioni i Ombudspersonit, gjithashtu kishte përbërë shkelje të nenit 3, pasi që ky nen kërkon zhvillimin e hetimeve efikase mbi pohimet për lëndimet e rënda trupore të pësuar që do të sjellin deri te identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës për vepra të tilla penale.

Ombudspersoni gjithashtu vërejtí që mungesa e ndonjë mjeti efektiv juridik lidhur me

ankesën e aplikantit për shkelje të nenit 3 kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që Policia e UNMIK-ut në të ardhmen të hetojë menjëherë pohimet për keqtrajtim nga ana e policëve. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të garantojë që të gjithë zyrtarët ndërkom-bëtarë të jenë në çdo kohë subjekt i një juridiksioni efikas penal dhe civil.

**Nuk ka pasur përgjigje në këtë raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit *ex officio* 41/05

### ***Lidhur me çështjen e diskriminimit në bazë të moshës në lajmërimet e konkurseve për vende pune në sektorin publik***

Më **20 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.3 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe paragrafëve 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Ky raport hetoi nëse caktimi i moshës si parakusht i detyrueshëm për kandidatët që ishin paraqitur në konkurset e hapura për punësim në sektorin publik ishte diskriminues në kuptim të nenit 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, që është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë. Shqyrtimi në këtë raport është kufizuar në konkurset e hapura për vende pune në sektorin publik që bien nën Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 të 8 tetorit 2001 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, dhe/ose Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë. Raporti kishte të bëjë me lajmërimet e caktuara për vende të lira të punës në sektorin publik që ishin publikuar në të përditshmen “Koha Ditore” gjatë periudhës prej 1 janarit 2004 deri më 31 gusht 2004, të cilat kishin vendosur kufizime në moshë për kandidatët e mundshëm.

Ombudspersoni së pari theksoi që Ligji kundër Diskriminimit i Kosovës nuk mund të zbatohet në rastet e analizuara në raport pasi që ato ishin publikuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ombudspersoni vërejtë që neni 26 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike përcakton që të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit, kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga ligji pa diskriminim, dhe që ligji do të garantojë mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit. Duke u bazuar në këto parime, Ombudspersoni konkludoi që kufizimi i moshës në rastet e shqyrtuara ishte në kundërshtim me nenin 26 të Konventës, pasi që ai nuk ishte i arsyetuar me kurrfarë baza të arsyeshme dhe

objektive. Në disa raste, autoritetet publike në fjalë e pranuan këtë; në rastet tjera arsyetimet e dhëna thjeshtë nuk ishin objektive. Në disa raste tjera, Ombudspersoni vërejti që kufizimi i poshtëm i moshës do të mund të arsyetohej nëse ishte në pajtim me shkollimin dhe përvojën e punës të kërkuar në mënyrë që të mund të kryhen detyrat themelore të postit përkatës, posaçërisht në rastet kur, për shkak të rëndësisë apo veçorive të një posti, kërkohej një person me një nivel të caktuar të përvojës dhe pjekurisë. Sidoqoftë, në rastet e shqyrtuara, kërkesat e punës të përmbajtura në lajmërimet e konkurseve nuk lejonin ndonjë dallim të arsyeshëm të bazuar në moshë. Ombudspersoni gjithashtu konkludoi që kufizimet e mësipërme të moshës përbënin shkelje të nenit 2.1 dhe 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, si dhe, në shumicën e rasteve, shkelje të nenit 2.1 (dh) dhe 2.1 (e) të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 1 shtator 2005, të garantojë që të gjitha institucionet e përfshira publike t'i respektojnë dispozitat përkatëse ligjore që e ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë në qasjen për punësim.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1176/04

### ***Florije Bislimi Ratkoceri kundër Komunës së Lypjanit***

Më **28 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullave 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast që kishte të bëjë me ankesën e aplikantit kundër procedurës së konkurrimit lidhur me emërimin e zyrtarit komunal për çështje gjinore në komunën e Lypjanit, Ombudspersoni hetoi nëse aplikantes i është mohuar e drejta e saj në gjykatë e përcaktuar me nenin 6 të Konventës. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje, të gjithë shërbyesit civil që ankohen kundër vendimeve të organit të tyre punëdhënës, si dhe kandidatët që ankohen për procedurat e konkurrimit për poste brenda shërbimit civil do t'ia drejtojnë ankesat e tyre të ashtuquajturit Këshill i Pavarur Mbikëqyrës. Megjithatë, deri më datën e këtij raporti, ky Këshill ende nuk e kishte filluar punën për shkak se ende nuk ishin finalizuar rregullat procedurale që rregullojnë punën e tij. Megjithatë, sipas Ombudspersonit, kjo procedurë ishte i vetmi mjet juridik i mundshëm për aplikanten, pasi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 përbënte një ligj të veçantë mbi ligjin e përgjithshëm administrativ. Aplikantja, që me sa dukej nuk ishte e informuar për procedurën e drejtë të ankimit, iu ankua Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Lypjanit dhe, pas refuzimit të ankesës së

saj, iu referua Drejtorisë së UNMIK-ut për Çështje Administrative, e cila në vazhdim ia përcjelli ankesën Zyrës Ligjore të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Pasi që Komuna refuzoi të veprojë në pajtim me rekomandimin e kësaj zyre për të përsëritur procedurën e konkurrimit, aplikantja paraqiti rastin e saj pranë Gjykatës komunale në Lypjan, e cila e refuzoi ankesën si të parashtruar jashtë afatit të paraparë kohor, në vend se të deklarohet jo kompetente për të vendosur mbi çështjet e punës që përfshijnë shërbyesit civil dhe që i takonin fushës së të drejtës administrative, jo të drejtës civile. Ombudspersoni vërejtí që Kryeshefi Ekzekutiv, Drejtoria e UNMIK-ut për Çështje Administrative, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Gjykata Komunale kishin dështuar ta udhëzojnë aplikanten për procedurën e drejtë gjyqësore që duhej ndjekur në rastin e saj. Në të njëjtën kohë, ai vërejtí që edhe nëse aplikantja të ishte informuar në mënyrë adekuate, fakti që organi kompetent në formë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës ende nuk e kishte filluar punën do ta kishte parandaluar atë nga fillimi i procedurës pranë Gjykatës Supreme të Kosovës që do të ishte organ kompetent për të vendosur mbi kontestet administrative. Duke supozuar, për qëllime të këtij raporti, që procedura pranë Gjykatës Supreme i përmbush kërkesat e përcaktuara me nenin 6 të Konventës, Ombudspersoni konkludoi që rasti në fjalë përbënte shkelje të të drejtës së aplikantit për qasje në gjykatë sipas nenit 6 të Konventës. Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 1 shtator 2005, të garantojë që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të jetë në gjendje ta fillojë punën e tij pa vonesë të mëtejshme. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që të gjitha institucionet e mbuluara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe gjykatësit në Kosovë, të informohen për procedurat e drejta të ankimit që duhet ndjekur në rastet e ankesave kundër procedurave të konkurrimit për shërbimin civil.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 1469/04 dhe 1470/04

### ***Selvije Qerimi dhe të tjerët dhe Xhezide Zogiani kundër Hekurudhave të UNMIK-ut***

Më **29 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 1.1 dhe 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe paragrafëve 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, aplikantët u ankuan për largimin e tyre të pohuar diskriminues nga puna nga ana e Hekurudhave të UNMIK-ut dhe që imuniteti i UNMIK-ut i parandalonte ata që të ankohen pranë gjykatës. Ombudspersoni përkujtoi në këtë raport që qëllimi kryesor i qëllimi kryesor i dhënies së imunitetit organizatave ndërkombëtare ishte që t'i mbrojë ato nga ndërhyrja e njëanshme e qeverisë në vendet ku ato janë të vendosura, që përbën një qëllim legjitim për ta siguruar punën dhe funksionimin efektiv të organizatave të tilla.

Megjithatë, ky parim themelor nuk vlen në Kosovë për shkak se funksionet e ushtruara nga UNMIK-u janë ato të një zëvendësimi të shtetit dhe nuk është e nevojshme që qeveria të mbrohet nga vetvetja. Ombudspersoni vërejtë që asnjë shtet demokratik që vepron nën sundimin e ligjit nuk i ka dhënë vetës imunitet të plotë nga çfarëdo përgjegjësie administrative, civile apo penale, që hap rrugën për pandëshkueshmërinë e shtetit apo, në rastin e UNMIK-ut, të një entiteti që e zëvendëson shtetin. Prandaj, Ombudspersoni gjeti që qëllimi i imunitetit të UNMIK-ut nuk ishte legjitim dhe kështu nuk arsyetonte kurrfarë pengese ndaj të drejtës së aplikantëve për qasje në gjykatë, duke përbërë me këtë rast shkelje të të drejtës së aplikantëve për qasje në gjykatë, siç është garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni rekomandoi PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 1 shtator 2005, të garantojë që të gjithë punonjësit vendorë të kompanive dhe ndërmarrjeve të udhëhequra nga UNMIK-u ta kenë mundësinë që punëdhënësin e tyre ta paraqesin në gjykatë.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i regjistrimit 732/02

### ***Rrustem Ibishi kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë***

Më **30 qershor 2005**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast që kishte të bëjë me ankesën e aplikantit për dështimin e vazhdueshëm të Gjykatës Komunale për ta përmbuar aktgjykimin e tij të datës 27 janar 1977, Ombudspersoni analizoi nëse aplikantit i ishte mohuar e drejta e tij për qasje në gjykatë ashtu siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës. Përmes aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Komunale e kishte urdhëruar të paditurin, Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Serbisë, që ta lejojë kthimin e aplikantit në vendin e tij të punës. Ombudspersoni vërejtë që nga viti 2001, çështja kryesore ligjore që e kishte penguar Gjykatën Komunale nga përmbarimi i aktgjykimit kishte qenë çështja nëse Fondi i Sigurimeve Sociale i Kosovës ishte trashëgues ligjor i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore të Serbisë. Derisa e pranoi që çështja e trashëgimisë ligjore të përgjegjësive do të mund të ngrit çështje të komplikuar ligjore, Ombudspersoni konsideroi që kjo nuk e kishte arsyetuar një vonesë prej tri vite e gjysmë pas kundërshtimit të Fondit të Sigurimeve Sociale të Kosovës ndaj procedurës së përmbarimit. Kështu, Gjykata Komunale e kishte shkelur të drejtën e aplikantit për qasje në gjykatë të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ombudspersoni rekomandoi që Kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë do të duhej që, jo më vonë se më 21 korrik 2005, të garantojë që Gjykata Komunale të nxjerrë një vendim mbi përmbarimin e aktgjykimit të tij pa vonesë të mëtejshme. Ombudspersoni

gjithashtu rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 1 gusht 2005, të fillojë procedurën disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës kundër atyre gjykatësve të Gjykatës Komunale që kishin qenë të përfshirë në rastin e aplikantit.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i regjistrimit *ex officio* 46/05

### ***Lidhur me ndarjen e banesave në ndërtesën “Gj” në Komunën e Obiliqit***

Më 30 qershor 2005, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë raport Ombudspersoni analizoi ligjshmërinë e vendimeve dhe procedurën lidhur me ndarjen e banesave punonjësve të Komunës në ndërtesën “Gj” që i takonte Komunës së Obiliqit. Raporti ishte rezultat i hetimeve *ex officio* të nisura me ankesat e mëparshme rreth parregullsive në procedurën e ndarjes që ishin pranuar nga individë të caktuar si dhe nga informata tjera që i ishin dorëzuar Ombudspersonit.

Në këtë raport, Ombudspersoni vërejti që komisioni që e kishte emëruar Këshilli Komunal për të zhvilluar procedurën e ndarjes nuk i kishte ndjekur dispozitat e ndarjes nga Ligji i zbatueshëm për Marrëdhënie Banesore të vitit 1983, as ndonjë parim tjetër ligjor, e as kriteret që i kishte përcaktuar vetë. Nga ai gjithashtu nuk është kërkuar t’i raportojë Këshillit Komunal apo ndonjë organi tjetër, as nuk kishte pasur ndonjë dispozitë që e rregullonte përbërjen e tij apo sa i madh do të ishte kuorumi për t’u lejuar marrë vendime të caktuara. Në këtë mënyrë, ky komision kishte vepruar me një pandëshkueshmëri pothuajse të plotë dhe nuk ishte i obliguar t’i përgjigjet kurrfarë ligjeve, procedurave apo organeve mbikëqyrëse. Prandaj, procedurat e ndarjes së banesave nuk kishin përmbytur garanci të mjaftueshme për të parandaluar veprimet arbitrare të Komisionit. Ombudspersoni konkludoi që të drejtat e personave që ishin paraqitur për të ju ndarë banesat ishin lënë pa mbrojtjen e nevojshme kundër veprimeve diskriminuese në shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe jo më vonë se më 1 shtator 2005, të garantojë që procedurat e kontestuara të ndarjes së banesave të zhvillohen përsëri, duke marrë në konsideratë standardet ndërkombëtare të përmendura në raport. Ai gjithashtu rekomandoi që PSSP dhe Ministrinë e lartpërmendura të përgjigjen në mënyrë adekuate në pohimet lidhur me parregullsitë në procedurat e ndarjes së banesave në lidhje me ndërtesën “Gj” në Obiliq.



## **Aneksi 4: Përmbledhje e letrave të përzgjedhura (1 korrik 2004 – 30 qershor 2005)**

### ***Kthimi i refugjatëve të përkatësisë etnike rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë***

*Në maj 2004, Ombudspersoni pranoi informata se Belgjika, Danimarka, Gjermania, Norvegjia, Suedia, Holanda dhe shtete tjera të Evropës qendrore ishin duke planifikuar të kthejnë në Kosovë refugjatët e përkatësisë etnike rome, ashkali dhe egjiptiane. Më 18 maj 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër të hapur Ministrive kompetente të këtyre shteteve duke theksuar që situata e pakicave etnike në Kosovë ishte përkeqësuar, siç ishte vërtetuar me dhunën e përhapur në mars të vitit 2004. As UNMIK-u, as policia vendore nuk kishin mundur ta vëjnë situatën nën kontrollë apo të garantojnë sigurinë për pjesëtarët e këtyre pakicave. Ombudspersoni i dërgoi nga një kopje të kësaj letre një numri të madh të organizatave për të drejtat e njeriut dhe kryesuesve të organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Kryetarin e Parlamentit Evropian. Gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, Ombudspersoni kishte pranuar përgjegjje në letrën e tij nga përfaqësuesit e Parlamenteve të Danimarkës, Suedisë dhe Belgjikës. Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Ombudspersoni pranoi përgjegjjet në vijim:*

**Më 21 korrik 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga znj. Erna Solberg, Ministre e Qeverisë Lokale dhe Zhvillimit Rajonal në Norvegji, në të cilën theksohej që, sipas ligjit në Norvegji, as ajo, as ndonjë Ministër tjetër i Kabinetit nuk mund të intervenojnë në procesimin e rasteve në ndjekje të Ligjit Norvegjez mbi Imigracionin. Në të njejtën kohë, asnjë nga Ministrat e Kabinetit nuk mund të ndërhyjnë në vendimet për të kthyer personat që nuk përmbushnin kriteret për qëndrim në Norvegji. Megjithatë, znj. Solberg e informoi Ombudspersoni që autoritetet norvegjeze ishin duke e përcjellur me vëmendje situatën në Kosovë dhe që, pas dhunës së marsit, autoritetet norvegjeze përgjegjëse çështjet lidhur me imigracionin kishin ndalur përkohësisht procesimin e kërkesave për azil të pjesëtarëve të komunitetit goran, ashkali dhe goran.

**Më 26 korrik 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga z. Patrick Dewael, Ministër i Punëve të Brendshme në Belgjikë, përmes të cilës e sigurontë që Departamenti për Imigracionin i Belgjikës i kthente në Kosovë vetëm personat e përkatësisë etnike shqiptare dhe që secili rast i ishte përcjellur UNMIK-ut për aprovim paraprak. Z. Dewael shtoi që Departamenti për Imigracionin në Belgjikë i përcjell UNMIK-ut të dhënat e pohuara mbi etnicitetin, vendlindjen dhe adresën e fundit në Kosovë të personave përkatës. Z. Dewael e informoi Ombudspersonin që, duke marrë parasysh faktin që UNMIK-u pranonte vetëm kthimin e personave të përkatësisë etnike shqiptare, ishte e qartë që Departamenti për Imigracionin në Belgjikë nuk kishte kthyer me forcë persona të ndonjë përkatësie etnike tjetër. Z. Dewael e përfundoi letrën e tij duke cekur që kthimi i personave të përkatësisë etike jo-shqiptare kishte ndodhur vetëm vullnetarisht dhe kurrë detyrimisht nga Departa-

menti për Imigracion në Belgjikë.

**Më 26 korrik 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Dr. Gerhold Lehnguth, Kryesues i Departamentit për Imigracion, Refugjatë, Integrim dhe Harmonizim në Evropë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme në Gjermani, përmes të cilës e informoi që zyrtarët gjermanë ishin duke e përcjellur me shumë vëmendje situatën në Kosovë dhe ishin në kontakt të rregullt me UNMIK-un lidhur me atë nëse pjesëtarët e pakicave do të duhej të kthehen në Kosovë. Dr. Lehnguth shtoi që, sipas Memorandumit për Mirëkuptim të nënshkruar mes PSSP-së dhe z. Otto Schily, Ministër Federal i Punëve të Brendshme në Gjermani në vitin 2003, pjesëtarët e pakicave romë dhe serbe ishin të përjashtuar nga kthimi për një kohë të pacaktuar. Dr. Lehnguth gjithashtu shtoi që, menjëherë pas dhunës së marsit, UNMIK-u, në konsultim me Gjermaninë, kishin ndërprerë të gjitha kthimet e refugjatëve nga Kosova deri më 15 prill 2004, dhe që prej atëherë ishin kthyer vetëm personat e përkatësisë etnike shqiptare. Pas bisedat pasuese mes qeverisë së Gjermanisë dhe UNMIK-ut dhe analizimit të situatës në Kosovë në qershor të vitit 2004, zyrtarët kishin ardhur në përfundim që pjesëtarët e komuniteteve turk, boshnjak, goran dhe torbesh tani mund të ktheheshin në Kosovë. Kryesuesi i Departamentit të lartpërmendur e mbylli letrën e tij duke shtuar që UNMIK-u dhe qeveria e Gjermanisë ishin pajtuar që rregullisht ta analizojnë situatën dhe që më tej të zhvillojnë procesin e kthimit për pjesëtarët e pakicave në Kosovë.

**Më 11 gusht 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtoresha e Zyrës së UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete, përmes së cilës e informonte që ishte qëndrim i vazhdueshëm i UNMIK-ut që të refuzojë kthimin e personavë pa garantim të sigurisë adekuate dhe qasjes në strehim dhe nevoja tjera humanitare; duke u bazuar në këtë qëndrim, asnjë pjesëtar i komunitetit romë nuk ishte kthyer me forcë në Kosovë. Sipas Drejtoreshës së Zyrës së UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete, kishte qenë qëndrim i UNMIK-ut që, derisa të mos kishte ndonjë përmirësim të dukshëm të situatës së sigurisë, të mos kthehet me forcë asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali, romë dhe egjiptian. Znj. Hicks theksoi që disa nga shtetet nikoqire kishin anuar kah kthimi i pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, mirëpo UNMIK-u kishte vazhduar të ua përsërisë këtyre shteteve rëndësinë e mbrojtjes së pakicave nga kthimi me forcë nëse siguria e tyre nuk mund të garantohej. Në mbyllje të letrës, znj. Hicks shprehu mirënjohjen e saj për vlerësimin e situatës nga ana Ombudspersonit, që përkrahte qëndrimin e zyrës së saj lidhur me këtë çështje të rëndësishme.

### ***Ligjshmëria e veprimeve të autoriteteve publike me synim ndalimin e mbajtjes të simboleve fetare nga nxënësit në shkollat publike në Kosovë***

*Më 4 qershor 2004, Ombudspersoni publikoi një Raport Special ku, në mes tjerash, gjeti se neni 4.7 i Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nuk mund të shërbej si bazë li-*

*gjore për veprimet e autoriteteve publike që ndërhyjnë në të drejtën e nxënësve për të mbajtur simbole fetare në shkollë. Ombudspersoni rekomandoi që, në mungesë të ndonjë dispozite adekuate ligjore, autoritetet publike do të duhej të përmbahen nga çfarëdo veprimi i tillë.*

**Më 30 korrik 2004,** Ombudspersoni e pranoi një përgjegje nga PSSP-ja. i cili kishte shkruar ekzistonin baza tjera të mundshme ligjore për një ndalim të tillë, duke sugjeruar që rregullat e nxjerra nga komunat do të mund të përbënin bazë adekuate ligjore për shkak se këto ishin rregulla të nxjerra nga një autoritet i deleguar vendimprurës. Prandaj, PSSS-ja e konsideroi si joadekuate të ndërmarrë veprimet e rekomanduara nga Ombudspersoni.

**Më 17 shtator 2004,** Ombudspersoni u përgjegj në letrën PSSP-së duke theksuar që i kishte marrë në konsiderim bazat tjera të mundshme ligjore, respektivisht “rregullat e shkollës” të nxjerra nga komunat në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi Arsimin. Megjithatë, Ombudspersoni nuk u pajtua me vlerësimin e PSSP-së që ky ligj do të mund të shërbente si bazë ligjore për ta kufizuar të drejtën për liri të fesë. Ombudspersoni iu referua nenit 3.1 të Ligjit mbi Arsimin duke sqaruar hollësisht që “rregullat e shkollës” të nxjerra nga komunat ishin të dedikuara për rregullimin e “sjelljes së mirë dhe disiplinës së nxënësve në çdo institucion arsimor”. Ombudspersoni theksoi që paragrafi 2 i nënit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i garanton secilit lirinë e shprehjes së fesë si një nga të drejtat themelore të njeriut që mund të kufizohet vetëm me një ligj të nxjerrë posaçërisht për këtë çështje e jo përmes “rregullave të shkollës” që rregullojnë sjelljen e mirë dhe disiplinën. Ombudspersoni shtoi që ligjet që e rregullojnë sjelljen e mirë dhe ato që e rregullojnë mbajtjen e simboleve fetare ishin dy gjëra plotësisht të ndryshme, kështu që autoritetet publike nuk mund të kufizonin lirinë e fesë përsëri ndalimit të mbajtjes së simboleve fetare në institucionet publike në emër të sjelljes së mirë dhe disiplinës së nxënësve. Ombudspersoni konkludoi që edhe nëse komunat do të kishin nxjerrë “rregullat e shkollës” përmes të cilave to të kufizonin lirinë e shprehjes së fesë, rregullat e tilla nuk do ta kishin “kualitetin e ligjit” në kuptim të së drejtën lëndore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke i përsëritur rekomandimet e theksuara në Raportin special nr. 8.

### ***Në lidhje me dështimin për përmbardim efektiv të vendimit të Departamentit për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB)***

*Më 5 maj 2004, Ombudspersoni publikoi një Raport ku gjeti që dështimi i autoriteteve kompetente për ta ekzekutuar në mënyrë efektive vendimin e DÇPB-së të datës 26 tetor 2001, me të cilin aplikantit i lejohej ta kthejë në posedim pronën e tij, kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për respektimin e vendbanimit të tij sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolet shtojcë. Ombudspersoni konkludoi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/60 mbi Kërkesat Pronësore dhe Banesore dhe Rregullat e Procedurës dhe të*

*Provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nuk kishte ofruar përgjegjjet adekuate për këto probleme.*

**Më 11 gusht 2004**, ZPSSP për Administrimin Civil, u përgjegj në raportin e mësipërm. ZPSSP-ja vlerësoi që DÇPB kishte ekzekutuar dhe ri-ekzekutuar vendimin e saj, por që ngjarjet në rastin e aplikantit, që e kishin parandaluar atë nga qasja në pronën e tij, kishin ndodhur pas ekzekutimit të vendimit nga ana e DÇPB-së. ZPSSP-ja shtoi që Ligjet Penale ekzistuese e autorizonin policinë që ta largojë nga një pronë çfarëdo personi që e ka thyer në mënyrë të paligjshme vulën e DÇPB-së pa ndonjë urdhër gjyqësor si dhe parashikojnë sanksionime penale për ata që bëjnë këtë veprim. Sipas ZPSSP-së, Ombudspersoni kishte konkluduar gabimisht në raportin e tij që Rregullorja e UNMIK-ut “nuk kishte paraparë kurrfarë veprimi të mëtejshëm për rastet kur banorët e paligjshëm kthehen pasi të jenë dëbuar një herë”. ZPSSP-ja vlerësoi që dispozitat relevante ligjore e obligojnë policinë ta largojë nga prona personin që e ka thyer vulën dhe shtoi që, në atë rast, prokurori kompetent publik do të duhej vazhdojë me ngritje të aktakuzës, duke pohuar që DÇPB nuk mund ta mbante përgjegjësinë e mbrojtjes së pronës pas dëbimit apo të luante rolin e prokurorit publik për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar kriminelët që kanë hyrë në pronë në mënyrë të paligjshme pasi që DÇPB ta kishte ekzekutuar vendimin e saj. ZPSSP-ja konkludoi që rekomandimi i Ombudspersonit që aplikanti t'i drejtohet prokurorit publik ishte “patjetër, qasja e drejtë këtij problemi”.

**Më 14 shtator 2004**, Ombudspersoni iu përgjegj ZPSSP- së, duke u pajtuar fillimisht që DÇPB nuk mund të merrte përsipër funksionet e prokurorit publik apo gjykatës për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar kriminelët që kanë hyrë në pronë në mënyrë të paligjshme pasi që DÇPB ta kishte ekzekutuar vendimin e saj. Megjithatë, Ombudspersoni vlerësoi që kur DÇPB njëherë ta kishte mbyllur me vulë një pronë dhe ta kishte ekzekutuar një vendim në favor të pronarit, atëherë DÇPB kishte marrë një përgjegjësi të caktuar me të cilën obligohej që të sigurojë që thyerja e vulës së saj të hetohet nga policia dhe prokurorët publik. Ombudspersoni theksoi që, në të shumtën e rasteve, pozita e pronarëve të pronave, pas vitit 1999, ishte e dobët në krahasim me atë të uzurpuesve të paligjshëm dhe e nxiti DÇPB-në që të përkrahë më shumë pozitën ligjore të pronarve të pronave.

### ***Mungesa e pohuar për hetime adekuate në një rast vrasjeje në prill 1999***

*Më 4 maj 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër, në atë kohë, PSSP-së, për të kërkuar informata lidhur me një rast të një aplikanti që ishte ankuar që Prokurori Publik i Qarkut dhe Policia e UNMIK-ut nuk kishin bërë ndonjë përparim adekuat drejt arrestimit dhe ndjekjes penale të individëve që ishin përgjegjës për vrasjen e gjashtë familjarëve të aplikantit. Këta persona ishin vvarë në fshatin Bërrnicë e Epërme, komuna e Prishtinës, më 18 prill 1999. Në letrën e datës 4 maj 2004, dhe në një letër të mëhershme të datës 9 dhjetor 2003, Ombudspersoni gjithashtu kishte kërkuar nga PSSP-ja që ta urdhërojë Policinë e UNMIK-ut që t'ia*

*përcjellë Ombudspersonit dosjen e policisë dhe dokumentet tjera lidhur me rastin.*

**Më 16 gusht 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendësi i PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, përmes së cilës e informonte që hetimet penale kundër njëzet e tre të dyshuarve ishin ndalur për një kohë pasi që të gjithë të dyshuarit ishin në liri. Zëvendësi i PSSP-së theksoi që fletëarrestet ishin lëshuar dhe që hetimet penale do të vazhdonin sapo të arrestohej ndonjë nga të dyshuarit, që besohet të ishin në Serbi. Zëvendësi i PSSP-së sqaroi që transferimi i të dyshuarve në qendër të hetimeve mbi vrasje në Kosovë ishte i vonuar për shkak se transferimi i subjekteve penale mes Kosovës dhe Serbisë kishte mbetur, në përgjithësi, problematik. Zëvendësi i PSSP-së shtoi që UNMIK-u do të vazhdonte përpjekjet për ta zgjidhur këtë çështje në nivelin politik dhe brenda kornizës së Marrëveshjes për Bashkëpunim të Policisë që ishte nënshkruar me Serbinë. Zëvendësi i PSSP-së e mbylli letrën duke e mohuar qasjen në dosjen e policisë që ishte kërkuar nga Ombudspersoni, me arsyetim që nuk ishte e mundur të jipet qasja në dosjet e këtij rasti të veçantë për shkak se ai ishte ende nën hetime apo ishte subjekt i procedurës gjyqësore.

**Më 17 shtator 2004,** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrisë për Drejtësi në Serbi, duke e informuar atë në lidhje me hetimet që janë bërë për rastin e lartpërmendur. Ombudspersoni shtoi që ishte vështirë të pranohet që një shtet që është bërë rishtas anëtar i Këshillit të Evropës në të njëjtën kohë mund të konsiderohet të jetë “vend i sigurtë” për personat e dyshuar të kenë kryer vepra të rënda penale siç janë vrasjet në Kosovë, duke përfshirë me këtë rast mbylljen e suksesshme të çfarëdo hetimesh mbi këto krime dhe sjelljen e kryerësve të tyre para gjykatave penale. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij drejtuar Ministrisë të Drejtësisë duke shprehur shpresat e tij që ky i fundit do t'i jipte kësaj çështje vëmendjen e duhur.

Kopje të kësaj letre i ishin dërguar ZPSSP për Drejtësi dhe Polici, Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, Kryetarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës si dhe Drejtorit për Çështje Ligjore pranë Këshillit të Evropës.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

### ***E drejta për arsimim e komunitetit boshnjak***

*Gjatë disa viteve të fundit, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në Kosovë ka filluar implementimin e reformave në arsim me qëllim të adaptimit të sistemit shkollor në Kosovë me standardet arsimore të shumicës së shteteve tjera evropiane. Fatkeqësisht, këto reforma nuk kishin marrë parasysh interesat specifike të atyre komuniteteve joshqiptare që flasin gjuhët sllave. Gjithashtu, kishte pasur mospërfillje të plotë të fazës së procesit të reformave në vendet fqinje, siç është Serbia, Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina dhe IRJM. Për shkak të kësaj situate, fëmijët e disa komuniteteve të mësipërme, në veçanti një numër i fëmijëve të komunitetit boshnjak dhe goran, të cilët gati humbën tërë vitin shkollor 2003/2004 dhe kishin*

*qenë në gjendje ta kompenzojnë këtë humbje vetëm përmes ndjekjes së “orëve plotësuese” të caktuara gjatë pushimeve verore. Diku nga mesi i 2004, në masë të madhe për shkak të insistimit të Ombudspersonit dhe UNMIK-ut, ndodhi që Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të fillojë të kontaktojë ministritë e ngajshme në shtetet fqinje me qëllim të arritjes së marrëveshjes lidhur me këtë çështje. Në një numër të rasteve gjatë periudhës së fundit për të cilën raportohet, Ombudspersoni u takua me familjet boshnjake dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut pasi që kishte ofruar shërbimet e mira të Insitucionit në mënyrë që t’ua mundësojë përfaqësuesve të familjeve boshnjake që të shprehin brengat e tyre drejtpërdrejt autoriteteve të UNMIK-ut. Letrat në vijim pasqyrojnë progresin e aritur në lidhje me çështjen e lartpërmendur gjatë periudhës për të cilën raportohet:*

**Më 18 gusht 2004,** Ombudspersoni i dërgoi një letër z. Rexhep Osmani, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përmes së cilës kërkoi nga ai që të marrë parasysh suspendimin e klasës së nëntë për pjesëtarët e komunitetit boshnjak për vitin e ardhshëm shkollor. Ombudspersoni gjithashtu shtoi që vazhdimi i drejtimit të përgjithshëm në gjuhën boshnjake në Shkollën e mjekësisë në Prishtinë ishte thelbësor në mënyrë që këtyre nxënësve t’u jipen më shumë mundësi për ta zgjedhur profesionin e tyre si dhe ta vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm në shtetet tjera që i takojnë grupit të njejtë të gjuhës. Ombudspersoni i bëri thirrje z. Osmani të marrë një vendim lidhur me këtë çështje para fillimit të vitit të ri shkollor.

**Më 2 shtator 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në Kosovë përmes së cilës i premtonte që do të përkujdeset që punonjësit arsimor të shkollës së dikurshme të mjekësisë do të ishin pjesë e shkollës së re të mesme në gjuhën boshnjake në Prishtinë. Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji theksoi që të gjithë fëmijët boshnjakë që jetojnë në Kosovë ishin regjistruar në sistemin e ri të reformuar të arsimit, respektivisht në klasën e nëntë dhe të dhjetë, që do t’i sjellnin ata në hap me standardet evropiane. Ai shtoi që do të ishte e panevojshme të vazhdohet lirimi i dy nxënësve boshnjake në Prishtinë nga vijimi i klasës së nëntë, kur të gjithë nxënësit tjerë boshnjakë tashmë ishin duke vijuar klasën e rë të nëntë dhe të dhjetë. Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji mbylli letrën e tij duke e informuar Ombudspersonin për përpjekjet e tij të vazhdueshme për ta rregulluar një rrjet të marrëveshjeve bilaterale mes qeverive në rajon në mënyrë që të arrihet deri te njohja e ndërsjellë e diplomave dhe certifikatave shkollore.

### ***Mungesa e pohuar e hetimeve adekuate në lidhje me vendosjen e eksplozivit në autobusin e “Nis Ekspres”***

*Më 8 gusht 2003, Ombudspersoni pranoi një aplikacion lidhur me mungesën e hetimeve adekuate mbi vendosjen e eksplozivit nën autobusin e “Nis Ekspres”-it më 16 shkurt 2001, në Merdar, afër kufirit administrativ të Kosovës me Serbinë. Aplikanti u ankua që nuk kishte*

pranuar kurrfarë dokumentesh zyrtare për rezultatet e hetimeve të policisë. Më 1 shtator 2003, Ombudspersoni i dërgoi një letër Komisarit të Policisë së UNMIK-ut, për të kërkuar informata lidhur me fazën e hetimeve të policisë dhe për të kërkuar kopje të çfarëdo dokumenti zyrtar në lidhje me rastin. Më 22 shtator 2003, Ombudspersoni pranoi një letër nga Komisar i Policisë së UNMIK-ut. Sipas atyre informatave, hetimet mbi vendosjen e eksplozivit nën autobusin e "Nis Express"-it ishin ende duke u zhvilluar dhe kishin treguar disa rezultate. Komisar i Policisë së UNMIK-ut refuzoi t'i ofrojë Ombudspersonit dokumentet përkatëse, pasi që rasti ishte ende nën hetime. Më 5 dhjetor 2003, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së në të cilën e përsëriti kërkesën e tij për të pasur qasje në dokumentet e lartpërmendura. Në rast të mohimit të kësaj qasje, Ombudspersoni kërkoi arsyetim me shkrim nga PSSP-ja për një veprim të tillë. Më 26 janar 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër të dytë PSSP-së, në të cilët përsëriti kërkesat e letrës së tij të mëparshme.

**Më 19 gusht 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendësi i PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, përmes të cilës sqaronte që hetimet mbi këtë rast ishin në zhvillim e sipër dhe ishin shumë të ndieshme. Megjithatë, Zëvendësi i PSSP-së e siguroi Ombudspersoni që hetimet kishin treguar rezultate, që ishte dëshmuar me arrestimet në qershor të vitit 2004 në Shqipëri dhe transferimin në Kosovë të dyshuarve kryesorë. Në emër të PSSP-së, Zëvendësi i PSSP-së i mohoi Ombudspersonit qasjen në çfarëdo informata të dala nga hetimet e policisë, duke vlerësuar që kjo do të mund ta rrezikonte rastin në procedurën gjyqësore dhe do të ndikonte negativisht në sigurinë e dëshmitarëve.

### **Refuzimin nga ana e Policisë së UNMIK-ut në kërkesën për të organizuar një protestë paqësore**

Më 28 qershor 2004, Ombudspersoni publikoi një Raport ku kishte gjetur se Policia e UNMIK-ut ishte thirrur gabimisht në Ligjin mbi Rendin dhe Qetësinë Publike për të mos e lejuar Lëvizjen Popullore të Kosovës që të organizojë një protestë paqësore kërkesën për të organizuar një protestë paqësore në rastin e Lëvizjes Popullore të Kosovës sepse ky ligj rregullon në mënyrë të përgjithshme sjelljen e qytetarëve në publik por nuk mbulon në mënyrë specifike kërkesat për ta marrë lejen për të organizuar një tubim publik. Në vend të kësaj Ombudspersoni vërejtë që ligji i aplikueshëm në situata të tilla ishte Ligji mbi Tubimet Publike, i cili, megjithatë, nuk përmbushte kërkesat e nenit 11 të Konventës Evropiane të të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit ligjet që rregullojnë të drejtën për tubim duhet të ishin precize dhe kishin nevojë të përmbajnë pasojat e parashikueshme për sjellje të caktuara siç kërkohet sipas nenit 11. Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që të garantojë miratimin dhe shpalljen e një ligji të ri mbi të drejtën për tubim publik dhe paqësor.

**Më 20 gusht 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga ZPSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, në të cilën kishte theksuar që nuk pajtohej me interpretimin e Ombudspersonit të Ligjit mbi Tubimet Publike. Zëvendës PPS-ja vërejtë që e drejta lëndore e Gjykatës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut që Ombudspersoni e kishte cituar në raportin e tij kishte të bëjë me hapjen e letërkëmbimit të të burgosurve dhe për këtë nuk arsyetonte gjetjet e Ombudspersonit që kërkesat e kualitetit të ligjit nuk ishin takuar në kontekstin plotësisht të ndryshëm të lejimit të protestës. Duke u thirrur në këtë bazë, Zëvendës PSPS-ja kishte shkruar që nuk pranonte rekomandimin e Ombudspersonit që do të duhej të miratohet dhe shpallet legjislati i ri mbi të drejtën për tubim publik dhe paqësor. Zëvendës PSPS-ja përfundoi letrën duke cekur që Policisë së UNMIK-ut do t'i drejtohej vëmendja drejt dështimit për t'u thirrur në Ligjin mbi Tubimet Publike.

**Më 14 shtator 2004,** Ombudspersoni e informoi Zëvendës PSPS-në se nuk pajtohet me konkludimet e tij dhe përsëriti pikat kryesore të analizës ligjore të përmbajtur në raportin në fjalë, duke theksuar që Ligji mbi Tubimet Publike nuk tregon me qartësi të arsyeshme fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit përkatës që i është ngarkuar autoriteteve publike lidhur me lirinë e tubimit. Ombudspersoni theksoi që ligjet duhet të tregojnë me qartësi të arsyeshme fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit përkatës që i është ngarkuar autoriteteve publike në mënyrë që për individin të garantohet niveli minimal i mbrojtjes në të cilën qytetari ka të drejtë në një shoqëri demokratike. Ky parim ishte i natyrës së përgjithshme dhe mund të gjendej në shumë raste të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke u bazuar në shembuj të tillë, Ombudspersoni përsëriti që e konsideronte të nevojshme të miratohet dhe shpallet legjislati i ri mbi të drejtën për tubim publik dhe paqësor.

### ***Përcjelljet e KFOR-it për konvojet në mes komunës së Shtërpcës dhe Merdarit dhe Mitrovicës veriore***

**Më 24 gusht 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komandantit të KFOR-it të Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes, përmes të cilës shprehu brengat e tij rreth vendimit të marrë rishtas për të mos ofruar përcjellje për konvojet që i mundësojnë serbëve vajtje-ardhje të rregullt mes komunës së Shtërpcës dhe Merdarit dhe Mitrovicës veriore. Ombudspersoni sqaroi që ishte ende e rrezikshme për serbët që të udhëtojnë nëpër Kosovë pa përcjellje dhe që një përcjellje e tillë ishte një nga kushtet elementare për mbijetesë për popullatën serbe të komunës së Shtërpcës. Ombudspersoni gjithashtu theksoi ngjarjet e dhunshme të marsit të fundit dhe kërkoi nga Komandanti i Brigadës së lartëpërmendur të KFOR-it që t'i ofrojë argumente bindëse dhe informata mbi vlerësimin e situatës së sigurisë që kishin shtyrë KFOR-in të marrë vendimin për të për të mos ofruar përcjellje për konvojet në fjalë.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër**



## ***Problemi i përgjithshëm i ndërtimeve të egra***

**Më 30 gusht 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër z. Bajram Rexhepi, Kryeministër i Kosovës, në të cilën përsëriti përmbajtjen e një letre të mëparshme lidhur me ndërtimet e egra në Kosovë. Ombudspersoni vërejti me keqardhje që nuk kishte pasur përgjegjje në letrën e tij të mëparshme dhe që nuk dukej të kishte pasur ndonjë përpjekje substanciale apo të dukshme nga ana e qeverisë ose komunat për t'u përgjegjur në mosrespektimin e përhapur në Kosovë të ligjeve mbi ndërtimin që momentalisht janë të zbatueshme. Ombudspersoni sqaroi që mungesa e vazhdueshme e reagimit adekuat ndaj praktikave të tilla të paligjshme do të mund ta krijonte bindjen në publik që shkeljet e ligjit vendor do të mund të kalonin pandëshkueshëm dhe që personat që nuk e ndjekin ligjin do të mund të përfundonin si të privilegjuar. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke e përsëritur kërkesën e tij që z. Rexhepi të ndërmarrë masat e nevojshme për t'i dhënë fund ndërtimeve të egra në Kosovë.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

## ***Përdorimi i narkotikëve***

**Më 30 gusht 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër z. Bajram Rexhepi, Kryeministër i Kosovës, në të cilën ia drejtoi vëmendjen drejt faktit që ishte rritur përdorimi i narkotikëve të rrezikshëm në Kosovë dhe që rinia kosovare, në veçanti, i ishte dhënë pas përdorimit të drogave të rënda në një shkallë alarmante. Ombudspersoni i bëri thirrje qeverisë që ta hartojë një strategji për t'u ballafaquar me këtë problem në rritje e sipër. Ombudspersoni theksoi që ishin më se të nevojshme ligjet përkatëse që ndalojnë përdorimin dhe trafikimin e narkotikëve të rrezikshëm, qendrat ku personat e varur nga droga do të mund të shëroheshin, si dhe një fushatë e informimit publik që do ta informonte popullsinë për llojet e drogave dhe rreziqet lidhur me to. Ombudspersoni rekomandoi që qeveria të fillojë të ndërmarrë veprimet e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur, në dobi të tërë popullsisë.

**Më 15 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Departamentit për Drejtësi në UNMIK, ku ai pajtohej me vlerësimin e Ombudspersonit që në Kosovë nuk kishte objekte adekuate për t'u përkujdesur për personat e varur nga droga, qofshin ata të dënuar për ndonjë vepër penale apo jo. Drejtori i Departamentit për Drejtësi në UNMIK shkroi që Ministria e Shëndetësisë e Kosovës do të mund të përgjigjej më mirë në brengat e Ombudspersonit, pasi që Departamenti i Drejtësisë nuk ishte në pozitë të merret me çështje që kanë të bëjnë me këtë problem.

## ***Pamundësia e kërkuesve me origjinë serbe të udhëtojnë të sigurtë në gjykata***

**Më 31 gusht 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër z. Soren Jessen-Petersen, në të cilën theksoi brengën që, edhe pse kishin filluar procedurat pranë gjykatave vendore lidhur me kompenzimin e pronave të dëmtuara ose të shkatërruara gjatë ngjarjeve të dhunës të marsit të vitit 2004, kërkuesit me origjinë serbe shpesh nuk mund të merrnin pjesë në procedurë për shkak të mungesës së përcjelljes të ofruar nga UNMIK-u dhe KFOR-i. Ombudspersoni e përkujtoi z. Petersen që ishte ende rrezik për serbët që të udhëtojnë nëpër Kosovë pa përcjellje dhe e nxiti që të gjejë një zgjidhje adekuate për këtë çështje sa më shpejt që të ishte e mundur.

**10 November 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të përgjithshëm (ZPSSP) për Polici dhe Drejtësi. Në letërn e tij, ZPSSP theksoi se Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut kupton shqetësimet e Ombudspersonin dhe është duke punuar me strukturat relevante për të siguruar qasje në gjykata për këta kërkues. Departamenti i Drejtësisë kishte filluar të organizojë përcjellje për personat përkatës të etnisë serbe dhe zyra ndërlidhëse e UNMIK-ut në Graçanicë kishte organizuar transportin me autobus deri në gjykatat në Prishtinë. Gjithashtu, Departamenti i Drejtësisë kishte kërkuar nga kryetarët e të gjitha gjykatave që mos të planifikohen raste të këtilla deri sa kjo çështje të zgjidhet në mënyrë të kënaqshme

### ***Personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova që qëndrojnë në Serbi***

*Më 5 maj 2004, Ombudspersoni i dërgoi letër Kryeministrit të Republikës së Serbisë në mënyrë që t'ia drejtoj vëmendjen në situatën e personave të zhvendosur nga Kosova që janë duke qëndruar në Serbi. Këta persona nuk kishin hyrë në Serbi nga ndonjë shtet i huaj prandaj ata nuk gëzonin statusin e refugjatit. Ombudspersoni nxiti Kryeministrin e Serbisë që të shohë se a ka mundësi që atyre tu garantohen së paku disa nga të drejtat dhe beneficionet të cilat i gëzojnë refugjatët sepse nuk ishte e mundur të thuhet se kur mund të kthehen këta njerëz në Kosovë. Gjithashtu, Ombudspersoni theksoi rëndësinë që këtyre njerëzve tu jipet e drejta, si qytetarë të Serbisë dhe Malit të Zi, që të zgjedhin nëse dëshirojnë të kthehen në Kosovë apo të ndërtojnë një jetë të re në Serbi.*

**Më 1 shtator 2004**, Ombudspersoni i dërgoi edhe letër tjetër Kryeministrit të Serbisë, në të cilën përsëriti porosinë e letrës së tij të parë, në të cilën kishte theksuar që një numër i madh i personave të zhvendosur nga Kosova ishte duke jetuar në Serbi në kushte të mjera të jetës për gati pesë vite. Ombudspersoni shtoi që situata lidhur me romët nga Kosova që ishin të vendosur në baraka në Beogradin e ri kërkonte veprim të menjëhershëm. Ombudspersoni e informoi z. Kostunica që këta romë ishin duke u përballur me rrezikun e dëbimit nga barakat në Beogradin e ri dhe e nxiti që të zgjidhte statusin ligjor të personave

të zhvendosur pa marrë parasysh përkatësinë etnike të tyre. Ombudspersoni gjithashtu apeloj te Kryeministri i Serbisë që t'i japë fund dëbimit në pritje të romëve që janë duke qëndruar në barakat në Beogradin e ri derisa të mos gjendet ndonjë zgjidhje tjetër për ta.

Gjithashtu, Ombudspersoni ngriti këtë çështje në disa raste gjatë takimeve me organe të ndryshme të Këshillit të Evropës, gjatë vizitës së tij në Strazburg.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

### **Zgjatja e procedurave pranë Komisionit për Kërkesa pranë DÇPB-së**

*Më 29 qershor 2004, Ombudspersoni nxjerr një Raport ku gjeti që dështimi i Komisionit për Kërkesa pranë DÇPB-së për të vendosur në rastet e aplikantëve brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtave të aplikantëve për respektimin e vendbanimit. Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, përmes masave përkatëse ligjore dhe praktikave administrative, të garantojë të drejtat për vendbanim dhe pronë të aplikantëve, si dhe të gjithë personave tjerë në të njejtën situatë.*

**Më 2 shtator 2004,** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendës PSSP-ja për Administrimin Civil, në të cilën theksohej që përmbajtja e përgjithshme e raportit të Ombudspersoni ishte duke u shqyrtuar aktivisht dhe vazhdimisht nga UNMIK-u. Zëvendës PSSP shtoi që autoritetet e UNMIK-ut kishin vendosur mbi më shumë se 60% të ngarkesës me raste gjatë dy viteve të fundit dhe që, sipas mandatit të DÇPB-së, është e paraparë që shqyrtimit i rasteve të përfundojë deri në fund të vitit 2005. Zëvendës PSSP shprehu keqardhjen për situatën e disa mijëra personave që kanë paraqitur kërkesat pranë DÇPB-së, mirëpo sqaroi që përfundimi i një detyre kaq të madhe brenda pesë viteve, duke marrë parasysh ambientin jostabil pas konfliktit, nuk mund të konsiderohet të përbëje shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Siç ishte theksuar në raportin e Ombudspersonit, vonesa në punën me rastet mund të mos paraqesë shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse në ndërkohë janë ndërmarrë veprime të dukshme përmirësimi me një shpejtësi të duhur për t'u përballur me situata të jashtëzakonshme të kësaj natyre. Zëvendës PSSP e informoi Ombudspersoni që çështje thelbësore e ngritur në Raport ishte duke u mbikqyrur me kujdes nga UNMIK-u dhe besonte që korniza ekzistuese ligjore ishte në pajtim me rekomandimin e Ombudspersonit për të garantuar të drejtat themelore përmes masave përkatëse ligjore dhe praktikave administrative. Në përfundim të letrës, Zëvendës PSSP e informoi Ombudspersonin që ishte formuar një Bord Këshillues për ta këshilluar PSSP-në lidhur me mandatin e DÇPB-së dhe që ky Bord do të takohej rregullisht.

**Më 14 shtator 2004,** Ombudspersoni u përgjegj në letrën e Zëvendës PSSP-së, duke shkruar që, përkundër nënkuptimeve të tij, raporti nuk e kishte kritikuar sistemin e punës me rastet pranë DÇPB-së. Në vend të kësaj, vazhdoi Ombudspersoni, raporti ishte përqëndruar në imlementimin në praktikë të këtij sistemi, në veçanti, në faktin që, për shkak

të mungesës së fuqisë punëtore, DÇPB nuk ishte duke i zgjidhur rastet aq shpejtë sa edhe pritet nga një organ i tillë. Ombudspersoni përsëriti që DÇPB me vite ishte detyruar të përballet me probleme që rrjedhnin nga mungesa e përkrahjes financiare dhe e punonjësve të nevojshëm. Ombudspersoni shtoi që ky problem nuk ishte zgjidhur nga ana e autoriteteve të UNMIK-ut. Megjithatë, Ombudspersoni mirëpriti formimin e një Bordi Këshillues për ta këshilluar PSSP-në lidhur me mandatin e DÇPB-së dhe dhe vërejtje që do të ishte mirënjohës për informimin e rregullt për çështjet e ngritura pranë këtij Bordi.

### **Personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova që qëndrojnë në Mal të Zi**

*Ombudspersoni vazhdon të jetë aktiv lidhur me fatin e personave të zhvendosur nga Kosova që janë duke qëndruar në Mal të Zi. Gjatë periudhës së fundit për të cilën është raportuar, ai u takua në Podgoricë me përfaqësuesit e personave të zhvendosur që janë duke qëndruar në Mal të Zi.*

*Më 19 maj 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër z. Milo Djukanovic, Kryeministrit të Republikës së Malit të Zi, duke kërkuar që t'u japë personave të zhvendosur nga Kosova disa të drejta dhe beneficione që gëzohen nga refugjatët. Ombudspersoni përsëri theksoi rëndësinë e asaj që këtyre personave, si qytetarë të Serbisë dhe Malit të Zi, do të duhej të ju jipet e drejta që të zgjedhin nëse dojnë të kthehen në Kosovë ose ta ndërtojnë një jetë të re në Mal të Zi.*

**Më 10 shtator 2004,** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë z. Milo Djukanovic, Kryeministrit të Republikës së Malit të Zi, në të cilën përsëriti porosinë e letrës së tij të mëparshme në të cilën kishte kërkuar që personave të zhvendosur nga Kosova t'u jipen disa nga të drejtat dhe beneficionet që gëzohen nga refugjatët. Ombudspersoni shtoi se kishte kaluar një kohë e gjatë prej kur këta persona ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, duke humbur me këtë rast shumë nga të drejtat që i gëzojnë njerëzit të cilët jetojnë në kushte normale të jetës. Ombudspersoni kërkoi nga z. Djukanovic që kësaj çështje t'i japë prioritetin e kërkuar. Gjithashtu, Ombudspersoni ngriti këtë çështje në disa raste gjatë takimeve me organe të ndryshme të Këshillit të Evropës, gjatë vizitës së tij në Strazburg.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër**

### **Problemi i qasjes të personave me paaftësi fizike në ndërtesat publike**

**Më 15 shtator 2004,** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, në të cilën ia drejtoi vëmendjen drejt faktit që personat me paaftësi fizike të shumtën e rasteve nuk

mund t'i qaseshin ndërtesave publike në Kosovë. Ombudspersoni sqaroi që gjatë dhjetë viteve të fundit, qeverive dhe organizatat qeveritare të shumë pjesëve të botës, duke përfshirë Bashkimin Evropian dhe shtetet tjera të Evropës, u ishte dashur ta kuptojnë që personat me paaftësi fizike duhet të integrohen në shoqëri dhe u takonin të drejtat dhe mundësitë e njejta sikur ato të banorëve tjerë të një rajoni të caktuar. Ombudspersoni theksoi që në pyetje ishte e drejta thelbësore e të qenit i barabartë, që do të duhej të zgjerohej në të gjitha aspektet e jetës publike. Në Kosovë, nuk i është dhënë vëmendja e duhur çështjes së trajtimit të personave me paaftësi fizike. Ombudspersoni konsideroi që ishte koha e fundit që qeveria e Kosovës t'u bashkangjitet shteteve tjera të Evropës në perpjekjet e tyre për të krijuar shoqëritë që u ofrojnë të drejtat e njejta të gjithë njerëzve.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

### ***E drejta për një proces të rregullt gjyqësor të dymbëdhjetë pjestarëve të suspenduar të Trupave Mbrojtëse të Kosovës***

*Më 30 qershor 2004, Ombudspersoni publikoi një Raport në të cilin gjeti që dymbëdhjetë anëtarët e suspenduar të TMK-së nuk ishin informuar në mënyrë të hollësishme për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tyre. Si rrjedhim i kësaj, ata nuk kishin qenë në gjendje ta mbrojnë vetën në mënyrë adekuate kundër këtyre akuzave. Ombudspersoni konkludoi që me këtë rast ishin shkelur të drejtat e këtyre personave për një proces të rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës.*

**Më 24 shtator 2004,** Ombudspersoni pranoi një përgjegjje nga Zëvendës PSSP, në të cilën ishte theksuar që "Raportit i ishte kushtuar vëmendja e duhur". Ombudspersoni shprehu keqardhjen që ZPSSP e kishte konsideruar këtë përgjegjje si të përshatshme për një raport që merret me çështje aq të rëndësishme dhe themelore të të drejtave të njeriut.

### ***Problemi i shpyllëzimit në Kosovë si rezultat i prerjes së paligjshme të drurit***

**Më 30 shtator 2004,** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimeve Rurale në Kosovë, duke ia drejtuar vëmendjen në problemin e përgjithshëm të shpyllëzimit në Kosovë. Ombudspersoni sqaroi që ky problem ishte i bazuar në masë të madhe në praktikën e përhapur të prerjes së paligjshme të drurit në tërë Kosovën dhe mungesën e reagimit adekuat të policisë dhe KFOR-it kur të jenë informuar për këto veprime. Ombudspersoni vërejtë që nëse lejohet që një praktikë e tillë të vazhdojë në mënyrë të pakontrolluar dhe të papenguar, Kosova faktikisht do të mbetet pa drunj. Ombudspersoni shtoi që rrënja e problemit ishte, mes tjerash, mungesa e burimeve al-

ternative të energjisë në zonat rurale, ku druri ishte i nevojshëm për ngrohje në shtëpitë e mijëra familjeve. Duke pranuar që veprime të caktuara ishin ndërmarrë nga PSSP-ja në të kaluarën, Ombudspersoni vërejti që nuk kishte pasur ndonjë përmirësim të dukshëm në këtë drejtim. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke shtuar që çështja tani ishte nën kompetencat e Institucioneve për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (IPVQ) dhe e nxiti Ministrin të sigurojë që qeveria e Kosovës t'i japë kesaj çështjeje prioritetin që i takon.

**Më 17 nëntor 2004**, Ombudspersoni pranoi një përgjegjje nga Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillime Rurale në Kosovë, përmes së cilës u informua që letra e Ombudspersoni ishte shqyrtuar nga të gjithë personat kompetentë dhe të arsyeshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimeve Rurale. Ministri e siguroi Ombudspersonin për përkushtimin e Ministrisë ndaj nevojës për të mbrojtur pyjet në Kosovë. Ai gjithashtu njohu problemet që ishin paraqitur si rezultat i shpyllëzimit në rajon. Z. Bogdanovic gjithashtu përshekroi disa nga aktivitetet e Ministrisë që kishin për qëllim zvogëlimin e shpyllëzimit dhe identifikimin e problemeve që kishin shkaktuar praktikatat e caktuara që fillimisht kishin sjellur deri te shpyllëzimi. Masa disiplinore për shpërdorim të detyrës ishin duke u ndërmarrë vazhdimisht ndaj të punësuarve në Agjensionin Pyjor të Kosovës (APK), që është përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve. Ministria e Bujqësisë kishte ndërmarrë hapa konkretë drejt krijimit të Shërbimit të Inspeksionit Pyjor.

### ***Përmbartimi i vendimeve të gjykatës në llogaritë bankare***

**Më 4 tetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi letër PSSP-së, në të cilën përmendi problemet me të cilat po ballafaqohen gjykatat në Kosovë me rastin e përpjekjes për të përmbartuar vendimet e gjykatës në llogaritë bankare të individëve. Ombudspersoni vërejti që ligjet në fuqi në Kosovë, derisa lejojnë përmbartimin e aktgjykimeve të gjykatës në llogaritë bankare të ndërmarrjeve që janë pronë shoqërore, nuk përmbajnë kurrfarë dispozita për mënyrën si të ekzekutohet në llogaritë bankare të individëve ose kompanive private. Si pasojë e kësaj, shtoi ai, bankat private shpeshherë nuk i përmbahen urdhërave të përmbartimit të lëshuara nga gjykatat vendore, thjeshtë për shkak të asaj se nuk ekziston ndonjë ligj ose rregullore që do t'i obligonte qartas që ta bëjnë këtë. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke kërkuar nga PSSP-ja që të përdorë autorizimet e tij për t'i dhënë fund këtij vakumi ligjor.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

### ***Problemet e arsimimit me të cilat ballafaqohen fëmijët e etnicitetit goran***

*Ombudspersoni vazhdon të jetë aktiv lidhur me fatin e nxënësve goran dhe problemet që ata i kanë lidhur me shkollimin e tyre të mesëm. Gjatë periudhës së fundit raportuese, ai*

shkroi disa letra, duke cekur se, pa mundësinë e vazhimit të shkollimit të tyre në vendet tjera në regjion, pjesëtarët e komunitetit goran (dhe boshnjak) nuk do të mund të kryejnë shkollimin e lartë në gjuhën e tyre amtare, pasi që institucionet arsimore kosovare nuk kanë siguruar një gjë të tillë. Më 21 qershor të vitit 2004, Ombudspersoni ka pranuar një letër nga Këshilltari ligjor i UNMIK-ut drejtuar Ministrin të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e cila e informonte atë se Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, kishte filluar një protokol për bashkëpunim në të gjitha fushat e arsimit, të nënshkruar në mes UNMIK-ut në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ish republikës Jugosllave të Maqedonisë. Njëra nga temat e trajtuara në këtë protokol ishte edhe pranueshmëria e certifikatave shkollore në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e cila do të aprovojë reforma shkollore të ngjashme me ato në Kosovë. Këshilltari ligjor më tutje informoi Ombudspersonin se sistemi modern i arsimit që së voni u është ofruar fëmijëve që flasin në gjuhën Serbe do t'u japë atyre qasje në të gjitha format e shkollimit të lartë si në shtetet fqinje ku flitën gjuhët sllave poashtu edhe në shtetet tjera të Evropës.

**Më 8 tetor 2004**, Ombudspersoni i shkroi një letër Zëvendësit të PSSP-së për Administratë Civile. Në letrën e tij, ai përsëriti kërkesën e tij për suspendimin e zbatimit të klasës së nëntë për pjesëtarët e komunitetit goran derisa të zbatohen reformat shkollore në rajon. Vetëm ky veprim do t'ua mundësonte nxënësve goran që të vijojnë shkollimin e lartë në gjuhën e tyre amtare, derisa Institucionet e Kosovës nuk kanë siguruar një gjë të tillë, dhe derisa disa shtetet të tjera në rajon nuk zbatojnë reformat shkollore. Nëse nuk gjindet ndonjë zgjidhje këta persona nuk do të jenë në gjendje që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre në shkollim dhe do të detyrohen që dikur të largohen nga Kosovën.

**Më 29 tetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendësi i PSSP-së për Administratë Civile i cili e informonte atë se kishte marrë një sigurim nga IRJM dhe Bosnja dhe Hercegovina se diplomat e reja të Kosovës do të pranohen atje. Zëvendësi i PSSP-së poashtu deklaroi se fakultetet e mësuesisë dhe biznesit të Univerzitetit të Prishtinës kishin degët e tyre në gjuhën Boshnjake/Serbe në Prizren dhe Pejë.

**Më 25 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP-ja e cila përmbante një përshkrim të detajuar të veprimeve të fundit dhe atyre të planifikuara në emër të Administratës civile të UNMIK-ut në lidhje me arsimimin në Komunën e Dragashit. Sipas këtij përshkrimi, UNMIK-u dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të vazhdojnë të punojnë së bashku me Departamentin Komunal të Arsimit dhe me udhëheqësit e komunitetit në zbatimin e plotë të reformës arsimore në Kosovë. Gjatë takimeve, prindërit e fëmijëve që janë duke e vijuar klasën e tetë u pajtuan që të dërgojnë fëmijët e tyre për të vijuar klasën e nëntë të obligueshme në pajtueshmëri me sistemin e ri në shtator të vitit 2005. Për fëmijët të cilët kishin munguar nga klasa e nëntë në vitin shkollor 2004/2005, do të ofrohen orët plotësuese me qëllim që t'ua mundësohet atyre të vijojnë klasën e nëntë duke filluar në shtator të vitit 2005, ashtu që ata të jenë në gjendje të marrin diplomën e cila verteton se ata i kanë vijuar nëntë vitet të shkollimit të obligueshëm.

## ***Hetimet mbi incidentet që kishin ndodhur gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004***

**Më 8 tetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për të kërkuar informata për fazën në të cilën gjendeshin hetimet mbi incidentet që kishin ndodhur gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004 dhe që kishin përfshirë vdekjen e një numri të personave, që në disa raste supozohej të ishte shkaktuar si rezultat e operacioneve të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Edhe pse këto ngjarje kishin ndodhur më shumë se shtatë muaj më parë, Ombudspersoni vërejti që ende nuk kishte informata zyrtare mbi atë nëse këto incidente serioze kishin qenë subjekt i hetimeve. Nëse ishin kryer hetime të tilla, nuk kishte pasur kurrfarë deklarata publike lidhur me natyrën ose rezultatit e tyre.

Në rastet që kishin përfshirë vdekjen e individëve, sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kërkohet që të zhvillohen hetime efikase dhe të pavarura me iniciativë të vetë autoriteteve publike, nëse ekziston edhe dyshimi më i vogël që në këtë mund të kenë qenë të përfshirë përfaqësuesit e autoriteteve publike.

**Më 22 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi edhe një letër PSSP-së, në të cilën theksoi që nuk kishte marrë përgjegje në letrën e tij të mëparme.

**Më 30 nëntor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga ZPSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, në të cilën kishte theksuar që ekzistonin tri raste të tilla që kishin të bëjnë me vdekjen e katër shqiptarëve kosovarë. Një rast në Bellopojë ishte mbyllur nga një prokuror ndërkombëtar që kishte konsideruar që polici i përfshirë ndërkombëtar kishte vepruar në mënyrën e duhur dhe në vetëmbrojtje nën kërcënimin e një sulmi të dhunshëm. Dy rastet tjera, prej të cilëve njëri kishte të bëjë me vdekjen e dy kosovarëve shqiptarë si rezultat i veprimeve të KFOR-it në Çagllavicë kurse tjetri me vdekjen e një shqiptari kosovar që kishte rënë nën një autoblindë në Ferizaj, ishin ende nën hetime. ZPSSP-ja vazhdoi duke shkruar që kundërshtonte pohimin e Ombudspersonit që nuk ishin dhënë deklarata publike lidhur me hetimet në vazhdim e sipër dhe rezultatet e tyre. Ai theksoi që Departamenti për Informim Publik rregullisht u kishte ofruar mediave dhe publikut informata për statusin dhe konkludimet e hetimeve. ZPSSP-ja e mbylli letrën e tij me përgjegjjen ndaj brengës së Ombudspersonin lidhur me nevojën për hetime të pavarura, duke shkruar që prokurorët ndërkombëtarë me përvojë të madhe, të ndihmuar nga një grup kyç i hetuesve ndërkombëtarë policorë, që janë duke i kryer hetimet, janë të gjithë profesionistë dhe “janë të përkushtuar të mos gjejnë asgjë tjetër përveç të vërtetës prapa këtyre incidenteve dhe sjelljes së kryerësve të veprave penale para drejtësisë”.



## ***Problemi i përgjegjesisë së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në Kosovë***

**Më 11 tetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër ZPSSP-së për Polici dhe Drejtësi, në të cilën ngriti problemin e përgjegjesisë së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në Kosovë. Në letrën e tij, Ombudspersoni përshkroi një rast që i ishte paraqitur atij lidhur me sjelljen e pohuar të pahijshme të një prokurori ndërkombëtar, lidhur me të cilin ushtruesi i detyrës së kryetarit të Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës, e kishte konfirmuar vlerësimin e Ombudspersonit që Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë kishte kompetenca vetëm lidhur me gjyqësorin vendor por jo edhe mbi gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë. Ombudspersoni shtoi që kur e kishte diskutuar këtë çështje me drejtorin e Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, dhe e kishte pyetur atë se cili organ është përgjegjës për hetimet mbi rastet e pohuara për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, as drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut nuk kishte qenë në gjendje të japë një përgjigje të kënaqshme. Ombudspersoni vërejtë që, duke marrë parasysh këtë, nuk mbetet të konkludohet asgjë tjetër përveç asaj se nuk ekziston asnjë organ që është përgjegjës për një detyrë të tillë, që dukej të nënkuptojë që derisa gjykatësit dhe prokurorët vendorë mund të jenë subjekt i hetimeve disiplinore në rast të sjelljes së pahijshme, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë nuk ishin nën ndonjë mbikëqyrje të tillë. Standarde të tilla të dyfishta dobësonin në masë të madhe përpjekjet e UNMIK-ut për të krijuar një sistem ligjor që ishte në pajtim me parimet dhe vlerat evropiane. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke kërkuar nga PSSP-ja që ta informojë atë nëse UNMIK-u planifikonte të ndërmarrë çfarëdo masa për t'i dhënë fund kësaj situate të patolerueshme.

**Më 1 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, përmes së cilës e informoi që Departamenti i Drejtësisë kishte bërë një analizë të kornizës legjislative që kishte të bëjë me emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut theksoi që Ombudspersoni e kishte vërejtur me të drejtë që as Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës, as Njësia për Inspeksion Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë nuk kryenin kurrfarë funksioni mbikëqyrës apo hetues në lidhje me gjykatësit dhe prokurorëve ndërkombëtarë, ashtu si kryenin për gjykatësit dhe prokurorët nga Kosova. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shtoi që gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë kryejnë funksionin e tyre sipas mandateve dhe rregullimeve institucionale që dallojnë nga ato sipas të veprojnë gjykatësit dhe prokurorët kosovarë. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/6 rregullon emërimin dhe shkarkimin e tyre nga detyra dhe u jep atyre autorizimet që t'i ushtrojnë funksionet e detyrave të tyre, duke përfshirë përgjegjësinë për të zgjedhur dhe marrë përgjegjësi për hetimet e reja dhe të pazgjidhura penale dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime penale. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut gjithashtu citoi Nenin 4 të së njëjtës rregullore, duke sqaruar që ai nën parasheh në mënyrë të veçantë shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë për arsye të sjelljes shumë të keqe, dështimit në kryerjen e

detyrës për shkak të sjelljes së tyre personale ose tjetër. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut dëftoi që gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë u nënshtrohen rregullave dhe rregulloreve të Kombeve të Bashkuara për sa i përket kryerjes së detyrave të tyre profesionale dhe sjelljes personale. Për më tepër, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut theksoi që shumica e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë ende ruajnë emërimet e në juridiksionet e shteteve të tyre derisa janë të punësuar në programin e UNMIK-ut për sundimin e ligjit, dhe që këto juridiksione mbajnë kontrollin përfundimtar ndaj certifikatave të emërimit dhe punës së tyre. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut pranoi që qytetarët e Kosovës kanë të drejtë ta kenë mundësinë t'i drejtohen një organi rregullator që do të hetonte dhe vendoste mbi pohimet për sjellje të pahijshme profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, mirëpo sistemi me anë të cilit ata ishin integruar në sistemin gjyqësor në Kosovë ishte i veçantë dhe i paprecedent në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut theksoi që Departamenti i Drejtësisë ishte duke shqyrtuar themelimin e një organi të tillë rregullator, detyra e të cilit do të ishte të dorëzojë rekomandimet e tij autoriteteve kompetente për të ndërmarrë masa përkatëse disiplinore ndaj gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, respektivisht PSSP-së, administratës së Kombeve të Bashkuara apo juridiksionit të shteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatës ndërkombëtar.

### ***Situata e të paraburgosurve në Qendrën për Paraburgim në Mitrovicë***

**Më 5 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë, për ta alarmuar atë rreth situatës së dy të paraburgosurve, në veçanti, të cilët ishin ankuar që në Qendrën e Paraburgimit ende nuk ishin vendosur linjet telefonike të PTK-së, duke e bërë shumë të vështirë komunikimin mes të paraburgosurve dhe avokatëve dhe familjeve të tyre. Për më tepër, dy të paraburgosurit, që ishin të etnicitetit shqiptar, theksuan që nuk kishin mjaft dritë dhe ajër të pastër për shkak se dritaret ishin të mbyllura me pllaka metali, që nuk ishte rasti me çelitë në të cilat mbaheshin të paraburgosurit serbë. Dy aplikantët shtuan që dritaret nuk ishin aq të pastra dhe mund të shkaktonin sëmundje. Të njëjtit të paraburgosur gjithashtu u ankuan që nuk kanë qasje në mjekë dhe staf tjetër mjekësor shqiptar, përkundër faktit që në një mjedis të dalë nga konflikti, siç është Kosova, ishte shumë e nevojshme që të gjithë të paraburgosurit të kenë qasje në stafin mjekësor të cilit i besojnë që do të ofrojë trajtimin përkatës mjekësor. Për më tepër, dy aplikantët u ankuan që nuk mund të pranenin vizita gjatë fundjavës, që do të siguronte që fëmijëve të tyre të mos u duhet të humbin ditët e shkollës. Si dukej, të paraburgosurit serbë ishin të lejuar të pranojnë vizita edhe gjatë fundjavës. Përveç kësaj, aplikantët u ankuan që vizitat e avokatëve të tyre ishin të kufizuara. Ombudspersoni e nxiti drejtorin e Qendrës së Paraburgimit të ndërmarrë masat përkatëse për të garantuar që problemeve të ngritura nga të paraburgosurit t'u përkushtohet vëmendja e duhur, posaçërisht duke marrë parasysh numrin e të paraburgosurve shqiptarë që momentalisht mbahen në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.

**Më 20 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, përmes së cilës e informoi që, sipas zyrtarëve të lartë të Divizionit për Menaxhim Penal (DMP) pranë Departamentit të Drejtësisë, kishte pasur vështirësi lidhur me linjat telefonike që kishin qenë jashtë kontrollit të tyre, por që më vonë ishin arritur të tejkalohen. Si dukej, një linje e re ishte vendosur rishitas që do të duhej të zgjidhë problemet e mëhershme. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut gjithashtu e informoi Ombudspersonin që ishin larguar objektet metalike që kishin qenë duke i penguar dritaret dhe pamundësuar hyrjen e ajrit dhe dritës nëpër çeli. Lidhur me stafin mjekësor, ai theksoi që Departamenti i Drejtësisë zgjedh stafin e tij vetëm në bazë të kualifikimeve, e jo në bazë të nacionalitetit, dhe do të vazhdonte ta bëjë këtë. Në përfundim të letrës, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë theksoi që, nga të gjitha qendrat e paraburgimit në Kosovë, vetëm Burgu i Dubravës kishte lokalet për të ofruar vizita gjatë fundjavës dhe e mohoi që Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë kishte ofruar vizita gjatë fundjavës për të burgosurit serbë. Përveç kësaj, vizitat juridike ishin absolutisht të pakufizuara – DMP vetëm kërkonte ndonjë lajmërim paraprak që një avokat dëshiron ta vizitojë klientin e tij, e që mund të bëhej edhe përmes një thirrje telefonike disa orë para kohës së dëshiruar.

**Më 11 shkurt 2005**, Ombudspersoni ktheu një përgjegje duke theksuar që Ombudspersoni pajtohej që emërimi i mjekëve dhe motrave medicinale vetëm në bazë të kualifikimeve dhe profesionalizmit të tyre ishte një qasje e drejtë dhe e duhur në një shoqëri në të cilën nuk kishte probleme të mëdha mes personave të përkatësive të ndryshme etnike. Ombudspersoni shtoi që nuk ishte i bindur nëse një qasje e tillë merrte parasysh dhe pasqyronte sa duhet realitetin në shoqërinë kosovare, që ende ishte duke u shëruar nga një konflikt i armatosur që në masë të madhe ishte bazuar në armiqësitë mes grupeve etnike. Ombudspersoni theksoi që raporti mes pacientit dhe mjekut mbështetej në besim, që është posaçërisht e vërtetë për të paraburgosurit të cilët janë në pozitë ta zgjedhin mjekun e tyre. Në rrethana të tilla, Ombudspersoni e gjeti të kuptueshme që të burgosurit do t'i besonin vetëm një mjeku të përkatësive së tyre etnike dhe që e flet gjuhën e tyre. Ai vazhdoi që ky problem nuk ishte i kufizuar vetëm në të paraburgosurit shqiptarë në Mitrovicën veriore, por do të vlente edhe nëse të paraburgosurit serbë apo romë do të mbaheshin në burgjet në Kosovën qendrore. Dukë marrë parasysh realitetet e tilla, Ombudspersoni nxiti drejtorin e Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut të garantojë që të burgosurve shqiptarë në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë t'u sigurohet një numër i mjaftueshëm i mjekëve dhe motrave medicinale shqiptare në të cilët do të mund ta vendosnin besimin e tyre.

**Më 14 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut në të cilën theksohej që ai kishte biseduar për këtë çështje me autoritetet përkatëse të Divizionit për Menaxhim Penal/Shërbimit Korrektues të Kosovës (DMP/SHKK), përfshirë këtu Kryesuesin e këtij divizioni, dhe Kryesuesin e Shërbimit Mjekësor. Rezultatet e këtyre hetimeve, shkroi drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, kishin konfirmuar që punonjës mjekësor në objektet e DMP/SHKK-së në Mitrovicën veriore nuk bënin pjesë pjesëtarët e bashkësisë shqiptare kosovare për shkaqe

të sigurisë në komunën e Mitrovicës. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut theksoi që DMP/SHKK kishte zotim të pamohueshëm ndaj përfaqësimit të të gjitha bashkësive në punonjësit e tij, të përbërë të shumtën nga kosovarët, dhe përshkroi në detaje përbërjen e punonjësve sipas bashkësive. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shtoi që DMP/SHKK konfirmoi në mënyrë specifike që punonjësit mjekësor në objektin e Mitrovicës veriore ishin duke u ofruar trajtim të shkëlqyeshëm dhe në mënyrë profesionale të gjithë të burgosurve dhe të paraburgosurve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, në pajtim të plotë me Betimin e Hipokratit dhe kodet e etikës. Ai gjithashtu pranoi që traumat e shkaktuara nga konflikti i fundit mund ta arsyetonin refuzimin e një të burgosuri apo të paraburgosuri që të trajtohet nga një mjek që i takon një bashkësie të caktuar. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shkroi që pajtohej me DMP/SHKK-në që një traumë të tillë do të duhej ta vërtetonte, si parakusht, një mjek tjetër me ekspertizën përkatëse, të cilin do ta ftonte drejtori i objektit pas njoftimit nga ana e mjekut kujdestar që një i burgosur apo i paraburgosur po refuzon të trajtohet. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shkroi që pajtohej me Ombudspersonin që, kur njëherë të jetë bërë kjo diagnozë, pacientit do të duhej t'i ofrohet trajtimi nga një mjek të cilit ai apo ajo i beson ose, nëse kjo shihet e nevojshme, të bartet pacienti në ndonjë objekt tjetër të DMP/SHKK-së ku është në dispozicion një mjek i tillë. Z. Monaghan theksoi që ky gjithmonë kishte qenë qëndrimi i DMP/SHKK-së. Megjithatë, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shkroi që nuk pajtohej me praktikën e përgjithshme të sugjeruar nga ana e Ombudspersonit, duke shtuar që një praktikë ose politikë e tillë rrezikonte ta mund rekomandimin e Ombudspersonit, derisa në të njëjtën kohë ishte në kundërshtim me parimet demokratike në bazë të të cilave drejtohej DMP/SHKK: rehabilitimi i të gjithë të burgosurve dhe vazhdimi i paqes sociale brenda dhe jashtë objekteve të paraburgimit, gjatë dhe pas paraburgimit të një personi në një objekt të DMP/SHKK-së. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shtoi që një qëndrim i tillë do të shkaktonte ankesa të panumërta nga të paraburgosurit me prapavija të ndryshme që do të kërkonin të trajtohen nga një mjek apo motër medicinale të DMP/SHKK-së sipas zgjidhjes së tyre, duke rrezikuar seriozisht me paraqitjen e trazirave shoqërore nëpër burgjet dhe qendrat e paraburgimit në mbarë Kosovën. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut konkludoi që në mungesë të diagnozës së çrregullimit psikik nga stresi post-traumatik, apo për çfarëdo arsye tjetër valide për ta refuzuar trajtimin nga ana e mjekut të DMP/SHKK-së në dispozicion, atëherë i burgosuri dhe i paraburgosuri ende mundej, si çdo i burgosur apo i paraburgosur, të heqë dorë nga trajtimi mjekësor i ofruar falas nga ana e DMP/SHKK-së dhe të kërkojë shërbimet e një mjeku sipas dëshirës së tij apo saj, me kusht që ai ose ajo të mbulojnë shpenzimet përkatëse.

## ***Pagesa e borxheve të energjisë elektrike***

**Më 11 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së lidhur me praktika të caktuara të faturimit nga ana e Korporatës Energetike të Kosovës (KEK). Ombudspersoni theksoi që, sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2002/19 mbi Pagesat e Borxheve të Shërbimeve Elektrike, KEK-u duhet që ti dorëzojë çdo klienti apo konsumatori një faturë, e cila përcakton shumën e plotë të cilën klienti apo shpenzuesi duhet t'i paguaj KEK-ut për shërbimet e energjisë elektrike gjatë periudhës së borxhit, me një periudhë kohore nga tetori 1999 deri më 20 shtator 2002.

Në këtë mënyrë, kjo përfshinë fushën e obligimeve nga shërbimet publike, që deri më tani është rregulluar nga Ligji Jugosllav mbi Obligimet i cili siguronte që pas kalimit të një viti, kalon afati i parashkrimit për të detyruar konsumatorët që të paguajnë borxhet e shërbimeve publike. Ai vërejtë që ky Udhëzim Administrativ jo vetëm që ka të bëjë me implementimin e dispozitave të përmbajtura në Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2000/49, por përmban dispozita të reja të konsiderueshme që nuk janë apo nuk bazohen në Regullorën e lartpërmendur. Kjo kishte ngritur çështje serioze për sa i përket parimeve themelore të sundimit të ligjit. Ombudspersoni konsideroi që, në këso raste, dispozitat e reja ligjore nuk mund të zëvendësojnë ligjin ekzistues paraprak, që në këtë rast është Ligji i SFRJ-së mbi Detyrimet. Nëse personat kanë ende borxh për energjinë elektrike të shpenzuar, ata nuk mund të detyrohen që të paguajnë për më tepër se një vit të shfrytëzimit të energjinë elektrike, në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit të SFRJ-së mbi Detyrimet, që Ombudspersoni e konsideroi si ligj që është ende i aplikueshëm në këtë çështje të veçantë.

**Më 17 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP, në të cilën theksohej që ai i kishte përfunduar hetimet e hollësishme mbi situatën e energjisë elektrike në Kosovë. PSSP shtoi që, UNMIK-u kishte angazhuar një lloj të “ekipit përmirësues menaxhues” nga i cili pritej që të rritë nivelin e mbledhjes së pagesave për energjinë elektrike nga niveli i ulët momental i mbledhjes e deri te nivelet më të larta të njejtë me ato të rajonit, si dhe të ndërmarrë masa konkrete në lidhje me mospagesën nga ana e shpenzuesve. Derisa KEK-u nuk ishte duke bërë çkyqje kolektive aktive në Kosovë, ai megjithatë ishte duke e rritur numrin e çkyqjeve individuale të atyre që nuk paguanin. PSSP vërejtë që, për shkak të përmirësimit të sistemit të faturimit të KEK-ut, ky sistem, edhe pse i papërfunduar, ofronte metoda adekuate për faturim dhe pagesë. PSSP shtoi që nuk përkrahte kurrfarë sistemi të “amnistisë” për borxhet e mëparshme pasi që kjo do të ishte “papërgjegjësi ndaj KEK-ut dhe të ardhmes së Kosovës”, duke theksuar që KEK-u kishte krijuar një sistem mirëkuptues për pagesën e borxheve. PSSP përsëriti që Urdhëresat Administrative kanë përparësi juridike ndaj ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989 dhe për këtë arsye ato kanë përparësi juridike edhe ndaj Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet. PSSP përsëriti se Neni 3 i Urdhëresës Administrative nr. 2002/19, “nuk përbënte kurrfarë shkelje të parimeve themelore të sundimit të ligjit dhe kishte fuqi të plotë ligjore”.

Në fund, PSSP shtoi që derisa kufizimet e përmbajtura në Ligjin e RSFJ-së mbi Detyrimet, e në lidhje me zbatimin e mbledhjes së borxheve përmes procedurës gjyqësore do të duhet

të vazhdojnë të aplikohen, megjithatë do të duhej të theksohet që këto kufizime në zbatimin e mbledhjes së borxheve përmes gjykatës nuk përbënin baza për shlyerjen e detyrimeve në formë të borxheve. Në raste të këtilla, borxhet ligjërisht mbeteshin “obligime natyrale” dhe që KEK-u do të mund të merrte në konsiderim borxhet e tilla gjatë punës me shenzuesit në fjalë, duke bërë njëkohësisht përpjekje në suaza të ligjit për të mbledhur këto borxhe.

### ***Problemet rreth faturave të energjisë elektrike***

**Më 11 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për të ia drejtuar vëmendjen drejt problemeve lidhur me pagesën për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) e që ishte e ngarkuar përmes faturave të KEK-ut. Ombudspersoni vërejtë që çdo amvisëri, aktivitet afarist ose institucion në Kosovë ishte e obliguar që të paguajë çdo muaj për emetimin e RTK-së, pa marrë parasysh nëse amvisëria, aktiviteti afarist apo institucioni posedonin ndonjë aparat televiziv/radio apo jo. Ombudspersoni theksoi që lidhja e pagesave për RTK-në me faturat e energjisë elektrike dhe mbledhja e të dyjave së bashku bënte të kuptohej që kishte një lidhje mes faturave të energjisë elektrike dhe pagesave për RTK-në. Mirëpo, shumë amvisëri dhe entitete tjera të ngjashme në Kosovë, posaçërisht në zonat rurale, nuk posedonin aparate televizive ose radio. Të tjerët, për shkak të vendit ku gjendeshin, nuk kishin mundësinë të pranojnë emetimet e RTK-së. Sipas informatave në dispozicion të Ombudspersonit, vetëm 80% e Kosovës ishte e mbuluar nga ana e RTK-së. Ombudspersoni konkludoi që vendosja e obligimit mbi një numër të konsiderueshëm të Kosovarëve për të bërë pagesat për shërbimet të cilat nuk i pranonin apo nga të cilat nuk kishin kurrfarë përfitimi, përbënte praktikë diskriminuese. Ai e nxiti PSSP-në që ta ndërrojë rregulloren për pagesat për RTK-në dhe ta marrë në konsiderim faktin që për personat në situata të ndryshme kërkohet trajtim i ndryshëm.

**Më 6 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga këshilltar ligjor i UNMIK-ut, në të cilën theksohej që UNMIK-u nuk pajtohej me vlerësimin e Ombudspersonit që praktikat e faturimit për RTK-në ishte diskriminuese. Këshilltari ligjor sqaroi që RTK ishte themeluar si emetues/ofruer i shërbimeve publike dhe që financimi i tij ishte i varur nga pagesat e qytetarëve, njëllë sikur për të gjithë ofruerit tjerë të shërbimeve publike. Këshilltari ligjor konkludoi që, për shkak se RTK ishte ofruer i shërbimeve publike të dedikuara të gjitha komuniteteve në Kosovë, nga qytetarët kërkohet që të japin kontributin për financimin e tij, edhe nëse në disa raste nuk ishin duke përfituar nga shërbimet e tij.

## ***Fondi për personat e zhvendosur brenda vendit nga pjesa veriore e Mitrovicës***

**Më 12 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për ta informuar atë për një letër të mëparshme, të datës 5 maj 2004, dërguar ish-Kryeministrit të Kosovës, në të cilën kishte kërkuar përkrahje dhe krijim të një fondi të posaçëm nga ana e Qeverisë së Kosovës për personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV) nga pjesa veriore e Mitrovicës. Pas vizitave në zona të caktuara të Kosovës dhe bisedave me personat e zhvendosur, Ombudspersoni erdhi në konkludim që jo vetëm personat e zhvendosur nga pjesa veriore e Mitrovicës, por shumica e personave të zhvendosur brenda vendit e që jetojnë nëpër Kosovë pas konfliktit të vitit 1999 ende ishin duke jetuar në kushte shumë të vështira të jetës. Ombudspersoni i bëri thirrje PSSP-së të sigurojë që këta njerëz të pranojnë ndihmën adekuate.

**Më 17 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga ZPSSP-ja për Administratën Civile, përmes të cilës theksoi që UNMIK-u ndante brengën e Ombudspersonit dhe ishte i gatshëm të bëjë çdo gjë brenda kompetencave të tij për t'u marrë me nevojat e PZhBV-ve. ZPSSP-ja ceku që ishte krijuar një mekanizëm që ishte duke funksionuar mirë për të lehtësuar situatën e PZhBV-ve dhe i cili merrej me kërkesat e tyre të menjëhershme. ZPSSP-ja theksoi që do të ishte problematike të krijohet një fond që do të përkrahte ekskluzivisht PZhBV0-ë nga pjesa veriore e Mitrovicës sepse besonte që nga një fond i tillë do të duhej të përfitonin të gjithë PZhBV-të në mbarë Kosovës, në mënyrë që t'i shmangen përshtypjes që mund të fitohet të trajtimit të jobarabartë. Megjithatë, ZPSSP-së, poqëse një iniciativë e tillë për krijimin e një fondit për PZhBV-të do të fillohej nga ana e Qeverisë së Kosovës, ajo do të përkrahej në masë të madhe nga UNMIK-u. në mbylljen e letrës së tij, ZPSSP-ja pranoi që ende ekzistonin pengesa që duhej të tejkalohen dhe që kufizimet financiare do të kishin përherë ndikim në përparimin e arritur. Sidoqoftë, zgjidhja e situatës së PZhBV-ve mbetej një nga prioritetet më të larta të UNMIK-ut.

## ***Çështja e librave shkollorë për fëmijët e shkollës fillore***

**Më 21 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në atë kohë, për të ia drejtuar vëmendjen në situatën e mjerë ekonomike në të cilën gjenden shumë familje në Kosovë dhe që e ka bërë të pamundur për shumë familje fëmijët e të cilëve vijnë shkollën fillore, posaçërisht familjet që ishin duke pranuar ndihma sociale, blerjen e librave dhe mjeteve shkollore për fëmijët e tyre. Në një situatë të tillë shumë nxënës janë detyruar ta braktisin shkollën. Në letrën e tij, Ombudspersoni theksoi që neni 3.2 i Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë përcakton që tekstet mësimore për nxënësit që vijnë shkollën fillore do të duhej të jipen falas. Ombudspersoni e nxiti Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të shfrytëzojë autoritetin e tij si Ministër për të siguruar që fëmijët, prindërit e të cilëve nuk kanë mundësi të paguajnë për

tekstet e tyre mësimore, të kenë gjithashtu mundësi të përfitojnë nga e drejta për arsimim. Ombudspersoni vërejti se është obligim primar i Qeverisë që të bëjë përpjekje të nevojshme për t'u siguruar të gjithë fëmijëve të Kosovës kushtet themelore për shkollim dhe përkujtoj Ministrin se viti shkollor ka kohë që ka filluar.

**Më 1 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga sekretari i përhershëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), i cili theksoi që, në pajtim me nenin 3.2 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, MASHT kishte shpërndarë falas librat shkollorë për jetimët dhe nxënësit e varfër nëpër tërë Kosovën. Zyrtarët përgjegjës për distribuim kishin shpërndarë librat shkollorë në të gjitha institucionet arsimore të komunave të Kosovës. Sekretari i përhershëm shtoi që MASHT kishte paguar shumën e përgjithshme prej 157,350.70 Euro për librat shkollorë të dedikuar për t'u shpërndarë. Në mbylljen e letrës së tij, ai theksoi që MASHT kishte bërë çdo gjë në kompetencat e saj për ta implementuar ligjin përkatës.

### ***Kushtet e vështira jetësore të romëve të zhvendosur në pjesën veriore të Mitrovicës***

**22 nëntor 2004**, Ombudspersoni i shkroi një letër PSSP-së në të cilën ai shkruante për detajet e kushteve të vështira jetësore me të cilat ballafaqoheshin romët e zhvendosur në pjesën veriore të Kosovës, siç ishte parë gjatë një vizite. Në letrën e tij, Ombudspersoni shtoi se shkalla e lartë e papunësisë në mesin e banorëve të kampeve të romëve në këtë zonë ka sjellë një ndjenje të përgjithshme frustrimi, sikur edhe në humbjen e besimit në autoritetet ndërkombëtare dhe lokale, të cilët duket se i kanë harruar problemet e këtyre personave. Ombudspersoni kishte përmblyllur letrën e tij duke nxitur PSSP-në, që të ndermerr ndonjë veprim të menjëhershëm për të ndihmuar këta njerëz, pasi që dimri po afrohej.

**20 dhjetor 2004**, Ombudspersoni kishte pranuar një përgjegjje nga Zëvendësi i PSSP-së për Administratë civile në emër të PSSP-së. Zëvendësi i PSSP-së kishte shkruar se UNMIK-u i ndanë shqetsimet për situatën me të cilën ballafaqohen romët e zhvendosur, në veçanti ata të cilët jetojnë nëpër qendra kolektive tek të cilët Organizata botërore e shëndetësisë -WHO kishtë gjetur nivel të lartë të plumbit në gjak e që është i rrezikshëm sidomos për fëmijët. Zëvendësi i PSSP-së kishte shkruar se problemi të cilin ata e hasnin kishte qenë i vazhdueshëm dhe se nuk kishte përgjegjje pavarësisht nga përpjekjet e investuara që të thehet cikli i mangësive gjatë disa viteve të fundit. Ai shtoi se, përpjekjet për të kthyer romët në vendet e shtëpive të tyre të dikurshme që gjenden në lagjen e quajtur "Mahalla" në Mitrovicën veriore kishin përparuar, por ato ishin dobësuar dukshëm nga dhuna e mesit të marsit 2004. Zëvendësi i PSSP-së theksoi se kjo punë ishte duke u nxitur dhe përshkroi marrëveshjen e fundit në mes të Ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit regional të komunës së Mitrovicës dhe Kryetarit të kuvendit komunal lidhur me kthimin e romëve të zhvendosur. Zëvendësi i PSSP-së shtonte se më 10 dhjetor 2004, Kuvendi



komunal i Mitrovicës kishte aprovuar që të ndajë 1.5 hektarë tokë për të zhvendosurit romë në afërsi të vendit të ashtuquajtur Mahalla për një rivendosje të përkohshme deri në rindërtimin e shtëpive të tyre. Ai citonte se ishin hulumtuar mundësitë për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme të akomodimit në tokën e pakontaminuar. Zëvendësi i PSSP-së kishte përmbyllur letrën e tij duke njoftuar se një zgjidhje e pranueshme nuk ishte gjetur dhe ftoi Ombudspersonin që të ndërlihet drejtpërdrejtë me zyren rajonale të UNMIK-ut, në rast të kërkesave dhe informacioneve të reja të mëtutjeshme.

### ***Personat e zhvendosur brenda vendit në Graçanicë***

**Më 24 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara, për t'i shprehur brengat e tij rreth mungesës së përkrahjes adekuate për tridhjetë e pesë persona që ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre gjatë dhunës së marsit të vitit 2004 dhe të cilët ishin duke qëndruar në 14 kontejnerë në Graçanicë. Pas dhunës, PZhBV-të në fjalë kishin qëndruar në Kampin e KFOR-it "Slim Lines" dhe pas një kohe të shkurtër ishin rivendosur në Graçanicë ku së pari ishin strehuar në në shkollë, e pastaj në kontejnerët përballë spitalit. Ombudspersoni theksoi që kushtet në kontejnerë tashmë kishin qenë të padurueshme gjatë verës, kur një nga banuesit kishte vdekur nga sulmi në zemër si rezultat i temperaturave të larta. Situata ishte bërë dëshpëruese pasi që temperaturat përnjëherë kishin rënë në vjeshtë. Ombudspersoni përshkroi si PZhBV-të ishin duke jetuar në të njëjtat rroba të cilat i kishin pasur veshur kur i kishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe që atyre u mungonte ngrohja, rrobat dhe furnizimet e nevojshme për dimër. Ombudspersoni vërejti që edhe pse ata ishin të pajisur me ngrohëse elektrike, ato nuk ishin në funksionim për shkak të mungesave të shpeshta të energjisë elektrike. Ombudspersoni shtoi që një numër i këtyre PZhBV-ve ishin tashmë të vjetër dhe të sëmurë, disa ishin fëmijë, disa ishin duke vuajtur nga sëmundjet psikike kurse një grua vuante nga epilepsia. Ombudspersoni theksoi që kontejnerët nuk përbënin objekte të përshtatshme banimi dhe që, deri më atëherë, autoritetet kompetente nuk kishin bërë asgjë për t'i përgatitur ato për dimrin që po afrohej. Ombudspersoni e nxiti PSSP-në që të garantojë që PZhBV-ve tu sigurohen mjetet përkatëse për ta kaluar dimrin, duke marrë parasysh që kthimi i personave të zhvendosur ishte një nga prioritetet më të larta të UNMIK-ut.

**Më 27 janar 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje në emër të PSSP-së nga një përfaqësues i Zyrës së UNMIK-ut për Kthime dhe Bashkësi (ZKB), përmes të cilës e informoi Ombudspersonin që duke filluar prej nëntorit të vitit 2004, UNMIK-u kishte ndërmarrë masa për t'u përgjigjur në nevojat e dy grupeve specifike të PZhBV-ve në Graçanicë: grupin e njerëzve që ishin duke jetuar në kontejnerë, situatën e të cilëve e kishte theksuar Ombudspersoni, dhe një grup tjetër të individëve të cilët ishin duke jetuar përkohësisht në sallën e edukatës fizike të Shkollës "Kralj Milutin". Përfaqësuesi i UNMIK-ut shkroi që ZKB dhe Administrata Civile e Prishtinës, në koordinim me Komunën e Prishtinës dhe

Kryqi e Kuq të Serbisë dhe Malit të Zi, e kishin ndihmuar realizimin e një projekti për të siguruar strehim të përkohshëm dhe një zgjidhje të qëndrueshme për dimrin për PZhBV-të në fjalë. Projekti ishte përfunduar dhe përkrahur financiarisht nga ana e Qeverisë së Kosovës si pjesë e Programit të Asistencës Qeveritare për Kthim të UNDP-së. Në dhjetor të vitit 2004, pesëdhjetë e katër PZhBV-të ishin vendosur në 21 kontejnerë që i kishte siguruar Kryqi i Kuq i Serbisë dhe Malit të Zi. Të gjithë kontejnerët ishin plotësisht të përgatitur për dimër dhe të pajisur me shporetë druri. Gjithashtu, ishte siguruar furnizimi me ujë dhe energji elektrike, kuzhina, lokalet me hapësirë të përbashkët si dhe dalja në ujëra të zeza. PZhBV-ve gjithashtu u ishin siguruar tri metra kub dru për djegie dhe gjësende tjera thelbësorë dhe pritej që të merrnin rroba dimri nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Përfaqësuesi i UNMIK-ut theksoi kontributin prej 10,000 Euro nga Komuna e Prishtinës menjëherë pas dhunës së marsit të vitit 2004, e që ishin të dedikuara në mënyrë specifike për nevojat humanitare të PZhBV-ve.

### ***Obligimi për të paguar taksat për të marrë dokumente personale në Komunën e Gjakovës***

**Më 25 nëntor 2004**, Ombudspersoni i shkroi një letër PSSP-së për ta informuar rreth praktikës në komunën e Gjakovës, sipas së cilës zyrtarët komunal nuk i lejonin qytetarët që të marrin dokumente të caktuara, duke përfshirë certifikatat e lindjes apo të martesës, nëqoftëse ata qytetarë nuk e kishin paguar paraprakisht tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Ombudspersoni theksoi që kishte pranuar informata për një praktikë të tillë edhe nga komunat tjera. Ombudspersoni shtoi që Këshilli Komunal i Gjakovës e kishte bazuar veprimin e saj në nenin 17.3 (c) të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2003/29 për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë. Megjithatë, Ombudspersoni theksoi që ai nen nuk i referohej kurrfarë praktike që do të autorizonte autoritetet administrative komunale që të ndër marrin hapa të tillë. Ombudspersoni nxiti PSSP-së që menjëherë të angazhojë autoritetet kompetente të UNMIK-ut për të reaguar ndaj kësaj praktike të paligjshme dhe ta informojë Ombudspersonin për masat e ndërmarra në këtë drejtim.

**27 janar 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga ushtruesi i detyrës së Përfaqësuesit Racional të UNMIK-ut për Pejë, në të cilën Përfaqësuesi e informoi atë se ushtruesi i detyrës së Shefit Ekzekutiv dhe Drejtori i Administratës së Përgjithshme të Komunës së Gjakovës janë pajtuar se komuna do ta ndalë praktikën e kushtëzimit të dhënies së dokumenteve personale me pagesën e taksave në pronë.

### ***Ndërprerjet e energjisë elektrike për fshatrat që kanë borxh***

**Më 26 nëntor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për t'ia drejtuar vëmendjen në një vizitë që i ishte bërë rishtas zyrës së Institucionit në Prishtinë nga ana e përfaqë-

suesve të fshatrave serbe Bërnice e Poshtme, Bërnice e Epërme, Bardhosh dhe Slivovë për t'u ankuar në lidhje me faktin që prej 18 nënorit 2004 fshatrat e tyre kishin mbetur pa energji elektrike. Sipas informatave në dispozicion të Ombudspersonit, KEK-u ishte arsyetuar se shkak për ndërprerjen e energjisë elektrike në këto fshatra kishin qenë dëmtimet në kabllo të përçues të energjisë elektrike. Megjithatë, Ombudspersoni vërejti që kur përfaqesit e këtyre fshatrave kishin kërkuar nga KEK-u që të riparohet dëmet, këta të fundit i kishin informuar përfaqësuesit se riparimet do të bëheshin vetëm në rast se së paku 60% e banorëve të këtyre fshatrave do të nënshkruanin një kontratë që i obligon ata të paguajnë borxhet për 5 vitet e fundit në këste mujore për 24 muaj me radhë, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Ombudspersoni e informoi PSSP-në që, sipas dënjës së tij, nuk ekzistonte asnjë dispozitë ligjore që lejon KEK-un të veprojë në mënyrë të tillë. Gjithashtu, fshatarëve në fjalë asnjëherë nuk u ishin dërguar faturat për pagesë të energjisë elektrike apo ndonjë kërkesë paraprake për pagesë apo vërejtje. Duke iu referuar Ligjit mbi Energjinë Elektrike Nr. 2004/10, të shpallur rishtas përmes Regullores së UNMIK-ut 2004/22 të 30 qershorit 2004, Ombudspersoni vërejti që ajo përcakton që megjithëse KEK-u mund të ndërpres furnizimin me energji elektrike për mos pagesë të borxheve, personat në pozitë të vështirë duhet të mbrohen nga çkëqija e energjisë elektrike gjatë dimrit. Ombudspersoni vazhdoi letrën e tij duke theksuar situatën posaçërisht të mjerë ekonomike të fshatrave të lartpërmendura dhe pengesat me të cilat ballafaqohen ato për të siguruar të ardhurat për shkak se një pjesë e madhe e tokës së tyre bujqësore ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga persona të fshatrave të afërta, duke e bërë të pamundshme që këta fshatarë të paguajnë shumat e kërkuar nga KEK-u ose të blejnë gjeneratorë si mjet zëvendësues për prodhimin e energjisë elektrike. Ombudspersoni gjithashtu vërejti që zonat rurale në veçanti ishin të prekura më së shumti nga këto praktika të KEK-ut, të cilat nuk kishin përfshirë vetëm fshatrat serbe, por ndikonte te shumë njerëz në tërë Kosovë pa marrë parasysh etninë e tyre. Për këtë arsye, por edhe për arsye të situatës ekonomike të shumë banorëve të Kosovës, gati gjysma e popullatës së Kosovës nuk paguanin energjinë elektrike. Ombudspersoni shtoi që një nga problemet kryesore është që KEK-u nuk ka qenë në gjendje të krijojë deri tani një sistem të organizuar përmes të cilit do të mund të kërkonte pagesat e energjisë elektrike. Në shumë zona, nuk ka sistem të duhur të matjes dhe kur punonjësit e KEK-ut kërkojnë nga popullata Kosovare pagesën e energjisë elektrike borxhlinjtë nuk kanë mundësi të dijnë se a është shuma që u kërkohet atyre nga KEK-u e saktë apo jo. Duke e përshkruar gjithë sistemin e pranimit dhe pagesës të energjisë elektrike gjatë pesë viteve të fundit si "arbitrar dhe kaotik", Ombudspersoni kërkoi nga PSSP-ja që të marrë në konsiderim një lloj "amnestie" për personat borxhet e të cilëve vazhdojnë të rriten pranë KEK-ut, derisa në të njëjtën kohë gjasat që këta njerëz do të mund të paguajnë borxhet astronomike sa vijne e zgovëlohen. Ombudspersoni sugjeroi që, në mënyrë që të përmirësohet përmirësohet sistemi i shërbimit me energji elektrike, do të ishte e preferueshme të fillohet me një "fillim nga zeroja" në kuptim të menaxhimit të shërbimit elektrik dhe pagesave për këtë shërbim kur njëherë të jetë instaluar një sistem i ri që do t'ia lejonte KEK-ut që të pranojë pagesat bazuar në një sistem të duhur të matjes dhe faturimit. Ombudspersoni nxiti PSSP-në ta marrë në konsiderim shlyerjen e borxheve pesëvjeçare si një masë reale për t'u marrë me situatën momentale. Ombudspersoni

përsëriti qëndrimin e tij që e konsideronte Ligjin e RSFJ-së mbi Detyrimet të jetë ende i aplikueshëm në raste të këtilla, siç ishte theksuar në një letër të mëhershme lidhur me praktikën e KEK-ut.

**Më 17 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP, në të cilën theksohej që ai i kishte përfunduar hetimet e hollësishme mbi situatën e energjisë elektrike në Kosovë. PSSP filloi komentet e tij duke përshkruar që rrjeti i energjisë elektrike nuk ishte mirëmbajtur për shumë vite para 1999 dhe që të gjithë banorët e Kosovës ballafaqoheshin me rënie të vazhdueshme të sistemit të energjisë elektrike. Duke marrë parasysh situatën momentale financiare në KEK, rëniet e tilla përkeqësoheshin me faktin që menaxhmenti i KEK-ut nuk ishte në gjendje të financojë riparimet ose mirëmbajtjen e rregullt. PSSP sqaroi që problemet në këtë drejtim rrjedhnin pothuajse plotësisht nga fakti që, prej vitit 1999, ishte bërë më se e përhapur një praktikë e vjedhjes së energjisë elektrike dhe mos pagesës së saj. PSSP insistoi që një praktikë e tillë nuk guxon të vazhdojë sepse “energjinë elektrike nuk është privilegj social në Kosovë, një lloj sikur nuk është në asnjë vend tjetër në botë”. PSSP shtoi që, në mënyrë që të kryheshin reformat aq të nevojshme në KEK, UNMIK-u kishte angazhuar një lloj të “ekipit përmirësues menaxhues” nga i cili pritej që të rritë nivelin e mbledhjes së pagesave për energjinë elektrike nga niveli i ulët momental i mbledhjes e deri te nivelet më të larta të njejtë me ato të rajonit, si dhe të ndërmarrë masa konkrete në lidhje me mospagesën nga ana e shpenzuesve. Derisa KEK-u nuk ishte duke bërë çkyqje kolektive aktive në Kosovë, ai megjithatë ishte duke e rritur numrin e çkyqjeve individuale të atyre që nuk paguanin. PSSP përshkroi hollësisht arsyet specifike për mungesën e energjisë elektrike në fshatrat e përmendura në letërën e Ombudspersonit dhe theksoi që fshatarët nuk kishin marrë faturat për energji elektrike sepse lexuesit e matësve të KEK-ut nuk ishin lejuar të hyjnë në fshatrat serbe në Kosovë. PSSP vërejti që, për shkak të përmirësimit të sistemit të faturimit të KEK-ut, ky sistem, edhe pse i papërfunduar, ofronte metoda adekuate për faturim dhe pagesë. PSSP shtoi që nuk përkrahte kurrfarë sistemi të “amnistisë” për borxhet e mëparshme pasi që kjo do të ishte “papërgjegjësi ndaj KEK-ut dhe të ardhmes së Kosovës”, duke theksuar që KEK-u kishte krijuar një sistem mirëkuptues për pagesën e borxheve. PSSP përsëriti që Urdhëresat Administrative kanë përparësi juridike ndaj ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989 dhe për këtë arsye ato kanë përparësi juridike edhe ndaj Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet. PSSP gjithashtu kundërshtoi pohimet e Ombudspersonit në një letër të mëparshme të tij lidhur me Nenin 3 të Urdhëresës Administrative nr. 2002/19, duke theksuar që ky nen “nuk përbënte kurrfarë shkelje të parimeve themelore të sundimit të ligjit dhe kishte fuqi të plotë ligjore”. PSSP shtoi që derisa kufizimet e përmbajtura në Ligjin e RSFJ-së mbi Detyrimet, e në lidhje me zbatimin e mbledhjes së borxheve përmes procedurës gjyqësore do të duhet të vazhdojnë të aplikohen, megjithatë do të duhej të theksohet që këto kufizime në zbatimin e mbledhjes së borxheve përmes gjykatës nuk përbënin baza për shlyerjen e detyrimeve në formë të borxheve. Në mbylljen e letrës së tij, PSSP theksoi që, në raste të këtilla, borxhet ligjërisht mbeteshin “obligime natyrale” dhe që KEK-u do të mund të merrte në konsiderim borxhet e tilla gjatë punës me shpenzuesit në fjalë, duke bërë njëkohësisht përpjekje në suaza të ligjit për të mbledhur këto borxhe.

## ***Procesi i ekshumimit dhe identifikimi i të mbeturave të kufomave të serbëve dhe joshqiptarëve tjerë në Kosovë***

**Më 1 dhjetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për ta informuar atë rreth një ankese që e kishte pranuar nga kryesuesi i Zyrës për Ekshumim dhe Identifikim pranë Qendrës Koordinuese Serbe për Kosovë dhe Metohi, që është përgjegjëse për ekshumimin dhe identifikimin e serbëve dhe joshqiptarëve tjerë të vrarë para, gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Ombudspersoni përshkroi se si kryesuesi i Zyrës për Ekshumim dhe Identifikim ishte ankuar që procesi i ekshumimit dhe identifikimit të të mbeturave të kufomave të serbëve dhe joshqiptarëve tjerë ishte zhvilluar në mënyrë shumë të ngadalshme. Ombudspersoni kërkoi nga PSSP që ta shqyrtojë këtë çështje dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të gjetur një zgjidhje të duhur. Ombudspersoni gjithashtu kërkoi nga PSSP që ta informojë rreth reagimit të tij ndaj pohimeve të kryesuesit të Zyrës për Ekshumim dhe Identifikim dhe për veprimet që planifikonte t'i ndërmarrë në këtë drejtim.

**Më 18 shkurt 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP, përmes të cilës e informonte që Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (ZPML) e Departamentit të Drejtësisë (DD) pranë UNMIK-ut kishte kryer ekshumime ekstensive prej kur ishte krijuar në vitin 2002. Sipas PSSP-së, ishin kryer 1170 ekshumime të viktimave të të gjitha përkatësive etnike, pa kurrfarë paragjykimesh. PSSP vërejti që ishte përgjegjësi e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur (KNPP), e jo e ZPML-së, që të kryejë analizat e ADN-së. PSSP theksoi që ZPML-ja, në raportin e saj të fundit dyvjetor në atë kohë, e kishte cekur numrin e mostrave të viktimave shqiptare dhe joshqiptare që i ishin dërguar KNPP-së për analiza të ADN-së, si dhe numrin e rezultateve që ishin pranuar. PSSP shtoi që kryesuesi i Zyrës për Ekshumim dhe Identifikim dhe/ose përfaqësuesit e tij kishin marrë pjesë personalisht në shumicën e ekshumimeve të të vdekurve në Kosovë. PSSP konkludoi që e konsideronte çështjen e personave të pagjetur të jetë e rëndësishme më të madhe dhe që do të vazhdonte të bëjë çdo gjë në fuqinë e tij për ta zgjidhur atë.

## ***Ligji i shlyerjes së borxheve publike të Republikës Federale të Jugosllavisë përmes kursimeve të këmbimeve të jashtme të qytetarëve***

**Më 3 dhjetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Guvernatorit të bankës kombëtare të Serbisë duke e informuar atë lidhur me ankesat e fundit të pranuar në lidhje me problemet me të cilat ballafaqohen shqiptarët e Kosovës që shpresojnë të shfrytëzojnë llogaritë e tyre kursyese në ish Jugobankë. Ombudspersoni kërkoi nga guvernatori që t'i sigurojë informacione lidhur me procedurat adekuate që duhet ndjekur.

**Më 12 janar 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Guvernatori i bankës kombëtare të Serbisë. Në letren e tij Guvernatori i bankës kombëtare të Serbisë e informoi Ombudspersonin lidhur me kushtet kur është fjala për kursimet e këmbimit të jashtëm të the-

meluara në një rregullore të lëshuar për këtë qëllim nga qeveria e republikës së Serbisë në vitin 2004, në pajtueshmëri me Ligjin e shlyerjes së borxheve të Republikës Federale të Jugosllavisë përmes kursimeve të këmbimit të jashtëm të qytetarëve. Sipas kësaj rregulloreje, vetëm individët të cilët i paguajnë taksa republikës së Serbisë kanë të drejtën e marrjes së pagesave të privileguara nga kontot e tyre të kursimit. Statusi i taksapaguesve mund të dëshmohet përmes një çertifikate të lëshuar nga organet kompetente në Serbi.

**Më 11 mars 2005**, Ombudspersoni i ka dërguar një letër Ministrit të Financave të republikës së Serbisë duke iu referuar korrespondencës së tij të lartpërmendur me Guvernerin e Bankës Kombëtare të Serbisë. Ombudspersoni e ka informuar atë se sipas aplikantëve, Ministria e Serbisë kishte ndaluar zyrat e administratës tatimore në Graçanicë dhe Mitrovicë që të lëshojnë çertifikatat e nevojshme. Ombudspersoni kërkoi nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave që t`i jap një shpjegim lidhur me këto fakte dhe që t`i dërgojë atij një listë të vendeve në Kosovë ku gjenden njesitë kompetente organizative të administratës tatimore.

**Më 25 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori i Zyres së Administratës tatimore në kuadër të Ministrisë së financave të Serbisë. Në këtë letër, Drejtori i Zyres së Administratës tatimore deklaroi se në pajtueshmëri me nenin 161 të ligjit të aplikueshëm për procedurat e përgjithshme administrative, organet shtetërore ishin të obliguara që të lëshojnë çertifikata *inter alia* për faktet për të cilat ata kanë mbajtur regjistrime zyrtare. Duke ndjekur implementimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të sigurimit të KB-së në Kosovë në vitin 1999, Administrata tatimore e Ministrisë së financave të Serbisë nuk ka më ndonjë regjister lidhur me tatimpaguesit nga Kosova dhe për këtë arsye nuk mund të lëshojë ndonjë çertifikatë të tillë. Ai poashtu theksoi se Administrata tatimore nuk ka lëshuar instrukcione që ndalojnë lëshimin e çertifikatave për personat e kombësisë shqiptare. Në lidhje me kërkesën për një listë të vendeve në Kosovë ku janë vendosur njesitë organizative të Administratës tatimore, Drejtori i Zyres së Administratës tatimore e informoi Ombudspersonin se duke ndjekur Rezolutën 1244 të Këshillit të sigurimit të KB-së në Kosovë, personat e kombësisë shqiptare me banim në Kosovë e Metohi nuk ishin të obliguar të paguajnë taksa apo çmime tjera për Republikën e Serbisë.

**Më 5 maj 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, të cilës i bashkangjiti të gjitha korrespondencat relevante në lidhje me këtë rast. Në letrën e tij, ai kërkoi nga PSSP që të ngrisë këtë çështje gjatë takimit të ardhshëm me autoritetet serbe.

### **Zgjatja e procedurave penale pranë Gjykatës komunale në Prishtinë**

**Më 4 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një aplikacion ku aplikanti ankohej në lidhje me zgjatjen e procedurave penale kundër mjekëve për krime serioze kundër shëndetit publik pranë Gjykatës së qarkut në Prishtinë, të cilat janë në pritje për tu përfunduar që nga 14 nëntori 2002. Aplikanti bënte pjesë në këto procedura si palë e dëmtuar dhe viktimë të

cilit i ishte kërkuar që të paguaj për një biopsi të nevojshme për procedurat.

**Më 7 dhjetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër kryetarit të Gjykatës së qarkut me të cilën kërkonte informacione në lidhje me veprimet që janë ndërmarrë apo planifikohet të ndërmerren për të zgjidhur këtë rast.

14 dhjetor 2004, Ombudspersoni pranoi një letër nga administratori i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, me të cilën ky i fundit e informonte se procedura e rastit ishte ndalur në pritje të rezultatit dhe rezultateve të analizave të biopsisë së mëlqisë, që mund të bëhej vetëm në Shkup, IRJM.

**Më 24 mars 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, ku kishte shprehur shqetësimin e tij në lidhje me faktin se ky rast ishte suspenduar për arsye se aplikanti nuk kishte mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet e biopsisë. Fakti që aplikantit i ishte kërkuar që të paguajë për biopsinë përbën shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë. Në letrën e njejtë, Ombudspersoni kërkoi informacione në lidhje me veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikohen të ndërmerren nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë që rasti të zgjidhet pa vonesë të mëtejshme.

**Më 7 qershor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit të Drejtësisë, me të cilën ky i fundit e informonte se rasti ishte hetuar nga Njësia për Inspeksion të Gjyqësorit pranë Departamentit të Drejtësisë. Njësia për Inspeksion të Gjyqësorit kishte gjetur se vonesa në procedura ishte rezultat i ekspertizës mjekësore që nevojitet për përfundimin e hetimeve që nuk mund të bëhej në Kosovë. Në atë kohë, rasti ishte inaktiv sepse Gjykata e qarkut nuk kishte mundësi të zgjidhë problemin e mbulimit të shpenzimeve të një ekspertize tjetër që duhej bërë jashtë vendit. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë gjithashtu theksoi se departamenti i tij kishte kontaktuar Departamentin e UNMIK-ut për Administratën Gjyqësore dhe kishte kërkuar një zgjidhje për problemin e kompenzimit të shpenzimeve që do të paguheshin për një ekspertizë të tillë

### ***Problemet e komunitetit serb në komunën e Obiliqit***

**Më 17 dhjetor 2004**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, për ta informuar rreth problemeve të caktuara që i kishte ngritur një përfaqësues i komunitetit serb në komunën e Obiliqit. Sipas tij, në Obiliq kishin jetuar 6000 serbë, 2000 romë dhe 3000 shqiptarë para luftës së vitit 1999. Përfaqësuesi e theksoi që shumica e serbëve ishin dëbuar pas hyrjes së bashkësisë ndërkombëtare në rajon. Deri në mars të vitit 2004, në komunën e Obiliqit ishin duke jetuar gjithsej 400 serbë të cilët pastaj ishin dëbuar gjatë ngjarjeve të dhunshme në atë kohë. Katër muaj pas këtyre ngjarjeve të dhunshme, përafërsisht 100 serbë u kthyen në komunën e Obiliqit. Serbët që ishin kthyer pohonin që rindërtimi i shtëpive të tyre si dhe kthimi i personave tjerë të zhvendosur kishte qenë shumë i ngadalshëm. Ata gjithashtu u ankuan rreth mungesës së përgjithshme të sigurisë për këta njerëz

në komunën e Obiliqit. Këto çështje sollën deri te një brengë e përgjithshme që njerëzit që ishin evakuuar nga fshati Hadë, e që ishin shqiptarë, kishin marrë dëmshpërblim dhe pre-  
tendohej që ishin duke i përdorur këto të holla për të blerë shtëpitë e rindërtuara të serbëve  
në komunën e Obiliqit. Ombudspersoni vërejti që këta faktorë do të mund të shpinin deri  
te një komunë njëetnike. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke i bërë thirrje Kryemi-  
nistrit që të ndihmojë pakicat që të integrohen në jetën shoqërore në komunë.

**Më 5 janar 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Kuvendit Komunal të  
Obiliqit, i cili ofroi një përmbledhje të shkurtë të punës dhe situatës në komunën e Obi-  
liqit. Kryetari i Kuvendit Komunal informoi Ombudspersonin që liria e lëvizjes kishte  
arritur nivelin më të lartë të mundshëm, integrimi i komunitetit serb ishte bërë në të gjitha  
sferat e jetës, duke përfshirë edhe Administratën komunale ku për çdo ditë vijnë në punë  
24 punëtorë serbë. Në Plemetin mësojnë bashkë shqiptarët dhe serbët, ku serbët janë të  
privileguar sepse mësojnë në objektin shkollor të ndërtuar me vetëkontributin e të gjithë  
qytetarëve të Plemetit, ndërsa shqiptarët mësojnë në kontejnerë. Në qytetin e Obiliqit,  
nxënësit serbë mësojnë në të njëjtin objekt të rregulluar dhe vetëm në një ndërrim, kur-  
se shqiptarët në një objekt shumë të ngarkuar në dy ndërrim dhe në kushte shumë më  
të vështira se serbët. . Kryetari i Kuvendit Komunal gjithashtu përshkroi që komuniteti  
serb, sikur edhe të gjitha komunitetet tjera që jetojnë në komunën e Obiliqit, gëzojnë  
mbikëqyrje të shkëlqyeshme shëndetësore, derisa objektin e ri të ambulancës në Plemetin  
e shfrytëzojnë vetëm personeli i punësuar serb dhe pacientët serbë. Kryetari i Kuvendit  
Komunal gjithashtu përshkroi hollësisht përpjekjet për t'u marrë me çështjen e PZhBV-vë  
serbë dhe krijimin e grupit punues për kthim. Sipas kryetarit të Kuvendit Komunal, janë  
duke u bërë të gjitha përpjekjet që kthimi dhe jeta e serbëve të jenë sa më të mira dhe të  
qëndrueshme, derisa organet komunale kishin bërë fushatë publike për të parandaluar  
komunitetin shqiptar nga blerja ose marrja me qira e shtëpive të serbëve. Kryetari i Ku-  
vendit Komunal theksoi që të gjithë ata që mendojnë se Obiliqi është apo duhet të jetë  
njëetnik gabojnë rëndë, sepse në Obiliq jetojnë një numër i madh i familjeve në shtëpitë  
dhe banesat e tyre dhe kthimi vazhdon për çdo ditë. Kryetari i Kuvendit Komunal e nxiti  
Ombudspersonin që të vërtetojë vetë informatat që i kishte ofruar në letrën e tij, dhe ceku  
që autoritetet komunale ishin të gatshme që në çdo kohë për të shqyrtuar çfarëdo çështje,  
posaçërisht ato në lidhje me komunitetin serb. Në mbyllje të letrës së tij, ai theksoi që  
bashkëpunimi i autoriteteve komunale me bashkësinë serbe ishte shumë i mirë dhe që ai  
dhe kolegët e tij ishin duke punuar në vazhdimësi për një të ardhme të mirë për qytetarët  
e komunës së Obiliqit.

## **Një grup i punonjësve i shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën serbe**

**Më 23 dhjetor 2004**, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga një grup punonjësish të  
shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën serbe nga disa fshatra të caktuara të komunës së  
Prishtinës, në të cilën ata ankohen në lidhje me dështimin e Ministrisë së Arsimit, Shken-



cës dhe Teknologjisë që të ju sigurojnë pagat që nga marsi 2004.

**Më 20 maj 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duke e informuar atë në lidhje me ankesën e lartpërmendur. Ai sqaroi se Drejtorët e të gjitha shkollave në gjuhën serbe të komunës së Prishtinës kishin nënshkruar një kontratë të përbashkët me Departamenti për Arsim dhe Shkencë pranë UNMIK-ut për një periudhë nga 1 shtatori deri më 31 gusht 2003, pas së cilës arsimtarët, punonjësit e administratës dhe punonjësit mbështetës kishin marrë pagat e tyre. Pasi që përgjegjësitë për shkollat në gjuhën serbe i ishin bartur Ministrisë për Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më tepër se 80 punonjës ishin hequr nga lista e pagave që nga marsi 2004. Pas kërkesave të mëherëshme të pasukseshme të aplikantëve pranë Ministrisë për informacione në lidhje me rastet e tyre, Ombudspersoni kërkoi nga Ministri që të ndërmarr hapat e nevojshme për të siguruar që aplikantët të marrin pagat e tyre për periudhën pas marsit 2004 dhe për kohën në vazhdim pa vonesë të mëtejshme.

**Më 31 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri për Arsim, Teknologji dhe Shkencë në të cilën theksoi se që nga korriku 2003, përgjegjësitë financiare për çështje të tilla ishin bartur nga Ministria në Drejtoritë Komunale për Arsim, të cilat ishin përgjegjëse për të siguruar që numri i mësimdhënësve të jetë në proporcion me numrin e nxënësve (1 mësues shqiptar për 21 nxënës, 1 arsimtar serb për 14 nxënës).

### ***Mbyllja e rrugës “Mulla Idrizi”***

**Më 11 janar 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Komesarit të Policisë së UNMIK-ut, për ta alarmuar për një ankesë të parashtruar në lidhje me mbylljen e rrugës “Mulla Idrizi”, përballë Stacionit Policor në Gjilan, prej vitit 1999. Sipas parashtruesit të ankesës, mbyllja e kësaj rruge, që paraqet një nga rrugët kryesore në Gjilan, pengon seriozisht lirinë e lëvizjes dhe funksionimin e formave të ndryshme të afarizmit. Para ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, rruga e lartpërmendur kishte qenë e hapur për këmbësorë dhe trafik. Sipas informatave në dispozicion të Ombudspersonit, kërkesa të shumta i ishin drejtuar UNMIK-ut, Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Kuvendit Komunal në Gjilan për ta rihapur këtë rrugë. Deri më atë datë, ende nuk kishte pasur kurrfarë përgjigje në këto kërkesa. Ombudspersoni mbylli letrën duke kërkuar nga z. Vittrup që t’ia ofrojë arsytet për mbylljen e rrugës “Mulla Idrizi” dhe kushtet në të cilat do të ishte e mundur që kjo rrugë të rihapet në një të ardhme të parashikueshme.

**Më 15 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Komesari i Policisë së UNMIK-ut i cili shkroi që Zyra e tij kishin biseduar me Drejtorin e Operacioneve të Policisë së UNMIK-ut, dhe Zëvendës Komesarin e Shërbimit Policor të Kosovës, lidhur me mbylljen e rrugës. Ai theksoi që si stacioni i policisë, ashtu edhe i tërë rajoni do të barteshin së shpejti nën autoritetin e SHPK-së dhe që Policia e UNMIK-ut do të ndërprente operacionet e saj me përjashtim të një force monitorimi dhe disa njësite të specializuara. Për më

teper, Komesari i Policisë së UNMIK-ut shkroi që autoriteti mbi ndërtesën ishte në proces të bartjes mbi SHPK-në dhe që Zëvendës Komesari i Shërbimit Policor të Kosovës e kishte lajmëruar atë që autoritetet komunale ishin të njohura me situatën dhe ishin duke kërkuar ndonjë lokacion tjetër për policinë. Deri kur kjo të ndodhte, Drejtori i Operacioneve të Policisë së UNMIK-ut kishte vlerësuar që rruga do të mbetej e mbyllur për shkak të sigurisë së të gjithë atyre që e shfrytëzonin këtë ndërtesë.

### ***E drejta për të votuar e personave të zhvendosur brenda vendit të përkatësisë etnike serbe që janë duke qëndruar në Mal të Zi***

Më 2 qershor 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Komisionit Republikan Zgjedhor në Serbi, në të cilën theksoi se së shpejti do të mbahen zgjedhjet për presidentin e ri të Serbisë dhe sipas ligjit të aplikueshëm në Serbi, çdo qytetar i Serbisë ka të drejtë vote. Ombudspersoni gjithashtu theksoi që serbët që ishin duke jetuar në diasporë nuk kishin pasur problem për të votuar në zgjedhjet e mëparshme. Megjithatë, personat e zhvendosur në Mal të Zi nuk kanë pasur mundësi të votojnë në zgjedhjet parlamentare të Serbisë të mbajtura më dhjetor 2003. Ombudspersoni i kërkoi Kryetarit të Komisionit Republikan Zgjedhor në Serbi informata në lidhje me atë se në çfarë mënyre Komisioni Qendror Zgjedhor mendon t'iu sigurojë këtyre personave të cilët qëndrojnë në Mal të Zi mundësinë për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar. Më 7 qershor 2004, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Komisionit Republikan Zgjedhor në Serbi, në të cilën ai sqaronte që autoritetet serbe nuk kishin juridiksion ose kompetenca në Mal të Zi që do të ua mundësonte të organizojnë pjesëmarrjen në zgjedhje PZhBV-ve që ishin duke qëndruar atje. Më 8 qershor 2004, Ombudspersoni i dërgoi një faks urgjent z. Walter Schwimmer, Sekretarir të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, për ta informuar atë që PZhBV-të nga Kosova ishin të privuar nga njëra nga të drejtat themelore në një demokraci funksionale. Një kopje e kësaj letre i ishte dërguar edhe Ombudspersonit të Malit të Zi. Më 11 qershor 2004, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga z. Schwimmer, me të cilën e informonte që i kishte shkruar Ministrit të Jashtëm të Serbisë, duke e nxitur që të sigurojë në mënyrë të shpejtë që të gjithë qytetarëve të Serbisë dhe të Malit të Zi t'u jetë e garantuar pjesëmarrja e tyre e barabartë në procesin demokratik.

Më 20 janar 2005, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Zëvendës Ombudsmani i Malit të Zi, përmes së cilës e informonte Ombudspersonin që nuk e kishte harruar letrën e tij të 8 qershorit 2004 drejtuar z. Schwimmer. Zëvendës Ombudsmani theksoi që Zyra e Ombudsmanit të Malit të Zi e kishte ngritur këtë çështje para Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Malit të Zi dhe Kryetarit të Komisionit Republikan Zgjedhor, duke kërkuar nga ta që ta informojnë nëse u ishin qasur autoritetet kompetente të Serbisë me kërkesë që t'u mundësohet PZhBV-ve të votojnë në Mal të Zi. Në përgjigje, Kryetari i Komisionit Republikan Zgjedhor e kishte informuar Zyrën e Ombudspersonit të Malit të Zi që autoritetet kompetente në Serbi nuk kishin kërkuar një gjë të tillë nga Komisioni. Zëvendës Ombudsmani theksoi që Kryetari i Komisionit gjithashtu e kishte informuar Zyrën e tij që

sipas legjislacionit mbi zgjedhjet, Komisioni Republikan Zgjedhor nuk kishte kompetenca mbi organizimin e zgjedhjeve në Republikën e Serbisë. Në fund, Zëvendës Ombudsmeni kërkoi ndjesë që nuk e kishte informuar Ombudspersonin menjëherë pas pranimit të informatave të mësipërme.

### ***Krijimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Kosovës***

**Më 4 shkurt 2005:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, për ta përsëritur qëndrimin që e kishte shprehur në një takim të mëhershëm me këtë të fundit lidhur me formimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Kosovës. Derisa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ishte duke ekzistuar brenda Kuvendit për katër vite, deri më tani nuk kishte pasur kurrfarë iniciative për ta formuar një komision që do të ishte përgjegjës për ngritjen e çështjeve tjera të të drejtave të njeriut për të mirë të tërë popullit të Kosovës. Ombudspersoni shkroi që e konsideronte ekzistimin e një komisioni të tillë si parakusht të nevojshëm për të siguruar që puna e Kuvendit të Kosovës dhe ligjet e aprovuara nga ky organ të mund të jenë në gjendje të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai shtoi që nuk e shihte si të dobishëm formimin e një komisioni të ri brenda Kuvendit, por në vend të kësaj sugjeroi zgjerimin e kompetencave të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në mënyrë që të përfshijnë edhe të drejtat e përgjithshme të njeriut dhe që, në pajtim me këtë, të ndërrohet edhe emri i Komisionit. Ombudspersoni theksoi që përgjegjësitë e reja të Komisionit do të përfshinin, mes tjerash, edhe shqyrtimin e projektligjeve në kuptim të pajtueshmërisë së tyre me vlerat e përbashkëta të të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Duke pasur parasysh rëndësinë e një hapi të tillë sa i përket përmbylljes së standardeve, Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke vërejtur që kjo do të forconte dhe lehtësonte në masë të madhe bashkëpunimin më se të nevojshëm mes Kuvendit dhe Institucionit të Ombudspersonit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Pas kësaj letre, Ombudspersoni u takua me Kryetarin e Komisionit për Çështje Gjyqore, Legjislative dhe të Kornizës Kushtetuese dhe biseduan për mundësinë e themelimit të një Komisioni të tillë sipas kornizës kushtetuese. Për më tepër, Ombudspersoni pranoi informata se Kuvendi ishte duke planifikuar themelimin e një Nën-Komisioni që do të funksiononte në kuadër të Komisionit të lartpërmendur.

### ***Zgjatja e procedurave gjyqësore pranë Gjykatave komunale në Kosovë***

**Më 11 shkurt 2005,** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës (KGJPK), për ta informuar që IOK ishte duke punuar në një numër të konsiderueshëm rasteve që kishin të bëjnë me ankesat për zvarritje të procedurës

pranë Gjykatave komunale në Kosovë, duke përfshirë këtu Gjykatat komunale në Ferizaj dhe Viti. Ombudspersoni përmendi që një raport mbi situatën në Gjykatën komunale në Prishtinë ishte publikuar në dhjetor të vitit 2004, derisa raporte të ngjashme mbi Gjykatat komunale në Prizren dhe Pejë ishin duke u përgatitur. Ombudspersoni shkroi se si kishte kërkuar vazhdimisht nga kryetarët e gjykatave përkatëse komunale që të njoftohej për arsyet e zvarritjes së procedurës gjyqësore në rastet të caktuara civile. Përgjigjet e tyre ishin zakonisht të njëjta, respektivisht që problemi kryesor ishte mungesa e gjykatësve të mjaftueshëm për t'u përgjigjur në ngarkesën në rritje e sipër me raste. Ombudspersoni theksoi që, sipas kryetarëve të gjykatave përkatëse komunale, ata kishin kërkuar shumë herë nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë dhe Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut që të rritet numri i gjykatësve në gjykatat e tyre. Megjithatë, në këto kërkesa nuk kishte pasur përgjigje adekuate. Ombudspersoni e nxiti Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës të veprojë sipas kërkesave të mësipërme duke e përshtatur numrin e gjykatësve në gjykatat e lartpërmendura komunale me numrin e rasteve në pritje për t'u zgjidhur në këto gjykata, në mënyrë që këto gjykata më në fund të jenë në gjendje të zhvillojnë procedurat gjyqësore në pajtim me garancitë e përmbajtura në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në veçanti me ato që vendosin që procedura gjyqësore duhet të zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

**Më 9 mars 2005,** Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Kryesuesi i KGJPK-së, në të cilën ai e kishte shqyrtuar, mes tjerash, edhe problemin e zgjatjes së procedurës pranë gjykatave në Kosovë. Në letrën e tij të datës 7 mars 2005, ai e informoi Ombudspersonin që në mënyrë që të zgjidhet problemi i përgjithshëm i zvarritjes së tepruar të procedurës gjyqësore në tërë Kosovën, ai e përkrahte një qasje që kishte për qëllim identifikimin e faktorëve që përcaktonin kohëzgjatjen momentale të procedurës, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të kapacitetit të gjykatësve dhe prokurorëve për të zgjidhur dhe drejtuar rastet në mënyrë efektive. Ai gjithashtu e përkrahu idenë e paraqitjes së një plani të ri të strukturës së punonjësve që, duke u bazuar në kritere objektive dhe gjithëpërfshirëse, do ta pasqyronte më mirë numrin dhe natyrën e ngarkesave me raste me të cilat përballeshin gjykatat. Kryesuesi i KGJPK-së, e informoi më tutje Ombudspersonin që KGJPK dhe Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut tashmë kishin filluar një seri të iniciativave përkatëse lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore, siç ishin të ashtuquajturit Menaxhimi i Rrjedhës së Rasteve dhe Projekti i Reduktimit të Vonesave, që ishin të përqendruara në procesin e menaxhimit në gjykata duke përcjellur rastet civile prej parashtrimit deri te rregullimi, dhe në një shqyrtim të reformave procedurale në lidhje me zvarritjet që ishin ndërmarrë rishtas në rajonin e Ballkanit, në veçanti reformat ligjore të aprovuara rishtas në Bosnë, të drejtuara në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e vonesave në procedurën civile. Departamenti i Drejtësisë gjithashtu do të krijonte disa grupe punuese legjislative me bashkëpunëtorët e tij vendorë dhe ndërkombëtarë në mënyrë që të propozojë ndryshime në ligjet momentale mbi procedurën, që do të kishin për qëllim zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore. Një ekip i përbërë nga specialistët evropianë dhe amerikanë kishte përgatitur rishtas një vlerësim të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në Kosovë dhe, duke u bazuar në këtë vlerësim, kishte propozuar një plan të ri të strukturës

së punonjësve për tërë sistemin gjyqësor në Kosovë. Nga ky plan pritej të pasqyrojë më mirë nevojat e vërteta momentale dhe të ardhme të punonjësve dhe ishte prezantuar dhe diskutuar më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2005. Një specialist ndërkombëtar ishte duke punuar momentalisht në azhurnimin e planit dhe ende duhej të arrihej pajtimi për propozimin përfundimtar lidhur me strukturën e punonjësve. Për këtë arsye, KGJPK nuk kishte qenë në pozitë të hapë vende pune për gjykata të caktuara. Duke marrë parasysh që angazhimet e mësipërme të natyrës më përfshirëse ofronin bazën më të mirë për t'u marrë në mënyrë efikase me çështjen e zvarritjes së procedurës gjyqësore në Kosovë, Kryesuesi i KGJPK-së e gjeti të arsyeshme që të pritet përfundimi i këtyre angazhimeve.

### ***Kërkesat për dorëzimin e parashtresave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim***

**Më 18 shkurt 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër drejtorit të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, për ta njoftuar rreth një numri të ankesave që e kishte pranuar në lidhje me kërkesat për dorëzimin e parashtresave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim. Sipas Ombudspersonit, këto ankesa kryesisht përqendrohen në faktin që kërkohet që të gjitha parashtresat dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara në gjuhën shqipe apo serbe duhet të jenë të shoqëruara me përkthim në gjuhën angleze të parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e përkthimeve të duhet të mbulohen nga ana e palës përkatëse. Duke marrë parasysh faktin që tri gjuhët zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze, Ombudspersoni konsideroi që secilës nga këto gjuhë duhet t'i jepet rëndësia e njëjtë. Vendosija e obligimit mbi personat që dorëzojnë parashtresat pranë Dhomës së Posaçme që të përkthejnë të gjitha dokumentet në gjuhën angleze njëkohësisht vendos mbi ta një barrë të konsiderueshme financiare, që sipas mendimit të tij përbënte një pengesë të panevojshme ndaj ushtrimit të të drejtës së këtyre personave për qasje në gjykatë. Ombudspersoni nxiti Departamentin e Drejtësisë që ta rishikojë nenin 22.7 të Urdhërësës Administrative nr. 2003/13 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare për Mirëbesim për të gjetur një zgjidhje që do të ishte njëlloj e kënaqshme si për gjykatësit e Dhomës së Posaçme, ashtu edhe për palët e përfshira në procedurën pranë saj.

**Më 9 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut në të cilën ai i referohej nenit 22.7 të Urdhërësës Administrative të përmendur nga Ombudspersoni në letrën e tij, duke theksuar që neni me të vërtetë përmbante kërkesën që parashtresat të jenë të shoqëruara me një përkthim në gjuhën angleze. Në vazhdim, drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut citoi dy nenet në vijim 22.8 dhe 22.9, duke theksuar që pala mund t'i paraqesë kërkesë gjykatësit krye-

sues për t'i kërkuar ndihmë në përkthimin e parashtrësave dhe dokumenteve mbështetës dhe që gjykatësi kryesues gjithashtu mund të urdhërojë që përkthimi i dokumenteve dhe parashtrësave nga neni 22.7 të sipërmerren nga Dhoma e Posaçme me shpenzimet e saj, kur ai ose ajo vendos se është e arsyeshme të urdhërojë kështu, duke marrë në konsideratë mjetet e palës. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut shkroi që gjykatësi kryesues i Dhomës së Posaçme kishte pranuar një numër të kërkesave për ndihmë në përkthim, ku secila kërkesë ishte duke u vlerësuar në bazë të veçorive të saj. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut konkludoi që, pasi që legjislacioni mundëson të ndihmë në përkthim për palët për të cilat është dëshmuar të jenë duke u përballur me vështirësi financiare, nuk kishte kurrfarë pengese të panevojshme në ushtrimin e të drejtës së secilit person për qasje në gjykatë, posaçërisht kur të merret parasysh fakti që shërbimet e Dhomës së Posaçme, së paku për momentin, ofroheshin falas.

### ***Themelimi i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet lidhur me Kornizën Kushtetuese***

**Më 21 shkurt 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së për t'ia drejtuar vëmendjen në problemin me të cilin po përballej një numër në rritje e sipër i qytetarëve, të cilët ishin udhëzuar t'i drejtohen Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet lidhur me Kornizën Kushtetuese. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë, kjo Odë ishte kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të caktuara administrative. Ombudspersoni theksoi që, sipas informatave që kishte në dispozicion, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës ia kishte dërguar PSSP-së në atë kohë një draft të një Udhëzimi Administrativ në maj të vitit 2003. Ky Udhëzim Administrativ ishte paramenduar ta rregullojë themelimin dhe punën e organit të lartpërmendur. Sipas Kryetarit të Gjykatës Supreme, ai deri më tani nuk kishte pranuar kurrfarë përgjigje lidhur me këtë draft as nga PSSP në atë kohë, as nga PSSP i tanishëm. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështje dhe që përherë e më shumë njerëz po udhëzoheshin të parashtrojnë ankesat e tyre para Odës së Veçantë që ende nuk ishte funksionale, Ombudspersoni e nxiti PSSP-në që ta informojë për fazën në të cilën në atë kohë gjendeshin përgatitjet për themelimin dhe punën e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet lidhur me Kornizën Kushtetuese.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

### ***Fëmijët e rrugës***

**Më 23 Shkurt 2005**, Ombudspersoni ka shkruar një letër për Ministrin e arsimit, shkençës dhe teknologjisë duke tërhequr vëmendjen e tij për situatën e fëmijëve që i kalojnë ditët tyre nepër rrugë, duke punuar apo duke kërkuar të holla pas ndërprerjes së shkolimit

apo për shkak të mosvijimit të shkollimit. Edhe pse ata në kuptimin e ngushtë të fjalës nuk janë “fëmijë të rrugës”, sepse ata në mbrëmje kthehen në shtëpitë dhe familjet e tyre, këta fëmijë akoma janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme, dhe lehtë mund të bëhen viktima të trafikimit apo të prostitucionit të fëmijëve. Duke patur parasysh se fëmijët janë akoma në mesin e grupeve më të dobëta të shoqërisë dhe që kanë nevojë për ndihmë, Ombudspersoni theksoi se kjo situatë kërkon veprim të menjëhershëm. Për këtë arsye, ai kërkon të jetë i informuar në lidhje me çfarëdo hapi që është ndërmrur apo që ka për qëllim të ndërmerret nga ministria, me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi.

**Më 16 mars 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër të ngjajshme Ushtruesit të detyrës së Kryeministrit.

**Më 20 prill 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër të ngjashme Kryeministrit të tashëm me qëllim që të përsërisë porosinë e tij të mëhershme.

**Nuk kishte asnjë përgjegjësi në këto letra.**

### ***Dekriminalizimi i veprave kundër nderit dhe autoritetit***

**Më 28 shkurt 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” (Fushata Globale për të Shprehurit e Lirë), në emër të Kryetarit të Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, dhe Drejtorit të Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, lidhur me faktin se veprat kundër nderit dhe autoritetit ishin të përfshira në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, që është aktualisht në fuqi, si vepra penale. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” e nxiti Ombudspersonin që ta përdorë ndikimin e pozitës së tij për ta ngritur çështjen e dispozitave penale të Kosovës mbi veprën kundër nderit dhe autoritetit, që ishin në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” ceku që “Article 19” i kishte dërguar një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi pranë UNMIK-ut, për t’ia drejtuar vëmendjen drejt faktit që kishte disa vite që askush nuk ishte burgosur për veprën penale kundër nderit dhe autoritetit në vendet me demokraci të vendosur, si dhe për të nxitur autoritetet ndërkombëtare që veprat penale fyerje dhe shpifje të hiqen nga drafti i Kodit Penal në atë kohë dhe të zëvendësohen me dispozitat përkatëse të ligjit civil. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” theksoi që dënimi me burg deri në tre muaj ende parashihej sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe përmendi një rast të kohës së fundit kur një gazetar i Kosovës ishte dënuar me 6 muaj burg pasi që ishte gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale të shpifjes kundër Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Prizren, sa për ta vërtetuar gatishmërinë e gjykatave në Kosovë për të shqiptuar dënime të rënda. Sipas Drejtorit Ekzekutiv të OJQ “Article 19”, sanksionime të tilla nuk ishin në pajtim me kërkesën e proporcionalitetit që e kishte vendosur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” shkroi që “Article 19” po kërkonte heqjen e plotë të

dispozitive penale mbi veprën kundër nderit dhe autoritetit dhe në këtë nismë ishin duke e përkrahur tri mandatet ndërkombëtare që ishin themeluar për ta mbrojtur dhe promovuar të drejtën për lirinë e shprehjes. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” gjithashtu shtoi që shtetet tjera ishin duke ndërmarrë hapa për ta filluar dekriminalizimin e veprës kundër nderit dhe autoritetit. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” theksoi që koha kur Kosova po hyn në reforma në një numër të fushave me avancimin e bisedimeve të mundshme për statusin, është sipas besimit të saj koha e duhur që autoritetet ta rishqyrtojnë baraspeshën që duhet arritur mes të drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për reputacion, duke i përdorur mjetet juridike që dalin nga ligji civil më parë se të përdoren sanksionime penale. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” shtoi që një shembull në rajon tashmë ishte dhënë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare kur ajo e përkrahu heqjen e dispozitave penale mbi veprën kundër nderit dhe autoritetit në Bosnjë, në vitin 2001, dhe i zëvendësoi me ato të ligjit civil mbi veprën kundër nderit dhe autoritetit. Drejtori Ekzekutiv i OJQ “Article 19” shkroi që nuk shihte ndonjë arsye përse standardi i njëjtë nuk do të mund të zbatohet në Kosovë dhe e nxiti Ombudspersonin që ta drejtojë vëmendjen e autoriteteve përkatëse të Kosovës kah kjo çështje.

**Më 2 mars 2005**, Ombudspersoni i shkroi PSSP-së duke e informuar për letrën që është e përmbledhur më lart, në të cilën organizatat e mësipërme e kishin ngritur çështjen e dispozitave penale të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës mbi veprën kundër nderit dhe autoritetit, të cilat, sipas tyre, ishin në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Në letrën e tij, Ombudspersoni përsëriti pikat kryesore të theksuara nga ana e “Article 19” në letrën e tyre të përmbledhur më lart. Ombudspersoni shkroi që e përkrahte në tërësi këtë kërkesë dhe kërkoi nga PSSP-ja që të shfrytëzojë autorizimet që i janë dhënë atij për të garantuar që dispozitat përkatëse të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës të ndryshohen, në mënyrë që kjo pjesë e ligjit penal të Kosovës në të ardhmen të jetë në pajtim me standardet e përgjithshme ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

### ***Përpyekja e dytë për të ngritur çështjen e kthimit me forcë të refugjatëve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë***

**Më 4 mars 2005:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrisë të Punëve të Brendshme të Italisë, Ministrisë të Punëve të Brendshme të Gjermanisë dhe Ministres për Migrim dhe Politikë mbi Azilin në Suedi, për ta drejtuar vëmendjen e tyre ndaj situatës të disa refugjatëve nga Kosova me përkatësi etnike rome, ashkali dhe egjiptiane që cilët ishin duke qëndruar në shtetet e tyre përkatëse. Ombudspersoni shkroi që kishte Pranuar informata që këto shtete kishin për qëllim që në një të ardhme të afërt të kthejnë këta persona në Kosovë. Duke e pasur parasysh situatën në Kosovë, Ombudspersoni i këshilloi fuqishëm që ta rishqyrtojnë një plan të tillë. Ombudspersoni vërejti që shumica e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira në Kosovë dhe që papunësia e lartë në Kosovë ndikon në pjesëtarët e pakicave etnike më shumë se pjesëtarët e shu-



micës shqiptare. Ai shtoi që romët, ashkalitë dhe egjiptianët kanë qasje tepër të kufizuar në shërbimet publike dhe drejtësi dhe që mundësitë që ata të kenë një jetë normale dhe jetesë të qëndrueshme janë jashtëzakonisht të vogla. Ombudspersoni shkroi që kishte pasur trazira në mars të vitit 2004, gjatë të cilave një turma e dhunshme dhe e zemëruar ka organizuar sulme jo vetëm ndaj pjesëtarëve të pakicës serbe por edhe ndaj personave të tjerë të përkatësisë etnike joshqiptare. Ombudspersoni vërejti që UNMIK-u, KFOR-i dhe policia vendore nuk kanë mundur të garantojnë sigurinë për këta persona në atë kohë. Ombudspersoni vërejti që edhe pse situata e sigurisë situata e përgjithshme e sigurisë ishte përmirësuar deri në një masë pas një viti nga këto trazira, ajo prapë se prapë mbetet e brishtë dhe nuk ua mundësonte personave të përkatësive të mësipërme etnike që të jetojnë një jetë të qetë dhe të sigurt. Ombudspersoni gjithashtu citoi Raportit e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Kosovë S/2005/88 të 14 shkurtit 2005, në të cilin theksohej që “Qeveria nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme të dënojë krimet me prapavijë etnike, të vendosë një sistem për të mbikëqyrur dhe dënuar shkeljet e ligjeve për gjuhët dhe të promovojë kulturën e të drejtave të njeriut dhe tolerancës”. Duke u bazuar në këto informata dhe në vlerësimet e përditshme të Ombudspersonit për situatën në Kosovë, Ombudspersoni konsideroi që kthimi në Kosovë i personave të përkatësisë etnike rome, ashkali dhe egjiptiane në atë kohë do të ishte i përcjellur me rrezik të konsiderueshëm dhe vështirësi për ta. Ai e përfundoi letrën e tij duke përsëritur kërkesën e tij që shtetet përkatëse ta rishqyrtojnë qëndrimin e tyre për kthimin e këtyre personave në Kosovë, së paku për një periudhë kohore.

**Më 14 mars 2005:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit të Brendshëm të Mbretërisë së Bashkuar, për ta lajmëruar qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar për qëndrimin e tij lidhur me shtete të caktuara që një të ardhme të afërt paramendonin ta realizojnë planin e kthimit në Kosovë të refugjatëve të përkatësisë etnike rome, ashkali dhe egjiptiane. Ombudspersoni përsëriti çështjet që i kishte ngritur në letrën e tij drejtuar Ministrive kompetente të Italisë, Gjermanisë dhe Suedisë që është e përmbledhur më lart, dhe tërhoqi vërejtjen që kthimi i refugjatëve romë, ashkali dhe egjiptian nuk do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

**Më 24 mars 2005 :** Ombudspersoni e pranoi një përgjigje nga kryesuesi i Departamentit për Migrim, Integrim, Refugjatë dhe Harmonizim Evropian, në emër të Ministrit të Brendshëm të Gjermanisë. Në letrën e tij, ai theksoi që kthimi i ashkalive dhe egjiptianëve ishte ndalur pas trazirave të marsit të vitit 2004. Lidhur me kthimin e romëve, ende vlente Memorandumi për Mirëkuptim i nënshkruar mes UNMIK-ut dhe Gjermanisë më 31 mars 2004, me anë të cilit ishte caktuar që pjesëtarët e pakicës rome dhe serbe ishin të përjashtuar nga kthimi deri sa të merrej ndonjë vendim tjetër. Dr. Lehnguth shtoi që qeveria e Gjermanisë ishte ende në kontakt të rregullt me UNMIK-un lidhur me zhvillimet më të reja dhe që kthimet bëheshin vetëm pas konsultimeve të ngushta me administratën përgjegjëse të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

**Më 12 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjegje nga Ministria për Migrim dhe Politikë mbi Azilin në Suedi, e cila e informoi Ombudspersonin që në nëntor 2004 Suedia dhe UNMIK-u kishin nënshkruar një “Memorandum Mirëkuptimi” sipas të cilit përjash-tohet kthimi i Romëve, Ashalive dhe Egjiptianve në Kosovë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, Ministria vërejti se sipas qëndrimit të UNHCR të bërë publik në mars 2005, ashkalitë dhe egjiptianët nuk kishin më nevojë të vazhdueshme për mbrojtje ndërkombëtare.

### ***Përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet publike të Kosovës***

*Me 18 dhjetor të vitit 2002, Ombudspersoni kishte hapur një hetim “ex officio” lidhur me aspektet e caktuara të përdorimit zyrtar të gjuhës serbe dhe asaj shqipe në Kosovë. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni vazhdoi hetimet në këtë çështje.*

**Më 14 mars 2005**, Ombudspersoni i dërgoi letër Kryeministrit të Kosovës dhe të gjitha Ministrive në Qeverinë e Kosovës duke kërkuar nga ata që t'i sigurojnë informacione lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare në korrespondencën mes tyre dhe organeve qendrore dhe lokale në pushtet në Komunat e Prishtinës, Lipjanit, Fushë Kosovës, Obiliqit, Novobërdës, Shtërpçës dhe Kamenicës, sikur edhe përdorimin e gjuhëve zyrtare brenda këtyre komunave.

**Më 16 mars 2005**, Ombudspersoni u dërgoi një letër komunave të lartpërmendura duke kërkuar informacione lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare në korrespondencën mes tyre dhe organeve të ndryshme të autoriteteve qendrore. Ai poashtu kërkoi informacione në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në dokumentet e lëshuara për individët nga këto komuna, si dhe lidhur me shenjat publike brenda komunave.

**Më 21 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjegje nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes të cilës ai u informua se përdorimi i gjuhëve zyrtare në korrespondencën në mes të organeve të autoritetit qendror dhe autoriteteve lokale ishte përcaktuar në bazë të asaj se cilës komunë i ishte adresuar korrespondenca.

**Më 21 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë në të cilën ai theksoi se Ministria që ai drejton ishte duke përdorur të dy gjuhët zyrtare, shqipe dhe serbe, në korrespondencën e saj me institucionet lokale.

**Më 31 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i Pushtetit Lokal. Në letrën e tij, Ministri e informoi Ombudspersonin se të gjitha komunikimet me shkrim në mes të Ministrisë dhe organeve tjera ishin bërë në gjuhët shqipe dhe serbe. Përkthimet në gjuhën angleze dhe turke ishin siguruar sipas nevojës apo përdorimit. Ministri poashtu theksoi se me vendimin e datës 15 shkurt 2005, qeveria kishte vendosur që të gjitha komunikimet në mes të autoriteteve qendrore dhe komunave duhet të koordinohen përmes kësaj ministrie.

**Më 31 mars 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i Shëndetësisë i cili e informonte se përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet e kujdesit shëndetësor ishte rregulluar përmes Cirkularit informativ 6/2002 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Ai poashtu theksoi se në shtator 2004, Ministria kishte themeluar një zyrë speciale për përkthime.

**Më 4 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Komunës së Dragashit në të cilën ky i fundit kishte permendur se komuna e tij në mënyrë tradicionalisht ka përdorur të dy gjuhët në të gjitha korrespondencat. Ai poashtu kishte theksuar se komuna e tij duhet të shfrytëzohet si model për komunën e cila siguron rrespekt të plotë të sistemit të dygjuhësisë. Megjithatë, letra e kryetarit të komunës ishte e shkruar vetëm në gjuhën shqipe.

**Më 4 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Komunës së Shtërpces. Në letrën e tij, kryetari i komunës kishte informuar Ombudspersonin se megjithëse komuna ishte duke përdorur gjuhën shqipe dhe atë serbe, ajo kishte probleme me qeverinë lokale dhe autoritetet qendrore, të cilat kishin përjashtuar përdorimin e gjuhës serbe në korrespondencë.

**Më 14 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Komunës së Novo Bërdës, në të cilën kryetari i komunës kishte theksuar se të dy gjuhët zyrtare ishin duke u përdorur në mënyrë të barabartë në komunën e tij. Ai poashtu, kishte përmendur se korrespondenca me Ministrinë ishte bërë vetëm në gjuhën shqipe dhe angleze.

**Më 25 Prill 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrinë të Pushtetit Lokal, duke theksuar se ai kishte marrë informacioneve sipas të cilave komunat e Novobërdës dhe Shtërpces kishin pranuar letrat nga autoritetet qendrore vetëm në gjuhën shqipe apo ndonjëherë në gjuhën angleze. Takimet me qeverinë, ministrinë dhe organet tjera në të cilat përfaqësuesit serb kishin marrë pjesë ishin mbajtur në gjuhën shqipe pa përkthime në gjuhën serbe. Ombudspersoni kërkoi nga Ministri që të hetojë të gjitha këto pohime dhe ta informojë lidhur me hapat që ai planifikon t'i ndërmarë.

**Më 10 Maj 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i Pushtetit Lokal. Në letrën e tij, Ministri e kishte informuar Ombudspersonin se të gjitha takimet e qeverisë ishin mbajtur në të dy gjuhët zyrtare me përkthim nga dhe në gjuhën angleze. Lidhur me takimet e nivelit qendror, Ministri kishte theksuar se gjatë takimeve të cilat ai i kishte drejtuar, ishin siguruar përkthimet nga dhe në gjuhën shqipe dhe serbe. Lidhur me korrespondencën e shkruar, ai i referohet letrës së tij të datës 31 mars 2005. Ministri e kishte përmbyllur letrën e tij duke deklaruar se ai i kishte përmbushur të gjitha obligimet lidhur me përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

## ***Përkujdesja dhe trajtimi i personave të varur nga droga në Kosovë***

**Më 22 mars 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, për ta informuar rreth ankesave të caktuara nga një numër i banorëve të Kosovës lidhur me përkujdesjen dhe trajtimin joadekuat të personave të varur nga droga në Kosovë. Sipas Ombudspersonit, këto ankesa të shumtën e herëve i kishin parashtruar prindërit apo familjarët tjerë të afërt të personave që konsumonin narkotikë. Ombudspersoni shtoi që e kishte pranuar një petition nga një numër i qytetarëve në të cilin kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me sjelljen agresive dhe asociale të kësaj kategorie të individëve në mjedisin ku ata jetojnë. Pasi që shumica e këtyre individëve nuk kishte kryer ndonjë veprë penale, autoritetet kompetente gjyqësore nuk ishin në gjendje të urdhërojnë masa mbrojtëse siç ishte trajtimi i obligueshëm në institucionet shëndetësore. Ombudspersoni vërejtë që situata përkeqësohej edhe më tej përmes mungesës së përkujdesjes institucionale në Kosovë dhe që, si dukej, një numër i pacientëve që ishin vendosur në institucionet shëndetësore vazhdonin të marrin drogë që mund të sigurohej lehtë nga stërshitësit që vepronin nëpër spitale. Ombudspersoni e mbylli letrën e tij duke kërkuar nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë që ta informojë për veprimet që ai i planifikonte apo tashmë i kishte ndërmarrë për ta zgjidhur këtë çështje.

**Më 15 prill 2005**, Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga drejtori i Departamentit të Drejtësisë, ku ai pajtohej me vlerësimin e Ombudspersonit që në Kosovë nuk kishte objekte adekuate për t'u përkujdesur për personat e varur nga droga, qofshin ata të dënuar për ndonjë veprë penale apo jo. Drejtori i Departamentit të Drejtësisë shkroi që Ministria e Shëndetësisë e Kosovës do të mund të përgjigjej më mirë në brengat e Ombudspersonit, pasi që Departamenti i Drejtësisë nuk ishte në pozitë të merret me çështjet siç janë qasja në narkotikë nëpër spitale apo sjellja e pacientëve të spitaleve.

## ***Ligji mbi shëndetin mental***

**Më 25 prill 2005**, pas hetimit paraprake dhe korrespondencën me UNMIK-un mbi draft ligjet potenciale për të sëmurët mental, Ombudspersoni i shkroi një letër Zëvendësit të PSSP-së për Polici dhe Drejtësi në të cilën e njoftoi mbi diskutimet e mëparshme të lartëpërmendura lidhur me këtë temë. Duke pasur parasysh se ligjet e planifikuara për shëndetin mental, përpilimi i të cilave kishte filluar në vitin 2001, dhe ende nuk kishte përfunduar, Ombudspersoni nxiti Zëvendësin e PSSP-së që të marrë në konsiderim përgatitjen e të dy ligjeve si çështje me prioritet të lartë dhe kërkoi informacione lidhur me fazën e procedurave të përpilimit. Për më tepër, Ombudspersoni e përkujtoi Zëvendësin e PSSP-së lidhur me një raport “*ex officio*” lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të personave me të meta mentale në repartin e psikiatrisë të Univerzitetit të Prishtinës të publikuar nga Ombudspersoni me 7 tetor 2004 dhe e informoi atë se një raport i ngjashëm lidhur me ligjshmërinë e vendosjes së njerëzve në Qendrën për përkujdesje sociale në Shtime ishte

në përgatitje e sipër.

**Më 10 Qershor 2005**, Ombudspersoni ka pranuar një letër nga Zëvendësi i PSSP-së për Administratë civile si përgjegjje në raportin lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të personave me të meta mentale në repartin e psikiatrisë së Klinikën e Univerzitetit të Prishtinës, raport që ishte publikuar nga Ombudspersoni në tetor të vitit 2004. Në letrën e tij, Zëvendësi i PSSP-së shkruan se janë ndërmarrë disa veprime nga Ministria e Shëndetësisë, siç është zhvillimi i udhëzimeve administrative lidhur me shëndetin mental dhe institucionet përkatëse për kujdesin ndaj shëndetit mental. Për më tepër, bashkë me UNMIK-un, Ministria ka mbetur e angazhuar në përpilimin e një “Draft ligji për shëndetin mental”.

### ***Mungesa e kurseve në gjuhën shqipe për personat me përkatësi etnike joshqiptare***

**Më 27 prill 2005**, Ombudspersoni ka dërguar një letër për Kryeministrin e Kosovës duke e informuar atë në lidhje me situatën e vështirë të një numri të madh të banorëve të Kosovës, kryesisht nga komunitetet joshqiptare, të cilët nuk e flasin gjuhën shqipe. Në shumë pjesë të Kosovës, këta persona kanë mbetur jashtë pjesmarrjes në jetën publike, shoqërore dhe politike, pasi që ata nuk e flasin gjuhën që e flet shumica e popullatës. Ombudspersoni theksoi se kjo situatë kërkon veprime konkrete që do t`u mundësonin individëve të lartpërmendur të komuniknin në gjuhën shqipe.

**Më 9 maj 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i asrimit, shkencës dhe teknologjisë duke theksuar se ai kishte analizuar me kujdes kërkesën e Ombudspersonit dhe se ai dhe ministria e kishin mbështetur iniciativën e Ombudspersonit. Sipas Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ministria e tij ishte e gatshme që të organizojë kurse, të cilat do të ndihmonin në procesin e integritit. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i kësaj iniciative, Ministria do të përpilojë një plan operacional dhe një udhëzim administrative lidhur me vijimin e kurseve. Edhe pse ka një mungesë të përgjithshme të hapsirës, ministria poashtu do të sigurojë klasët dhe personelin e nevojshëm arsimor për të realizuar kurset. Ministri i asrimit, shkencës dhe teknologjisë kishte shtuar se ministria do të përpilojë planet dhe programet mësimore. Ai theksoi se mbështetja e përgjithshme do të jetë e nevojshme, në veçanti mbështetja finaciare nga fondet publike ose donacionet, pasi që mjetet financiare duhet të sigurohen për personelin arsimor dhe shpenzimet e tjera. Ministri i asrimit, shkencës dhe teknologjisë e kishte përmbyllur letrën e vet duke shkruar se ai dhe ministria ishin të gatshëm të diskutojnë të gjitha detajet me Ombudspersonin.

## ***Tabelat e mëparshme të regjistrimit të automjeteve në Kosovë***

**Më 29 prill 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi duke e informuar atë në lidhje me disa parregullsi në zbatimin e ligjeve ekzistuese mbi regjistrimin e automjeteve me tabela regjistrimi që janë shfrytëzuar në Kosovë para ardhjes së administratës ndërkombëtare civile. Ombudspersoni bëri të ditur se kishte pranuar shumë ankesa nga persona, kryesisht me origjinë serbe, të cilët ishin ndaluar nga Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) për ngasje me tabela të tilla. SHPK, me këtë rast ua kishte konfiskuar tabelat dhe dokumentet e automjetit, me arsyetim se pronarët e makinave nuk kishin paguar taksën e nevojshme doganore. Gjatë hetimeve të zhvilluara në këto raste, policët e SHPK-së kishin informuar një përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit që pronarët e automjeteve me tabela të mëparshme të Kosovës ishin të liruar nga detyrimi për të paguar taksat doganore deri më 1 korrik 2005. Në të njejtën kohë, një polic i Policisë së UNMIK-ut në Fushë Kosovë kishte theksuar se të ngasësit të cilët nuk kishin tabela regjistrimi KS të lëshuara nga UNMIK-u, ishin të detyruar të paguajnë taksat doganore bazuar në vendimin e doganave të UNMIK-ut 2005/1. Ombudspersoni theksoi se sipas doganave të UNMIK-ut, një vendim i tillë nuk ekzistonte, ndërsa ngasësit të cilët ngasin automjete me tabela të mëparshme të Kosovës ishin të liruar nga pagesa e taksave doganore sipas një dispozite të Udhëzimit Administrativ Nr.8/2004 që përcakton dispozitat për procedurat doganore për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/1 të Kodit Doganor të Kosovës. Ombudspersoni kërkoi nga Zëvendës PSSP që ta siguroj me informacione lidhur me konfiskimin e tabelave të regjistrimit të automjeteve të mëparshme të Kosovës.

**Nuk ka pasur përgjegjeje në këtë letër.**

## ***Publikimi i emrave të anëtarëve të qeverisë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale***

**Më 10 maj 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër Komisionarit të përkohshëm për media, duke theksuar se Partia Demokratike e Kosovës kishte dërguar informacione për vepra penale për të cilat pohoet të jenë kryer nga anëtarët e Qeverisë së Kosovës ndaj UNMIK-ut. Ombudspersoni e informoi Komisionerin e përkohshëm për media se pjesë të këtyre dokumenteve ishin publikuar në gazetata lokale siç janë gazetata “Express” dhe “Epoka e Re”. Ai shprehu shqetësimet e tij lidhur me atë që gazetata e lartpërmendura kishin publikuar pjesë të dokumenteve të cilat akuzonin individët për kryerjen e veprave serioze penale para se të bëhej ndonjë hetim penal për këto akuza që kanë filluar. Akuzat e tilla kanë krijuar përshtypjen se të akuzuarit me të vërtetë kanë kryer këto krime, në mungesë të ndonjë vendimi gjyqësor i cili do të përcaktonte fajsinë e tyre. Prandaj, Ombudspersoni kërkon nga Komisioneri i përkohshëm për media që të sigurojë se publikimi i emrave të personave të akuzuar se kanë kryer krime nuk do të përsëritet më në të ardhmen.

**Nuk kishte ndonjë përgjegjeje në këtë letër.**

## ***Publikimi i listës së borxhlinjëve të KEK-ut në mediat e shkruara***

**Më 13 maj 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër drejtorit të përgjithshëm të KEK-ut. Në letrën e tij, ai shprehu brengat që ka lidhur me një listë të publikuar më 15 prill 2005 dhe 10 maj 2005 në gazetën “Koha Ditore”, e cila përmbante emrat e konsumatorëve të KEK-ut të cilët së shpejti do të çyqeshin nga rrjeti elektrik, si pasojë e dështimit të tyre që të paguanin borxhin e rrymës së shpenzuar. Ombudspersoni theksoi se shpallja publike e emrave të individëve privat në një kontekst të tillë mund të ngrisë çështje serioze lidhur me të drejtën e këtyre personave në jetën private dhe kështu ka kërkuar të dijë bazën ligjore për publikimin e emrave të qytetarëve të Kosovës pa lejen e tyre.

**Më 31 maj 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga drejtori menaxhues i KEK-ut. Në letrën e tij, drejtori menaxhues i KEK-ut e informoi Ombudspersonin se menaxhmenti i KEK-ut ishte kohët e fundit i kyqur në një kampanjë intenzive nepër tërë Kosovën për të rritur nivelet e faturave dhe të mbledhurave nga e nivelet e ulta të arritura në vitet paraprake. Për shkak të këtyre niveleve të ulta, KEK-u nuk ka qenë në gjendje të përbushë shumë nga obligimet e tij operative dhe funksionale dhe kështu është bërë faktori më i rëndësishëm në pengimin e zhvillimit të ekonomisë në Kosovë. Drejtori menaxhues i KEK-ut kishte theksuar se njëra nga arsyet e rëndësishme për publikimin e emrave në shtypin lokal ishte që të sigurohet se këta konsumatorë të cilëve u është caktuar koha për çyqje të bëhen të lajmërohen dhe të jenë të vetëdijshëm për këtë para kohe. Ai e kishte përbmbyllur letrën e tij duke thënë se në publikimin e emrave të konsumatorëve të pasjellshëm në shtypin lokal, nuk janë publikuar të dhënat personale si adresa apo shuma e borxhit, ashtu që identiteti i këtyre individëve nuk i është zbuluar askujt jashtë shënimeve konfidenciale të KEK-ut.

## ***Përkthimet e udhëzimeve lidhur me përdorimin e prodhimeve medicinale***

**Më 17 maj 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër Ministrit të shëndetësisë për të drejtuar vëmendjen e tij në praktikën e shitjes së prodhimeve medicinale në barnatoret nepër regjion pa ndonjë përkthim të udhëzimeve, dozës, dhe/apo katalog në ndonjërin nga gjuhët e Kosovës. Ombudspersoni kishte shkruar se individët të cilët kishin blerë barërat e lartpërmendura zakonisht nuk e kishin kuptuar gjuhën në të cilën ishin shkruar udhëzimet, dhe thjeshtë u kishte mbetur të besonin në udhëzimet e dhëna gojore nga farmacistët apo, edhe çka është edhe më keq, nga nëpunësit që punojnë nepër barnatore. Shumica e barërave të importuara në Kosovë nuk kërkojnë që konsumatori të bëjë një përshkrim nga mjeku në mënyrë që të mund të blehen ato, edhe pse në shtetet tjera barërat e tilla kërkojnë përshkrime paraprake. Ombudspersoni theksoi se kjo situatë ka shkaktuar dëme fizike dhe/apo mentale tek konsumatorët e barërave të tilla. Megjithatë, Sekcioni 9.4 i Ligjit për prodhime medicinale dhe pajisje mjekësore, i publikuar nga rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/23, obligon që prodhimet mjekësore mund të sigurojnë autorizimin e marketingut

nëse ato janë të shoqëruara *inter alia* me “një prezantim të saktë dhe të vlefshëm të katalogut, përmbledhjes së cilësive të prodhimit dhe një fletushke të paketimit (fletushkë për informimin e pacientit) të prodhimit medicinal për përdorim në Kosovë”. Duke patur në mendje se kjo situatë ka ekzistuar për një kohë të gjatë, Ombudspersoni ka shprehur shqetësimin e tij, prej kur ai e ka ditur këtë, nëse Ministri i shëndetësisë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent publik ka ndërmarrur ndonjë hap efektiv për të zgjidhur këtë çështje. Deri sa të mos gjendet ndonjë zgjidhje adekuate, kjo situatë do të shkaktojë rrezik të konsiderueshëm për shëndetin dhe mirëqenien si dhe për jetën e banorëve të Kosovës.

**Më 8 qershor 2005**, Ombudspersoni ka pranuar një përgjegjie nga Ministri i shëndetësisë i cili shkruante se në mënyrë që një prodhim mjekësor të fitojë të drejtën e regjistrimit në Kosovë, njëra nga kriteret ishte paraqitja e një “fletueshke informuese” për pacientët në dy gjuhët zyrtare të Kosovës, atë shqipe dhe serbe. Sipas ministrit, shumica e kompanive farmaceutike që kanë aplikuar për regjistrim të prodhimeve mjekësore kanë qenë kompani ndërkombëtare dhe prandaj kanë pasur probleme në përkthimin e fletushkave nga gjuha angleze në atë shqipe dhe serbe në një kohë të duhur. Edhe pas një paraqitje të vonuar të fletushkave, aty kishte shumë gabime në gramatikën, shqiptimin, dhe përmbajtjen e fletushkave të cilat kanë pamundësuar që prodhimi të lejohet për shitje në tregun lokal. Në një situatë të tillë, Agjencia e Kosovës për prodhime mjekësore ishte e obliguar që të kontraktonte një institucion i cili do të mund të korrigjonte fletushkat informuese. Sipas Ministrit të shëndetësisë, Ministria kishte pranuar tri oferta nga institucionet e ndryshme për të përmbushur këtë detyrë dhe kohët e fundit është në process të zgjedhjes së njerës nga ato. Duke u referuar në Seksionin 9.4 të Ligjit për prodhimet medicinale dhe pajisjet mjekësore, Ministri i shëndetësisë ka theksuar se autorizimi i plotë i marketingut ende nuk është aplikuar në Kosovë, por që Ministria ka filluar një autorizim të përkohshëm, që autorizon marketingun e prodhimeve mjekësore, të bazuar në Udhëzimet e saj administrative 2003/09, si një dispozitë tranzicionale e cila dërgon drejt autorizimit të plotë të produkteve mjekësore. Autorizimi i përkohshëm i prodhimeve mjekësore mund të jipet për 18 muaj dhe duhet të ripërtrihet pas një periudhe të caktuar kohore.

### ***Trotuaret e pambrojtura në afërsi të shkollave***

**Më 25 maj 2005**, Ombudspersoni i shkroi një letër Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit duke i informuar ata në lidhje me aksidentin e trafikut i cili kishte ndodhur në fshatin Prelez i Jerlive të komunës së Ferizajt. Ai theksoi se sipas autoriteteve publike të kësaj komune, trotuaret e rrezikshme të pambrojtura afër shkollave fillore kishin qenë vende të aksidenteve të shpeshta në të cilat kishin vdekur kryesisht fëmijët. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, komuna nuk kishte qenë në gjendje të përmirësojë kushtet e sigurisë. Për më tepër, Ombudspersoni theksoi se situata në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor ka mbetur njëra



nga brengat e shumë komunave. Prandaj, ai kërkoi informacione lidhur me ndonjë veprim që Ministria ka planifikuar ta ndërmerre në lidhje me këtë çështje.

**Më 6 qershor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit përmes të cilës u informua se Departamenti për siguri në trafik, bashkë me policinë e trafikut ishin duke punuar në identifikimin dhe përmirësimin e të ashtuquajturave vende “pika të zeza” në trafik. Pas një inspektimi të bërë në vendin e ngjarjes në situatën e fshatit në Prelez i Jerlive, ky fshat ishte futur në listën e dhjetë lokacioneve më të rrezikshme në Kosovë.

### ***Kthimet me forcë në Kosovë***

**Më 1 qershor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke e informuar për numrin e madh të kthimeve me forcë në Kosovë. Ai theksoi që derisa të kthyerit të cilët kthehen vullnetarisht në Kosovë zakonisht janë në gjendje ta përgatisin kthimin e tyre para se të arrijnë në Kosovë, të kthyerit me forcë zakonisht dëbohen përnjëherë dhe shpesh herë faktikisht nuk kanë ku të shkojnë. Pasi që shumica e të kthyerve me forcë kanë jetuar në shtetet nikoqire për periudha të kohore prej gjashtë e më shumë vite, fëmijët shpesh herë nuk i flasin gjuhët vendore aq sa duhet për t'u integruar në shkolla dhe e kishin humbur lidhjen e tyre me Kosovën dhe shoqërinë e saj. Në shumë raste, shtëpitë e të kthyerve ishin shkatërruar gjatë konfliktit të viteve 1998-1999 dhe e kanë vështirë të punësohen për shkak të situatës së mjerë ekonomike në Kosovës. Ombudspersoni konsideroi që UNMIK-u nuk i kishte kushtuar vëmendje sa duhet kësaj çështjeje. Përveç faktit që nuk kishte ndjenjë të mjaftueshme të përgjegjësisë nga ana e administratës ndërkombëtare dhe vendore, gjithashtu nuk dukej të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përkrahur kthimet e tilla. Derisa deri vonë ishin kthyer kryesisht personat e përkatësisë etnike shqiptare, kjo kishte ndërruar shumti për shkak të qëndrimi të nxjerrë nga UNHCR në mars të vitit 2005, në të cilën mes tjerash ishte theksuar që personat e përkatësisë etnike ashkali, egjiptiane, gorane dhe boshnjake dukej të ishin më të toleruar tani. Duke u bazuar në këtë vlerësim, disa shtete kishin filluar t'i kthejnë personat që i takojnë grupeve të mësipërme etnike. Gjermania, për shembull, kishte nënshkruar të ashtuquajturën “Letër Marrëveshje” me UNMIK-un, për të detyruar përafërsisht 300 persona të përkatësisë etnike ashkali dhe egjiptiane të kthehen me forcë për çdo muaj duke filluar prej majit të vitit 2005. Duke filluar prej korrikut të vitit 2005, ky numër pritej të rritet deri në 500 kurse prej fillimit të vitit 2006, numri i personave të propozuar për kthim me forcë më nuk do të kishte kurrfarë kufizimesh. Përkundër fakti që do të ishte e mundshme që personat të kthehen me forcë vetëm pas një procedure përzgjedhëse dhe që palët nënshkruese të “Letër Marrëveshjes” nuk parashikonin që më shumë se 20% të personave të propozuar faktikisht do të ktheheshin me forcë, prapë se prapë do të ishte një numër i konsiderueshëm i personave që nuk do të kishin ku të shkojnë. Në të njëjtën kohë, Ombudspersoni vërejti që kishte pranuar informacione nga Ministria i Jashtme e Suedisë që vlerësimi të kohës së fundit të bërë nga UNHCR-ja,

ajo gjithashtu konsideronte që personat e përkatësisë etnike ashkali dhe egjiptiane më nuk kanë nevojë për mbrojtje. Prandaj, Ombudspersoni supozoi që Suedia dhe me siguri edhe shumë shtete tjera të Evropës perëndimore gjithashtu do të fillonin të kthejnë në Kosovë një numër të madh të refugjatëve të dikurshëm. Duke marrë parasysh situatën e mjerë të atyre të kthyerve tashmë në Kosovë, Ombudspersoni shprehu brengën e tij që derisa gjithnjë më shumë persona kthehen me forcë në Kosovë, ky grup do të krijonte një forcë të madhe destabilizuese që me kalimin e kohës do të mund të paraqesë rrezik për sigurinë publike nëse nuk bëhet asgjë për t'i ndihmuar ata. Ombudspersoni konsideroi që vetëm një angazhim i harmonizuar i UNMIK-ut dhe IPVQ-ve do ta përmirësonte fatin e këtyre të kthyerve, për shembull, duke hapur një zyrë informimi në aeroport që do të mund t'i informonte të kthyerit për atë se ku të shkojnë për të kërkuar ndihmë dhe përkrahje. Të kthyerit me forcë do të duhej që gjithashtu të regjistrohen dhe t'u ofrohet strehimi dhe duhet të fillohen programe të veçanta për t'ju ndihmuar që të integrohen. Ombudspersoni mbylli letrën e tij duke theksuar që i takonte UNMIK-ut dhe IPVQ-ve që të marrin përgjegjësinë në këtë çështje.

**Më 16 qershor 2005,** Ombudspersoni pranoi një letër nga PSSP në lidhje me kthimet me forcë. Në këtë letër, PSSP përkujtoi që qëndrimi i UNHCR-së do të ofronte bazën për qëndrimin e UNMIK-un lidhur me kthimet me forcë. Pas marsit të vitit 2005, UNMIK-u kishte vendosur të lejojë një kthim të kufizuar të pjesëtarëve të komunitetit ashkali dhe egjiptian që vijnë nga vendet ku kthimi i tyre konsiderohej të jetë i sigurt. Për të kontrolluar këto kthime, nga Zyra e UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete ishte kërkuar që për secilin rast të vendosë individualisht. Për më tepër, PSSP e informoi Ombudspersoni se në bazë të një "Letër Marrëveshje" me Gjermaninë, vetëm 14 ashkali ishin kthyer në maj dhe në qershor të vitit 2005. PSSP theksoi që nuk parashihte një kthim masiv dhe të menjëherëshëm me forcë në Kosovë të romëve nga ndonjë shtet tjetër mikpritës në Evropë, dhe as UNMIK-u nuk ishte pajtuar për një gjë të tillë. Sa i përket kapacitetit të kufizuar të Kosovës për të pritur pjesëtarët e komuniteteve të tilla, ai përsëri do t'ia theksonte këtë qëndrim qeverive të shteteve mikpritëse, që do të mbahej në mes të qershorit të vitit 2005. PSSP u pajtua që nevojiteshin përpjekje të përbashkëta për të zhvilluara kapacitetin integruar në Kosovë. Edhe nëse përgjegjësia përfundimtare lidhur me këtë qëndronte mbi IPVQ-të, UNMIK do të ndihmonte në zhvillimin e një skeme për t'u përgjigjur në nevojat e menjëherëshme të kthyerve me forcë. PSSP kishte kërkuar përkrahje nga Drejtori i Përgjithshëm i ONM-së, i cili kishte filluar përgatitjen e një projekt propozimi për menaxhimin dhe përkrahjen e kthimeve me forcë. PSSP e mbylli letrën e tij duke e informuar Ombudspersoni që planifikonte të takohej me Ministritë përkatëse të IPVQ-ve si dhe me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë lidhur me këtë çështje, dhe gjithashtu do ta diskutonte këtë çështje me Kryeministrin.

## ***Dëbimi i pesëmbëdhjetë personave të zhvendosur brenda vendit (PZhBV) që jetojnë në Komunën e Fushë Kosovës***

Më 6 qershor 2005, Ombudspersoni i shkroi një letër Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës për ta informuar për një ankesë të cilën e kishte pranuar nga pesëmbëdhjetë PZhBV-ve të cilët për momentin ishin duke jetuar në disa baraka në Fushë Kosovë. Sipas pohimeve të PZhBV-ve, më 25 maj 2005 dy prej PZhBV-ve kishin marrë letër nga Kryesuesi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale pranë komunës së Fushë Kosovës me të cilën ishin informuar se duhet të braktisin barakat deri më 4 qershor 2005. Aplikantët e tjerë ishin informuar gojarisht për dëbimin e tyre të pashmangshëm dhe u është thënë se kanë edhe dhjetë ditë për të gjetur tjetër strehim. Aplikantët ishin ankuar se disa persona të cilët punojnë në Komunë kanë keqpërdorur pozitat e tyre duke thyer dyert e dy dhomave ku ishin duke banuar PZhBV-të. Për më tepër, sipas pohimeve të aplikantëve, Kryesuesi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale dhe zëvendësi i tij i kërcënonin gati çdo ditë se shumë shpejtë do ti dëbonin nga aty. Duke e pasur parasysh se këto baraka ishin aty për të strehuar PZhBV-të të cilët kishin humbur shtëpitë e tyre, Ombudspersoni kërkoi nga Kryetari i Komunës arsytet për dëbim dhe se a do të sigurohet ndonjë strehim alternative për këta persona.

Më 8 qershor 2005, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Komunës së Fushë Kosovës se PZhBV-të e lartëpërmendur nuk do të dëbohen dhe se vetëm dy nga këta persona do të dëbohen nga barakat. Si kryetar i komunës, ai garantoj personalisht se së bashku me autoritetet komunale janë duke ndjekur situatën nga afër dhe se do të ndërmarrin të gjitha masat për të parandaluar çfardo lloj diskriminimi.

## ***Situata e personave civil me të drejtë në përfitime pensionale për lëndimet e pësuar gjatë Luftës së Dytë Botërore***

Më 10 qershor 2005, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrin të Kosovës duke shprehur brengën e tij në lidhje me situatën e civilëve të lënduar gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët, që nga fundi i konfliktit më 1999, nuk janë duke marrë pensionet e tyre invalidore apo ndonjë formë tjetër të ndihmës në të cilën kishin të drejtë me ligj. Ombudspersoni e informoi Kryeministrin se ligji Nr. 32 i Krahinës Autonome të Kosovës mbi “Mbrojtjen e civilëve invalid të luftës” i vitit 1976 ishte ende në fuqi në Kosovë. Sipas këtij ligji, civilët të cilët ishin lënduar gjatë Luftës së Dytë Botërore kishin të drejtë në disa përfitime siç janë, përfitimet financiare, ndihmë mjeksore pa psgesë dhe shtesat invalidore. Ombudspersoni vërejti se nuk ishin bërë kurrfarë përpjekje për të zgjidhur këtë çështje dhe kërkoi informata nga Kryeministri për çfardo lloj veprimesh që ky i fundit planifikon të ndërmerr në këtë drejtim.

Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.

## **Këshilli pavarur mbikëqyrës**

**Më 20 qershor 2005**, Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke drejtuar vëmendjen e tij në problemet me të cilat ballafaqoheshin shërbyesit civil apo personat që marrin pjesë në procedurat e rekrutimit për shërbime civile, të cilët pas procedurave administrative të nivelit të parë, ishin këshilluar që të dërgojnë rastin e tyre para të ashtuquajturit Bordi i pavarur mbikëqyrës. Ky bord, megjithese akoma nuk ishte operacional pavarasisht nga fakti se ishte konstituuar në vitin 2001. Sipas informacioneve në dispozicion të Ombudspersonit, kjo vonesë kishte ndodhur për shkak të faktit se puna e nevojshme në rregullat e procedurave nuk ishte finalizuar akoma. Ombudspersoni kërkoi nga PSSP-ja që ta informonte atë se në cilën fazë ishte puna në këto rregulla në atë kohë dhe nëse kishte ndonjë shpresë që këto rregulla të finalizohen në të ardhmen e afërt.


**Më 30 qershor 2005**, Ombudspersoni pranoi një letër nga Ushtruesja e detyrës së zëvendësit të PSSP-së për Administratë civile . Në letrën e saj, zëvendësja e PSSP-së e informonte Ombudspersonin se Bordi i pavarur mbikëqyrës, i cili ishte themeluar më 23 shtator 2004, ishte operacional në dy nga tri funksionet e tij . Megjithatë, rregullat e procedurave duhet të adoptohen para ekzekutimit të funksionit të tretë të bordit. Zyra e këshilltarit ligjor të UNMIK-ut kishte rishikuar draftin e parë dhe Ministria e shërbimeve publike kohët e fundit ishte duke punuar në komentet e pranuar. Posa që ministria të ketë finalizuar draftin e ri; rregullat do të paraqiten tek PSSP-ja për aprovim. Ushtruesja e detyrës së zëvendësit të PSSP-së kishtë përmbyllur letrën e saj duke deklaruar se ajo besonte se Bordi i pavarur mbikëqyrës do të jetë në gjendje të ekzekutojë funksionin e vet të kërkesave para fundit të gushtit 2005.

### **Mungesa e përgjegjjes nga Komuna e Prishtinës**


*Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka dërguar disa letra intervenimi për organet udhëheqëse të Komunës së Prishtinës, por asnjëherë nuk ka marrur përgjegjje në ndonjerën prej tyre. Megjithëse, kjo çështje po ashtu ishte ngritur me Ministrin e Pushtetit Lokal, i cili e përcolli këtë ankesë te komuna në fjalë, sjellja jobashkëpunuese e komunës së Prishtinës ka mbetur e pandryshuar.*

**Më 29 qershor 2005**, Ombudspersoni ka pranuar një letër nga Ushtruesi i detyrës së përfaqësuesit komunal të komunës së Prishtinës. Në letrën e tij, ai deklaronte se pas një takimi me përfaqësuesin e Institucionit të Ombudspersonit lidhur me mungesën e përgjegjjes nga komuna në letrat që vinin nga Institucioni, ai kishte shtyrë komunën që të përmirësonte shkallën e përgjegjjes, duke i dhënë prioritetin e domosdoshëm që duhet t`i jipet komunikimit me Institucionin e Ombudspersonit.

# Aneksi 5. Skema Organizative e Institucionit të Ombudspersonit



Nën-tabela për Zyret  
në terren të Institucionit  
të Ombudspersonit



## **Aneksi 6: Lista e punonjësve (më 30 qershor 2005)**

Ombudspersoni	Marek Antoni Nowicki
Zëvendës i Ombudspersonit	Ljubinko Todorović
Zëvendës i Ombudspersonit	Hilmi Jashari
Drejtor i Hetimeve	Veton Vula
Zëvendës Drejtori i Hetimeve për Zyre Rajonale	Sefadin Blakaj
Zëvendëse e Drejtorit për Projekte Speciale	Violeta Rexha
Jurist i Lartë, Prishtinë	Avni Hasani
Jurist i Lartë, Prishtinë	Gjylbehare Murati
Jurist i Lartë, Prishtinë	Dragana Ristić
Kryesues i Zyrës Rajonale në Gjiilan	Goroljub Pavić
Kryesues i Zyrës në Teren	Aleksandra Dimitrijević
Kryesues i Zyrës Rajonale në Mitrovicë	Naim Krasniqi
Kryesues i Zyrës Rajonale në Pejë	Ilirjana Çollaku
Kryesues i Zyrës Rajonale në Prizren	Murlan Prizreni
U.D. Kryesues i Zyrës Rajonale në Prizren	Hunaida Pasuli
Jurist, Prishtinë	Agron Kelmendi
Jurist, Prishtinë	Enis Shatri
Jurist për GDF	Thëllënza Arifi
Jurist për NjBGJ	Luljeta Domaniku
Jurist për GMD	Dragana Rodić
Jurist për GMD	Merita Syla
Jurist, Gjiilan	Isuf Sadiku
Jurist, Mitrovica veriore	Miljana Scekić
Jurist, Pejë	Besim Tafa
Drejtor i Administratës	Përparim Vula
Zyrtar për Informim dhe Media	Ibrahim Arslan
Përgjegjës për IT	Flamur Gogolli
Përgjegjës për IT	Hekuran Latifi
Zyrtar për prokurim	Gëzim Latifi
Zyrtar i financave	Beqir Musliu
Asistente Speciale e Ombudspersonit	Leonora Visoka
Udhëheqëse e Përkthyesve, Prishtinë	Branislava Stojilović
Përkthyes i Lartë, Prishtinë	Lirak Hamiti
Përkthyes i Lartë, Prishtinë	Alban Stafai
Përkthyes, Prishtinë	Safete Sadrija
Përkthyes, Prishtinë	Isak Skenderi
Përkthyes/Asistent Ligjor, Gjiilan	Meliha Brestovci
Përkthyes/ Asistent Ligjor, Graçanicë	Milan Prljinčević
Përkthyes/Asistent Ligjor, Mitrovicë	Merita Gara
Përkthyes/Asistent Ligjor, Pejë	Aida Nela
Përkthyes/Asistent Ligjor, Prizren	Abdullah Kryeziu
Asistente Ekzekutive	Arta Ibrahim
Asistente Ekzekutive	Shqipe Paçarada
Asistent Ligjor, Prishtinë	Venera Rizvanolli
Asistent Ligjor, Prishtinë	Labinot Sheremeti

Asistent Ligjor, Prishtinë  
Recepcionist  
Udhëheqës i Vozitësve  
Vozitës  
Vozitës  
Driver Vozitës  
Udhëheqës i Rojtarëve  
Rojtar  
Rojtar  
Rojtar  
Rojtar  
Rojtar  
Rojtar  
Rojtar  
Pastruese  
Pastruese  
Pastruese, Gracanicë

Xhafer Tahiri  
Bedri Kamberi  
Shpëtim Reçica  
Tamer Gas  
Sami Kuqi  
Goran Stević  
Bekim Bunjaku  
Hakif Imeri  
Muhamet Jahiri  
Mentor Myftari  
Avni Osmani  
Besim Osmani  
Arben Plakaj  
Nekibe Hoxha  
Gëzime Lepaja  
Vesna Cvejić

### ***Këshilltarët Ndërkombëtar (më 30 qershor 2005)***

Ushtruese e Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv  
Këshilltare Ndërkombëtare për Projekte Speciale  
Këshilltare Ndërkombëtare e Ombudspersonit  
për Media dhe Marrëdhënie Publike  
Këshilltare Ndërkombëtare e Drejtorit të Hetimeve

Antonella Ingravallo  
Francesca Marzatico  
Katalin Mester  
Alice Thomas

### ***Personat që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet***

Drejtor Ekzekutiv  
Jurist, Prizren  
Përkthyes/ Asistent Ligjor, Gjilan  
Vozitës  
Roje  
Roje  
Roje

Agron Berisha  
Mahir Tutuli  
Sofije Sadiku  
Fatmir Pireva  
Xhevat Cakolli  
Skender Krasniqi  
Gëzim Hadri



## Aneksi 7: Lista e shkurtesave

CR-Rastet	Rastet për Veprim (një kategori speciale e rasteve në Institucionin e Ombudspersonit)
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
NJBGJ	Njësia për Barazi Gjinore në Institucionin e Ombudspersonit
DÇPB	Drejtoria e KB-ve për Çështje Pronësore dhe Banesore
KQKN	Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar
PZHBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-së në Kosovë
KGJPK	Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorisë së Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
NATO	Organizata e Paktit Veri Atlantik
GMD	Grupi i Mos-diskriminimit në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
OJQ	Organizata joqeveritare
ZIDDNj	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisjes
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
KSZHN	Korporata Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
KLKBR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
FKBF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
FKBZHG	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Gruas
MKBK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë



**Punonjësit e Institutit të Ombudspersonit Qershor 2005**



# Si të kontaktohet IOK?

Institucioni i Ombudspersonit gjendet në Prishtinë. Në strukturën e tij përfshihen edhe pesë zyre në terren në Gjilan, Pejë, Mitrovicë Prizren dhe Graçanicë. Zyrja në Mitrovica gjithashtu ka edhe nënzyrën e saj në pjesën veriore të qytetit.

## **PRISHTINË/PRIŠTINA**

---

Insitucioni i Ombudspersonit në Kosovë,  
ruga “Agim Ramadani” (ish ndërtesa “Kosovodrvo”) 10000 Prishtinë

Tel: +38138 501 401/545 303,

**Linja urgjente:** +38138 548 087

**Fax:** +38138 545 302

**Posta elektronike:**

ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org

**Web faqja:**

www.ombudspersonkosovo.org

**ZYRET NË TERREN**

### **60000 GJILAN:**

---

Rruga 28 nëntori

Ndërtesa e Komunës II

Tel: +38 (0)280 20 843

Kryesues i zyrës: z. Goroljub Pavić

### **30000 PEJË:**

---

Sheshi i Republikës,

(ish ndërtesa 17 nëntori) I

Tel: +381(0)39 32 931

Kryesuese e zyrës: znjsh:

Iliriana Çollaku

### **40000 MITROVICË:**

---

Rr. “Mbretëresha Teuta”,

pn, Zona e sigurimit

Tel:+381(0) 28 30 138

Kryesues i zyrës: z. Naim Krasniqi

### **40000 NËN-ZYRE NË MITROVICË:**

---

Aneksi i Trepçës,

Rr. Filip Vishnjica 4

Juriste: znj. Miljana Sćekić

Tel: 063 917 44 79; 044 393 181

### **20000 PRIZREN:**

---

Rr. “Mosha Pijade”

OSCE, II, nr. 20

Tel: +381 (0) 29 44 200, ext-109

Kryesues i zyrës: UD. Hunaida Pasuli

### **10000 GRAÇANICË:**

---

Tel: +381(0) 63 73 8 73 73

+381(0)38 64 606

Kryesues i zyrës:

znjsh. Aleksandra Dimitrijević

**Për të drejtat tuaja!**



